



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 6, 7 dhe 8 SHTATOR 2010**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
6. 7. i 8. SEPTEMBRA 2010. GODINE**

**SHTATOR – SEPTEMBAR
2010**

E hënë, 6 shtator 2010, ora 10:00

Drejton mbledhjen: anëtari i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj që në sallë janë të pranishëm 55 deputetë dhe konform Rregullores, kushtet janë të përmbushura që të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që është:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Në bazë të nenit 47.3 të Rregullores së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në 3 minuta.

Po fillojmë. Sipas radhës, është paraqitur deputeti Riza Smaka. E keni fjalën, zoti deputet.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues,

Të nderuar zotëri zëvendëskryeministra, ministra, deputetë të respektuar,

Shqetësimi i imi është, jam i bindur jo vetëm i imi, fakti, kisha pasur dëshirë të mos ishte fakt, që një numër i madh i aktgjykimeve të formës së prerë, konsiderohet përafërsisht 100 mijë raste gjyqësore dhe një numër po aq siç është enorm i aktvendimeve të formës së prerë që nuk përmbahen, nuk ekzekutohen edhe kjo është kjo, do të thotë ligji nuk zbatohet se, fundi i fundit, aktvendimi, aktgjykimi është titullus ekzekutivus që e obligon prej presidentit të Republikës deri te cilido qytetar i Kosovës. Kjo është gjendje lamentuese dhe vajtuese, do të thotë nuk funksionon ekzekutivi. Numër i madh i ministrave janë të cilët nuk i ekzekutojnë aktvendimet e formës së prerë. Zotëri kryesues, kjo është një çështje.

Çështja tjetër është po asisoj vazhda e uzurpimeve të tokave jo ndërtimore, të cilat mbulohen me objekte joproduktive pa kurrfarë shanse për të qenë produktive apo të dobishme, po edhe të ishin ndërtohen mbi tokat që nuk janë ndërtimore dhe vazhda e pandërprerë e uzurpimeve, e prirjeve arbitrare të pyjeve, devastimi i natyrës në mënyrë frontale, del se nuk funksionon ekzekutivi. Kam dëshirë që këto të mos jenë shqetësime të ardhshme, po t'i marrë Qeveria me shumë seriozitet edhe këtu nuk ka kurrfarë as mjeshtërie, as teknike, se e ka infrastrukturën, vetëm vullneti i mirë edhe këto do t'i përmbahen. Është fjala për aktvendimet të cilat nuk përmbahen, ndërsa për aktgjykimet është çështje tjetër që i apeloj edhe i adresoj dhe i aludoj Këshilli Gjyqësor i Kosovës që këtë çështje ta marrë në pikën e parë të rendit të ditës për ta trajtuar dhe për ta performuar. Ju falënderohem!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputeti Ismail Kurteshi.

ISMAIL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Unë desha këtu ta ngrejë një shqetësim që, po ashtu, mendoj që s'është vetëm i imi. Këtë vit gjatë muajit gusht, sidomos, por kjo ka ndodhur edhe viteve tjera, anembanë vendit janë shkaktuar plot zjarre nëpër fusha të cilat kanë filluar qëllimisht ndoshta nga pronarët e tokave ose nga dikush tjetër,

por mandej ato nuk janë kontrolluar dhe kanë shkaktuar shumë dëme jo vetëm në fusha, por edhe në malet tona. Nuk është vërejtur angazhimi ose reagimi që të pengohen zjarret dhe dëmet nga to, as nga nivelet komunale, në pjesët ku unë jam i informuar, por as nga niveli qendror. Prandaj, apeloj që në të ardhmen institucionet përkatëse të ndërmarrin masa që të pengojnë ndezjen e zjarreve dhe sidomos të pengojnë dëmet që ato mund t'i shkaktojnë në pyjet tona. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit zoti kryesues!

Kolegë të nderuar deputetë,

Çështjen që do ta ngrejë sot ka të bëjë me pyjet e Kosovës dhe me prerjet ilegale të drunjve. Përsëri erdh shtatori, vijnë përgatitjet për dimër dhe problemi i prerjes ilegale të drunjve vazhdon të përsëritet. Dihet se shumë familje në Kosovë, qofshin ato rurale apo urbane, për nevojat të ngrohjes përdorin si burim energjinë e drurit, pasi që mundësitë alternative dhe më të lira janë të kufizuara.

Sipas të dhënave të Agjencionit të Pyjeve të Kosovës, ky agjencion për disa vite me radhë ka arritur që të planifikojë prerje vjetore të drunjve, që ka të bëjë domethënë për djegie dhe për teknikë, vetëm rreth 250 mijë metër kub. Nga kjo sasi e planifikuar, ka arritur të realizohen rreth 200.000 metër kub, që në fakt paraqet 20% të potencialit që ofrojnë pyjet tona dhe, njëkohësisht, me këtë sasi përmbushen rreth 20% të nevojave të familjeve që konsumojnë dru. Nga kjo del se pjesa tjetër e nevojave të qytetarëve plotësohet nga prerjet ilegale. Sipas mendimit të ekspertëve të kësaj fushe, planifikimi dhe realizimi i prerjeve vjetore prej 900 mijë m³, sa vlerësojnë ekspertët potencialin që mund të ofrojnë pyjet tona dhe nxjerra e tyre në treg do ta ulëte sasinë e prerjeve ilegale. Pra, zgjidhja e problemit të prerjeve ilegale të drunjve mund të arrihet nëse institucionet tona bëjnë planifikimin dhe realizimin e prerjes së sasisë së lejuar vjetore të masës drunore, që sipas mendimit të ekspertëve është 900 mijë m³ drunj industrialë dhe drunj zjarri. Parashtrohet pyetja se a kanë gatishmëri dhe a kanë kapacitet institucionet tona të bëjnë planifikimin dhe realizimin e prerjes së sasisë së lejuar të masës drunore që parashohin ekspertët të kësaj fushe. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Ju njoftoj që në sallë janë 72 deputetë.

Sipas radhës, fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndër shqetësimet e shumta po edhe dështimet e shumta të kësaj Qeverie, unë sot do ta ngrejë shqetësimin të cilin e ka Lidhja Demokratike e Dardanisë në lidhje me qytetarët të cilët kërkojnë kompensimin e pronave nëpër të cilat prona po kalon infrastruktura rrugore.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe Ministria e Telekomunikacionit arsyetohen se në mungesë të ngritjes së kapaciteteve të vlerësimit të pronave për shpronësim kanë marrë një firmë për këtë çështje, domethënë duhet ta kemi parasysh se Ligji për shpronësim tashmë është i aprovuar në vitin 2009, diku në fillim të vitit 2009 dhe këto dy ministri ende nuk kanë mund të ngrehin kapacitete për vlerësimin e pronave dhe arsyetohen se kanë marrë një firmë për këtë çështje dhe, realisht, sot kur qytetarët me të drejtë kërkojnë kompensimin e pronave të tyre, këto dy ministri arsyetohen duke e hedhur fajin te kjo ndërmarrje që e kanë marrë vetë për t'i vlerësuar këto prona. Kjo gjë është tërësisht e pa drejtë dhe e pa pranueshme, kur ne e dimë se prona është e shenjtë dhe

natyrisht se tashmë Kosova ka legjislacion dhe kjo çështje na jep për të kuptuar se këtu është ngritur një grup i interesave dhe ka manipulime të ndryshme edhe në vlerësim, edhe në kompensim.

Në bazë të kësaj, për të mos e zgjatur shumë, Lidhja Demokratike e Dardanisë kërkon nga auditori gjeneral që ekskluzivisht të bëhet auditimi i të gjitha pronave nëpër të cilat po kalon ndërtimi i rrugëve apo infrastruktura rrugore në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ky fillim i sesionit vjeshtor mendoj se duhet të përcillet me një reflektim në gjendjen në të cilën jemi, me pikat referente me gjendjen e cila ka ekzistua një vit më përpara. Mendoj se është e radhës që Kuvendi të paktën t'i nxjerrë disa pika dhe të shoh se ku është sot Kosova në krahasim me periodhat e kaluara, po them, në mënyrë që edhe në të ardhmen, pas një viti, pas një periudhe kohore të mund të reflektoj dhe ta shoh se ku gjendet Kosova, do të thotë me pika krahasuese.

Duke krahasuar këtë vit me vitin e kaluar, do të thotë para një viti, ose edhe me fillimin e vitit të kaluar, janë disa elemente të cilat po na përcjellin dhe të cilat duhet të nënvizohen, mendoj unë.

E para është se, keni lexuar nëpër raporte të institucioneve relevante se këtë vit, në krahasim me vitin e kaluar Kosova është 12 vende më poshtë në listën e vendeve joshëse për investimet e huaja. Janë institucionet ndërkombëtare kredibile që i nxjerrin këto lista edhe kjo duhet të jetë shqetësuese, por askush nuk po flet. Dikush thotë që ndoshta është çështje e krizës globale, po ju them, listat janë krahasuese dhe krahasohen me vendet tjera, e kriza globale i ka ndikuar të gjitha vendet, jo vetëm Kosovës. Do të thotë, nëse vendet të cilat janë ndikuar nga kriza globale janë ngritur në listë, e Kosova që po ashtu është ndikuar deri diku nga kriza globale, ka rënë në listë, atëherë Kosova duhet të shikojë se ku janë problemet dhe të provojë t'i adresojë të paktën, Qeveria e Kosovës, ekzekutivi. Duhet të shohim, për shembull, se qysh ka ndodhur që për herë të parë në histori të veten na dalin raporte se Kosova blen qymyr. Dikush duhet t'i tregojë popullit të Kosovës qysh mund të ndodhë që shteti i cili ka rezervat më të mëdha të qymyrit në Evropë dhe ndoshta ndër 4 vendet me rezervat më të mëdha të qymyrit në botë, importon qymyr. Kjo është një çështje të cilën Qeveria duhet ta adresojë për të mos folur për 24 orë rrymë, të cilën duhet ta adresojmë për shkak se ka qenë premtimi më i madh parazgjedhor i kësaj qeverie aktuale, premtim i cili ma merr mendja që edhe ju dhe të gjithë qytetarët e Kosovës jeni dëshmitarë që nuk është as afër të plotësohet për shkak se ndërtimi i kapaciteteve as që ka nisur.

Brenda 3 viteve të qeverisë, më pak se 3 vjet qeverisje ose mund të themi edhe ta shohim, ta bëjmë një prerje këtu, vlera nominale e përlllogaritur e Postës dhe e Telekomit të Kosovës prej 1 miliard euro ka rënë në 300 milionë euro, ajo që llogaritet. Edhe kjo është një e arritur që ne duhet të bisedojmë, duhet të flasim, Kosova duhet të flet për këto çështje, duhet ta ngritë zërin, se nuk bën të heshtë.

Kemi problem edhe me demokracinë, realisht. Nuk e di çka duhet më tepër të themi për demokracinë dhe për sundimin e ligjit, për kushtetutën edhe për dhunimin e kushtetutës, se nëse e përmendim fjalën Rahovec, mendoj se Rahoveci ka për t'u shënuar në historinë e Kosovës si një ndër rastet më banale, ku në mënyrën më brutale, në mënyrën më qesharake të mundshme, pa asnjë konsideratë të

vetme është shkelur kushtetuta e vendit, mos të flasim edhe për shkelje të vazhdueshme të kushtetutës nga ana e presidentit të vendit. Kjo është gjendja në të cilën është Kosova sot.

Flasim për ekonominë, kemi dëgjuar rritje 6%, rritje 7%, tash dëgjojmë që është 4, nuk ka qenë as 6, as 7, po ka qenë 4. E përmenda, 12 vende më poshtë në rangimin e vendeve të cilat joshin investimet e huaja dhe shohim që papunësia në Kosovë po rritet edhe në aspektin relativ dhe në atë absolut. Kjo do të thotë që jo vetëm që numri i të papunëve po rritet, realisht për shkak se një numër i madh të rinjve hynë në tregun e punës, por po rritet edhe përqindja për shkak se rritja ekonomike nuk korrespondon as për së afërmi me nevojat e Kosovës për krijimin e vendeve të punës dhe prapë ne na thuhet që Kosova është një vend i suksesshëm, që Kosova po ecë përpara.

Një çështje tjetër tepër serioze për ne është Raporti i fundit i ICG-së. Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, në raport të ICG-së citohet një zyrtar i lartë i Qeverisë së Kosovës t'i ketë thënë grupit se Qeveria e Kosovës pajtohet që në veri të Kosovës të ketë legjislativ dhe ekzekutiv. Të gjithë ne në Kuvend të paktën e dimë çka do të thotë kur një njësi territoriale ka legjislativ edhe ekzekutiv, flasim për të paktën për autonomi dhe askush në Kosovë nuk pyet kush ka thanë, kë e ka pyetur, në emër të kujt ka folur, kush po pajtohet me këtë dhe ku po dinë këta çka po lyp Serbi në shkëmbim për njohje, shembull. E keni në raport, kush të dojë mund ta lexojë raportin.

Çështje tjetër është diçka që është tepër befasuese. Ju e dini që një ish kryeministër i Kosovës dhe një lider i opozitës është në Hagë, po pret rigjykimin dhe EULEX-i ka dërguar letër mbështetëse. Ka qenë dashur ndoshta që edhe institucionet e Kosovës të paktën ta mbështesin EULEX-sin që po e mbështet kthimin e ish kryeministrit Haradinaj.

Në fund, po ju them një citat të një ish presidenti amerikan, nuk është Washingtoni, është Linkolni, i cili ka thënë një farë shprehje që nuk po e them në anglisht, po në shqipe të përkthyer, ma merr mendja mirë, që "heshtja në kohën kur duhet të protestojmë, është ai mëkati që i shndërron burrat në yqarë". Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti, në emër të grupit parlamentar.

SABRI HAMITI: Zoti kryesues,

Zotërinj ministra, zotërinj deputetë, kolegë,

Sot po nisim faktikisht sesionin vjeshtor të punës së Kuvendit me një punë të fortë obligimi në zhvillimet edhe politike, edhe demokratike brenda në vend, po gjithashtu edhe me zhvillime të jashtëzakonshme politike rreth Kosovës, jashtë.

Mendoj që është e udhës dhe këtë do ta them në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, që janë disa muaj që do të kërkojnë edhe përqendrim, edhe përgjegjësi të jashtëzakonshme për grupacionet që janë në Kuvendin e Kosovës, në mënyrë që organi ynë që ka fuqinë edhe kontrolluese të qeverisë, edhe detyrën legjislativ, ta kryejë punën e vet me efikasitet shumë më të madh se në sesionin pranveror.

Pikë së pari, është pika legjislative. Ne edhe sot në rend dite kemi 13 ligje në leximin e parë dhe pritët që do të kemi edhe një ritëm të tillë të ligjeve që kanë të bëjnë ose me nevojat të brendshme të rregullimit të lëmive të ndryshme në Kosovë, ose me ato që quhen obligime në komunikime demokratike ndërkombëtare të Kosovës, kështu që Kuvendi me siguri do të punojë me orare të tjera brenda javës. Këto ligje kanë të bëjnë edhe me politikën e brendshme edhe të jashtme, thashë, të

Kosovës dhe është mirë definitivisht të thuhet këtu që të ketë një konkordim shumë, shumë më të mirë në mes Qeverisë, si propozues i ligjeve, dhe Kuvendit, sidomos për ato të cilat janë të domosdoshme që të kalojnë në periudha të caktuara.

Në vendin e dytë vjen problemi i asaj që quhet kontroll i Qeverisë. Kuvendi e ka detyrë dhe duhet ta marrë këtë detyrë fuqishëm në këtë sesion, që ta kryej detyrën e kontrollit të qeverisjes. Kur flas këtu, nuk mendoj veç pozitë – opozitë, por edhe në venerimet individuale të deputetëve që janë të vlefshme qofshin të pozitës, të opozitës.

Dhe, ajo e treta, për të cilën ne flasim shpesh edhe në Kryesi, po edhe në grupet parlamentare, ka tema të rëndësishme të jetës sociale, politike dhe ekonomike në Kosovë të cilat donë një shqyrtim të nivelit të debati në Parlament. Është mirë që ky Parlament të jetë i hapur për debate të tilla, sepse ato në të vërtetë reflektojnë çfarë kërkon shoqëria përtej një organizimi përfaqësues. Kjo ka të bëjë me tema edhe politike, edhe sociale, edhe ekonomike. Dhe, në fund, Kuvendi vetëm në këtë mënyrë mund të mbrojë vendimet e veta që i ka marrë këtu dhe që nuk do të lejojë që vendimet e tij të merren përkëmbë në vendimmarrjet e ngushtuara. Këtu u përmendën disa probleme. Ne kemi vendimmarrje të ngushtuara, edhe ekonomike, edhe politike, të cilat bëhen ekzekutive pa marrë miratimin e Kuvendit. Kuvendi merr ngjyrimin e vet përfaqësues dhe obligimet e veta kushtetuese nëse vendimet e veta i merr dhe i përcjell deri në ekzekutimin e tyre ose nëse ato vendime nuk ekzekutohen, atëherë rikthehet dhe i bën çështje nacionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Unë në vazhden e shqetësimeve që u ngritën këtu rreth respektimit ose mosrespektimit të ligjeve, do të ngrejë një çështje pak më konkrete rreth anarkisë institucionale që është duke ndodhur në pushtetin vendor, konkretisht në Prizren. Nëse ju kujtohet, unë pikërisht në këtë sallë kisha kërkuar nga kolegët deputetë kur është bërë miratimi i rishikimit të buxhetit të konsoliduar të Kosovës që mos të miratohet pozicioni buxhetor i komunës së Prizrenit, sepse nuk i ka kaluar procedurat. Një javë pasi është miratuar ai buxhet, domethënë ministri i Pushtetit Lokal e ka njoftuar kryetarin e komunës se miratimi i buxhetit në Prizren duhet të kalojë nëpër procedurë. Në të njëjtën kohë veç ky parlament e kishte miratuar. Unë atëherë kisha kërkuar me qëllimin më të mirë që ne t'i disjplinojmë institucionet për respektim të ligjit dhe, për befasinë e këndshme, edhe Heqa ishte përkrahës i imi, por me gjasë në atë moment ai kishte votuar papë me të veten.

Gjithsesi, shkeljet ligjore janë edhe më të rënda nga kjo që po them, sepse atje kemi një asamble të qytetit, e cila më shumë se 6 muaj s'ka mbajtur mbledhje, kemi shkeljen e Ligjit dhe qeverisjes lokale. Në një takim krejt rastësishëm në hollin e Kuvendit me ministrin rreth këtyre shqetësimeve, ministrin e Pushtetit Lokal, thotë ia kam dhënë një shans. Unë mendoj se koha e qeverisjes vendore të kohës së Ahmet Zogut në Myzeqe, domethënë me ato prefekturat që Maliqi e bënte vetë ligjin si donte, ka përfunduar dhe në këtë rast unë ngrejë këtë shqetësim në kuadër të asaj që faktikisht ne si institucion më i lartë për nxjerrjen e ligjit, duhet të kërkojmë edhe të zbatohet ligji. Ne jemi dëshmitar të asaj që i pari vend nuk e zbaton ligjin dhe kushtetutën, por gjithsesi ky parlament mendoj se e ka për nderë, por edhe për obligim që në këtë drejtim të marrë masa përmes mekanizmave të vet, siç janë edhe komisionet parlamentare, që faktikisht ligjet që i nxjerrim ne, që pritet sidomos sot të nxjerrim shumë ligje, duhet të mendojmë se a do të zbatohen ato ligje apo veç ne jemi duke bërë rendin edhe thjeshtë ta kalojmë kohën në Parlament. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Përshëndetje, kryesues!
Përshëndetje, zëvendëskryeministra, ministra!

Unë do ta ngrejë një çështje të cilën shtetet demokratike të Evropës vetëm që ka vite që festojnë këtë ditë prej viteve '90, 23 gushtin - Ditën e dënimit të krimeve totalitare dhe autoritare. Ndërsa, 23 gushti në Kosovë, që edhe Kosova i ka përjetuar pikërisht këto krime, nuk është parë e arsyeshme as nga Qeveria, as nga Kuvendi, nga askush, të paktën ta ngrejë zërin, një përkujtim që edhe Kosova t'iu bashkëngjitet shteteve demokratike pikërisht kundër dënimit të krimeve të komunizmit edhe të totalitarizmit.

Ndërsa, çështjen tjetër të cilën unë dua të ngrejë, është për ministrin Enver Hoxhaj, është që Universiteti i Prizrenit në cilin hap është, a janë bërë përgatitjet dhe a do të filloj më 1 tetor.

E dyta e kësaj çështjeje është, në Prizren është ngritur çështja këtu se a do të ketë Fakultet të Edukimit. Nëse po, a është në përgatitje apo jo? Unë këto desha t'i ngrejë, ndërsa për çështjen e pushtetit lokal, që e ngriti edhe kolegu, është që në javën e kaluar pushteti lokal ka mbajtur mbledhje në seancën e asamblesë atje edhe ka pasur kuorumin e mjaftueshëm, që mendoj se është legale jo 6 muaj, por javën e kaluar ka mbajtur mbledhje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra, të dytë qenkeni këtu,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,

Para disa ditëve, e dimë që Rektorati i Universitetit të Prishtinës ka marrë një vendim, vendimi i fundit është për ngritjen e semestrave për studentët tanë. Dhe, të nderuar deputetë, siç e dini, në Universitetin e Prishtinës më së shumti kemi studentë nga kategoritë - fëmijë të mjekëve, fëmijë të arsimtarëve, të mësuesve dhe fëmijë të njerëzve të cilët punojnë në institucionet publike. Ju e dini shumë mirë se sa është paga mesatare e këtyre kategorive. Ndërsa, në anën tjetër, Universiteti i Prishtinës, Rektorati konkretisht ngritë semestrin për këta studentë. Unë e lus ministrin e Arsimit, zotin Enver Hoxhaj që të marrë një vendim dhe mos ta lë këtë vendim pezull, sepse deri më tani ende nuk e dinë studentët se sa do të paguajnë. Ju e dini që semestri për studentë është ngritur afër 80%, andaj duhet mos t'i krahasojmë studentët tanë me studentët e vendeve të tjera, sepse nëse e shihni, në vendet tjera demokratike studentët kanë mundësi edhe të studiojnë edhe të punojnë, ndërsa në vendit tonë studentët tanë nuk kanë mundësi të punojnë, shumica prej tyre nuk kanë mundësi të punojnë, njëkohësisht edhe të studiojnë. Duke e marrë parasysh një zhvillim jo të mirë ekonomik për vendin tonë, duke marrë parasysh që papunësia është jashtëzakonisht e madhe dhe nuk është në nivelin e lëvizshëm apo të ngritjes së punëve aty të cilët punësohen, duhet të keni konsiderata që këtë vendim ta anuloni dhe ju bëj thirrje që vendimi të mos vlejë për studentët e Universitetit të Prishtinës. Nëse jeni bazuar në atë që keni marrë shumë studentë dhe keni ngritur numrin e studentëve sivjet, atëherë kjo është edhe një arsye më shumë sepse nuk është dashur të ngrihet semestri për ta. Në momentin kur ju iu krijoni kushte studentëve tanë që të punojnë, atëherë është shumë e logjikshme që të kërkonin nga ata që ngritja e semestrit të jetë e arsyeshme. Me këtë klimë politike ne nuk po shohim politika krijuese për këto kategori, sidomos për kategoritë që i përmenda

prej nga vinë studentët të cilët aderojnë në Universitetin e Prishtinës. Kemi edhe universitete private, mirëpo studimet e tyre kanë jashtëzakonisht kosto të lartë, ndërsa ju e dini shumë mirë që politikanët dhe biznesmenët i dërgojnë fëmijët e tyre atje. Ndërsa, këto kategori të cilët i përmenda, këto i dërgojnë në Universitetin e Prishtinës.

Zoti ministër, besoj që e keni marrë porosinë time, besoj që është kërkesë e të gjithë deputetëve, sepse nuk jemi në një klimë ku duhet të ngrihet semestri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

I fundit, deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë na kanë arritur dy shqetësime që kanë të bëjnë me dy çështje të ndryshme dhe zona të ndryshme të Republikës së Kosovës. Në cilësinë edhe të deputetit, por edhe kryetarit të Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, ngrejë shqetësimin e disa banorëve të fshatrave të komunës së Pejës, të Klinës dhe në veçanti të Rahovecit për degradimin enorm të brigjeve të lumi Drini i Bardhë, i cili po ndodhë me vite të tëra nga eksploatuesit e pandërgjegjshëm të zhavorrit, të cilët kemi parë në pranverën e këtij viti, vërshimet që kanë ndodhur sidomos në komunën e Klinës dhe të Rahovecit, ku janë dëmtuar mijëra hektarë prona, objekte afariste dhe po rrezikohet jeta e qytetarëve. Andaj, duke e parë një aero-fotografim që është bërë nga KFOR-i dhe ka qenë edhe në mediat elektronike të Kosovës, kërkojmë nga Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, por edhe nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale që vërtet të shikojë me vëmendje se kujt po i jep leje, pse nuk pengohen ata eksploatues të pandërgjegjshëm që punojnë pa leje atje, e degradojnë ambientin dhe rrezikojnë pronën dhe jetën e qytetarëve.

Shqetësimi i dytë është për fshatin Tërstenik apo Qendresa e sotme, nga komuna e Drenasit, me 178 shtëpi, 3250 banorë, të cilët që nga qershori i vitit 2002, edhe pse kanë participuar për ujësjellës, kanë marrë leje nga Ujësjellësi rajonal i Batllavës, ende nuk e kanë asnjë pikë ujë. E keqja e kësaj është që edhe nxënësit e shkollës fillore “Zenel Hajdini” të atij fshati po ashtu përballen me këto probleme, që janë elementare për të vazhduar procesin e arsimit. Pastaj, është për t’u theksuar shqetësimet e qytetarëve të këtij fshati që vendosja e shtyllave elektrike, të cilat janë vendosur me vite, ende nuk kanë sjellë fluksin e ri të elektrifikimit atje. Pastaj, është participuar nga fshati me 12 mijë euro për rrugën dhe kanalizimin e ujërave të zeza dhe asgjë që nga viti 2007 nuk ka lëvizur.

Andaj, kërkojmë nga institucionet komunale atje, e në veçanti nga institucionet qendrore që ndërlidhen me këto projekte, që t’ju dalin në ndihmë për këto nevoja elementare qytetarëve të fshatit Tërstenik. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Konstatoj që koha e paraparë me Rregullores është konsumuar.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, që është:

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mbajtura më 15, 22, 23 dhe 27 korrik 2010

Të nderuar deputetë,

Pyes, nëse keni vërejtje në këto procesverbale? Nuk ka vërejtje. Atëherë, konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 15, 22, 23 dhe 27 korrik 2010.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputetët për një mbledhje mund të parashtrojnë më së shumti dy pyetje. Sipas radhitjes që është bërë, deputeti Abdyl Ymeri, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra, kolegë deputetë,

E drejta për ujë të pijshëm është e drejtë elementare dhe e pacenuar. Nga donatorë të ndryshëm dhe komunat janë ndërtuar projekte të shumta të ujësjellësve nëpër ato fshatra ku ka pasur burime të ujit, por problemi kryesor është menaxhimi, funksionimi dhe përmbajtja e tyre sepse kjo nuk është e rregulluar mirë me ndonjë rregullore apo udhëzim e as me Ligjin ekzistues për ujëra.

Pyetja: zoti ministër, ju dhe ministria që e drejtoni a keni një strategji apo plan të veprimit që do ta rregullonte këtë çështje edhe në pikëpamje ligjore, sepse në tërë territorin e Kosovës është një numër shumë i madh i këtyre ujësjellësve të ndërtuar në zonat rurale, që nuk kanë menaxhim adekuat.

KRYESUESI: Ministri e ka fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryesues,

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

I nderuari deputet Abdyl Ymeri,

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, në kuadër të Ministrisë ekziston Departamenti i Ujërave. Por, gjithashtu, ne jemi në fazën e hartimit të strategjisë për ujëra, gjithashtu është edhe Ligji i ri për ujërat, në Parlament ka kaluar në leximin e parë dhe do të procedohet më tutje. Sa i përket çështjes së projekteve nëpër fshatra dhe vendbanime të tjera, ekzistojnë shumë projekte në të cilat investon edhe Ministria, por edhe ministritë tjera. Nga aspekti i menaxhimit, për këto çështje është përgjegjëse Ministria e Ekonomisë dhe Financave për ndërmarrjet publike, për ujësjellësit. Për aspektin e cilësisë së ujit është përgjegjës Instituti i Shëndetit Publik, po ne sigurisht do të tentojmë përmes strategjisë edhe të ligjit të rregullojmë infrastrukturën ligjore. Sa i përket menaxhimit, janë kompetencat në instanca tjera.

KRYESUESI: Zoti Ymeri, e ka fjalën, pyetje shtesë.

ABDYL YMERI: Zoti ministër,

Unë e di që ekziston Departamenti i Ujërave në kuadër të Ministrisë dhe më intereson në kuadër të këtij departamenti a ka shënime, sa është numri i këtyre ujësjellësve, në çfarë gjendje janë, dhe çka do të ndërmerret në të ardhmen me qëllim që këto të jenë funksionale dhe të menaxhuara mirë. Është pak ndoshta një ngatërrim, sepse në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave ata i kanë, kryesisht i menaxhojnë ujësjellësit regionalë, kurse ujësjellësit nëpër fshatra nuk i kanë në kompetencë për t'i

menaxhues dhe është ky një problem në mes të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Mjedisit. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Po, edhe një herë falënderoj!

Ashtu, vërtet është ashtu, por ne jemi duke tentuar të realizojmë ose të bëjmë zgjidhje përmes strategjisë edhe ligjit të ri, por besoj që në të ardhmen prapë do të krijohen probleme në qoftë se nuk rregullohet fushëveprimi i të gjitha ndërmarrjeve publike edhe regjionale, por gjithashtu edhe komunale. Por, besojmë që me strategjinë edhe me ligjin e ri do të bëjmë zgjidhje edhe për këto çështje ose këtë problematikë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Bujar Dugolli, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, kryesues!

Që nga viti 2005, në atë kohë Ministria e Tregtisë, Industrisë, në bashkëpunim me agjencinë donatore, Agjencioni Evropian për Rindërtim dhe Zhvillim, kishte bërë një projekt për ndihmën e komunave të marginalizuara. Si rezultat i kësaj, në atë kohë ishte bërë një projekt që të ndërtohet një zonë industriale, një park i biznesit në komunën e Drenasit dhe kishte vazhduar projekti i tillë. Kohëve të fundit ne shohim se ky projekt ka pësuar disa degradime sa i përket ndërtimit të objekteve tjera përcjellëse që do t'i hynin në plan pune Parkut të biznesit në Drenas. Fjala është konkretisht për Institutin e Ndërtimit dhe Institutin e Industrisë Kimike, për të cilat ishin përfunduar projektet dhe papritmas marrim informacion se këto projekte janë zhvendosur që të bëhen në një lokacion në komunën e Prishtinës, në Bërnice. Ngjashëm është vepruar edhe me Parkun apo Qendrën e Panairit, që kishte pasur për qëllim të ndërtohet atje. Duke ditur që ky vend ishte shumë strategjik, ishte në mes të Kosovës, ka infrastrukturë rrugore, është afër KEK-ut, është afër Aeroportit, ka mundësi të investimeve të huaja, unë i kam bërë pyetje ministrit se pse, për çfarë arsye është ndërruar ndërtimi i këtyre lokacioneve dhe sa është kostoja buxhetore për shkak të ndërrimit të këtyre lokacioneve dhe bartja në lokacione tjera. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Zharku, e keni fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryesues,

Zëvendëskryeministra, kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti deputet,

Ngritja e infrastrukturës së cilësisë përmes krijimit të institucioneve dhe infrastrukturës fizike është një ndër prioritetet dhe orientimet e Qeverisë me qëllim të implementimit të Ligjit për kërkesa dhe vlerësim të konformitetit, si dhe të Ligji për sigurinë e produkteve. Një nga këto fusha është edhe ngritja e laboratorëve, gjegjësisht instituteve. Për këtë qëllim, ne gjatë vitit 2008 dhe në fillim të vitit 2009 kemi iniciuar dhe përfunduar projekte për Institutin e Ndërtimit dhe Laboratorin e Industrisë. Këto dy objekte kanë filluar së ndërtuari në ... të vitit të kaluar dhe pritet që të përfundojnë në gjysmën e parë të vitit të ardhshëm.

Sa i përket çështjes së ngritur nga ju, më lejoni të sqaroj si kryesues i Bordit menaxhues të Parkut Industrial të Drenasit ne nuk kemi gjetur në Ministri, gjegjësisht në Agjencionin për ndërmarrje të vogla dhe të mesme kurrfarë vendimi se këto dy objekte ka qenë e paraparë të ndërtohen në Parkun Industrial të Drenasit. Po ashtu, edhe në takimet e rregullta të mbajtura gjatë kryesimit tim, asnjëherë

nuk është shqyrtuar mundësia e vendosjes së këtyre objekteve në Parkun Industrial të Drenasit, duke u nisur nga vetë qëllimi i ndërtimit të parkut, e që është krijimi i infrastrukturës fizike për biznese prodhuese, të cilat do të ndikojnë në rritje të punësimit dhe të industrisë. Ashtu siç e ceka edhe më lartë, këto dy projekte janë iniciuar dhe ka filluar realizimi i tyre gjatë kohës së udhëheqjes sime me Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë, prandaj nuk qëndron pohimi i juaj se ka qenë e paraparë të ndërtohen në Parkun Industrial të Drenasit.

Në mbështetje të kësaj, më lejoni të theksoj se termit e referencës për Laboratorin e Industrisë janë kryer më 18 korrik 2008, kurse për Institutin e Ndërtimit janë kryer më 10 shtator 2008. Projektet kryesore për këto objekte janë përfunduar në fillim të vitit 2009. Prandaj, nuk është bërë kurrfarë zhvendosje e këtyre objekteve pasi që nuk ka pasur kurrfarë projekti për ta dhe që nga fillimi është paraparë ndërtimi i tyre në kryeqendrën e Kosovës, gjegjësisht në Prishtinë, duke marrë parasysh edhe vetë natyrën e këtyre objekteve. Natyrisht që këtu nuk kemi të bëjmë me kurrfarë kostoje shtesë buxhetore, përkundrazi, ngritja e tyre në Prishtinë do të bëjë shumë më të lehtë operimin e tyre.

Më lejoni që me këtë rast të ju falënderoj komunën e Prishtinës për gatishmërinë e treguar për ndarjen e dy parcelave nga 80 ari. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Keni pyetje shtesë, zoti Dugolli? Deputeti Dugolli e ka fjalën.

BUJAR DUGOLLI: Zoti ministër, ka pasur përpjekje domethënë nga ju që t'i ndërroni arsyet, ju i dini pse i keni ndërruar. Shkresa e 24.10.2008, kur është formua komisioni për ta hartuar projektin dhe mbikëqyrjen e Institutit të Produkteve të Ndërtimit në Parkun e Drenasit, ka emër dhe mbiemër dhe si është bërë ky komision. Mandej, shkresa tjetër më 6.03.2009, ku është ndarë kërkesa për lejen e ndërtimit edhe nga komuna e Drenasit. Këto janë të argumentuara, domethënë organet kompetente duhet t'i vlerësojnë se ka pasur apo s'ka pasur kosto. Dihet që një projekt kur bëhet për një lokacion dhe i ndërrohet destinomi, ka kosto buxhetore sepse përshtatja në një lokacion tjetër, i cili s'ka qenë as i urbanizuar, as me infrastrukturë, siç është Bërnica e Prishtinës, i shkakton dëme buxhetit të Kosovës. Mandej, ju në vend që të përgatiteni për ta bërë një bazë ligjore për themelimin ...

KRYESUESI: Faleminderit!

E keni fjalën ministër Zharku.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Më duket se isha i qartë, termit e referencës në bazë të cilave punohet projekti janë bërë në kohën time. Projektet janë bërë në kohën time, kështu që nuk qëndron ajo se ka pasur projekte në kohën e juaj që i keni bërë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Sipas radhës, deputetja Gjylnaze Syla e ka fjalën.

Regjia, deputetes Gjylnaze Syla, fjalën. S'po dëgjojnë, si duket. Urdhëroni këtu në foltore.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Pyetja ime i drejtohet ministrit të Ekonomisë dhe të Financave, zotit Ahmet Shala, e cila ka të bëjë me nënshkrimin e kontratës para se të sigurohen mjetet financiare për ndërtimin e autostradës Morinë – Merdarë. Me ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, nga Buxheti i Republikës së Kosovës për projektin kapital, ndërtimin e autostradës Merdare – Morinë janë

aprovuar 20.500.000 euro. Me ndryshimin e këtij ligji në muajin korrik me, rishikimin pra të njëjtit projekt kapital, është aprovuar buxheti prej afërsisht 124 milionë euro. Po ashtu, kontrata për ndërtimin e autostradës Morinë – Merdare është nënshkruar më herët nga përfaqësuesi i Komitetit ndërministror për autostradën Morinë – Merdarë, që do të thotë nga ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit dhe përfaqësuesit të Konzorciumit Bechtel - Enka, më saktë më 12 prill të këtij viti. Nga kjo rrjedh se kontrata është nënshkruar pa u siguruar mjetet financiare për ndërtimin e autostradës.

Zoti ministër,

Pse është bërë nënshkrimi i kontratës para se të sigurohen mjetet për realizimin e projektit të ndërtimit të autostradës Morinë – Merdarë?

KRYESUESI: Zoti ministër Shala, e keni fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar zoti kryesues,

I nderuar zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete, Syla,

Së pari më lejoni që t'i uroj gjithë Kuvendit një fillim të mbarë dhe besoj që do të arrijmë të kemi një bashkëpunim të shkëlqyer, sikurse deri më tani.

Më lejoni që të përgjigjem në pyetjen e juaj. Përgjithësisht, për kontratat shumë vjeçare Ligji i prokurimit parasheh mundësinë për fillim të procesit të prokurimit me të cilin krijohen obligimet financiare në vitet e ardhshme fiskale, ndërsa Korniza afatmesme e shpenzimeve parasheh, po citoj: “një bazë të arsyeshme për të pritur që do të ketë ndarje të fondeve të mjaftueshme në ato vite fiskale të ardhshme, me qëllim të përmbushjes së atyre obligimeve”.

Në bazë të kësaj, Ministria e Ekonomisë dhe Financave qysh në vitin 2008, në Kornizën afatmesme të shpenzimeve, me vendim të Qeverisë dhe, natyrisht, edhe me aprovimin e Kuvendit, ka paraparë financim për autostradë. Ndërsa, financimi fillestar për projektin për eksproprijim të tokës është siguruar në vitin 2009.

Në vitet në vijim, pra në vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2013 janë paraparë me kornizë afatmesme këto shifra të cilat do t'i lexoj tani, e të cilat janë harmonizuar edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Sigurisht që shifrat që janë, besoj që do ta tejkalojnë vlerën e autostradës, por për qëllime të sigurisë së financimit të këtij projekti në kushte në të cilat Fondi Monetar Ndërkombëtar ka kërkuar që të kemi një siguri më të lartë të financimit dhe të vetë qëndrueshmërisë, për vitin 2010 janë siguruar 129.500.000, më 2011 - 275, më 2012-296,8 dhe më 2013- 272,1 milionë.

Sipas të gjitha procedurave që Ministria e Ekonomisë dhe Financave gjatë dëgjimeve buxhetore ka aprovuar dhe një konsultim me të gjitha institucionet tjera relevante, qoftë edhe agjencionet e prokurimit dhe ekspertë të tjerë të prokurimit, sa i përket nënshkrimit të kontratës është në kuadër të procedurave dhe në kuadër të planifikimeve buxhetore sipas Kornizës afatmesme të shpenzimeve dhe, si të tillë, ne nuk shohim ndonjë shqetësim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Pyetje shtesë, deputetja Syla.

GJYLNAZE SYLA: Zoti ministër,

Nga mediat ne jemi informuar se keni zhvilluar tenderin dhe keni kontraktuar një avans prej 50 milionë eurove. Shtrohet pyetja se çka ju është dashur rishikimi i buxhetit, kur i keni kryer punët më herët pa rebalanc!? Me një fjalë, keni shfrytëzuar Kuvendin e Kosovës për të legjitimuar shkeljet e juaja joligjore. Është shkelje flagrante, atë çka keni bërë, e Ligjit për huan publike. Si ka mundur të paguhet avansi pa sigurimin e mjeteve? Faleminderit!

KRYESUESI: faleminderit!

Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Sinqerisht, më vjen keq për këto spekulime, të cilat nuk di si t'i cilësoj ndryshe, pos një paranojë joprofesionale dhe do t'ju kisha sugjeruar shumë që t'i lexoni ligjet e prokurimit. Ministria e Ekonomisë dhe e Financave luan rolin e vet të planifikimit dhe të sigurimit të mjeteve për agjensionet buxhetore, të cilat në prioritet i kanë projektet e veta. Në qoftë se keni pyetje kaq specifike për procedurat e prokurimit, do t'ju kisha lutur shumë që të bisedoni dhe të merrni ndonjë leksion pak më profesional për këto çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti ministër,

Qeveria ka vendosur që PTK-në ta privatizojë. Për këtë arsye, kohë më parë pati angazhuar këshilltarët e transaksionit dhe tashti së voni edhe këshilltarë strategjikë apo super këshilltarë. Pyetja është kjo: Sa janë vlerësuar asetet e PTK-së nga këshilltarët e transaksionit dhe, u mor vesh, nga këta super këshilltarët dhe, të lutem, na tregoni, para se i punësuar familjarët e tu dhe pas punësimit të familjarëve të tu, së bashku me këtë kontingjentin e fundit, që i punësuar 30 a sa ishin ata të ... ekspertëve, pa konkurs. Po them pas, sepse ata pa tjetër që kanë bërë prurje në PTK, 30 ekspertë të profileve të ndryshme janë asete për secilën kompani, po them ekspertë, nuk dyshoj që s'janë ekspertë sepse ju, zoti ministër, po edhe kjo qeveri, që nga fillimi keni qenë të përkushtuar për efikasitet, për ekspertizëm, transparencë, sikurse që keni qenë kundër familjarizimit, nepotizmit, kundër korrupsionit, jeni qeveri për mos t'ju marrë mësysh. Andaj, na trego, të lutem, sa është vlerësuar çmimi i aseteve të PTK-së, konkretisht na jepni vlerën, të lutem!

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar deputet!

Është e vërtetë që ne kemi angazhuar, mund të them, dy grupe konsulente, njëra që është quajtur këshilltar i transaksionit dhe, grupi tjetër, kompani ndërkombëtare, që e kemi quajtur këshilltarë strategjikë, thjeshtë për të rritur sigurinë në vendimet tona strategjike, të cilat bashkërisht do t'i marrim.

Sa i përket vlerësimit të aseteve të Post-Telekomunikacionit të Kosovës, varësisht nga cila metodologji që është përdorur, gjithsesi këshilltari i transaksionit ka dhënë shumën dhe vlerat të cilat janë pasqyruar edhe në strategjinë, që e keni ju, të cilat shifra paraqesin gjendjen reale të aseteve të Post-Telekomunikacionit të Kosovës. Do ta kem shumë të vështirë ta them, sepse sipas këshilltarëve specialistë do të duhej të ishim të kujdesshëm në vlerësimet tona për hir të mos spekulimit të çmimit. Megjithatë, për hir që është një Kuvend i Kosovës këtu, unë besoj që nuk do të bëjë ndonjë shkelje për të thënë vlerësimet që i ka bërë këshilltari i transaksionit, të cilat sillen prej 300 deri në 600

milionë euro. Këto janë vlera me të cilat është e vlerësuar. Ne po bëjmë gjithçka që është e mundur që të rrisim konkurrencën dhe roli i këshilltarit strategjik për Postën është mu ky, që në vendimet tona strategjike, qoftë në sasinë e aksioneve të cilat do t'i shesim, qoftë në mënyrën e marketingut për të atraktuar blerës më të fuqishëm, të bëjmë gjithçka që është e mundur që gjatë procesit të shitjes të arrijmë vlerat maksimale. Unë uroj sinjerisht që parashikimet e tregut, përkatësisht reagimet e tregut të jenë më të larta se sa vetë parashikimet e këshilltarëve të transaksionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Pyetje shtesë? Zoti Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Zoti ministër,

Je kah më habit ti kështu si ekspert, së bashku me gjithë ata këshilltarët e tu, brezi shumë i gjanë 300, 600 milionë. Unë pyeta konkretisht për vlerën, sa është vlera e aseteve, nuk thashë çmimi i tregut. Pyetjen e ke që një muaj ditë, është dashur të konsultohesh me këshilltarët e tu, edhe me super këshilltarët e tu dhe të ta japin një çmim të aseteve, vlerën e aseteve, ishte pyetja. Ju lutem, përgjigjuni konkretisht, unë kam parasysh se 100, 200 milionë që të jetë më shumë a më pak, nami s'është, se e ke dëmtuar ekonominë e Kosovës për më shumë se 200 milionë, ku ke prekur ke shkretuar, por më jep përgjigje konkrete. Është shumë për t'u qeshur për ty, por nami i punëtorëve janë kah qajnë, se nuk po mund të ngihen bukë. Të jesh më serioz në përgjigje. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Unë do të kisha lutur Kryesinë që të jetë më e disiplinuar, nëse mund të them, me masat për atributet që cilat jepen vend e pa vend, me etikë e pa etikë se, natyrisht, në proceset kaq të rënda çfarë kemi shtetet në tranzicion, nuk është lehtë për të marrë vendime strategjike. Unë përgjigjen ta dhashë dhe përgjigja ishte ajo të cilën e ke edhe në strategjinë e afruar, si juve, lexoi pak më mirë dhe i ke të gjitha. Por, do të kisha lutur, i nderuari zoti kryesues, për njerëzit të cilët marrin kurajon dhe tejkalojnë të gjitha sjelljet e etikës dhe përdorin fjalor kaq jo profesional dhe jo të këtij niveli, është mirë më në fund të merren masa të cilat, vërtet, do t'i kishin, do të ngrehnin hijen e këtij institucioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Rexhep Hoti, pyetje për ministrin Haki Demolli.

REXHEP HOTI: Do të parashtoj pyetjen kur të jetë ministri i pranishëm. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: S'është ministri.

Atëherë, vazhdojmë me deputetin Rexhep Hoti, pyetje për ministrin Lutfi Haziri, s'është këtu, prapë e njëjta gjë.

Deputetja Drita Maliqi, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

DRITA MALIQI: Faleminderit!

Përhëndetje për të gjithë!

I nderuar zoti ministër,

Gjendja socio-ekonomike në Kosovë vazhdimisht po përkeqësohet, duke u bërë kërcënim kryesor i stabilitetit në vend. Duke pasur parasysh papunësinë e madhe në Kosovë, çmimet e artikujve të ndryshëm janë shumë më të larta për dallim nga pagat që vazhdojnë të mbesin edhe më tutje të ulëta. Ndërkohë që standardi jetësor në mënyrë të vazhdueshme është duke shënuar rënie. Varfëria në

Kosovë po rritet, indeksi i tërësishëm i çmimeve të konsumit në vendin tonë është më i lartë për 0,3% krahasuar me vitin paraprak, kështu që qytetarëve tanë në fillim vit u është shtrenjtuar shporta e konsumit. Si e vlerësoni ju këtë, i nderuari zoti ministër, dhe çfarë masash do të ndërmarrë Qeveria për ta ndaluar këtë trend shqetësues.

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

E nderuara zonja deputete,

Së pari dua të jap një shifër, të paktën të saktë, sa i përket përqindjes së ngritjes së çmimeve, është 0,3% sipas shënimeve tona që kemi ngritje të çmimeve. Natyrisht që është një shqetësim, por megjithatë nuk do të doja që të lë vend për ndonjë alarm në ngritjen e çmimeve në përgjithësi. Ky është një trend i përgjithshëm botëror, sidomos në çmimin e bukës për shkak të katastrofës, nëse mund të them, e cila ka ndodhur në Rusi dhe e cila po reflektohet mbase edhe në mënyrë spekulative nëpër vende të caktuara të ndarjeve primare botërore. Gjithsesi, konsideroj që nëse shikohet një trend 3 vjeçar mbrapa, Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimet që i ka marrë dhe me ligjet që i ka aprovuar dhe masat në përgjithësi, ne kemi një përkushtim të vazhdueshëm të rritjes së pagesave ndaj shtresave sociale. Por, si filozofi dhe si koncept, konsideroj që i vetmi shpëtim për të tejkaluar gjendjen e të varfërve është zhvillimi ekonomik dhe investimet në sektorët e zhvillimit ekonomik, siç jemi duke bërë.

Rritja e investimeve kapitale nga 157 milionë euro, në 650 milionë euro, faktikisht për 4 fish e më tepër, jemi të sigurt që ka ndikuar në ruajtjen e pozitës së Kosovës të rritjes së GDP-së deri më tani.

Në vitin 2008 kemi pasur, sipas shënimeve edhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar, një brutoprodhim shoqëror prej 2,6 a 7 miliardë euro, ndërsa tani kemi mbi 4 miliardë dhe kjo tregon për rritjen, përkatësisht për pasurimin e vet qytetarëve të Kosovës. Natyrisht, shtresa të caktuara mbesin gjithmonë të varura dhe ligjet të cilat i kemi aprovuar dhe ato të cilat janë në vazhdimësi duke u aprovuar, shfaqin një përkujdesje më të lartë. Dua të them që në vitin 2009 ne i kemi rritë rrogat e pensionistëve, po dua të them pensionet për 12,5%, edhe pse është një rritje e vogël nominale, por në përqindje megjithatë është 12,5% dhe për herë të parë kemi reflektuar vlerën e indeksit të çmimeve, si proces, i cili do të jetë në mënyrë të vazhdueshme. Në të njëjtin aspekt, shtresat e caktuara sipas prioritetëve kanë pasur një ngritje deri në 47%, siç dihet, arsimtarët, 30% në vitin e kaluar, përkatësisht duke filluar nga 1 dhjetori i këtij viti të gjithë shërbyesit civilë, sidomos të shëndetësisë, duke përfshirë 44 eurëshin e famshëm, që ishte i pazgjedhur, kemi ngritur këto pagesa dhe në vazhdimësi, sivjet është aprovuar Ligji i punës, përkatësisht është në proces të përmbylljes, sa di unë, Ligji i veteranëve të luftës dhe plotë ligje të tjera të cilat kanë për qëllim zbutjen e saj.

KRYESUESI: Faleminderit!

Pyetje shtesë? Deputetja Malqi.

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e kuptoj ministrin dhe e di se e di shumë bukur që 45% e popullsisë tonë në Kosovë, domethënë, jetojnë në varfëri vetëm me 1.42 euro në ditë, ndërsa 15 deri 18% prej tyre jetojnë në varfëri të skajshme, me 0,93 euro në ditë. Unë mendoj se ky është një mjerim i madh, edhe pse për juve nuk ishte shumë shqetësuese, i nderuari zoti ministër, që mund t'i ndodhë një shteti, kjo është shqetësuese, sipas mendimit tim, për popullatën tonë dhe vendin tonë, është alarmante. Këto po ndodhin sot në këtë keq qeverisje të shtetit dhe ju, e nderuara Qeveri, nuk po mund ta shihni këtë

varfëri të skajshme. Shihet qartë se nuk keni vizion për asgjë. Edhe një pyetje. A u shkon mendja të kontrolloni ndonjëherë çmimet e shportës familjare te ne në Kosovë? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Mund të debatojmë mjaft në këtë temë, por një t'ju them, ngritja e çmimit të bukës, përveç anëve negative që ka në goditjen e atyre më të varfërve, në anën tjetër do të jetë stimulues për bujqësinë. Unë e di që ka kontroversa rreth kësaj politike, por nuk do të kemi bujqësi të zhvilluar derisa nuk do të kesh çmime të mira të grurit. Ka politika për të subvencionuar forma të ndryshme të bukës, por koncepti ynë, sidomos i dominimit të, konsideroj, mendimtarëve të cilët dëshirojnë të zhvillojnë bujqësinë, është që çmimet e grurit dhe çmimet e produkteve në bujqësi të mbesin, e ne jemi përcaktuar për një ekonomi të tregut, të mbesin në nivelin më të lartë të mundshëm, varësisht qysh cakton dinamika e makro shkëmbimeve në tregun botëror, por të subvencionohen kategoritë më të ulëta, thjeshtë për të mbrojtur ata më të varfërit dhe të pamundurit. Kjo është qasja jonë dhe unë jam shumë i bindur që kjo është qasja më e drejtë deri më tani. Fatkeqësisht, jetojmë në një rrethinë ku shkëmbehemi me ekonomi që subvencionojnë shumë, por të cilat kanë taksa deri 68% dhe nuk është rrugë afatgjate ajo të cilën do ta zgjedhim, sepse vetë Evropa deri në vitin 2013 do të ndalë subvencionet për bujqësinë dhe, si të tillë, Kosova do të ketë avantazhet e veta afatmesme, afatgjate. Jemi të përkushtuar për të mbrojtur më të pamundurit, por rruga afatgjate është kjo të cilën e shpjegoja përafërsisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministren Justina Shiroka Pula. Nuk doni, Okej, lexoni.

NAIM RRUSTEMI: Po e lexoj pyetjen se, vërtet, nuk di qysh të atribuoj, s'po di cilattribute t'ju them nëse një njeri e ndryshon mendjen, para 3 muajve thotë diçka, mbas 3 muajve thotë diçka tjetër, s'ka atribut tjetër përpos mashtues.

Ministrja e Energjisë dhe e Minierave, Justina Pula, në një intervistë për gazetën "Koha Ditore" ka thënë se është e brengosur shumë për hyrjen e Termocentralit "Kosova B" në pakon tenderuese të projektit, që kishte ndodhur me aprovimin e Kuvendit të Kosovës. Edhe unë, normalisht, si detyrë që e kam, i lexova transkriptet e asaj mbledhjeje dhe e pash, në diskutimet e saja kishte qenë shumë luftarake edhe neve na kujtohet shumë mirë për futjen e "Kosovës B" në pakon tenderuese, së bashku me ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Ahmet Shalën, dhe kryeministrin dhe të tjerët, ishin shumë këmbëngulës dhe pas 3 muajve e ndërron mendimin. Desha ta pyes, a keni pasur atë qëndrim edhe para 4 muajve, apo ju ka detyruar dikush, apo ka luajtur ndonjë pazar tjetër që ju ka detyruar ta ndërroni mendimin. Nuk ka të drejtë të vendos aq shumë dyshime Qeveria e Kosovës tek qytetarët. Në një moment thotë diçka tjetër, në një moment thotë diçka total tjetër, thua se po do të shpërlahet prej një diçka të keqe që e ka bërë, andaj desha ta pyes publikisht dhe është mirë të sqarohet para opinionit, edhe në Kuvend të sqarohet, si mundesh, për shembull, në muajin prill ke luftuar, ke qenë shumë luftarake të vendoset "Kosova B" në pako tenderuese dhe tash del publikisht - jam shumë e brengosur për futjen e "Kosovës B" në pako tenderuese. Kjo s'ka kurrfarë kuptimi, së paku nuk ka në kuptimin e njerëzve që janë vendimmarrës, qysh t'ju besojnë së pari qytetarët, që nuk po e dinë çka po ndodh atje, se për mua, unë po e di përafërsisht çka po ndodhë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Rita Hajzeraj - Beqaj, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. A doni ta lexoni, apo të prisni kur të vjen? Deputetja Hajzeraj e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ: Meqenëse e kemi zëvendëskryeministrin, besoj që nuk është vështirë të përgjigjet edhe zëvendëskryeministri.

Çështja është për shëndetësinë në Kosovë. Vazhdon të jetë e mjerueshme gjendja vazhdimisht. Fatkeqësisht, kjo gjendje po vazhdon edhe pas dy vite e gjysmë të qeverisjes tuaj, i nderuar. Kjo mendoj se vjen si rezultat i faktit se shëndetësia asnjëherë nuk ka qenë prioritet i Qeverisë në Kosovë.

Zoti zëvendëskryeministër, a mendoni edhe ju se për të ndryshuar kjo gjendje e vështirë në shëndetësinë tonë, së pari shëndetësia duhet të bëhet prioritet i qeverisjes dhe të trajtohet si e tillë?

KRYESUESI: Faleminderit!

A të vazhdojmë me pyetjet? Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti ministër, një sqarim të vogël. Unë jam deputet këtu për t'i shprehur brengat e qytetarëve të Kosovës. E di që t'i nuk i kupton, se nuk ke hyrë në proces, je i deleguar apo i emëruar nga një njeri dhe ke përgjegjësi ndaj tij. Unë kam përgjegjësi ndaj qytetarëve dhe ky është disponimi i qytetarëve. Sidoqoftë, po kthehem te pyetja e radhës. Sipas të dhënave zyrtare, për ta hapur një bastore në Kosovë, pronari duhet t'i paguaj 25 mijë euro në vit për licencë, që t'i lë 150 mijë euro depozitë dhe po ashtu duhet që të njëjtën shumë ta ketë si kapital themelor, kurse pronari për çdo pikë që e hap, duhet t'i paguaj 5000 euro. Sidoqoftë, për shkak se ky biznes në Kosovë është nga më përfitabilët, qarkullimi ditor sillet nga 2000 deri 4000 euro, kur ka edhe evenimente të ndryshme sportive, andaj ky sektor joshë një numër të madh të ndërmarrje, qofshin ato nga Kosova, Shqipëria, Serbia, apo Kroacia. Gjer më tani, në Kosovë janë të hapur 309 pika, qarkullimi i të cilave sipas disa kalkulimeve sillet rreth 100 milionë euro në vit. Por, Administrata Tatimore e Kosovës edhe më tutje nuk ka arritur të fusë rend dhe rregull në këtë fushë. ATK nuk e di saktë se sa para kanë në qarkullim bastoret dhe sa kanë fitim. Pyetja: A ka Qeveria ndërmend të ndërmarrë diçka serioze që këtë sektor afaristë ta fus në rend dhe rregull. Pra, Qeveria a ka ndonjë plan për të futur disiplinë në këtë sektor të biznesit, nëse po, a na tregoni ju lutem konkretisht se cili është plani i Qeverisë dhe kur pritet implementimi i atij plani? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti ministër, e keni fjalën për t'u përgjigjur.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Sipas shënimeve zyrtare që kemi, deri më 31 dhjetor të vitit 2009 kanë qenë të licencuara 13 subjekte si bastore, me 271 njësi të basteve. 16 subjekte të bixhozit, me automate në klube të veçanta, me 2600 automate në përgjithësi, 13 subjekte si tombola bingo dhe 1 subjekt si kazino. Gjatë vitit 2009, janë paguar për taksë të licencimit 1.004.250 euro. Mund t'i jap shifrat e sakta, domethënë gjithsej licenca të lëshuara janë 43, baste 13, automate 16, bingo 13, kazino 1. Pagesa e tatimeve, po flas gjithnjë për janar – dhjetor të vitit 2009, janë 1.349.945,12 euro. Pagesa e taksave për licenca janë 1.004.250 siç e thashë, gjoba të lëshuara janë 75 mijë, të paguara 40 mijë dhe numri i subjekteve të njërive të mbyllura me ndihmën e policisë janë 104. Po ashtu, gjatë vitit 2010, Administrata Tatimore e Kosovës, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës ka marrë masa të rritura, besoj, dhe 49 bastore, përkatësisht forma të organizimit të këtyre subjekteve ekonomike janë mbyllur. Ndërsa, në janar - qershor 2010, janë licencuar 5, prej tyre 1 baste, 4 automate dhe kanë paguar gjithsej 1.148.525 euro, pagesa për taksa 689 mijë euro dhe gjobat e lëshuara 20 mijë euro, prej të cilave 20 mijë janë paguar.

Ministria e Ekonomisë dhe Financa, së bashku me ATK-në dhe me institucione të tjera të specializuara në këtë drejtim, sidomos me ndihmën e ekspertëve nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe disa ekspertë të Unionit Evropianë, në legjislacionin e vet ka për vitin 2010 dhe draftëligji i ri për këtë fushëveprimtari është në përmbyllje e sipër. Ne sipas planit e kemi që gjatë muajit tetor ta sjellim këtu në Kuvend, i cili në mënyrë mjaft të specifikuar dhe të avancuar në mënyrë më specifike se sa deri më tani legjislacioni në fuqi, zbërthen disa gjëra dhe ofron një zbatim të taksës së veçantë për këto biznese, gjithnjë me qëllim të kontrollimit dhe duke përdorur praktika më të mira, sidomos në shtetet në të cilat kjo, nëse mund të them, industri është mjaft e zhvilluar. Administrata Tatimore ka planet e veta për të vepruar kundër çdo...

KRYESUESI: Faleminderit!

Pyetje shtesë? Zoti Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti ministër,

Sipas 13 korrikut 2010, ATK-ja thotë se janë gjithsej 13 bastore me 309 pika, fola për bastore, plus ato, del që qarkullimi me plotë të drejtë është nga 80 deri 100 milionë euro. Ju s'keni bërë asgjë, mos më keqkuptoni, nuk jam kundër që shoqëria jote të fitojnë, të përfitojnë në këtë biznes shumë profitabil, është krejt në rregull, ia ke hequr edhe TVSH-në nga 1 korriku, s'ka lidhje se e mbulojnë me TVSH-në në ushqim që e paguajnë qytetarët e Kosovës. Kosovarët pa ushqim mund të jetojnë, po pa bixhoz, pa komor ne nuk mund të jetojmë. Pyetja është kjo: Pse nuk i fiskalizoni, apo pse nuk janë fiskalizuar deri më tash bastoret, a mos po ju duken edhe atyre shtrenjtë arkat fiskale, a çka është në pyetje? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Praktikën më të mira evropiane japin që të vendoset një taksë e veçantë dhe ligji e rregullorja janë në harmoni të plotë me standardet evropiane dhe ne në vend të TVSH-së do të vendosim taksë të veçantë për këtë veprimtari, e cila do të jetë, mendoj, më efikase se sa vetë TVSH-ja. Sa i përket fiskalizimit, Administrata Tatimore e ka planin e vet të saktë, me data të caktuara, të cilat do t'i zbatojë me përpikëri. Ne, po ashtu dua të informoj publikun, sepse është bërë shumë zhurmë rreth kësaj, jemi në fazën përfundimtare të licencimit edhe të operatorëve të tjerë për fiskalizim dhe para 15 shtatorit, besoj, do t'i keni të paktën edhe dy emra të tjerë. Ky do të jetë proces i hapur dhe vazhdimisht ne do të licencojmë operatorë të cilët i plotësojnë kushtet. Sigurisht që sugjerimet tuaja profesionale do të jenë më se të domosdoshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

NAIM RRUSTEMI: Ministër, ju keni miratuar një kod të etikës dhe qeverisjes kooperative të ndërmarrjeve publike qendrore. Ndërmarrjet nuk do t'ju sigurojnë, me të cilat i keni rregulluar në letër, ndërmarrjet nuk do t'ju sigurojnë vetura, kompjuter, telefona ose pajisje tjera, as nuk do t'ju sigurojnë për Bordin e drejtorëve zyra brenda objekteve të kompanisë. Gati të gjithë drejtorët e Bordit të drejtorëve nuk e respektojnë këtë kod të miratuar me datën 30 prill 2009. Të them të drejtën, nuk e di si t'ju atribuoj tjetër, përpos si një mashtrues gojëmbël, me të cilin ju në letër vendosni rregulla të mira, kurse në praktikë nuk i bëni ato. Me fjalë të tjera, diçka tjetër shkruani, diçka tjetër veproni. Unë, mund ta kuptoj, mund ta kuptoj pse ju bleni apo, me fjalë të tjera, korruptoni Bordin e drejtorëve me gjëra që ata nuk kanë të drejtë t'i përdorin, ndoshta që të

implementojnë diçka që ju dëshironi. Po pyetja ime konkrete është: Pse është miratuar ky kod i etikës?

KRYESUESI: Zoti ministër,

MINISTRI AHMET SHALA: Kodi i etikës, i cili është aprovuar në vitin 2009, është avancuar dhe në prill të vitit 2010 është aprovuar edhe një kod tjetër i etikës, me të cilën janë precizuar shumë më saktë edhe përgjegjësitë, edhe sjelljet e anëtarëve të bordit, qofshin ata ekzekutiv, qofshin joekzekutiv. Tani kemi përfunduar diku në korrik edhe matjen e performancës në secilën ndërmarrje publike dhe për çdo devijim nga ky kod do të mbajnë përgjegjësinë ata të cilët e kanë devijuar dhe ligji jep mundësi aksionare që pas 2 viteve, pra, që vjen tani diku tetori – nëntori i këtij viti, më së largu deri në dhjetor, të bëjë vlerësimin e sjelljes së secilit bord, përkatësisht secilit anëtarë veç e veç apo bordit si vendimmarrës për performancat e tyre dhe eventualisht devijimet që i kanë bërë. Për çdo devijim eventual qoftë nga kodi, qoftë nga të drejtat e tyre, secili mbanë përgjegjësinë individuale dhe, si të tillë, ligji do të veprojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Pyetje shtesë?

NAIM RRUSTEMI: Përgjigjja juaj, ministër, kish për t'u pranuar me dyshime nëse kishte qenë Kosova 10 milion kilometra² nëse kishte pasur 500 milionë banorë, por janë 2 milionë banorë, 10.700 – 800 kilometra². Ne të gjithë i shohim anëtarët e bordit të drejtorëve ashtu siç i shoh unë, jam shumë i sigurt që edhe ti e di se disa i ke edhe komshi dhe të afërm, të familjes nuk e di a i ke, po i njeh më mirë se unë. Ne të gjithë i shohim duke keqpërdorur pozitën e anëtarit të Bordit të drejtorëve. Nëse do, ti jap edhe me emra, se nuk kam asgjë për të heziturar sepse janë para publike, pse mos të flasim edhe me emër. Të gjithë anëtarët e bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore, duke filluar prej PTK-së, Aeroportit të Prishtinës, prej KEK-ut janë të pajisur shumica prej tyre me vetura zyrtare, bëjnë udhëtime zyrtare, bëjnë shpenzime marramendëse të parasë publike. Dhe pyetja ime është: Pse të miratohet një kod që t'i nuk do ta realizosh? Unë kam pritur përgjigjen që do ta japësh. Unë do ta bëj një kod në letër, nëse dua ua ndali, nëse dua ua lëshoj. Me fjalë të tjera, kur dua, kur mua të më konvenon, unë këtë privilegj që nuk ju takon, mund t'jua ndali. Kështu ke mundur...

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Mbase e di që shumë prej jush po të kishin qenë ministra në ndonjë sistem diktator shipi, do të kishin vepruar ndryshe, jam shumë i sigurt. Ne kemi përzgjedhur një sistem demokratik, në të cilën rregullat e lojës janë komplet më ndryshe. Kodi i etikës, ligji, rregulloret, statutet, të gjitha janë konform të gjitha praktikave të një shoqërie demokratike. Ai që si aprovon, e thashë, performanca e matjes së bordeve të drejtorëve do të përmbillet nga një komision i pavarur, i cili mbas dy vjetësh e jep ligji, unë jashtë ligjit nuk mund të dalë, ndërrojeni ligji, unë veproj sipas ligjit, në të cilin do të vlerësohet secili anëtar i bordit dhe secili bord i ndonjë ndërmarrje publike dhe, si të tillë, i përcakton të gjitha masat të cilat ne mund t'i marrim. Jashtë këtyre kompetencave nuk do të dalë, as s'e kam ndërmend ndonjëherë të dalë. Kushdo që mendon se mund t'i bëjë këto dalje, mbase mendojnë në ndonjë sistem tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Unë kërkoj falje sepse e shtyra miratimin e rendit të ditës për shkak të një kërkesë të pa përfunduar sipas Rregullores së Kuvendit, që ka ardhur nga Grupi Parlamentar “7+” dhe të cilën, me qenë se

Grupi Parlamentar e ka bërë kërkesën, e konsumuam edhe me kryetarin e Kuvendit dhe jam i obliguar sipas Rregullores që t'ia jap fjalën përfaqësuesit të Grupit Parlamentar “7+”, që ta arsyetojë kërkesën për ta hequr realisht nga rendi i ditës një pikë të cilën e kërkojnë ata. Po, paraprakisht ju njoftoj se në pajtim me nenin 15, paragrafi 3 dhe nenin 42 të Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare. Prandaj, deri sa ka filluar seanca, nuk ka pasur asnjë kërkesë me shkrim sipas rregullores, e cila është e protokolluar. Kërkesa tani ka ardhur në emër të Grupit Parlamentar dhe në emër të Grupit Parlamentar “7+” për ta arsyetuar kërkesën kush e do fjalën? Zoti Mahir Yagcilar.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryesues!

Flas në cilësinë e deputetit, sepse deputeti Enis Kervan nuk është prezent. Është kërkesa, është ndërlidhur edhe në një takim të Qeverisë, ku në pikën e rendit të ditës ka qenë regjistrimi i popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave, për çështjet teknike të shtyhet, sepse në qeveri është aprovuar një vendim për përfshirjen e disa amendamenteve, por ka ndodhur sigurisht ndërkohë një gabim teknik edhe ekziston vendimi, por ato vërejtje nga vendimi nuk janë inkorporuar në ligj, kështu që ne si grup parlamentar kërkojmë të shtyhet për takimin e ardhshëm, të bëhen harmonizimet në këto çështje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Për të sqaruar domosdoshmërinë e mbajtjes në procedurë apo jo, ia jap fjalën ministres Edita Tahiri.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër, kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Lidhur me mocionin në fjalë kam obligim t'ju sqaroj me sa vijon:

Së pari, ky mocion është jokushtetues për arsye se përmbajtja për të cilën insiston bie ndesh me kushtetutën. Fjala është pra për një kërkesë që e ka bërë ministri i Ambientit, që në procesin e përgatitjes së regjistrimit formularët të jenë edhe në gjuhën turke në nivelin nacional, në nivelin nacional, pra, gjuha turke të zbatohet në këto fletëregjistrime. Të gjithë e dimë që Kushtetuta e Kosovës njeh dy gjuhë zyrtare: gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe, si dhe e njëjta mundëson që për minoritetet, pra aty ku janë mbi 5%, të zbatohet edhe gjuha e minoritetit përkatës. Në bazë të Kushtetutës dhe të Ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare, edhe Projektligji për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave është konform kushtetutës dhe Ministria e Administratës Publike nuk ka mundësi, pra, të japë propozime tjera, përveç se ato që janë në harmoni me Kushtetutën. Çfarëdo ndryshimesh që mund të ndodhin sipas kërkesës, pra, në një ligji, një minoritetit të ngrihet në nivel zyrtar nacional, kjo do të na çojë edhe në Gjykatë Kushtetuese për shkak se çdo ligj duhet të jetë, pra, konform kushtetutës. Po ashtu, ne nuk e kemi vetën një minoritet, pra, janë edhe një numër i madh i minoriteteve, kjo hap edhe precedentë tjerë. Unë mendoj që Kushtetuta e Republikës së Kosovës është jo vetëm me standarde ndërkombëtare, por në raport me minoritetet madje mund të them se i tejkalon standardet ndërkombëtare. Prandaj, unë mendoj se ky mocion nuk duhet të pranohet dhe ligji duhet të procedohet, pra të shqyrtojmë si projektligj sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, konstatoj se në sallë janë 65 deputetë dhe e hedh në votim propozimin e Grupit Parlamentar “7+”, si propozim të parë, kuptohet edhe qëndrimin e Ministrisë, i cili qëndrim ishte konform Kushtetutës së Kosovës. Kush është, po e bëjmë “për” dhe kush është “kundër” tani propozimit të Grupit Parlamentar “7+”? S’kemi çka të sqarohemi, s’kemi debat. Kush është për ta hequr prej rendit

të ditës dhe kush është të procedojmë? Kush është për ta hequr prej rendit të ditës, le ta ngrejë dorën. Do të thotë, po shihet që janë 5 deputetë që votojnë “për”, kundër janë të tjerët me siguri, me qenë se s’kanë votuar. Pra, procedojmë me rendin e ditës dhe ligji i propozuar mbetet në agjendë. Faleminderit!

Kemi pikën e katërt të rendit të ditës.

Për rendin e punës, deputeti Emrush Xhemajli e ka kërkuar fjalën.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar dhe kolegë deputetë,

Unë kërkoj nga Kuvendi i Kosovës që të caktoj sot ose të caktojë datën se kur do të procedohet në Kuvend interpelanca lidhur me negociimin e marrëveshjes Zvicër – Kosovë lidhur me sigurimet shoqërore. Në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, më datën 5 korrik, në një grup deputetësh kemi kërkuar interpelancë të kryeministrit të Republikës së Kosovës lidhur me negociimin e marrëveshjes Kosovë – Zvicër lidhur me sigurimet shoqërore. Sipas Rregullores së Kuvendit, neni 44, pika 5, këtë mocion brenda 2 dite kryeparlamentari ia përcjell kryeministrit, ndërsa ai brenda 7 dite duhet ta kthejë përgjigjen. Ndërsa, prej atëherë, pas 7 dite dihet se duhet që t’i përcillet Kuvendit në seancë plenare. Nëse kryeministri në datën e caktuar nuk përgjigjet brenda 7 dite, ka qenë dashur të vijë interpelanca këtu. Po bëhet fjalë prej datës 5 korrik, deri më tash. Ka qenë pushimi, por ndërkohë janë mbajtur disa seanca. Janë shkelur të gjitha normat, e gjithë rregullorja komplet. Nëse Kryesia e sheh të arsyeshme që duhet të qëndrojë mbi Rregulloren që e ka aprovuar Kuvendi, atëherë është diçka tjetër, por nuk është tepër ose nuk është marre Kryesia të thotë se për këtë problem nuk jemi përgatitur dhe kjo do të kuptohet, por në shkresën që ka ardhur, nuk jepet asnjë arsyetim pse bëhet shtyrje pas shtyrjeje, kështu që unë kërkoj me sa thashë më lart.

KRYESUESI: Faleminderit!

Kryesia e Kuvendit e ka shqyrtuar kërkesën tuaj dhe të deputetëve të cilët e kanë kërkuar interpelancën. Me qenë se kryeministri ka pasur në agjentë udhëtimin përkatës që e ka, në kemi vendos që ta shtyjmë për mbledhjen e radhës që vjen, ose seancën e radhës, me arsyetimin që kryeministri duhet të jetë gjatë interpelancës që do të bëhet lidhur me këtë çështje. Pra, në seancën e ardhshme do të jetë interpelanca e kërkuar nga ju. Ky është vendimi i Kryesisë dhe mendoj që s’ka nevojë të hidhet në votë në Parlament. Faleminderit!

Ne i kemi të radhitura dy çështje, pikën 4 dhe 5, të cilat mendoj që duhet prapë të shtyhen, me qenë se për pikën e parë kërkohej dy të tretat që të jenë prezent dhe me qenë se në sallë janë 75 deputetë, ne nuk mund të vendosim, bile kërkohej dy të tretat që të votojnë. Uroj që vërtet kryetarët e grupeve parlamentare në këtë maratonë të votimit të këtij vendimi të takohen dhe të bisedojnë përfundimisht që ta votojmë, sepse është në interesin e të gjithëve, në këtë rast në interesin e Kosovës. Prandaj, po e shtyjmë për një vendim tjetër që ta vendosim në rendin e ditës të seancave të radhës ose në qoftë se ka mirëkuptim nga kryetarët e grupeve parlamentare dhe mund t’i sjellin deputetët në Kuvend, që të bëhet kuorumi i duhur, atëherë edhe sot mund të procedojmë me te.

Pika e pestë e rendit të ditës, do të kisha kërkuar që edhe kjo të trajtohet ndoshta sipas ligjit përkatës, Ligjit të ri lidhur me funksionimin e Bankës Qendrore, sepse kërkesa realisht sipas informatave që ne kemi, është bërë në bazë të ligjit të vjetër mbi funksionimin e kësaj dhe nesër mendoj që Kryesia e Kuvendit do të vendos që këtë çështje ta procedojë konform ligjit në fuqi, i cili sipas asaj që ne diskutuam më herët, duhet që Bordi përkatës të propozojë dhe ne pastaj ta shqyrtojmë këtë çështje. Tani unë këtë kërkesë e kam edhe nga kryetari sipas asaj që biseduam më herët, ishte edhe kryetari i

Komisionit për Buxhet dhe Financa, ramë dakord që kjo të procedohet nesër në Kryesi dhe Kryesia t'ia kthej përgjigjen kërkesës së bordit. Nuk hapi debat për këtë çështje, nuk po hapi debat. Jo, unë po ju jap, nuk e hapa debatin. Në rregull, po e shoh, veç më lejo ta përfundoj unë, pastaj po i trajtojmë të dy çështjet. Unë nuk po dua t'ua marrë të drejtën as të debatit, me qenë se është futur me vendim të Kryesisë kjo në rend të ditës dhe unë s'mund ta ndryshoj, as administrata nuk ma ka hequr nga agjenda, kështu që si të mendoni ju që është... po unë po mendoj që në bazë të asaj që biseduam dhe në bazë të kërkesave të faktorëve relevantë, të cilët kanë kërkesa dhe ne duhet të kemi mirëkuptim ndaj kërkesave të tyre, është mirë që ta lëmë këtë çështje për nesër në mbledhjen e Kryesisë dhe pastaj në qoftë se Kryesia vendos ndryshe dhe vendos që kjo të mbetet në rendin e ditës, të procedojmë sepse kemi mjaft kohë dhe hapësirë për të diskutuar këtë çështje në seancën që do të zgjatë edhe nesër edhe pasnesër, besoj. Prandaj, po kërkoj mirëkuptim nga ju që të vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës dhe pastaj t'i rikthehemi në qoftë se duhet t'i rikthehemi. Ne nuk kemi asnjë vendim të komisionit përkatës, as të komisioneve përkatëse të cilave ju kemi dërguar dhe ky është... Jo, nuk hapi asnjë debat, nuk hapi asnjë debat për këtë. Unë po kërkoj mirëkuptim pa debat, në qoftë se doni, në qoftë se s'doni, ne e vazhdojmë me rendin e ditës si është.

Unë isha shumë i singertë dhe qëllim mirë, megjithatë ju në qoftë se doni që të flasim dhe të mos vendosim asgjë... Unë po ju kërkoj ndjesë dhe po kërkoj që të dy pikat të shtyhen më vonë, do të thotë, që nesër t'i diskutojmë pas mbledhjes së Kryesisë e cila është e paraparë, në qoftë se ka mirëkuptim, në qoftë se jo, atëherë kuptohet që unë jam i detyruar që t'i nënshtrohem vendimit të juaj. A kemi mirëkuptim për këtë çështje, ju lus që të votojmë formalisht. Okej.

Atëherë, po vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës. Nesër vazhdojmë me pikën e katërt dhe të pestë. E para nuk ka kuorum dhe, e dyta, Nait, të lutem je deputet, unë jam duke folur, jam duke sqarua sinjerisht, s'ka as idhnim këtu, të lus. Të njëjtin mendim e kemi edhe unë edhe ti për këtë çështje, edhe shumica e deputetëve këtu, por ne duhet t'i plotësojmë procedurat ligjore që jemi të detyruar t'i respektojmë, kjo është, vetëm kjo. Dhe nuk është mirë që të hapim debat tani për procedurat dhe prapë të vijmë në përfundimin që duhet ta shtyjmë për nesër këtë çështje.

Prandaj, vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës

Konstatime hyrëse: Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji. Ftoj ministrin, ministri s'është këtu.

Atëherë, vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë e mallrave strategjike

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin, në parim, të këtij projektligji. Ftoj ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, zotin Lutfi Zharku, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë projektligjin.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryesues,
Zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh mungesën e infrastrukturës ligjore dhe nevojën për rregullimin e aktiviteteve në sektorin e eksportit, importit dhe transitit të mallrave dhe të shërbimeve strategjike, e që përfshinë edhe kontrollin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve me këto mallra dhe shërbime, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka hartuar Projektligjin për tregtinë me mallra strategjike.

Ky projektligj rregullon një fushë mjaftë të ndjeshme dhe një herrit mjaftë të rrezikshme të qarkullimit të mallrave dhe të shërbimeve, të cilat mund ta kanosin shtetin, ekonominë, sigurinë e përgjithshme dhe individuale të shtetasve kosovar.

KRYESUESI: Ju lus për qetësi!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Fillimisht, më lejoni të theksoj se mallrat strategjike përfshijnë mallrat ushtarake, si dhe mallrat me përdorim të dyfishtë, të cilat përfshijnë programe dhe teknologjinë kompjuterike të cilat mund të përdoren si për qëllime civile, ashtu edhe për qëllime ushtarake dhe mallra të cilat mund të përdoren për qëllime jo eksplozive, të cilat në çfarëdo mënyrë tjetër mund të ndihmojnë në prodhimin e armëve bërthamore apo të mjeteve tjera eksplozive bërthamore.

Vendimin për përpilimin e listës së mallrave dhe të shërbimeve strategjike në pajtim me listën e mallrave strategjike të Bashkësisë Evropiane e miraton Qeveria.

Projektligji parasheh se personat e interesuar për të ushtruar këtë aktivitet para se të fillojnë veprimtarinë të qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve strategjike duhet të regjistrohen në regjistrin e eksportuesve dhe importuesve të mallrave dhe shërbimeve strategjike, procedurat për mirëmbajtjen e të cilit rregullohen me akt nënligjor. Vetëm personat e regjistruar kanë të drejtë të aplikojnë për licencë, kurse dokumentacioni i nevojshëm për licencim po ashtu përcaktohet me akt nënligjor. Aprovimin e licencës e kryen komisioni, i cili formohet me vendim të qeverisë, që përbëhet nga përfaqësuesit e 5 ministrive që mbulojnë këtë fushë, si: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Forcës së Sigurisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Licenca lëshohet për secilin lloj të eksportit dhe importit veç e veç dhe nuk mund të transferohet te personat e tjerë. Licencën transite për kalim nëpër territorin e Republikës së Kosovës e lëshon Ministria e Punëve të Brendshme. Gjatë procesit të lëshimit të lejes për eksport, lejes për ofrimin e mallrave dhe të shërbimeve strategjike ministria dhe komisioni janë të obliguar që të kujdesen për interesat e politikës së jashtme të sigurisë, mbrojtjes dhe interesat ekonomike të Republikës së Kosovës, si dhe për obligimet e pranuar ndërkombëtare.

Projektligji përcakton obligimin që të mbahet një bazë e të dhënave për licencat e kërkuara, të lëshuara dhe të realizuara, si dhe rastet e anulimit të licencave, hedhjen poshtë të kërkesave për eksporte dhe importet e mallrave në shërbime strategjike.

Po ashtu, ministria është e obliguar që deri më 30 prill të vitit kalendarik të përpilojë një raport vjetor për vitin paraprak për eksportet dhe importet e mallrave dhe shërbimeve strategjike dhe t'i paraqesë Qeverisë me një shkallë sekreti. Ligji parasheh edhe detyrimet dhe obligimet tjera të personave që merren me këto aktivitete sa i përket mbajtjes së regjistrave për transaksionet e kryera, ruajtjen e dokumentacionit, raportimin për ndryshimet eventuale dhe përfundimin e punëve.

Mbikëqyrjen e eksportit të mallrave strategjike dhe vlerësimin e përpjthjes së mallit me licencën për eksport e bëjnë doganat e Kosovës. Në procesin e lëshimit të licencës për eksport dhe pas

lëshimit të saj ministria mund të kryej tek eksportuesi kontrollimin e mallrave strategjike dhe të dokumentacionit në lidhje me ato mallra.

Doganat e Kosovës mbikëqyrin realizimin e eksportit të mallrave strategjike, i cili duhet të kryhet në bazë të licencës për eksport, të lëshuar në pajtim me këtë ligj dhe për të gjeturat e tyre me shkrim i njofton Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në çdo 6 muaj. Mbikëqyrjen e formave të tjera të eksportit dhe ofrimit të shërbimeve strategjike e bëjnë organet e tjera të administratës shtetërore në kuadër të kompetencave të tyre.

Projektligji parasheh edhe masa të ndryshme ndëshkuese për shkelje të dispozitave, varësisht nga pesha, duke filluar nga gjoba në mjete monetare deri në 250% të vlerës së eksportit, dënimin me burg më së paku 5 vjet, si dhe me ndalimin e ushtrimit të aktivitetit.

Të nderuar deputetë,

Duke qenë të vetëdijshëm për rezultate të pritura me miratimin e këtij ligji në parandalimin e përhapjes së pakontrolluar të mallrave ushtarake dhe me përdorim të dyfishtë, që mund të cenojnë sigurinë dhe paqen në vend dhe më gjerë dhe vendosjen e kontrollit në këtë sektor, ju rekomandoj që këtë projektligj ta miratoni në këtë seancë të Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Pas prezantimit të projektligjit, hapi debatin për diskutim, në parim.

Sipas radhës ose renditjes, kryetari ose raportuesi i Komisionit funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion e ka fjalën. Në këtë rast, nuk do të diskutojë kryetari.

Atëherë, vazhdojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare ose kryetarët e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputetja Shala.

SALA BERISHA SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Përhëndetje, zëvendëskryeministër, ministra prezentë,

Përhëndetje kolegë deputetë,

Para se të filloj me analizimin e projektligjit, ju dëshiroj një sesion vjeshtor shumë të suksesshëm dhe dinamizëm më të madh në ritmin e punës së Kuvendit.

Në rend dite pra kemi projektligjin në fjalë, të cilin ekspozë e dha edhe ministri nga ministria që e sponzoroi këtë projektligj.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar me vëmendje projektligjin dhe vlerëson se është një projektligj i cili i duhet sferës legjislative të Republikës së Kosovës.

Qëllimi kryesor për hartimin e këtij ligji për tregtimin me mallra strategjike është harmonizimi me legjislaturën e BE-së. Përmes hartimit të këtij ligji synohet të zbatohen obligimet që i ka Kosova si shtet në përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare për t'i kontribuar parandalimit të tregtimit ilegal të këtyre mallrave të cilat kërcënojnë paqen ndërkombëtare.

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji do të ketë efekte pozitive në kontrollimin e lëvizjes, në veçanti të eksportit të mallrave ushtarake dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë.

Ne, si grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështesim në parim, po më lejoni të jap disa vërejtje, të cilat vërejtje shpresoj që do t'i përmirësojmë edhe në punën tonë gjatë fazës së amendamentimit në komisionin përkatës funksional.

Problem praqet këtu edhe kostoja buxhetore sepse, siç është e paraparë me ligj, nuk janë të definuara mirë, sidomos faktor kryesor dhe përcaktues është kostoja buxhetore, praqet obligim për themelimin e zyrës për kontrollimin strategjik, si dhe komisioni, në të cilin nuk është e paraparë se si do të paguhet komisioni të cilin e themelon Qeveria dhe nuk është e paraparë se sa punëtorë do t'i ketë zyra që do të themelohet në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Një vërejtje më tepër e natyrës teknike dhe që duhet ta ketë parasysh ministri dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është që këtu në faqen 4 të këtij dokumenti kemi komentet për projektligjin, të cilat komente i jep zyrtari nga ministria e Tregtisë dhe Industrisë, të cilat komente nuk është dashur të na vinë neve në këtë material, sepse është dashur të përfshihen këto vërejtje në projektligj dhe të mos na sillen ne si deputetë në parlament që të humbim kohë me këto vërejtje.

Gjatë analizimit të këtij materiali kam vërejtur se disa nga vërejtjet që i ka dhënë zyrtari i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë janë përmirësuar gjatë neneve, ndërsa disa nuk janë përmirësuar, prandaj e paraqesin një lloj konfuzioni, që komisionit do t'i nxjerrin punë pak më të madhe gjatë fazës së amendamentimit të këtij projektligji.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës edhe një herë e mbështesim, në parim, duke shpresuar se do të vijë në nivelin e duhur gjatë fazës së amendamentimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëendetje kolegë deputetë,

Ministra të nderuar, zëvendëskryeministër,

Projektligji për tregtinë e mallrave strategjike, për Grupin Parlamentar të LDK-së merr vlerësimin e rëndësishëm të veçantë. Përveç asaj që tha ministri në ekspozitën e tij, pra, për arsye të cilat ky projektligj i ka lidhur me sigurinë, lidhur me çështjet që kanë impakt në ekonominë e vendit, po përgjithësisht edhe në stabilitetin e përgjithshëm të vendit, që ka të bëjë me mallrat strategjike. Prandaj, drafti i afruar mundëson rregullimin e këtyre aktiviteteve, përmasat të cilat i ka paraparë, institucionet relevante dhe përgjegjëse të cilat duhet të merren me këtë sektor, si dhe për kontrollin e domosdoshëm që duhet të jetë në pajtim me standardet të cilat synohet të arrihen, që edhe vendi ynë t'i përmbushë ato.

Prandaj, në parim ne e përkrahim dhe, po ashtu, deputetët tanë do të marrin pjesë në komisione funksionale, në debate të cilat ka nevojë që ky projektligj që të begatohet edhe më shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Konsiderojmë si grup parlamentar që ky ligj është i nevojshëm për vendin pasi që e mbulon një sferë specifike të institucioneve të Kosovës në fushën e eksportit, importit dhe transitit të mallrave strategjike, fushë e cila deri më tani nuk është mbuluar me asnjë ligj përkatës. Por, përshtypja jonë është se për shkak të presionit të kohës, ndoshta ligji është përgatitur si shpejt e shpejt dhe si rezultat i ka edhe disa mangësi teknike, por ka edhe shpërputhje në përmbajtje në mes të tri gjuhëve që na afrohet ligji, që shumë herë na sjell edhe në konfuzion se cila është përmbajtja e vërtetë. Po ashtu, edhe dilema lidhur me koston reale të implementimit. Ne e kemi parë çka shkruan në raportin e Ministrisë së Financave për koston, mirëpo ka një dilemë a do të jetë ajo kosto reale e implementimit të ligjit.

Prandaj, mendojmë që deri në aprovimin final duhet të eliminohen këto mangësi të cilat mund të bëhen dhe janë të domosdoshme që të eliminohen dhe Grupi ynë do të japë kontributin e vet për këtë qëllim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet për Kabinetin qeveritar dhe për të gjithë deputetët në fillim të këtij sesi.

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar, në parim, Projektligjin për tregtinë e mallrave strategjike. Duke marrë parasysh se me këtë projektligj rregullohen veprimtaritë e institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës në fushën e eksportit, të importit dhe të transitit të mallrave dhe shërbimeve strategjike, si dhe kontrollin mbi këqyrjen e të drejtave dhe detyrimet e palëve që marrin pjesë në aktiviteti e biznesit nga kjo fushë për përdorimin e fundit, Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah në parim këtë projektligj. Ky projektligj bën edhe kontrollin e tregtimit të këtyre mallrave për mbikëqyrjen, kur dihet se Kosova edhe pse nuk është anëtare e strukturave gjegjëse ndërkombëtare, obligohet të mbikëqyrë dhe të kontrollojë këtë fushë dhe të respektojë konventat ndërkombëtare lidhur me këtë çështje.

Projektligji parasheh që me tregtinë me mallra strategjike të administrohet nga njësi e veçantë për kontrollin e eksportit brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Ndërsa kontrollimin e licencave dhe të eksportit të mallrave ushtarake dhe të mallrave me përdorim të dyfishtë dhe strategjik bëhet nga komisioni ndërministror, ku janë të gjithë përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë, të Punëve të Jashtme dhe të Punëve të Brendshme, FSK-së, MEF-it, gjegjësisht edhe nga doganat.

Anëtarët dhe zëvendësanëtarët e këtij komisioni propozohen nga ministrat e linjave dhe emërohen nga Qeveria e Kosovës. Duke marrë parasysh se ligji ka jo mbulesë buxhetore, mirëpo duke marrë parasysh se licencat të cilat jepen këto mallra mundësojnë që ky ligj të mbulohet nga këto licenca në zyrën e cila do të jetë e përfaqësuar në Ministrinë e Tregtisë, atëherë shoh që nuk do të ketë mundësi që për shkaqe buxhetore të mos implementohet ky ligj.

Duke marrë parasysh që Kosova është shtet që vetëm tri vjet dhe rregullimin e kësaj fushe me qëllim të parandalimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, sigurisë, parandalimin e shumë akteve terroriste, Grupi Parlamentar i AKR-së e mirë pret dhe përkrah dhe të gjitha vërejtjet teknike të cilat në këtë ligj do të paraqiten, do t'i japë në komisionin parlamentar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetja Morina.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Ministra, deputetë të nderuar,

Edhe pse këtij projektligji i jepet një rëndësi e veçantë në memorandum shpjegues të Ministrisë së Tregtisë, si sponzoruese e këtij projektligji, me arsye se Kosova nuk ka legjislacion ta aplikueshëm që mbulon këtë fushë, pastaj shpjegimi se për hartimin e këtij projektligji janë marrë për bazë ligjet e BE-së, por edhe pas prezantimit të juaj, zoti ministër, ende për LDD-në po mbeten shumë dilema dhe paqartësi lidhur me synimin dhe zbatueshmërinë efektive të këtij projektligji.

Dilemat tona lidhur me këtë projektligj janë në nenin 6, 7, kanë të bëjnë me eksportin e mallrave strategjike, nuk është e qartë cilat janë këto mallra strategjike që duhet licencuar nga komisioni, gjegjësisht Ministria e Tregtisë. Gjithmonë duke pasur parasysh se sipas këtij projektligji autorizimin për eksport e import të mallrave strategjike, të caktuara për FSK-në dhe institucionet shtetërore të sigurisë, lëshohen nga Ministria e Forcës së Sigurisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme. Gjithashtu, licencën transite për kalimin nëpër territorin e Republikës së Kosovës e lëshon Ministria e Punëve të Brendshme.

Sipas legjislacionit të BE-së që ka të bëjë me tregtinë e mallrave strategjike, kryesisht përfshin kontrollin e tregtisë së armëve dhe rregullimin e kontrollit të pajisjes së teknologjisë ushtarake. Atëherë, me arsye shtrohet pyetja - cilat janë ato mallra strategjike që licencohen për eksport dhe import nga Ministria e Tregtisë?

Gjithsesi do të duhej sqarimi shtesë nga ju, zoti ministër, për licencat për eksport që mund të kërkojnë dhe licencat kur bëhet fjalë për eksportin e mallrave të cilat nuk janë shënuar në dispozitat e këtij projektligji dhe atë e kemi në nenin 7.5.

Gjithashtu, do të citoja një nen ku janë aq shumë paqartësi të mëdha dhe do të kërkoja, zoti ministër, nëse do të mund të na qartësoni. Është neni 7. 5.1, thotë: Pas informatave të autoriteteve përgjegjëse nga vendi, destinacioni që mallrat strategjike në pyetje janë apo mund të përdoren në tërësi ose pjesërisht për përdorim në lidhje me zhvillimin, prodhimin, trajtimin, veprimin, mirëmbajtjen, deponimin, identifikimin, zbulimin ose përhapjen e armëve kimike, biologjike ose bërthamore apo mjeteve të tjera bërthamore, mjeteve atomike apo zhvillimin, prodhimin, mirëmbajtjen dhe deponimin e raketave të afta për dërgimin e armëve të tilla. Për mua, për ne ky nen ka qenë total i pa qartë.

Gjithashtu, në nenin 30 parashihet lëshimi i licencave për shërbime strategjike nga komisioni. Nuk është e qartë se çfarë shërbime strategjike janë këto, duke pasur parasysh që në përkufizim të këtij projektligji nuk gjejmë shpjegimin për shërbime strategjike. Gjithashtu, është evidente joserioziteti i paraparë sipas dispozitave të projektligjit, e që ka të bëjë me kontrollin e eksportit e importit të mallrave strategjike, si dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të biznesit nga kjo fushë, të kryhet nga komisioni, që është nga 5 anëtarë, nga përfaqësues të ministrave të ndryshëm, për të cilët kostoja shtesë buxhetore për një vit vlerësohet 12.000 deri 20.000 euro, që përfshin pagat dhe shpenzime e mallra.

Për ta kuptuar se çfarë dimensionit të gjerë dhe të rëndësishëm ka ky komision, gjegjësisht zyra e kontrollit, e që përcaktohet në nenin 37, që gjatë lëshimit të lisenave obligohet të mos rrezikojë strategjinë e sigurisë kombëtare të Kosovës, të mos rrezikohet paqja, siguria e stabilitetit rajonal gjatë lëshimit të këtyre licencave, atëherë shtrohet pyetja - sa mund të kryej këtë punë ky staf prej 5 anëtarëve me këtë buxhet. Duke pasur parasysh të gjitha dilemat dhe paqartësitë që i kemi, ne në parim nuk do ta mbështesim këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputetja Shpresa Murati e ka fjalën.

SPRESA MURATI: Hvala, predsedavajući!

Pozdrav svima,

I parlamentarna grupa „7+“ je takođe razmatrala Nacrt zakona o trgovini strateškom robom i u načelu ga podržava. Iz memoranduma se vide ciljevi i značaj ovog Nacrta zakona, te i način njegovog donošenja sa obrazloženjem o usklađenosti sa međunarodnom regulativom iz ove oblasti. Iz teksta nacrta se vidi da isti reguliše trgovinu robe strateškog karaktera, vojne robe ili robe kojima se izrađuje ili može izraditi hemijsko, biološko ili nuklearno oružje. Radi se uglavnom o relativno dobro izrađenom nacrtu, ali ono što nas interesuje jeste da upoređujući verzije Nacrta zakona, da smo uočili izvesne neusklađenosti termina koje se koriste u čitavom nacrtu zakona. Na primer, u verziji na našem jeziku, koriste se termini kao što su: „aplikant“, „aplikacija“, a trebaju se zameniti, jer je to urađeno i u verziji na albanskom jeziku, gde se koriste termini: „zahtev“ ili „podnosilac zahteva“

U članu 23. takođe naziv poglavlja glasi: „odbija aplikaciju“, trebalo bi da stoji: „odbijanje zahteva“. Zatim, u članu 31. takođe se koristi izrazi: „jedna deklaracija“, „jedna izjava“, „jedno ovlašćenje“, „jedan pisani izveštaj“ i tako dalje. Smatramo da treba da se ovaj izraz “jedan” izostavi.

Ako se kaže „ovlašćenje potpisano od odgovorne osobe“, logično je da se radi o jednom ovlašćenju i tako dalje. Na kraju, još jednom ponavljam, Parlamentarna grupa „7+“ u načelu podržava ovaj Nacrt zakona uz ove naše primedbe. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk ka të paraqitur.

Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, deputeti Vlladimir Todoroviq.

VLADIMIR TODOROVIC: Hvala, gospodine predsedavajući!

Pozdrav svim prisutnima.

Parlamentarna grupa za integraciju je razmatrala zakon i smatra da je ovo pozitivno i ona će u načelu da podrži ovaj Zakon. Hvala, puno!

KRYESUESI. Ju faleminderit! Konstatohet që grupet parlamentare janë deklaruar, tani sipas radhës, deputetët.

Është paraqitur deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues!

Qeveritarë, deputetë të respektuar,

Disa vërejtje parimore. Natyrisht e mbështesim dokumentin e tillë, por qëllimi është se ta bëjmë sa më të mirë që është e mundur.

1. Projektligji në fazën e projektit, përmban definime nocionale të mangëta e herë-herë edhe të pasakta. Dispozitat ligjore të tilla, në disa raste në vend që të ishin të sistematizuara organikisht, janë të disperzuara dhe të specifikuara kurdoherë jo në stil dhe përmbajtje konzistente.

2. Me dispozitën e nenit 1, paragrafi 17 dhe të nenit të njëjtë, paragrafi tregon nuk është specifikuar përmbajtjesisht emërtimin i organit për zbatimin e normave ligjore, referuar tregtisë së mallrave

strategjike, por është quajtur përgjithësisht Komisioni, vetëm Komisioni a ishte dashur omen est nomen, domethënë, emërtimi ta reflektojë një përmbajtje që kur e dëgjon emërtimin, domethënë e dimë se për çfarë funksionesh është ai organ e kështu me radhë.

3. Në vend të normimit të vendosjes së Komisionit me konsensus për lejimin e eksporteve dhe të importeve të mallrave dhe të shërbimeve strategjike, siç është vepruar me nenin 5, paragrafin 8 të këtij projektligji, do të duhej të kërkohej që në vend të konsensusit, të kërkohej shumica absolute e votave të atij organi. Dihet fare mirë se konsensusi është fort i dëshirueshëm dhe do të ishte me kuptimin e plotë demokratik si të them, por është shumë problematik, prandaj në rrethanat e caktuara mjafton që një të dështonte dhe të zhagitet procesi. Edhe çështjet shumë më të rëndësishme, shoqërore politike, ekonomike, në dokumentet tona, janë përcaktuar që të miratohen me shumicë herë- herë të kualifikuar, herë-herë absolute, por ndoshta edhe relative se sa po e zëmë vendosja për importime, eksportime, prandaj, do të duhej të rishikohen natyrisht, unë nuk jam kategorik se të bëhet modifikim.

4. Dispozitat e neneve 3, paragrafi 4 dhe 7 të këtij dokumenti, duhet të harmonizohen reciprokisht në favor të shmangies së konfuzioneve referuar autorizimeve për dhënie të licencave dhe për eksportim, importim të mallrave strategjike. Ndryshe, sipas diksionit aktual të atyre dispozitave, do të rezultonte se sikundër Komisioni, ashtu edhe ministri, do të kishin autorizime për dhënie të licencave, natyrisht komentimet praktike të tilla do të mund të rezultonin gjatë interpretimeve të dispozitave të theksuara.

5. Dispozitat e neneve 12, 13, 14, referuar procedurave të refuzimeve të evidencimeve në regjistër, jo të regjistrimeve në regjistër se do të ishte tautologji, ndryshimeve në regjistër si dhe fshirjeve nga regjistri, me këtë projektligj është lëshuar normimi i mjeteve juridike, në një anë dhe i afateve për aplikimin e atyre, në anën tjetër. Kjo është shumë me rëndësi në ligje, afatet, mjetet juridike janë substancë e akteve ligjore. Rrjedhimisht, as me dispozitën e nenit 16 të po të njëjtit akt ligjor, nuk është rumbullakuar rregullimi juridik i heshtjes administrative eventuale të Komisionit, përkatësisht i procedimeve vijuese ç' prej vendosjes nga Komisioni. Shpeshherë ndodh në praktikën jo vetëm tonë, por edhe të shteteve që janë me të vërtetë kështu me tradita, me të mira, që paraqitet heshtja administrative. Te ne, pothuaj se gati është rregull, prandaj do të duhej medoemos ky institut juridik të rregullojë ashtu si duhet edhe dihet si duhet.

Në vend të formulimeve të alineve të para të neneve 23 dhe 32 të këtij projektligji ku thuhet: "Ministria do ta refuzojë kërkesën për licencë, përkatësisht Ministria do të refuzojë regjistrimin", do të duhej riformuluar ato tekste me plotësimin me institutin juridik, aktvendim, sepse me këtë palës në procedurë i hapet mundësia e procedimit të mëtejshme nëse do të vlerësonte se çështja i është vendosur paligjshëm. Është çështje substanciale juridike, se nëse do të vendoste me akt juridik material, nuk do të kishte të drejtë ankese, bie fjala në procedurë, në akt juridik, bie fjala administrativ, atëherë do të kishte mundësi, bazë juridike për të proceduar, po qe se do të donte, në instancën e dytë po eventualisht edhe në konfliktin administrativ. Po qe se nuk do të modifikohet teksti i nenit 55 të projektligjit, me të do të cenohej parimi për të drejtën e fituar në dëmin e entiteteve natyrale e legale të licencuara për importim, për eksportim të mallrave strategjike të proceduara dhe konform me dispozitat valide para miratimit të po këtij projektligji se është parim shumë me rëndësi për të drejtat themelore të njeriut edhe të qytetarit edhe të entitetit, qoftë natyral qoftë legal, që e drejta e fituar, ju lutem nëse është fituar në procedurë ligjore, konform me ligjin, ajo nëse do të ishte më e volitshme për palën, më e favorshme se sa me aktin tjetër, bie fjala me këtë dokument kur do të miratohej se do të vlente e drejta e opsionit të palës. Natyrisht pala kurdoherë do të përcaktojë për dispozitën më të volitshme, prandaj, kjo është një

çështje substanciale. Natyrisht, po qe se do të miratoheshin këto vërejtje, ka edhe të tjera për hir të kohës dhe të durimit nuk i kamë vu në pah, do ta kisha mbështetur me kënaqësi këtë dokument. Ju falënderohem!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet të nderuar ministra dhe ju kolegë deputetë,

U paraqita për një digresion ndoshta për t'i dhënë një ide Komisionit, se t'iu them të drejtën edhe mua pak, përkufizimi i ligjit po më vë në dilemë se si do të gjejë zbatueshmëri ky ligj dhe do të jetë pak vështirë për Ministrinë dhe ata që janë kompetentë për të caktuar, për të definuar një mall strategjik? Për një vend që është prodhues i bananeve dhe 90% e eksportit varet prej bananeve, mall strategjik janë bananet, kurse për një vend i cili ballafaqohet me ujë të pijshëm, mall strategjik është edhe uji i pijshëm. Edhe gruri edhe mielli, janë mallra strategjik. Përkufizimi, tregtimi i mallrave strategjik nuk do të thotë kurrëgjë në rastin konkret për sferën të cilën po e trajton ky ligj.

Këtu bëhet fjalë për mallra të cilat rrezikojnë shëndetin publik, sigurinë e qytetarëve dhe paqen ndërkombëtare. Ekskluzivisht janë këto janë këto, ligji do të duhej të përkufizohej pikërisht në këto mallra, qofshin ato mallra të finalizuar, qofshin si elemente për prodhimin e mallrave të cilat rrezikojnë shëndetin publik, e rrezikojnë sigurinë e qytetarëve dhe sigurojnë paqen ndërkombëtare. Unë mendoj se këtu ligji duhet të përkufizohet ndryshe edhe vërejtjet që i dhanë kolegët janë pikërisht këtu se paraqet konfuzion çka do të caktojmë ne si mall strategjik në Kosovë? Për ne janë shumë mallra të cilat ndikojnë pozitivisht në shëndetin e qytetarëve dhe nuk e rrezikojnë fare sigurinë e qytetarëve që janë mallra strategjik, janë mallra të cilat na nuk i kemi, për shembull, e duhet t'i sigurojmë në tregun ndërkombëtar.

Unë mendoj se ky ligj duhet të përkufizohet përafërsisht kështu ose duhet të gjendet një zgjidhje në konsultim edhe me ekspertë, përkatësisht në konsultim edhe me legjislacionin e shteteve në rajon ose të ndonjë shteti të Bashkimit Evropian, që këto probleme i kanë të gjëra. Ndoshta ministri do të na jap edhe sqarime se në cilën përvojë legjislative është bazuar kur e ka hartuar këtë ligj? Unë mendoj se ligji ndoshta do të duhej të quhet kështu: Projektligji për tregtinë e mallrave të cilat rrezikojnë shëndetin publik, sigurinë e qytetarëve, paqen dhe stabilitetin ndërkombëtar ose sigurinë ndërkombëtare, paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Ndoshta, kështu do të ishte më lehtë, pastaj edhe nomenklatura e mallrave të përshkruhet gjatë procedimit të mëtutjeshëm në ligj.

Duke e përkrahur në parim dhe duke u pajtuar edhe me mendimin e Grupit Parlamentar, unë mendoj që duhet mjaft punë për të bërë një ligj të qartë, të kuptueshëm dhe të zbatueshëm në të ardhmen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! fjalën e ka deputeti Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Faktikisht edhe unë i bashkëngjitëm shqetësimeve që i thanë kolegët sa i përkufizimit se nga ajo kur lexohet shihet që këtu ka të bëjë kryesisht me mallrat ushtarake, domethënë, tregtinë e këtyre mallrave, ose nëse s' është kështu, atëherë duhet të përkufizohet qartë se në përkufizime çka nënkuptojnë mallrat strategjike dhe duhet të decidivohen në atë mënyrë që të kuptohet se për çka bëhet fjalë.

Unë do të ndalem edhe te disa çështje tjera, duke ditur që ky ka një karakter më gjithëpërfshirës, konsideroj që do të jetë ngarkesë për kapacitetet e Ministrisë të Tregtisë dhe të Industrisë, sepse kjo çështje nuk e ka vetëm karakterin komercial, por i ka edhe karakteret e sigurisë që të monitorojë zbatimin në praktikë të këtij ligji kur dihet që këtu do të tregtohen armë, qoftë me karakter të sigurisë së vendit për nevojat e policisë apo të ushtrisë, qoftë për nevojat e tregut komercial, domethënë, të pajisjes së qytetarëve me armë të lejuara nga autoritetet kompetente dhe konsideroj që ka të bëjë me çështjen e sigurisë dhe implikimi apo përgjegjësia e monitorimit nga një mekanizëm siç është Ministria e Tregtisë, Industrisë, për kapacitetet ekzistuese do të lë për të dëshiruar.

Duke e ditur që Ministria e Punëve të Jashtme, ndoshta ende s' e ka të rregulluar sektorin e tregtisë së jashtme, konsideroj që edhe këtu, kjo çështje implikimi në Komisionin përkatës për këtë fushë sa i përket licencave dhe çështjeve tjera, është për të dëshiruar. Unë mendoj që duhet të paktën për një periudhë tranzitore t'i jepet një rol Zyrës së Kryeministrit, përfaqësimit në këtë komision për shkak të karakterit më të gjerë që e ka kjo çështje, ndërsa Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Forcës, Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Sigurisë, duhet pa ashtu një rol më i theksuar në këtë komision.

Tek neni 3, ku flet po ashtu për Komisionin, unë kam vërejtur te pika 8, në kërkesat për aprovimin për eksport dhe import të mallrave dhe shërbimeve strategjike, jepet nga Komisioni me konsensus, thuhet. Mandej vazhdon, në rast të mungesës të një prej anëtarëve të Komisionit, e drejta për të votuar i bartet zëvendësit të tij. Mendoj që është një lapsus, konsideroj që e drejta për të votuar nuk mund t'i bartet askujt dhe kjo në praktikë juridike nuk njihet dhe mendoj që as në këtë komision nuk duhet të jetë kështu. Në rast se thuhet me konsensus, bëhet fjalë për mallra ushtarake dhe gjithë faktorët, qoftë në rast se mungon një përfaqësues ose jo, duhet të ketë zëvendësim nga organi kompetent, shembull në rast se mungon përfaqësuesi i Ministrisë së Rendit, duhet të dërgohet plotësimi, por jo që dikush të votojë për të në nivel të kryetarit ose të nënkryetarit.

Po ashtu tek neni 5 thuhet: "Nëse procedura e lëshimit të licencës për eksport, import dhe transitit të mallrave dhe shërbimeve strategjike nuk është e rregulluar me këtë ligj, zbatohen dispozitat e ligjeve tjera në fuqi." Mendoj që këtu duhet të saktësohet a ka ligje tjera në fuqi që e rregullojnë këtë çështje dhe është një praktikë e njohur deri tash kur në fund, në dispozitat përfundimtare thuhet që me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë të zbatuarit tjera dispozita, në ligje tjera? Dhe, këtu është një çështje tjetër që për mendimin tim, nuk ka një sqarim të nevojshëm se çka është dashur të thuhet me këtë. Edhe tek neni 7, pika 2, ku flitet për lejet apo licencat si shkruan, nga paragrafi 1 i këtij neni lëshohen në kohëzgjatje deri në 6 muaj. Unë mendoj që kohëzgjatje mund të jetë edhe më e madhe, por mos të ketë procedura burokratike sa i përket kësaj çështjeje. Ndërsa është e drejtë e organit kompetent ta mbikëqyrë në punën ndoshta edhe ditore të veprimtarisë ekonomike që e bën ky subjekt i pajisur me leje për ushtrimin e këtyre veprimtarive. Edhe një çështje tjetër që ka karakterin gjuhësor, është fjala te neni ku flitet për lejet, domethënë, shënohet neni 1.18 licencë, licence, licenca në gjuhën serbe, domethënë, kërkoj që të jetë në gjuhën shqipe leje dhe në këtu gjuhë tjera ashtu siç është, domethënë, të mos të quhet "licencë" por "leje".

Përndryshe, në parim e mbështes këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Naim Maloku e ka fjalën

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Unë me qëllim e lash të paraqitem kah fundi për t'i dëgjuar opinionet e deputetëve në lidhje me këtë projektligj. Sinqerisht mendoj se Kuvendi duhet sot këtë ligj t'ia kthejë Qeverisë ose ta heqë nga rendi i ditës.

I ftoj deputetët që posaçërisht vëmendje t'i kushtojnë nenit 7, të licencat ku Ministria që është për shembull neni 7, paragrafi 1, Ministria lëshon licencë eksporti ose importi për secilin lloj të eksportit ose importit veç e veç. Dhe, pastaj të gjithë paragrafët e këtij neni, kanë të bëjnë me mallrat të cilat praktikisht mendoj që Kosova në këtë fazë nuk ka kapacitete të mjaftueshme ekspertësh, njerëzish të cilët mund për t' i dhënë vlerësimet në mënyrë të duhur dhe në nivel profesional për t'u dhënë këto licenca të parapara në krejt nenin 7 të këtij ligji. Pra, Kosova për momentin edhe një kohë të gjatë nuk do të mund të ketë, të ngritë kapacitete që mund të monitorojnë ose mund të vlerësojnë dhënien, arsyet e dhënies së licencave dhe për këto armë për të kaluar nëpër territorin të Kosovës ose për t'u bërë Kosova, qoftë edhe si vend transiti i këtyre. Ne nuk mundemi t'i prodhojmë këto edhe një kohë të shumë të gjatë Kosova nuk mund të ketë kapacitete të afta për t'i prodhuar këto armë për të cilat bëhet fjalë këtu dhe për këto mjete, por edhe në Kosovë edhe një kohë të gjatë mendoj nuk mund të ketë kapacitetin mbikëqyrëse dhe monitorues të këtyre mjeteve.

Mendoj se këto ligje nuk është e thënë që Kosova tani t'i kopjojë ligjet e shteteve të përparuara perëndimore siç janë: Italia, Gjermania, e ku ta di unë, dhe ne t'i kemi domosdo edhe ato ligje, mendoj se Kuvendi duhet të vendosë në favor të heqjes të këtij ligji nga procedura e mëtejme dhe e ftoj ministrin që ta bëjë tërheqjen e këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Në fakt ato çka i thanë parafolësit, nuk dua t'i përsëris vetëm pse ekziston një konfuzitet i madh sa i përket këtij projektligji, do ta shtoja vetëm edhe një element.

Me këtë projektligj, Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Kuvendi nëse e miraton, i jep dritën jeshile legalizimit të tregtisë me mallra siç po e quajmë strategjikisht të rëndësishme. Në këtë rast janë mallra të cilat i dedikohen dy resorëve: FSK-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kryekëput, nëse dikush do ta lexonte vetëm përmbajtjen, atëherë do të bindej se sponzoruesi i këtij projektligji është Ministria e Punëve të Brendshme ose Ministria e FSK-së. Pse po e them po e legalizon, se kemi të bëjmë me persona fizikë dhe juridikë? Vetëm shikoni dispozitat ndëshkuese, kujt ai dedikohet. Nuk ka këtu të bëjë me ministrinë përkatëse për blerjen apo tregtimin e mallrave strategjikisht të rëndësishëm për nevojat e veta.

Kosova do të shndërrohet në një vend transit dhe pjesë, qoftë e personave fizikë ose juridikë, të cilët do të jenë pjesë e kësaj tregtie. Konsideroj që Ministria përkatëse, respektivisht Qeveria nuk i ka hartuar prioritetet e veta në kuadër të nevojave që i ka sot Kosova, prandaj, është një ligj i cili të gjitha vendet tjera, në qoftë se e kanë të rregulluar me rregullore të veçanta, në qoftë se po thirrem në direktivat e vendeve të BE-së, atëherë ne përmes të një projektligji kemi dashur të inkorporojmë shumë elemente të padefinuara në bazë të këtij ligji të cilat do të realizohen përmes rregulloreve apo përmes akteve nënligjore. Pra, lista e mallrave strategjikisht të rëndësishme në bazë të këtij projektligji, nuk është e definuar dhe atëherë ne këtë resor, këtë element, këtë dispozitë po e trajtojmë sikurse të jenë mallrat e tregtisë së përditshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nuk ka diskutues tjerë. Në sallë janë prezentë 66 deputetë. Përfaqësuesi i Qeverisë a e do fjalën? Nuk e do fjalën. Tani kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit. Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim. Votojmë, tani.

Konstatohet se “për” kanë votuar 49 deputetë, 12 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet Ligji për tregti me mallrat strategjike.

Ju faleminderit!

A doni pauzë 10 minuta ?

Mendoj se është herët për pauzë të drekës...

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK- së e kërkon fjalën.

Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: E di që ndoshta është pak herët, por munde ta vazhdojmë pak më gjatë, zotëri kryesues, për shkak të disa obligimeve që i kemi të pashmangshme, ju kisha lutur që të jetë së paku prej orës 12,45 pauza për drekë.

KRYESUESI: Okej, atëherë e bëjmë pauzën deri në orën 14,00

Vazhdimi i seancës pas pauze

Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë po vazhdojmë, me pikën:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Ministrisë të Punëve të Brendshme, zotëri Bajram Rexhepi, që në emër të Qeverisë, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Ju faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Parlamentit,

Fillimisht ju falënderoj që ma mundësitë të ndërrohet pak rendi i ditës. Ishin në 11- vjetorin e Policisë së Kosovës, kështu që në atë kohë kur ishte ligji, mu desh të jem në atë përvjetor.

Më lejoni që të paraqes para jush projektligjin e ri për Inspektoratin Policor të Kosovës Me projektligjin e ri të Inspektoratit Policor të Kosovës, përcaktohen: misioni, organizimi, funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit Policor të Kosovës, si agjenci e pavarur në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Objekt i veprimtarisë së Inspektoratit Policor të Kosovës, me këtë projektligj është: parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite, inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës, për të

siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet, hetimi dhe inspektimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë së Kosovës, si dhe hetimi i të gjitha shkeljeve disiplinore të zyrtarëve policorë me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhmentit, kolonelë policorë dhe zyrtarëve policor të nivelit të lartë ekzekutiv, menaxhmentit të Policisë, përveç drejtorit të përgjithshëm të Policisë.

Përmes këtij projektligji synojmë të sigurojmë polici të përgjegjshme, demokratike dhe transparente, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara ndërkombëtare.

Disiplina e rënë policore që aktualisht me ligjin në fuqi është përgjegjësi e Inspektoratit Policor të Kosovës, tani me këtë projektligj bartet si përgjegjësi e Policisë së Kosovës, përveç zyrtarëve policorë me gradën më të lartë dhe menaxhmentit të Policisë së Kosovës. Po ashtu më lejoni të potencoj se ky projektligj është hartuar në koordinim dhe bashkëpunim të plotë në të gjithë mekanizmat ndërkombëtarë që veprojnë në Republikën e Kosovës.

Në fund kërkoj që Kuvendi i Kosovës ta aprovojë në parim këtë projektligj, në mënyrë që i njëjti t'i nënshtrohet procedurës së mëtejme. Ju faleminderit për mirëkuptim.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Sipas radhës, në emër të Grupit parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën?
Deputeti Ramë Buja e ka fjalën.

RAMË BUJA: Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e kemi pas caktuar Rustem Mustafën, që të flasë për këtë projektligj, por megjithatë unë po i them disa fjalë. Grupi e ka analizuar edhe natyrisht se e mbështet në parim dhe kontributin e vet do ta japë në komisionet gjegjëse parlamentare për ta përplotësuar dhe bërë më të mirë ligjin në fjalë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Sabri Hamiti, e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Ne e kemi vendosur në Grupin Parlamentar që ta përkrahim në parim këtë ligj. Është dashur shefi i grupit ta japë arsyetimin, por besoj që e jep kur të mbërrijë. Ne e përkrahim në parim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Mjafton edhe fjala e juaj.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka Shkunbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zotëri kryetar!

Lidhur me projektligjin në fjalë për Inspektoratin e Punës edhe ne si grup parlamentar e përkrahim, mirëpo kërkojmë gjatë punës, personalisht jam anëtar i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri. Do të cilësojmë se do ta hartojmë një ligj të mirë me atë amendamentim, sepse edhe kësaj radhe, në kuadër të këtij projekti që është projektligj, ende nuk i jepet mundësi Inspektoratit që të ketë vendime ekzekutive brenda vetes dhe mos të mbesin vetëm vendime politike, ashtu siç na ka ndodhur deri tani që ministri thotë fjalën e fundit lidhur edhe me këtë autoritet ekzekutiv. Më vjen mirë që po bëhet agjencion se ka qenë një prej mekanizmave që ka qenë ekzekutiv edhe formë e inspektimit, por edhe të bëhet një barazim me mekanizmat tjerë, si agjencitë tjera ekzekutive që janë brenda ministrive të ndryshme edhe vetë Qeverisë.

Ju faleminderit, shumë! E përkrahim projektligjin dhe shpresojmë se do ta hartojmë një ligj të mirë.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli, e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar zotërinj ministra,

Të nderuar kolegë,

Projektligji në fjalë, më duhet të them fillimisht se ndryshon komplet strukturën organizative të mekanizmave të sigurisë në Kosovë, duke krijuar kështu edhe një organizëm tjetër që është polici mbi Policinë në Kosovë, me çka konsideroj se bie në kundërshtim edhe me vetë qëllimin dhe misionin për çka është themeluar Inspektorati Policor i Kosovës.

Neni 3 i projektligjit në fjalë thotë që misioni i Inspektoratit Policor të Kosovës, është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së tij, të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ndërkaq, në kreun 3 të këtij projektligj, kemi kompetencat themelore. Ndër tjera, thotë që hetuesit e Inspektoratit Policor të Kosovës, gjatë veprimtarisë së tyre kanë autorizimet policore, kjo nënkupton që kemi edhe një polici mbi polici, me çka në të vërtetë krijojmë dualizma brenda vetë institucioneve.

Grupi Parlamentar i AKR-së, nuk e mbështet projektligjin në fjalë me arsyetimet të cilat i dhashë dhe konsideroj se kur kemi reforma të tilla në këto institucione, do të duhej që paralelisht të jenë edhe në Ligjin për Policinë e Kosovës, sepse në Ligjin për Polici të Kosovës, flet krejt diçka ndryshe, ndërkaq në projektligjin në fjalë, është krejt diçka ndryshe. Thjesht kështu po krijojmë dy mekanizma që kanë të njëjtin qëllim dhe të njëjtat kompetenca, madje në disa prej fushave, Inspektorati Policor i Kosovës i merr kompetencat e Policisë, çka nuk do të duhej të ndodhë në asnjë rast. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit,

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet në parim projektligjin, duke e konsideruar se avancimi i pozicionit të Inspektoratit Policor të Kosovës, do të ndikonte drejtpërsëdrejti në vendosjen e një bazamenti të mirë për funksionimin e Policisë së Kosovës në tërësi, në mënyrë që të ngritët edhe profesionalizmi edhe sjellja edhe besimi në raport me qytetarët e Kosovës, por edhe në raport me, në veçanti po e them kur kemi të bëjmë me avancimin në ngritjen e kësaj strukture dhe të këtij mekanizmi të sigurisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit “7+”, fjalën e ka deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Dola para jush se shumë rrallë po dal, e ai që del rrallë han bakllavë.

Zotëri kryetar, ju faleminderit për fjalën që ma dhat.

Ju përshëndes juve si dhe zotëri ministrin!

Sot para nesh e kemi Ligjin për Inspektoratin e Policisë, i cili ligj para tij ka qenë shumë më i dobët se ky ligj që e kemi përpunuar sot, ashtu- kështu një ligj vërtet nuk di pse të kemi dilemë që duhet diçka të diskutojmë që a është dy si Policisë e si Inspektoratit? Mua më duket se shumë mirë

e tha shefi i Grupit që ky është një ligj si i Policisë e si Inspektoratit. Por një send është këtu që unë e kisha dhënë mendimin tim që, në qoftë ndonjë polici ose anëtar i inspektoratit vritet ose i bëhet diçka, vetëm familja e tij mund 12 muaj të marrë ndihma, kurse unë kisha thënë për 12 muaj. Mirëpo, pas 12 muajve çka do të bëjë ajo familje, çka do të hajë, a nuk do të hajë edhe pas 12 muajve? Për atë kisha thënë jo 12 muaj, por mendimi i Grupit “7+” është që të bëhet pensioni për atë familje që e humb anëtarin e vet nëpër, ku ta di unë qysh i ndodh atij. Për këtë Grupi “7+” e mbështet edhe do ta përkrahim ligjin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputeti Slobodan Petroviq e ka fjalën.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Uvaženi ministre,

Poštovani kolege, narodni poslanici,

Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke, imajući u obzir važnost ovog zakona će prihvati u načelu ovaj predlog zakona, s tim što uzimamo obavezu da ćemo kroz funkcionalne komisije da damo doprinos u jačanju ovog zakona kroz amandmane koji slede. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Ju faleminderit! Nga Grupi Parlamentar për Integritet, nuk ka të lajmëruar.

Kemi tre deputetë që janë lajmëruar. Fjalën e ka Sanije Aliaj.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Funksionimi i një shërbimi policor demokratik të përgjegjshëm, është fushë shumë e nevojshme për të rregulluar me ligj që i plotëson standardet bashkëkohore. Aktualisht është në fuqi Ligji për Inspektoratin e Policisë së Kosovës, mirëpo, me këtë projektligj rregullohet autoriteti jashtë policisë së Kosovës, i cili përveç kompetencës inspektuese mbi Policinë e Kosovës, do të jetë përgjegjës të zhvillojë hetime penale ndaj punonjësve të policisë në detyrë për veprat e kryera.

Projektligji rrit llogaridhënien krahasuar me ligjin e kaluar, rrit efektivitetin dhe efikasitetin në zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore, rrallon hetimin e i incidenteve disiplinore të zyrtarëve policorë që deri më tani nuk funksiononte në nivelin e dëshiruar. Pra, me këtë projektligj përcaktohet: misioni, organizimi i funksionimit, detyrat përgjegjësitë e Inspektoratit të Policisë së Kosovës. Inspektorati i Policisë së Kosovës, si agjenci funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, detyrë e të cilës është të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm dhe transparent në përputhje me ligjet në fuqi. Mirëpo, me këtë rast kërkoj që përveç kompetencave politike të këtij mekanizmi, përgjegjësitë të zbatohen edhe në praktikë për të plotësuar standardet ndërkombëtare për funksionimin e mirëfilltë të Policisë së Kosovës.

Nga neni 13 e deri te neni 16 të Projektligjit përcaktohen kriteret dhe procedurat për zgjedhjen e kryeshefit të Inspektoratit të Policisë së Kosovës, qëndrimi në detyrë të tillë, lirimi dhe shkarkimin e tij, përgjegjësitë për të ofruar ministrit të Punëve të Brendshme raport dhe informatat e nevojshme për punën dhe funksionimin e punonjësve të policisë së Kosovës, por merr parasysh edhe gradat, pa marrë parasysh gradat dhe pozicionet që ka. Me këtë rast, propozoj që nenit 15, pas paragrafit 2,3 t'i shtohet edhe një paragraf i ri me këtë përmbajtje: “nëse në ndërkohë argumentohet ndonjë kriter i paplotësuar, me rastin e emërimit të kryeshefit të Inspektoratit të Policisë së Kosovës, me të cilin fakt nuk mund të jetë në nivel të përgjegjësive, të shkarkohet nga kryeministri me propozimin e ministrit”.

Kryeshefi mund të shkarkohet edhe nëse argumentohet se nuk i përmbush objektivat e planit vjetor të veprimit. Këtë po e potencoj, sepse me një dispozitë të këtij projektligji, kriter për shkarkimin e tij apo për lirimin nga detyra është, nëse ai nuk i plotëson objektivat strategjike të tij. Pra, në radhë të parë, përveç objektivave strategjike, duhet t'i plotësojë edhe objektivat e planifikuara vjetore.

Paragrafi 5 i nenit 18, rregullon se edhe pas pushimit, kjo është ajo e veçanta e projektligjit të ri, të hetimit penal të hedhur poshtë nga prokurori, Inspektorati i Policisë së Kosovës, nëse ka prova dhe dëshmi të reja kërkon procedurë të re nga prokurori për zhvillimin e hetimeve për veprat penale nga punonjësit e Policisë së Kosovës. Ky nen, mendoj se plotëson standardet, sepse në Kosovë shumë vepra penale të kryera dhe në kuadër të këtij institucioni kanë mbetur në mes të rrugës, pa u hetuar dhe pa e marrë dënimin adekuat kryerësit e këtyre veprave.

Projektligji i plotëson standardet dhe është në harmoni me ligjet e BE-së dhe ka koston buxhetore, prandaj e përkrah në parim me shpresë se në komisionet funksionale do të amendamentohet dhe do të bëhet më lehtë i zbatueshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! fjalën e ka deputeti Riza Smaka

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryetar,

Të nderuar ministra,

Deputetë të respektuar,

Disa vërejtje parimore. Përkundër konkludimit fillestar se Ligji për Inspektoratin Policor është përgatitur me kujdes dhe me të janë ofruar zgjidhje juridike të përshtatshme për misionin dhe funksionin e Inspektoratit Policor të Kosovës, megjithatë i njëjti përmban disa formulime ekuivokale e herë-herë të mangëta, madje edhe kontradiktore. Konkretisht ky dokument, me këtë projektligj, Inspektorati Policor i Kosovës nuk është karakterizuar qartë se është institucion politik apo juridik, administrativ? Kjo është çështje parimore substanciale.

Megjithëse me dispozitën e nenit 6 të këtij dokumenti, është theksuar se Inspektorati Policor i Kosovës është agjencion ekzekutiv në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i pavarur nga Policia e Kosovës, me alinenë vijuese të po kësaj dispozite, është apostrofuar se Inspektorati Policor i Kosovës është në vartësi të drejtpërdrejtë nga ministri (i Punëve të Brendshme), natyrisht, se andejmi përderisa ministri është edhe kurdoherë me bazë mund të pritet se do të jetë person krejtësisht politik, implicite përgënjeshtrohet mesazhi themelor i dispozitës së nenit 6 të këtij projektligji, referuar karakterit juridik, administrativ apo politik të tij. Në këtë rast dhe në këtë mënyrë në favor të komponentës politike, aq më parë dhe me shumë kur me dispozitën e nenit 10 po të këtij akti ligjor, nga alineja e parë apostrofohet eksplicite se Inspektorati Policor i Kosovës, funksionon nën autoritetin e ministrit.

Me nenin 1, paragrafi 1 të këtij projektligji është stipuluar se punonjësit e IPK-së, duhet ta respektojnë kodin e etikës, domethënë duhet, e nënvizoj duhet të respektojnë kodin e etikës së IPK-së, si dhe parimet e Kodit të Mirësjelljes së Nëpunësve Civil. Formulimi i tillë, në vend të karakterit imperativ dhe të vënies në parësi të ligjit, e praktikon të kundërtën, ashtu që ligjin e obligativ e injoron, ndërsa nga nëpunësit e IPK-së, në vend të detyrimit për përfillje, nga ata apelon për ta respektuar Kodin e Etikës. Unë mund ta respektoj këndo, por mund të ndodhë që nuk e përfilli, a intenca jonë është për ta përfillur edhe atë imperativisht, se jo duhet, ju lutem se duhet, e jep fakultativen.

Me dispozitën e nenit 12, paragrafi 1 të këtij dokumenti është apostrofuar se kryeshefi ekzekutiv i IPK-së, është autoritet ekzekutiv apolitik në kuadër të IPK-së, ndërkaq me asnjë dispozitë, madje as me ato fillestare- shpjeguese, nuk është definuar nocioni apo koncepti apolitik ç' është apolitik, a mund të ketë njeri apolitik ne e dimë nga Aristoteli atje, zoon politikon se nuk mund të jetë kurrkush apolitik, aq më parë kur kriteret për zgjedhjen e kryeshefit të përcaktuara me nenin 13 të të njëjtit ligj, nuk garantojnë, madje aspak në favor të apolitikës së tij. Ndryshe, në rrethanat kosovare do të ishte kërkesë absurde që të aplikohet zgjedhja e cilito funksionar publik apolitik, ndaj del se postulati apolitik edhe në këtë rast, është një pleonazëm dhe si e tillë më mirë do të kisha preferuar të hiqet. Tek e fundit, nuk mund ta gjejmë një person, nuk besoj që do të ishte apolitik në qoftë se aludohet që mos të jetë në ndonjë parti politike. Të tillët janë pak.

Personalisht s' jam në asnjë parti politike. Në rastin nga neni 30, paragrafi 2 i këtij dokumenti, kur është normuar se, nëse hetimet rezultojnë se sjellja e punonjësit të IPK-së përbën vepër penale, rasti do t'i referohet për ndjekje penale Zyrës së Prokurorisë. Është dashur medoemos të normohet edhe automatikisht, suspendimi obligator nga se natyra juridike e të tillë ipso fakto e imponon largimin imperativ të përkohshëm të personit të tillë. Mos të ndodhë diçka siç ndodh, bie fjala në Bankën Qendrore e tjera e tjera se jo ligji, jo kjo, jo tjera e tjera? Në qoftë se dyshohet se ka bërë krim, atëherë automatikisht do të duhej të ishte një dispozitë që autorizon, po e zëmë ministrin për ta suspenduar.

Përfundimisht, ky dokument duhet suplementuar edhe dispozitat edhe me dispozitat ndëshkimore për dispozicionet juridike për të cilat janë aluduar sanksionet respektive të cilat në mungesë të dispozitave denimore në këtë fazë të procedimit, nuk janë postuluar. Para dispozitave ndëshkimore, pothuaj se do të bëheshim një ligj të mirë, mirëpo do të ishte i paaplikueshëm. Ju falënderohem!

KRYETARI: I fundit për diskutim është deputeti Gani Koci, ndoshta nuk e zgjatë shumë.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Sa i përket, unë do të shfrytëzoj kohën që më takon për të diskutuar dhe Nait Hasani po ashtu mi ka falur minutat e vet, kështu që do të jem i dyfishtë në këtë diskutimin tim, do të thotë sa i përket kohës.

Sinqerisht po ju them, nga diskutimet e të gjithëve këtu, po shihet se sikur nuk ka pasur ndonjë interesim shumë të madh në leximin e këtij projektligji dhe në analizimin e këtij projektligji, në mënyrë që vërtet të ishte një diskutim pak më serioz dhe për t'iu qasur një problematike shumë të rëndësishme që përditë gati ne përballemi këtu dhe sikur me lehtësi pranohet, pranohet dhe kjo pastaj, më vonë e shohin se ndoshta kemi bërë një defekt të madh ose një, një shkelje të madhe që nuk jemi ndalur ta analizojmë vërtetë nen për nen, fjalë për fjalë, dhe dispozitë për dispozitë.

E thanë disa nga parafolësit, në qoftë se është qëllimi i krijimit të një mekanizmi që do të mbikëqyrë punën dhe angazhimin e policisë, veprimet e tyre gjatë kryerjes së detyrave, respektimin e ligjeve, rregullave dhe nën rregullave po i quaj ose asaj që quhet Kod i veprimit dhe i etikës në Shërbimin Policor, me këtë projektligj nuk na del kjo, por na del diçka tjetër e veçantë, ajo që u tha nga disa të tjerë, krijimi i një mekanizmi, i një institucioni hetimor plotësisht hetimor dhe që kryekëput dhe ekskluzivisht merret me veprat penale që kryhen brenda Shërbimit Policor. Dhe, në qoftë se nga kjo del nga neni 1, ku thuhet parandalimi, zbulimi i veprave penale. A thua ka në Kosovë mekanizma tjerë që veprojnë në kuadër të Policisë ose është vetë policia ajo dhe mekanizmat e tjerë që veprojnë jashtë kuadrit policor që merren me parandalimin, hetimin,

zbulimin e veprave penale, në përgjithësi, por në këtë rast edhe veprave penale që kryhen nga pjesëtarët e Policisë ose nga pjesëtarët e Shërbimit Policor?

Nuk mendoj se për veprat penale që kryhen nga pjesëtarët e Shërbimit Policor, duhet të ketë mekanizëm dhe institucion të veçantë që do të merrej me hetimin, hulumtimin dhe parandalimin e këtyre veprave. Kjo, në qoftë se është kështu atëherë i gjithë Shërbimit Policor që merret edhe me këto vepra brenda kuadrit policor, i merret kjo e drejtë. Dhe, u tha nga një parafolës se në një rast të caktuar thuhet decidivisht kur inspektorët e Inspektoratit të Policisë hetojnë një vepër penale dhe sigurojnë vendin e ngjarjes, e thërrasin policinë përkatëse që merret me këto çështje, çështjet e hetimit dhe e fusin nën direktivat e policisë së Inspektoratit Policor dhe i tërë mekanizmi tjetër, duhet të veprojë mbi bazë të udhëzimeve, mbi bazë të direktivave dhe mbi bazë të sugjerimeve të inspektorëve të Inspektoratit të Policisë së Kosovës.

Në anën tjetër, të gjitha atributet që i ka Agjencioni i Inteligjencës së Kosovës, i ka atributet e njëjta edhe ky inspektorat. Me sa di unë, ky inspektorat ka për qëllim atë rolin mbikëqyrës, ta quaj rolin kontrollues, rolin e një mbikëqyrjeje civile të policisë dhe veprimeve të policisë dhe jo hetimin dhe eskalimin ekskluzivisht të veprave penale që kryhen brenda Shërbimit Policor. Këtë po e them për vet faktin se ky shërbim, përdor të gjitha mjetet e hetimit që përdorin edhe mekanizmat tjerë hetues që janë në Kosovë, përdor të gjitha mundësitë që përdorin edhe mekanizmat tjerë, siç janë shërbimet brenda policisë për hetime të veprave penale, po edhe të Agjencionit të Inteligjencës të Kosovës, përdor mjete përgjuese, përdor edhe mjete të atilla që thotë një dispozitë në kuadër të ligjit që nuk janë të parapara, me asnjë akt tjetër ligjor, por që janë të nevojshme të përdoren për hulumtimin dhe zbulimin e një veprë penale. Dhe, kjo qon deri te ajo se këta i kanë duart e lira të përdorin edhe mjete ligjore dhe mjete joligjore, kushtimisht në hetimin e veprave penale që këtë të drejtë nuk e ka askush, asnjë mekanizëm të përdorë mjete joligjore dhe mjete të paautorizuara në hetimin dhe zbulimin e krimeve.

Një tjetër absurd, ky shërbim ndjek ose heton gjithë njerëzit e policisë ose Shërbimit të Policisë, por nuk e ka këtë të drejtë dhe këtë autorizim për drejtorin e policisë dhe tash rrjedh pyetja: a mund të jetë subjekt i kryerjes së veprës penale edhe drejtori i policisë dhe cili institucion dhe cili mekanizëm duhet ta ndjek këtë rast, drejtorin e Policisë në, ose të parandaloj në kryerjen e veprës penale?

Dhe, krejt në fund, po them do të dëshiroja shumë që komisioni përkatës të marrë, të analizojë, të bëjë krahasimet e përgjegjësiave dhe rolit të këtij institucioni dhe rolit të institucionit të asaj që e quajmë ne Agjencioni i Inteligjencës të Kosovës dhe të shoh se mos ka ndërhyrje, ndërthurje të përgjegjësiave dhe ngatërime të kompetencave që nesër, pasnesër, pastaj të hidhet faji dhe të hidhet përgjegjësia nga një institucion në institucionin tjetër.

Shtrohet pyetja, në fund krejt, hetuesit a duhet të kenë hetues? Dhe, sipas këtij ligji, këta hetues nuk kanë hetues, janë nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të ministrit, që nuk besoj se ministri do të mund t'i mbikëqyrë deri në shkallën e duhur dhe u lejohej një arbitraritet dhe futja ndoshta edhe një frike vetë në Shërbimin Policor që mos të munden nesër ta kryejnë misionin dhe funksionin për të cilin edhe janë thirrur.

KRYETARI: Ne po vazhdojmë, por kam një përshtypje që edhe këta që po diskutojnë, nuk e kanë përcjell mirë gjithë tekstin e ofruar për të lexuar nga deputetët. Është mirë që t'i lexoni edhe opinionet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës dhe komentet e përgjithshme

për projektligjin. Ju duhet të keni edhe komente të veçanta për projektligjin. Por, po vazhdojmë edhe pse thashë diskutuesi i fundit është Gani Koci, fjalën e ka kërkuar Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, kryetar!

Unë fola në emër të Grupit, por edhe një herë po flas. Ne e kemi pasur rastin edhe më herët, ky mekanizëm ka funksionuar, ka funksionuar me ligj, por trajtimi i legjislacionit tonë edhe procedurat në strategjinë legjislative, nganjëherë po ndryshojnë shumë se ky më shumë është dashur të jetë si plotësim -ndryshim i ligjit e jo ta spastrojmë gjoja se s' kemi pasur ligj fare dhe t'i jepet prioritet një koalicioni qeverisës se ne po hartojmë ligje dhe kemi bërë ligje me numër sasior, por në këtë rast kisha pasur dëshirë t'i them edhe zotit Koci, që të ketë durim të rrijë në sallë se foli shumë edhe të dëgjojë se në këtë rast Inspektorati Policor e ka kryer punën e vet vazhdimisht edhe me rastin e dhënies për humbjen e provave në Polici, po e them më butë, të atyre dëshmive që edhe një humbje e madhe, një vjedhje e madhe që ka ndodhur në Drejtoratin e përgjithshëm të Policisë, por kushtimisht kjo punë përcillet me standarde të dyfishta, i jepet mundësi e madhe edhe ministrit, por jo për këtë rast edhe drejtorit të përgjithshëm të Policisë me vetë tekstin e këtij projektligji që na ka ardhur, sepse çfarëdo forme që mund të jetë, ndoshta i duket zoti deputet se ka një hapësirë të madhe Inspektorati Policor, por është i dyfishtë vetë përfundimi i çdo procesit të tyre hetimore, sepse në radhë të parë nuk kanë të drejtë të marrin vendime inspektorët e policisë, që është një shkelje e madhe i një mekanizmi ekzekutiv, në këtë rast si inspeksion, por i jepet mundësia që atë raport të investigimit të hetimeve deri në atë moment, inspektorët t'ia dërgojnë drejtorit të përgjithshëm të Policisë, drejtori t'ia paraqesë ministrit.

Duhet t'i jepet një hapësirë më e madhe këtij inspektorati që ata të marrin vendime, sepse në një gjykatë policie nuk kemi në këtë rast, por iu ka dyfishuar mundësia edhe e nxjerrjes së mundësisë, të vlerësohen vetë inspektorët policisë së Kosovës. Ju faleminderit, zoti kryetar! Kaq.

KRYETARI: Gani Koci e ka fjalën.

GANI KOCI: Humbja e dëshmive në Polici, nuk është pjesë e Inspektoratit Policor. Inspektorati Policorë thënë shkurt, është një mekanizëm që merret kryesisht me disiplinën brenda Policisë. Veprimet e tyre a shkojnë veshur mirë, a e shajnë ndonjë qytetarë, a i përfillin rregullat e punës, a e qet kapelën kur duhet me qitë, a din ta respektojë eprorin e vet që është më lartë dhe këto janë detyrat e Inspektoratit të Policisë. Detyrat tjera janë edhe shkeljet më të rënda që qojnë ndoshta deri te vepra penale, por jo sipas nenit 1, që ekskluzivisht merret me hetimin, parandalimin e veprave penale brenda policisë. Ju Lutem, qëllimi i parë është neni 3, e përcakton shumë mirë misionin e këtij, por jo neni 1. Nëse nisemi sipas nenit 1, ky është organ që heton krimet e rënda brenda policisë. Nuk do të duhej të ishte ekskluzivisht organ që i heton krimet e rënda brenda policisë dhe brenda pjesëtarëve të policisë. Kjo është ajo, se si ka funksionuar deri tash, ne e dimë, as tash, as ky ligji nuk i jep shumë për të funksionuar, përkundrazi vetëm ka duplikuar shërbimet dhe vetëm e ka lënë nën kompetencë dhe përgjegjësi, herë të njërit e herë të tjetrit.

Sa i përket anës buxhetore, ju e dini se këta të Inspektoratit angazhojnë edhe informatorë dhe informatorët duhet të paguhet, prandaj duhet parë edhe anën financiare edhe ngarkesat financiare që duhet t'i kenë se dihet kush mund të ketë informatorë dhe kush nuk mund të ketë informatorë, punë të përkohshme dhe punë të pak më të stërzgjatura dhe këta bëhen me pagesë dhe nuk bëhen falas. Megjithatë te ne bëhen falas zakonisht punët e tilla, por në botë paguhet por paguhet goxha shtrenjtë.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Nuk kemi të lajmëruar për fjalë. Hyjmë në procedurën e votimit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Në sallë kemi 67 deputetë, do të thotë votojmë në parim Projektligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Votojmë, tash:

Konstatoj se me 58 vota “për”, 6 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës. Në bazë të Rregullores së Kuvendit, ngarkohen këto komisione:

- Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional dhe komisionet e përhershme.

Komisionet duhet që në afatin më të shpejtë të mundshëm, Kuvendit t’i paraqesin raportin me rekomandime.

Nëse jeni dakord, e kalojmë pikën 8 dhe kalojmë në pikën 9 të rendit të ditës, që kemi në shqyrtimin e parë Projektligjin të ish të burgosurit politikë. Këtu e kemi edhe një delegacion nga Shoqata e të burgosurve politikë, të kryesuar nga Adem Demaqi, do të thotë Baca Adem dhe e përshëndes edhe në emrin tim dhe në emrin e juaj këtë prezencë dhe pastaj i kthehem pikës së 8-të. Jeni dakord? Me një votim formal, kush është “për” ju faleminderit! A ka “kundër”, nuk ka. Ju faleminderit!

Pra kalojmë në shqyrtim të pikës së nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ish të burgosurit politikë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj deputetin Hydajet Hyseni, që në emër të Grupit të deputetëve nënshkrues dhe në cilësinë e propozuesit, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

HYDAJET HYSENI: I nderuar, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke ju përshëndetur juve të gjithëve, më lejoni që t’ju sjell edhe përshëndetje nga ish të burgosurit e shumtë politikë, disa nga përfaqësuesit e të cilëve i kemi edhe këtu në sallë të cilët edhe i përshëndesim posaçërisht.

Më lejoni po ashtu që në emër të Grupit të deputetëve nënshkrues të nismës ligjvënëse, t’i paraqes Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Projektligjin për të drejtat e ish të burgosurve politikë. Nevoja për këtë ligj është evidente dhe e pakontestueshme. Kosova, siç është e njohur, ishte ekzemplar tipik i burgut të madh politik dhe është mbase i fundit vend në Evropë që po fillon trajtimin dhe zgjidhjen e kësaj padrejtësie të madhe.

Për pasojë, sa e sa veteranë të shquar të lëvizjes çlirimtare demokratike në Kosovë, kanë mbyllur sytë, pa pasur rastin aq të pritur për të përjetuar, qoftë edhe ndonjë formë të trajtimit dhe rehabilitimit të shëndetit të tyre të rrënuar nga burgimet, mundimet e keqtrajtimet dhe qoftë satisfakcionin moral, rehabilitimin juridik, politik e shoqëror.

Ligji për kategoritë e luftës, ka paraparë zgjidhjen me ligj të veçantë të problematikës të ish të burgosurve politikë. Ky ligj ka qenë i përfshirë në programin qeveritar dhe në programin ligjvënës të Qeverisë. Legjislatura vijuese e Kuvendit të Kosovës, me vendim të posaçëm e ka përfshirë këtë projektligj në kalendarin ligjvënës të Kuvendit dhe tani e kemi në procedurë.

Shoqata e ish të Burgosurve Politikë në bashkëpunim me Shoqatën e Juristëve të Kosovës, dhe me partnerë të tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë, ka hartuar Projektligjin për të drejtat e ish të burgosurve politikë dhe grupi fillimisht prej 44 dhe më vonë më se 81 deputetë, praktikisht me mbështetje koncesuale të gjitha grupeve të Kuvendit, e ka proceduar në procedurë të rregullt për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Kosovës. Propozim-ligji nuk u shqyrtua në Kuvend dhe në ndërkohë në konsultim me përfaqësues të Misionit Evropian në Kosovë dhe përfaqësues relevant të pranisë diplomatike ndërkombëtare në Kosovë, si dhe me partnerë të caktuar vendorë dhe ndërkombëtarë, janë rishikuar dhe janë përshtatur dispozita të caktuara të projektligjit, të cilat materien e ligjit e bëjnë më të qartë dhe më të implemtueshme.

Përfitojmë nga rasti që të falënderojnë të gjithë ata që kanë mbështetur dhe ndihmuar hartimin dhe përpunimin dhe perfeksionimin përmbajtësor e funksional të këtij projektligji.

Gjatë hartimit të këtij projektligji, janë pasur parasysh mundësitë e kufizuara financiare të Kosovës dhe institucioneve të saj, prandaj edhe janë dizajnuar zgjidhje të kursyera që do të mund të ishin më lehtë të realizueshme. Modestia dhe vetëmohimi i ka karakterizuar në vazhdimësi ish të burgosurit politikë dhe nuk ka dyshim se kështu do të jetë edhe në të ardhmen.

Duke pasur parasysh se ligji mëton zbutjen e një padrejtësie të madhe shoqërore, me kosto relativisht të lartë për kushtet kosovare, projektligji mëton fillimisht zgjidhjen parimore dhe krijimin e bazës ligjore, institucionale për njohjen e statusit dhe të drejtave të ish burgosurve politikë, kurse sa i përket implementimit, u është lënë kohë edhe mundësi zgjidhjeve graduale dhe me akte të veçanta ligjore, nënligjore, të cikat do të përgatiten nga Qeveria në pajtim me përvojat e vendeve fqinje.

Projektligji ka përvijuar një strategji të zgjidhjes graduale dhe me forma të ndryshme të kompensimit në pajtim me praktikatat e vendeve tjera përreth që do ta lehtësojnë shumë implementimin e plotë të këtij ligji. Qeverisë, ministrive respektive dhe segmenteve tjera institucionale, kjo do t'u mundësojë planifikimin e nevojshëm buxhetor dhe masave tjera infrastrukturore, organizative, normative e administrative. Llogaritet se në fillim shpenzimet do të jenë të vogla, simbolike, kryesisht për përgatitjen e infrastrukturës dhe dokumentacionit për kompletimin dhe pastaj implementimin e pakos legjislative, administrative që rregullojnë të drejtat e ish të burgosurve politikë dhe si të tilla nuk do ta rëndojnë buxhetin e këtij viti buxhetor.

Llogaria e plotë financiare, pritet të bëhet nga Qeveria, respektivisht ministritë përkatëse, ndërkaq llogaritjet e përafërta financiare, shpien në përfundimi se edhe në fazat vijuese, shpenzimet e nevojshme për realizimin e këtij ligji do të jenë të përballueshme.

Grupi nënshkrues është i vetëdijshëm për mangësitë dhe lëshimet që mund të jenë përvjedhur, prandaj edhe mbetet i gatshëm dhe tejet i interesuar që projektligji t'i nënshtrohet shqyrtimit, amendamentimit, plotësimit dhe përmirësimit të tij. Në këtë mënyrë do të krijohet baza për rregullimin me ligj të njërës prej problemeve më të ndjeshme dhe padrejtësive të mëdha shoqërore të Kosovës së re, dhe në këtë mënyrë Kuvendi i Kosovës do të inventojë edhe një sukses legjislativ

dhe njëkohësisht do të përmbushë edhe një nga rekomandimet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Miratimi i këtij ligji, do të shënojë një hap të rëndësishëm në zbatimin e drejtësisë tranzicionale në Kosovë dhe demokratizimin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës për të cilën ish të burgosurit politikë kanë kontribuar dhe sakrifikuar shumë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BARJAMI: Ju faleminderit, i nderuari kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Fillimisht më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të uroj ardhjen e këtij ligji në Kuvend dhe të shprehim mbështetjen parimore dhe padyshim se miratimi i këtij ligji, krijon një bazë të mirë ligjore për rregullimin e pozitës të drejtave dhe statusit të ish burgosurve politikë, një çështje që është dashur të rregullohet ndoshta edhe më herët me ligje, por është shumë mirë që tani po bëjmë një ligj organik, jo ligj të vetëm, një ligj organik që jep shpresa që pozita e të ish- burgosurve të rregullohet në mënyrë adekuate.

Gjithashtu dëshiroj ta uroj zotëri Hydajet Hyseni dhe grupin e deputetëve që kanë sponsoruar këtë ligj dhe padyshim që ky ligj po hap rrugë për zgjidhjen e kësaj çështjeje shumë të rëndësishme duke qenë që kategoria e ish të burgosurve politikë, është një kategori që ka dhënë shumë për Kosovën, por fatkeqësisht pozita e tyre ka qenë deri më tash krejtësisht e parregulluar.

Ligji, siç tha edhe vetë zoti Hydajet Hyseni është parimor dhe nuk shtrohet në çështje konkret, por në mënyrë parimore krijon bazën ligjore që të rregullohet tërë problematika e ish të burgosurve politikë dhe ky ligj, në mënyrë shumë precize e saktëson nocionin e ish të burgosurve politikë duke i përmendur kategoritë që përfshihen me të burgosurit politikë, të dënuarit politikë, të persekutuarit politikë dhe të ish burgosurve politik, përcakton statusin e tyre dhe të drejtat që rrjedhin nga statusi i ish të burgosurve politik. Po ashtu edhe periudha kohore që është marr, është një periudhë adekuate, pra një periudhë që përfshinë kohën e regjimeve diktatoriale në Kosovë që nga viti 1913 e deri te viti 1999. Ligji është i strukturuar mirë dhe ai është një bazë e mirë që me legjislacionin e mëpastajshëm të rregullohen të drejtat e ish të burgosurve politikë, të drejtat e kompensimit material dhe të drejtat e sigurimit social dhe të sigurimit shëndetësor si dhe të drejtat tjera shtesë që në të gjitha vendet post-komuniste ish të burgosurit politik i gëzojnë.

Mendoj që edhe formimi i dy institucioneve të rëndësishme që dalin nga ky ligj, Komisionit qeveritar, që do të merret me klasifikimi në të burgosurve politik dhe e Institutit për Integrimin e ish të burgosurve politikë, tregon se Kosova në mënyrë institucionale po i qaset zgjidhjes të problemeve të ish burgosurve politikë dhe jep shpresa që pozita e tyre më në fund do të rregullohet brenda mundësive që ka Republika e Kosovës, brenda mundësive të kufizuara buxhetore, por mjafton që me këtë ligj po shprehet një kujdes shtetëror i shtetit të Kosovës ndaj kësaj kategorie shumë të rëndësishme të Kosovës.

Duke e përkrahur tërësisht, unë do të jap tri sugjerime parimore, pa hyrë në çështje konkrete që mendoj që duhet të merren në konsideratë me rastin e ... leximin e dytë dhe duhet të zgjidhen në mënyrë adekuate, në mënyrë që implementimi i këtij ligji të jetë sa më i mundshëm.

E para, në dispozitat kalimtare patjetër duhet të definohet periudha kohore brenda të cilave do të vihet legjislacioni sekondar apo legjislacioni tjetër që do të mundësojë implementimin e të drejtave në kompensim të ish të burgosurve politikë. Në ligj nuk ka një afat, por thuhet se të drejtat konkrete, në kompensim material dhe të drejtat tjera, do të rregullohen me ligje të veçanta. Kjo mund të na qojë në një periudhë të pacaktuar për këtë arsye unë sugjeroj që në dispozitat kalimtare kjo periudhë të limitohet në një vit, do të thotë, një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vihen dispozitat konkrete për realizimin e të drejtave të ish të burgosurve politikë që dalin nga ky ligj.

Çështja e dytë kruciale për implementimin e këtij ligji është buxheti i konsoliduar për këtë. E tha edhe sponzoruesi, ka pasur kujdes që mos të ketë menjëherë ngarkesa buxhetore, por këto ngarkesa të jenë vit pas viti. Unë mendoj se duhet të gjendet një pozicion i qartë buxhetor. Siç e keni vërejtur në projektligj, përmenden disa mundësi alternative financiare për të cilat nuk jam i sigurt që do të jenë gjithmonë efektive. Për shembull, përmendën letrat me vlerë, aksionet nga procesi i privatizimit dhe format tjera alternative për të cilat nuk jam i sigurt që do të funksionojnë. Unë mendoj se duhet definitivisht kjo të jetë një obligim i shtetit dhe në mënyrë progresive vit pas viti të ndahen mjetet e caktuara që të realizohen të drejtat, sa i përket kompensimit material dhe kompensimeve tjera.

Çështja e fundit është çështja e Institutit për Integrimin e të ish Burgosurve Politikë. Është shumë mirë që po formohet ky institut dhe shumë mirë që ky institut është shtetëror. Unë e kuptoj rëndësinë e Shoqatës së të Burgosurve Politikë dhe e përkrah aktivitetin e saj, i cili po kulminon edhe me këtë ligj, por unë mendoj se krijimi i këtij instituti, është një qasje institucionale ndaj të burgosurve politikë. Mendoj se ky institut duhet ta marrë përkujdesën e plotë të tërë procesit të kompensimit dhe rehabilitimit moral, juridik, shoqëror, për rehabilitimet tjera të ish burgosurve politikë. Dhe, mendoj se ky institut duhet të funksionojë plotësisht me mbështetje buxhetore, qeveritare në mënyrë që ai ta realizojë misionin për të cilin edhe po formohet.

Marr në tërësi, ligji edhe pse ka vetëm 25 nene, është një bazë e mirë që kjo materie të rregullohet dhe të kompletohet me legjislacionin sekondar. Unë i kuptoj kufizimet që ka pasur edhe Komisioni gjatë hartimit, por mendoj se me disa ndryshime të vogla, ne leximin e dytë, ky ligj është një bazë solide që kjo çështje të rregullohet në mënyrë adekuate dhe në mënyrë meritore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Armend Zemaj, e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zotëri kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka shqyrtuar Projektligjin për të drejtat e ish të burgosurve politikë dhe njëherit edhe ashtu e ka përkrahur edhe mocionin e ministres ligjdhënëse përmes deputetëve të saj për rregullimin e statusit dhe të drejtat e ish të burgosurve politikë, të persekutuarve politikë dhe të ndjekurve politikë.

Pse ne mendojmë se ky projektligj duhet të përkrahet dhe të miratohet, është se këto tri kategori që rregullon ky projektligj, janë pjesë e pandashme e historisë së Kosovës të cilët në kontinuitet dhe shumë fuqishëm e ruan veten, familjen, shoqërinë në shërbim të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës.

Jemi të vetëdijshëm që numri i ish të burgosurve politikë është i madh, por regjimi ishte totalitar dhe ishte agresiv dhe pothuajse për një shekull persekutoi në mënyrë shumë mizore të gjithë ata që nuk u pajtuan apo e kundërshtuan që Kosova të jetë shtet i pavarur. Andaj, arsyeja financiare nuk duhet të mbetet edhe 10 vjet pas lirisë, që kjo kategori dhe të drejtat që janë në përputhje dhe me aktet universale për të drejtat e njeriut, të mos rregullohen me ligj të veçantë. Sa i përket periudhës kohore për realizimin e kësaj të drejte edhe pse është një periudhë e gjatë, viti 1999, domethënë, është viti i cili duhet të merret i fundit që ka pasur të burgosur politikë në Kosovë dhe njëherit edhe krijimi i Institutit, sepse vitet po kalojnë dhe është, edhe ashtu më se i domosdoshëm. Me këto dy vërejtje parimore dhe me këtë përkrahje Grupi Parlamentar i LDK-së, do të angazhohet edhe në procedurat e mëtutjeshme që ky ligj të miratohet dhe implementohet sa më shpejt nga Qeveria e Republikës së Kosovës

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka kërkuar deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Ju faleminderit, zotëri kryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e ka shqyrtuar Projektligjin për të drejtat e të burgosurve politikë dhe, që në fillim po e them se e përkrahim fuqishëm, sepse kemi arsye të plotë duke pasur parasysh se për krahasim prej vendeve tjera që kanë bërë ligje të tilla, se janë shtypur nga sistemet totalitare brenda shtetit të tyre, të burgosurit politikë të Kosovës kanë dy elemente që i kanë përcjellë për të qenë të persekutuar dyfish, njëri është ai se Kosova ka qenë e robëruar dhe të gjithë ata që kanë qenë shqiptarë janë trajtuar mizorisht nga pushteti serb dhe e dyta se një sistem, në mënyrë sistematike ka vepruar duke u munduar që edhe të zhdukë elementin shqiptar në Kosovë. Edhe pse është ligj i vonuar, konsiderojmë se tani është momenti i fundit kur duhet ta kemi një ligj dhe, në procedurat e mëtejshme duhet të jetë shumë më i shpejtuar se sa ligjet tjera në mënyrë që vërtet të burgosurit politikë, të gjithë ata që u persekutuan dhe u maltretuan nga ish- pushteti i kaluar, të kenë një satisfakcin ata, familjet e tyre dhe shoqëria në përgjithësi.

Momentalisht kështu si është draftligji, është pak sa i përgjithësuar, por në amendamentin e mëtutjeshëm mendojmë se mund të thjeshtësohet në kuptimin e zbatimit praktik të tij dhe po ashtu që sa më shpejt ish të burgosurit politikë edhe nga ana morale, por edhe nga ana materiale të jenë të stimuluar, sepse kemi edhe më tutje këtë kategori të përbuzur dhe pa ndonjë përkujdesje të mjaftueshme. Prandaj, edhe një herë po e them që Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e përkrah dhe do të jetë në punë në amendamentimin e këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli, e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zotëri kryetar!

Edhe në herë e shpreh kënaqësinë që në mesin tonë sot është edhe baca Adem, njeriu që 30 vjet të jetës së tij i ka kaluar si i burgosur politik.

Grupi Parlamentar i AKR-së, e mbështet projektligjin në fjalë. Te ne thonë: “Më mirë vonë se sa hiq”, e kësaj radhe është mirë që ky përfundimisht ky ligj shumë i nevojshëm për një pjesë mjaft të madhe të shoqërisë së Kosovës, është sot para nesh.

Grupi Parlamentar i AKR-së, do të jap kontributin e vet në procedurat e mëtutjeshme të këtij projektligji, prandaj do ta ketë mbështetjen e pa rezervë tonën si grup parlamentar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Gani Geci , e ka fjalën.

GANI GECI: Ju faleminderit, kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar, ne i përshëndesim të burgosurit politikë. Dhashë Zoti që nuk do të jetë hera e fundit që t'i thërrasim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, e mbështet në parim Ligjin për të burgosurit politikë. Ne kemi qenë iniciues dhe nënshkrues, faktikisht nënshkrues të iniciativës së deputetit Hydajet Hyseni për Ligjin për të burgosurit politikë dhe mendojmë se, para se të aprovohej ky ligj, do të duhej të aprovohej Ligji për hapjen e dosjeve të komunizmit, duke pasur parasysh se të burgosurit politikë dikush i ka quar në burg për shkaqe politike dhe ata të tjerët janë marr me politikë dhe kanë qenë udhëheqës politikë dhe do të duhet t'i hapni dosjet që të dihet se kush i ka quajtur në burg. Ekziston rreziku të jetë dikush në Kuvendin e Kosovës dhe i ka quajtur të burgosurit politik në burg.

Meqë ne, me ligj duhet t'i rehabilitomë të burgosurit politik, në të njëjtën kohë do të duhej t'i rehabilitonim edhe ata që i kanë quajtur në burg, t'ua bëjmë një ligj dhe të dimë se kush janë ata. Mandej, do të ishte mjaft mirë për hapjen e dosjes, sepse nëpër burgjet e Republikës së Jugosllavisë, ka pasur të burgosur politikë të rekrutuar në mesin e të burgosurve politik si udbash, të cilët në të njëjtën kohë kanë bërë burgje, por kanë qenë udbash dhe nuk të duhej që secili ta gëzonte këtë të drejtë dhe ai që ka qenë udbash dhe ai që ka qenë i burgosur politik. Prandaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet në parim dhe vërejtjet tona ne do ti japim gjatë amendamenteve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar "7+", deputeti Xhezair Murati e ka fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsjedniče!

I mi smo izvršili analizu ovog nacrtu zakona sa svim materijalom koji ja dat uz nacrt. Pročitali smo i memorandum koji obavezno ide uz obrazloženje ovog Nacrtu zakona.

Ja bih hteo da dodam nešto u vezi potrebe da se reguliše status političkih zatvorenika, osuđenika ili na drugi način oštećenih lica od strane bivših režima. Radi se upravo o licima bez kojih možda danas Kosovo ne bi bilo ono što jeste. Ja bih takođe naveo da, na primer u običnom sudskom postupku kod krivičnih dela telesne povrede, naknade štete se često mere hiljadama i desetinama hiljada eura, i to za pretrpljen bol, strah, nervozu, strah porodice i tako dalje. E, sat se postavlja pitanje kolika je nematerijalna šteta za odvođenje ljudi tamo gde se odvode. S toga, mislimo, ako Kosovo uspe da iznađe mogućnost da prizna ovaj status i pravo na materijalnu satisfakciju, onda ide u pravcu države koja brine o svojim građanima, u pravcu države koja teži da reguliše socijalnu politiku na odgovarajući način.

U nacrtu se govori i o roku od 4. godine, u kome se najkasnije mogu podnositi zahtevi za priznavanje statusa političkih zatvorenika i ostvarenja materijalnih prava po osnovu toga. Mi mislimo da bi taj rok trebalo produžiti na još jednu godinu, dakle, kao i da Vlada mora da odredi

rok u kome je dužna da imenuje komisiju koja će promatrati te zahteve. Zatim, u članu 18. stav 4. se ovim zakonom mora odrediti rok i navedenoj komisiji u kome je ista dužna da izradi podzakonski akt kako bi regulisala ove probleme. Ovi rokovi ne smeju biti predugi.

Član 20. stav 3. govori o pisanoj potvrdi koju izdaje Udruženje političkih zatvorenika overenoj od dva svedoka. Ovde se mora naći zakonski mehanizam koji će kontrolisati ovo udruženje, jer može doći do zloupotreba i korupcije. Mi u načelu dakle prihvatamo ovaj nacrt zakona i u skladu sa mogućnostima daćemo doprinos konačnoj verziji do konačnog usvajanja ovog zakona. Hvala, vam!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së dhe as në emër të grupit Parlamentar për Integritet, nuk ka.

Atëherë, vazhdojmë me diskutimet e deputetëve.

Unë e kisha një kërkesë, nuk kemi shumë, por megjithatë i kemi disa deputetë që janë lajmëruar dhe të tjerë ndoshta mund të lajmërohen më vonë, por diku të jetë diskutimi rreth 5 minuta, mos të jetë më shumë se 5 minuta, nëse jeni dakord.

Atëherë ju faleminderit! Mendoj se me 5 minuta, mjaft i thotë njeriu mendimet e veta.

Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Të nderuar përfaqësues të Shoqatës të burgosurve politikë,

I dashuri dhe i nderuari, Bacë Adem Demaçi

Kosova pati shumë halle dhe nuk pati mundësi deri më tash të vë në rend dite çështjen që sot po e trajtojmë – Projektligjin për të drejtat e të burgosurve politik të Kosovës. Ahmet Haxhiu, Ramadan Shala, Abdyl Lahu, Ali Aliu e me qindra të burgosur politikë, më nuk janë në mesin tonë. Shkuan pa e ndierë që shoqëria e Kosovës e ktheu në vend drejtësinë që atyre u është bërë në rrugën e lirisë dhe se sakrificat e tyre po vlerësohen.

Përsëritës ardhjen në Kuvend të Projektligjin për të drejtat e të burgosurve politikë dhe kemi nder të madh që ta bëjmë atë, sikurse burgu që preku gjithë shoqërinë tonë edhe sot i ndiejmë pasojat e tij, pavarësisht partive politike, ju ftoj që ta votojmë së bashku. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Përsëritës, të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Ne do të jemi komisioni funksional që do të punojmë për ligjin. Ne përsëritës Komisionin hartues të projektligjit. Natyrisht që mbetet shumë të punojmë në komision dhe komisionet tjera parlamentare për të qartësuar projektligjin. Unë e kuptoj që Komisioni ka qenë në situatë që ndoshta për shkak të situatës që nuk është dhënë shumë përkrahje, nuk ka mundur ndoshta për ta qartësuar, mirëpo tani në këtë fazë duhet ta qartësojmë.

Unë i kam disa nga dilemat të cilat duhet ndoshta t'i diskutojmë edhe tani në parim që pas muajit që po vjen, të mos kemi dilema tjera, apo mos ta bëjmë një ligj sa për të mbetur në sirtarë. Dilema e parë është edhe tani në këtë kohë, projektligjit i mungon deklarata financiare dhe nga ky vend,

kërkoj nga Qeveria e Kosovës, që brenda afatit të paraparë, së paku gjatë periudhës kur e bëjmë amendamentimin, ta sjellë deklaratën financiare, sepse do të ishim në situatë që nuk do të dinim si do të lëvizim, mos të mbetet sa për ta diskutuar sot në parim, por mandej dekorata financiare të jetë pretekst që projektligji të mos ecën drejt zbatimit praktik.

Një çështje tjetër shumë diskutuese, projektligji flet për statusin dhe të drejtat e ish të burgosurve politikë. Mendoj që edhe titulli i projektligjit duhet të ndërrohet. Duhet qartë ta dimë kush është i burgosur politik, jo të futet në përkufizime. Përkufizimet janë për ta sqaruar projektligjin, por nuk është pjesa normative, duhet saktë ta përcaktojmë me nen, që të mos kemi më pastaj probleme në interpretim, ta përcaktojmë kush janë të burgosurit politikë, cila kategori bie në të ish-dënuar politikë dhe kategoritë e tjera, kush do të jenë përfitues dhe çështjet tjera.

Vlen të përmendet se në projektligji, nëse e keni lexuar, ndoshta në nenin 4.2 shkruhet që, nëse një i burgosur politik ka humbur jetën kështu, në këtë kohë, domethënë do të fitoj edhe statusin e dëshmorit të kombit. Të gjithë jemi të pajtimit, që natyrisht janë dëshmorë si të gjithë dëshmorët e tjerë, por duhet të bimë në situatë që të mos bimë në kolizion me ligjet tjera. Pak më vonë do ta kemi Ligjin për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, invalidët ku pikërisht edhe atje flitet se kush do ta fitoj statusin e dëshmorit të kombit, pa e përjashtuar periudhën jo vetëm në luftën e fundit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por të gjitha përpjekjet e njerëzve që kanë bërë, prandaj mos të bimë në situatë që ta dyfishojmë statusin, sepse dëshmor mund të jetë vetëm me një status dhe jo me shumë statuse, ndoshta edhe këtë situatë ta sqarojmë dhe në anën tjetër do të doja ndoshta qartë të shikojmë edhe nenin 21, ku është kërkuar që nga Qeveria e Kosovës, të krijohet buxheti prej fondit të privatizimeve dhe çështje tjera. Mendoj që kjo nuk i shkon, ne duhet ta qartësojmë në projektligj dhe të kërkojmë që Projektligji për të burgosurit politikë, buxheti të sigurohet nga Qeveria e Kosovës dhe neve nuk na intereson nga do të jenë burimet sepse, nëse e lëmë kështu në projektligj, ne kemi ligje të tjera të cilat nuk e lejojnë që ta shesin pronën e patundshme siç është thënë në projektligj, mandej çështjet e mjeteve të privatizimit është marrë vendim të shfrytëzohen për çështje tjera dhe, ndoshta e qesim situatën që me vetëdije sjellim një situatë që ligji të mbetet në sirtarë.

Edhe një herë i lus të gjithë deputetët, grupet parlamentare e posaçërisht grupin punues që bashkërisht të na përcjellë gjatë kohës së amendamentimit, sepse jemi në fazën përfundimtare ku duhet ta qartësojmë. Nëse e lëmë kështu si është, do të kemi pak vështirësi për implementim në praktikë. Edhe një herë, duke ju uruar sukses, shpresoj që të burgosurit politikë do ta rregullojnë statusin shumë shpejt. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Mimoza Ahmetaj.

MIMOZA AHMETAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Përhëndetje të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të gjithë të burgosurit politikë, pjesëmarrës në këtë seancë dhe jo vetëm ata, por të gjithë të burgosurit anë e kënd botës të cilët na përcjellin, të cilët kanë kontribuar në forma të ndryshme në këtë ditë të cilën ne jetojmë sot.

E përshëndes ardhjen e këtij ligji në Parlament dhe kjo është një gjë mjaftë e rëndësishme, gjenerata të tëra kanë kontribuar në forma të ndryshme për këtë për këtë ditë, në të cilën jetojmë sot.

Nuk dua t'i përsëris ato të cilat u thanë më parë, do të thosha se, nëse ne arrimë ta implementojmë këtë ligj në këtë formë, ashtu siç neve na ka ardhur, do të ishte më tepër se sa e pëlqyer. Një dilemë të cilën e kam hasur gjatë leximit të këtij projektligji dhe gjithashtu edhe të Projektligjit për veteranët

e luftës, është një kategori e cila nuk përfshihet në asnjërin nga këto ligje, kategoria e të plagosurve, të cilët në forma të ndryshme, qoftë në demonstrata, qoftë në format të ndryshme kanë qenë të plagosur gjatë regjimit totalitar serb dhe të cilët edhe sot e tutje i bartin në trupin e vet plagët apo plumbat e atij regjimi.

Do të dëshiroja ta kërkoj apo ta parashtroj në formë të pyetjes edhe të kërkoj sqarim, qoftë nga grupi hartues i këtij projektligji, qoftë nga ekspertët të cilët kanë punuar në hartimin e këtij projektligji, të sqarohej se ku do të mbetej kjo kategori? A i takon që edhe kjo kategori të përfshihet brenda këtij ligji për të burgosurit politikë, që edhe ata në një formë të jenë të vlerësuar dhe të çmuar për kontributin e tyre të cilin e kanë dhënë me kohë? Po e përshëndes edhe njëherë Shoqatën e të Burgosurve Politikë si dhe zotin Hyseni dhe të gjithë profesionistët, ekspertët të cilët në forma të ndryshme kanë kontribuar në hartimin e këtij projektligji dhe në ardhjen e tij në Kuvend.

Shpresoj që si i tillë sa më shpejt të hyjë në fuqi dhe të arrijë të implemetohet dhe që më në fund kjo kategori edhe në formë institucionale ta ketë përkrahjen nga institucionet tona shtetërore. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe unë i bashkohem qëndrimit që ka Grupi Parlamentar i AKR-së, në mbështetje të plotë të këtij ligji.

Përshëndes Shoqatën e të Burgosurve Politikë për nismën,

Përshëndes edhe përfaqësuesit e tyre prezent sot këtu në krye me zotëri Demaçin.

Për ne është nderë se si legjislaturë na erdhi mundësi a që ta procedojmë një projektligj të domosdoshëm të cilën e kanë bërë të gjitha shoqëritë e vendeve që e kanë kaluar tranzicionin si dhe natyrisht, ne nuk po bëjmë diçka më shumë por vetëm një obligim konstitucional që e kemi si deputetë.

Natyrisht, që ky ligj është në parim e mori mbështetjen siç po shihet nga diskutimi dhe do ta marrë padyshim, por mirë është që të, si të them të përmbahet, të përplotësohet dhe në aspektin e terminologjisë juridike të përkufizimeve që janë dhënë, të jetë më e saktë, të jetë më i saktë. Për shembull, neni 1 dhe neni 5 kur flitet për shtrirjen e të drejtave dhe mënyra e realizimit, citohet, të neni 5 citohen paragrafët 1.1, ndërkaq këtu kemi 1 (a) edhe nuk është ajo përmbajtja çka këtu thotë që statusin e të ish të dënuarve politikë e bartin kategoritë që në njëfarë mënyre referohen në neni 1, megjithatë këto janë detaje që sigurisht dhe në komision edhe në procedurat deri te leximi i dytë do të përplotësohen, ndoshta edhe një çështje që mua më ra në sy, është mirë që te kualifikimet, regjimet totalitare është shumë e saktë që ato kanë qenë regjime totalitare, por mbi të gjitha kanë qenë regjime antishqiptare se formalisht, juridikisht për shembull nga viti 1919, 39-n, Jugosllavia ka qenë monarki kushtetuese që ka pasur lirinë e partive politike e tjera, e që domethënë termi, është mirë të gjendet një term më adekuat në aspektin formal që i përgjigjet periudhës për ta ndarë prej periudhës pas Luftës së Dytë Botërore, që vërtet ka qenë regjim totalitar, pra pa të drejtën e mendimit të lirë.

Në parim thash e mbështes dhe i gëzohem faktit që më në fund po e procedojmë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ky ligj i referohet statusit juridik të të burgosurve politikë. Kush ishin ata edhe ato? Ishin pa kurrfarë dileme personat e këtij vendi guximtarë e përparimtarë e humanistë e nacionalistë edhe civilistë, më të mirët e kohës së vet, dhe nuk ka dyshim që ky dokument është dashur të bëhet pak më herët, mirë por edhe tash mund të bëhet një kompezacion. Disa vërejtje parimore, me qëllim së paku t'i bëjmë disa përkujtime ku do të ishin përqendruar në etapën e dytë për ta përmirësuar. Bie fjala, në fillim kur thuhet: "Me qëllim të njohjes dhe të rregullimit të statusit të të drejtave dhe të prestacioneve të ish të burgosurve politikë . Prestacioni është një term që përdoret në komerc, në tregti edhe apriori ia devalvon si të them kontestin edhe destinacionin, por duhet të gjendet një shprehje tjetër o bëri, veprimtari ose aktivitet e tjera, e tjera, do të mendojnë për, por gjithsesi, domethënë, jo prestacion se nuk ishte, ata nuk kanë bërë punë për prestacion, por për ideale madhore.

Te zotëri Gashi, parafolësi e tha me vend atë, duhet të meditojmë të gjejmë shprehje më adapte, sepse këtu kapet një periudhë prej vitit 1913 deri në vitin 1999, e ajo më pastaj etapizohet. Ishte viti 1913-1919 që ishte Serbia, më pastaj ishte apo shteti , më pastaj mbretëria, më pastaj ishte Jugosllavia e kështu me radhë. Gjithsesi ato nuk ishin shtete totalitare në kuptimin e nocionit që e njihni, enciklopedi politike apo juridike, ama ishin pa marrë parasysh se çfarë ishin, se ishin disa parti politike ishin, ne nuk duhet të hezitojmë ta themi atë që ishte dhe mjerisht ishte antishqiptare ishin me krejt qenien. Prandaj, duhet të gjejmë shprehje adekuate, pa kurrfarë hezitimi. Se fundi i fundit, e lexon edhe dikush tjetër edhe thotë, ja domethënë, do të dilte në diskurs jo i disfavorshëm.

Te neni 2, paragrafi 5, duhet referenca të jetë (l) i vogël ligji, sepse e kemi Ligjin për familjen, e kemi Ligjin për trashëgiminë që janë ligje speciale e që e kanë prioritet ndaj këtij ligji sa i përket trashëgimisë, sa i përket familjes, prandaj atje edhe është rregulluar edhe më mirë e mos të bëjmë një rregullim të cekët këtu të panevojshëm, por të jepet referenca ashtu si aplikohet në praktikat e legjislacionit

Te paragrafi 8, i nenit 2, këtu është propozuar që "Komisioni i Ankesave" është futur në shojza, pse në shojza, Komision qeveritar që i shqyrton ankesat e palëve lidhur me realizimin e të drejtave me këtë ligj. Ndoshta do të ishte më mirë që të jetë komision që e kemi komisioni konstant që është i themeluar nga Kuvendi, se ka rol më tepër, ka autoritet më tepër edhe aq më parë kur kemi ligj sistemor që i referohet si suplementar këtij ligji - Ligji për procedurën e përgjithshme administrative, prandaj më autoritativ do të ishte Komisioni i Pavarur i Ankesave se sa një komision qeveritar, tek e fundit komisioni qeveritar nuk di se sa do të ishte kompetent për të vendosur për çështjet juridike, administrative, së paku kompetent.

Te neni 3, paragrafi 2, këtu është dhënë kjo zgjidhje - propozim. Afati për nismën e procedurës për realizimin e të drejtave të parapara me këtë ligj, fillon nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe zgjat 4 vjet. Do të duhej të ishte ky standard, 1 vit afati subjektiv, 3 vjet afati objektiv e ka institute juridike që e mundësojnë atë që quhet kërkesa për kthimin në gjendjen e mëparshme, që mund të jetë edhe jo 4, por edhe më gjatë se 4 vjet, prandaj t'i përdorim standardet juridike dhe janë më të përshtatshëm, sepse jep edhe më notë të lartë se sa disa shprehje ad-hoc...

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet! fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Për shkak të kohës, do të jem më i shkurtër se që u përgatita të flas, sepse i pata disa dilema, por konkretisht do të ndalem në dy dhe më lejoni paraprakisht të deklaroj se si përkrahës i nismës, si nënshkrues i listës, e përkrah patjetër, bile mendoj se është i vonuar ky ligj. Po ashtu, më lejoni të them se e kam parasysh sikletin që e kanë pasur përpiluesit e këtij ligji dhe kjo shihet në përshkrimin që shumë kanë lënë vakuume në kuptimin e qartësimit, që e thanë edhe parafolësit, dhe mendoj që kjo duhet të bëhet në leximin e dytë. Dhe, jo aq shumë për shkak të implikimeve financiare, që sigurisht se edhe për atë që kemi një buxhet të varfër, por për më shumë për fillimin e futjes së standardeve në nocione, sepse kështu siç jemi, me këto standarde, me këtë hipokrizi, them kolektive, mendoj se nuk shkohet më tutje.

Këtu do të ndalem konkretisht te pika 2.1, te neni 2 dhe pika 2.2, ka edhe tjera po them, por po ndalem këtu. Ky definicion apo ky përshkrim 2.1, mua nuk më thotë kurrgjë hiq, i dënuar politik dhe ish i burgosur politik po ashtu mua, por edhe lexuesit të paanshëm mendoj i thotë gjithçka, por edhe jo konkretisht.

Si do t'ia bëjmë, të them, me disa që kanë qenë bile bien në pikën 2.1, ish të dënuar politikë, ashtu na thonë tash, shiten për disidentë që për ko incidencë shumica e tyre kanë qenë të djathtë, kështu na thonë NDSH-ja apo të një grupacioni tjetër, por që më pastaj kanë marrë pozita të rëndësishme edhe ato nëpër institucionet e arsimit apo emancipimit ideo-politik të popullatës, siç ka qenë "Rilindja" apo në sistemin arsimor edhe atë të lartë. Dhe, këtu bie ndesh me disidentin. Si mund të jesh ti disident për një kohë kundërshtar i sistemit, pa paragjykim, qoftë i majtë apo i djathtë, kushdo që ka pasur guxim t'i thotë mendimet e veta kundër sistemit, është disident gjithkund në botë, por ke qenë i djathtë, më pastaj tërë jetën tënde je marrë duke na lodhur, duke na shpjeguar Marks dhe Engelsin, e tash po të njëjtit i kritikojnë Marks dhe Engelsin dhe na thonë se kanë qenë disidentë. Mendoj se shumë i dëmtojnë edhe vetë disidentët e vërtetë. Përsëri po them, gjithnjë duke i respektuar përcaktimet e tyre, qofshin ato të djathta apo të majta që i kanë pasur.

Mendoj se këto duhet t'i qartësojmë, po them te pika 2.2 është një përkufizim pak më duket edhe mos të them qesharak apo grotesk. Ju lutem, më tepër se 72 orë në lokal in thuhet, në lokal in e organeve të një... sinqerisht e kam parasysh sikletin që e kanë përpiluesit. E di se sinqerisht janë munduar që të bëjnë diçka dhe janë munduar që mos t'i lëndojmë emocionet e disave, por historia nuk zhbëhet, është ajo që ka qenë. Tash, unë e kam parasysh se shumë kanë qejf të jenë disidentë, por nuk kanë qenë kur ishte koha dhe për hir, po them edhe një herë, të futjes së standardeve, të mos kemi morale të dyfishta, të trefishta e të katërfishta, siç po i kemi tash. Ngjashëm është edhe me Ligjin që do ta bisedojmë për dëshmorët e kombit apo dëshmorët luftës, të futen standardet, dihet kush ka qenë disident e kush nuk ka qenë dhe kush është, kujt i takon ky status. Po them, për hir të atyre atdhetarëve të cilët e kanë dhënë edhe jetën, qofshin të majtë, edhe një herë po e them, qofshin të djathtë, se kohën e fundit nuk është në modë me qenë i majtë, po frikohen njerëzit që kanë qenë të majtë e po na thonë se jemi të djathtë, e tjera e tjera, domethënë veç tregojnë se as atëherë nuk e kanë ditur çka kanë qenë ata. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, zotëri kryesues!

Konsideroj që sot Kuvendi po e bën një veprim shumë të mirë sa që po jep një mesazh para gjeneratave të reja se ky institucion më i lartë i shtetit të ri, i Republikës së Kosovës, e ka marrë me seriozitet dhe po e bën një përmirësim të historisë dhe po i jep rolin e duhur të gjithë atyre brezave që kanë sakrifikuar për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Unë si i ri, që tanimë nuk jam në moshën e re por jam frymëzuar me veprimtarinë politike të shumë atdhetarëve këtu që janë edhe në këtë seancë po edhe jashtë seancës dhe thjeshtë jam motivuar që të angazhohem... secili që të bëjë një punë për vendin duke u frymëzuar nga veprimtaria politike atdhetare e këtyre të burgosurve politikë të Kosovës jo nga ideologjitë që shpeshherë dikush tenton t'iu vë atë që nuk e kanë pasur me qëllim që ta zhvlerësojë veprimtarinë e vetë kombëtare në dobi të çështjes së Kosovës.

Ndodh që në emisionet televizive del që të arsyetohet puna e pushtetarëve të atëhershëm komunistë dhe të dënohet puna e të burgosurve politikë pse kërkonin republikë – pavarësi, dhe mendoj që ky ligj i adreson shumë mirë çështjet se kush ishin ata veprimtarë që e frymëzuan ndjenien kombëtare për liri dhe pavarësi dhe është në nderin e këtij Kuvendi që sot nën një, me pikën e parë po e njeh veprimtarinë politike e shumë brezave që kanë punuar dhe kanë sakrifikuar me vite të tëra të burgut për lirinë e Kosovës. Dhe nën dy, po e krijon një bazë ligjore, konsideroj modeste sepse ende nuk është përfundimtare kjo për t'iu gjend afër atyre të cilët për shkak të vuajtjeve të gjata të burgut iu shkaktuan dëme në shëndetin e tyre dhe ende i vuajnë pasojat dhe edhe ata që janë më mirë tanimë me shëndet mund t'i vuajnë pasojat në ditët apo në vitet në vazhdim. Dhe mendoj se është në të mirë të shtetit që këtë çështje edhe të përkrahjes financiare ta rregullojë pasi që me këtë ligj nuk është qartë e rregulluar një përkrahje financiare pasi që ligji nuk ka kosto buxhetore të specifikuar nga Qeveria e Kosovës dhe të gjitha këto, do me thënë, duhet të bëhen edhe në procedurat e leximit të dytë që ligji të jetë komplet dhe të mos ketë vështirësi në zbatimin e tij.

Konsideroj që tek përkufizimet do të ishte mirë që të ishin vetëm dy përkufizime: ish i burgosur politik dhe ish i persekutuar politik dhe te emri i ligjit, mendimi im është që më mirë do të ishte të quhet Projektligji për të drejtat e ish të burgosurve dhe të persekutuarve politikë. Thjeshtë, t'i dallojmë, do me thënë, të burgosurit me vite të gjata të burgimit nëpër procese të caktuara gjyqësore dhe të persekutuarit që në forma të ndryshme iu nënshtruan persekutimit të okupatorit. Qëndrimi 72 orësh nuk është një fakt sepse ka pasur të tillë që kanë mund të jenë 72 orë, duke dhënë informacione për shokët e vet, por jo të persekutuar dhe ai nesër mund të aplikojë për t'iu njohur një e drejtë e tillë, por thjeshtë duhet të jenë organet përveç të shoqatës së burgosurve politikë dhe mekanizmave tjerë që kanë vepruar në Kosovë vite të caktuara por edhe faktet ndërkombëtare qoftë përmes shtypit të kohës, të dhënave nëpër arkiva e tjera që ta dëshmojnë se me të vërtetë kush ishte i burgosuri politik, kush ishte i persekutuar politik dhe të mos ndodhin që nesër të mos e njohim njëri-tjetrin nga këto veprimtari.

Unë e mbështes dhe dëshiroj që në lexim të dytë të amendamentohet me amendamente të veçanta që e plotësojnë këtë ligj dhe njëkohësisht kërkoj nga Qeveria ashtu siç e tha edhe deputeti Bajrami që të caktohet një afat, ndoshta shumë do të jetë një vit por edhe më i shkurtër që të dihet kostoja buxhetore dhe të fillojë zbatimi i tij sepse shumë të burgosur kanë nevojë jashtëzakonisht të mëdha për të pasur një përkujdesje financiare nga shteti se ka të tillë që kanë pasoja shëndetësore shumë serioze, pasoja edhe psikike edhe jetojnë ndoshta me 40 euro apo edhe hiq pa to dhe nuk ka dorë të shtetit në përkujdesje në këtë drejtim.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Lista po shtohet, deputeti Gani Buçinca e ka fjalën.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Pa dyshim është një ngjarje e rëndësishme sot kjo ditë kur po e trajtojmë Ligjin për të përndjekur dhe të burgosur politikë. Nuk dëshiroj t'i përsëris ato të gjitha fjalë që u thanë nga kolegët këtu, mirëpo desha të tërheq vëmendjen se ky ligj, ashtu siç është paraparë kështu do të zvarrisë shumë fatin e të burgosurve dhe të përndjekurve politikë.

Unë mendoj se një periudhë katërvjeçare me i lënë kohë Qeverisë për të bërë një planifikim buxhetor, koston buxhetore financiare të këtij ligji, është periudhë shumë e gjatë.

Asnjë qeveri nuk mund të bëjë një planifikim financiar përderisa nuk e ka numrin e saktë të burgosurve, të përndjekurve politikë dhe të dënuarve politikë, kështu që, unë mendoj se me një dispozitë, një nen i ligjit duhet hëpërhë të njeh menjëherë statusin e atyre të burgosurve politikë të cilët me një akt ligjor të formës së prerë mund të argumentojnë burgun e vet, domethënë burgosjen e vet dhe t'i lihet mundësi, pastaj për një periudhë tjetër, që kategoritë e ndryshme të dëshmojnë me fakte se kanë qenë të përndjekur ose të dënuar.

Ne kemi mjaft të burgosur politikë që brenda 24 orëve mund të vërtetohen me vendime gjyqësore se kanë qenë të burgosur politikë dhe t'i marrim këta menjëherë në mbrojtje dhe t'u ofrojmë së paku një bazë materiale se disa prej tyre janë edhe të moshuar dhe nuk mund as të punojnë. Domethënë kjo mund të bëhet lehtë, ma merr mendja.

Afati për fitimin e statusit të burgosurit politik mendoj se nuk mund të jetë më i gjatë se një vit në atë mënyrë që Qeveria pastaj të përgatisë edhe koston financiare për zbatimin e Ligjit. Për ndryshe, besoj se kjo do të zvarritet shumë.

Pastaj, një dispozitë në këtë ligj duhet të jetë padyshim edhe ajo që duhet të paditet ish shteti jugosllav, qoftë ai shteti monarkik, qoftë ai komunist për të gjitha ato dëme që iu kanë shkaktuar, të paditet në Gjykatën ndërkombëtare dhe këtë obligim ta bëjë shteti pastaj në bazë të numrit të burgosurve dhe të përndjekurve politikë,

Kurse, sa i përket asaj që e tha një kolegë i nderuar këtu se ka pasur të tillë që janë dënuar, e pastaj iu kanë nënshtruar pushtetit dhe kanë marrë funksion e ose kanë punuar për të mbajtur familjen e vet, unë mendoj se këto janë dy fakte që nuk mund të futen bashkë. Dënimi politik ka qenë dënim politik, sistemi totalitar jugosllav nuk ka zgjatë 3 ditë ose 5 ditë ose 6 muaj. Ata qytetarë të cilët janë dënuar për bindje politike, por pastaj kanë pranuar të punësohen dhe të mbajnë familjen e vet, ata kanë pasur të drejtë të jetojnë, nuk kanë pasur rrugë tjetër dhe nuk duhet këtu të bëhet devalvim i kontributit dhe sakrifica e të burgosurve politikë ose të dënuarve politikë për shkak se në një periudhë, ndoshta, është dashur edhe të heshtin dhe të punojnë për të jetuar. Kaq pata. Ligjin sigurisht se do ta mbështes. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryesues!

Nuk e pata ndërmend ta marr fjalën sepse ashtu në Grup Parlamentar jemi marrë vesh që të mos të flasim të burgosurit politikë ose kategoritë që i rregullon ky projektligj, mirëpo e pash të arsyeshme megjithatë ta thyej pak atë marrëveshje dhe t'i them nja dy-tri fjalë.

Ish të burgosurit politikë do t'i gjejmë në çdo periudhë kohore dhe sigurisht se do t'i gjejmë edhe në shumë ligje specifike që e ka obligim ky Kuvend t'i hartojë, sidomos gjatë këtij mandati se i ka njerëzit më të merituar në ulëset e këtij Kuvendi.

Ish të burgosurit politikë, sigurisht se do t'i gjejmë në kategori edhe në ligjin që do ta kemi në shqyrtim për më të merituarit – për veteranët, dëshmorët e UÇK-së e tjerë, që do të jetë sot në seancë plenare.

Ajo që më shtyri ta marr fjalën ishte më shumë provokimi i nenit 2, paragrafi 2.7 ku parashihet me të drejtë instituti për integrimin e ish të burgosurve politikë. Që të mos marrë kohë, sigurisht se secili e keni përpara se çka paraqet ky paragraf por kjo më përkujtoj një kërkesë të nënkuptuar në Konferencën Shkencore që u mbajt në prill të këtij viti, e organizuara nga Shoqata e të Burgosurve Politikë, në mbështetje të Zyrës së kryeministrit të Kosovës e që tema e asaj konference shkencore ishte veprimtaria e grua për çlirim kombëtar.

Njëra nga të ftuarat në këtë konferencë patë thënë, shumë e emocionuar “Më në fund ndihem shumë e lumtur që dikujt iu kujtua se diku në një kohë kam qenë njëra nga rrugëtarët e rrugicave që kërkonin diell për Kosovën dhe për çlirim kombëtar”. Andaj, shpresoj se ky institut do të merret me hulumtimin e njerëzve të tillë dhe së paku do të merret me integrimin shoqëror. Ndoshta ky institut do ta ketë rolin jo më shumë të një benificioini në kuptimin e përfitimit material se sa të një satisfaksioni shpirtëror.

Dhe krejt në fund, shpresoj shumë që njëzëri do të mbështetet ky projektligj dhe të mos hyjmë në detale të analizojmë sepse disa prej parafolësve si duket nuk e kuptuan shumë qartë dhe tashti në hollësira të mëtutjeshme në këtë ligj, por ju ftoj të gjithëve që ta mbështesni dhe në këtë rast dua të falënderoj zotin Adem Demaçi i cili me veprimtarinë e tij politike ka ndërtuar një autostradë për gjeneratat e mëtutjeshme të cilat edhe sot e kanë kurorëzuar këtë liri që po e gëzojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hajdin Abazi.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra, zëvendëskryeministër,

I nderuar baca Adem, që ke qenë dhe mbetesh simbol i qëndresës shqiptare,

Vërtet sot jemi duke shqyrtuar një ligj që në të vërtetë ka vlerë jashtëzakonisht të madhe dhe unë për veti do ta ndajë diskutimin tim, meqenëse pajtohem me shumicën e vërejtjeve dhe sugjerimeve që i dhanë kolegët më herët. Diskutimin tim do ta ndaj në dy pjesë, atë se çfarë unë kuptoj në fakt me këtë që do të rregullojë ky ligj dhe me çështjen që ka të bëjë me implementimin.

Çështja e parë, mendoj se ky ligj më tepër duhet të konceptohet në aspektin parimor, sepse për herë të parë pretendohet që përmes një ligji t'i rikthehet dinjiteti qytetarit të Kosovës, atyre qytetarëve të cilët dikur kur askush nuk e besonte ishin të gatshëm dhe sakrifikuan pjesë të jetës së tyre me qëllim që ta ndërtonin dhe shtronin rrugën që të vinte dita e lirisë dhe dita e pavarësisë.

Prandaj, si i tillë, mendoj se ky ligj vërtet, natyrisht se mund të perfeksionohet edhe më tepër dhe të rregullohet nënkapitulli i përkufizimeve dhe të ndonjë nënkapitulli tjetër, por në parim do të thotë ky ligj vërtet rikthen dinjitetin për hir të asaj sakrifice që e kanë bërë ish të burgosurit politikë.

Kurse për mua është pak sa shqetësuese pjesa e dytë. Këtu e përmendën edhe kolegët se mungon kostoja implementuese dhe kjo për mua do të thotë se Qeveria nuk e ka pas këtë ligj ose nuk e ka bërë një përllogaritje se sa do të jenë shpenzimet dhe duke qenë se kjo shtresë e ish të burgosurve politikë dhe duke marrë parasysh edhe rrethin familjar që ndërlidhet me ta, del një kosto që është

shumë e madhe. Prandaj, ne kemi nevojë që të kemi një lloj strategjie në këtë aspekt nga Qeveria se me çka mund të fillohet, po supozojmë, gjatë vitit të parë që të realizohen këto të drejta, çka gjatë vitit të dytë apo tri viteve me qëllim që të arrijë deri te një fazë kur do të mund të implementohet ligji në tërësi dhe thjeshtë të kryhen obligimet ndaj kësaj kategorie në tërësi.

Nëse kjo nuk do të bëhet, unë personalisht kam drojë se do të ketë një zvarritje shumë më gjatë se sa që u parapa këtu, në njëfarë mënyre indirekte, nëse mund ta them, këtu në ligj, që deri në 4 vjet të ketë mundësi të kërkojnë të drejtat në një aspekt për të kërkuar, por nëse Qeveria nuk do ta bëjë një strategji për përmbushjen e obligimeve të veta ndaj kësaj kategorie dhe në anën tjetër duke ditur limitin e buxhetit, po e përsëris edhe një herë, druaj se ne me qëllim që të bëjmë diçka të mirë ka rrezik që në terren në praktikë të zvarrisim punën. Me këtë dua thjeshtë t'i bëj apel Qeverisë që sa më parë dhe kur të vijë leximi i dytë veç të na e ofrojë një strategji se si dhe në çfarë etapa do të mund të realizohet deri sa të arrihet niveli i plotë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë dua t'ju falënderoj për zemërsisht edhe për mbështetjen që i keni dhënë deri në shqyrtim, por edhe për debatin e zhvilluar i cili, nuk e them për politesë, por vërtet e vlerësoj si një kontribut të vërtetë, si një avancim, përsosje të materies së ligjit, një konkretizim të tij dhe ju ftoj që këtë angazhim ta vazhdojmë edhe në procesin e amendamentimit të ligjit.

Më lejoni vetëm për të sqaruar se lidhur me dilemat që i kishim te terminologjia dhe disa nga formulat, ne jemi mbështetur në përvojat e vendeve tjera, kryesisht Kroacisë, Shqipërisë e ndonjë vendi në fqinjësi. Nuk është e lehtë të normohet kjo materie, prandaj edhe një kategorizim ka qenë i domosdoshëm edhe për të kategorizuar pastaj qasjet edhe përfitimet por edhe për të evituar fytyrën e ngushtë, gjendjen në të cilën të gjithë pothuaj se do të futeshim në këtë ligj, sepse fati ynë ka qenë vërtet i veçantë. Prandaj, mendoj se përvojat e të tjerëve po ashtu kanë qenë të dobishme dhe diçka mund edhe të rishikohet dhe të përpunohet.

Lidhur me koston financiare, në këtë fazë, është e pamundshme të ketë një kosto precize. Ligji prandaj, siç u tha, është ligj më shumë bazik. Ne kemi miratuar edhe tash së voni disa ligje të tilla, të cilëve u ka munguar kostoja financiare. Por ligji parasheh zgjidhjen me ligje të tjera ose me akte të tjera nënligjore të cilat pastaj duhet ta kenë edhe llogarinë financiare. Natyrisht, është e drejtë që kjo të mos shërbejë si pretekst për ta zvarritur dhe për ta dërguar në kalendrat greke.

U theksua nevoja që pse edhe ai limiti 72 orë. Ju lutem, vetëm për të evituar keqkuptimet. Ka raste që njerëz janë mbajtur pak ditë në burg, por gjatë atyre ditëve u është shkatërruar shëndeti, janë në gjendje të paaftë jetësore dhe natyrisht që ata duhet të përfshihen. Por, kategorizimi e eviton pastaj çfarëdo mundësie të abuzimit dhe unë jam i sigurt se në këtë rast nuk do të lejohen abuzime si ato që ndoshta janë vënë re aty-këtu.

Edhe lidhur me afatin e kontestuar me të drejtë 4 vjet. Nuk është menduar afati 4 vjet si afati, si të thuash, kur do të fillojë zbatimi. Zbatimi duhet të fillojë me t'u krijuar të gjitha kushtet dhe mendoj kjo mund të bëhet brenda një viti, por afati i fundit për ata që mund të vonohen është edhe ajo kohë, do të thotë për të pas një limit, por megjithatë zbatimi do të duhej të fillonte shumë më herët.

Sa i përket kategorive tjera, të plagosurve e tjera, që me të drejtë duan trajtim, mendoj që ato duhet të përfshihen në ligje të tjera dhe s'besoj se mund të kontestohen nga dikush.

Më lejoni vetëm ta përfundoj se këtë ligj ne e mendojmë edhe në funksion të krijimit të unitetit që i duhet Kosovës si është vepruar edhe në të kaluarën dhe jo në funksion të tensionimeve të reja dhe fenomeneve që i kemi parë gjetiu dhe në Kosovë nuk i kemi lejuar dhe jam i bindur se kështu do të funksionojë. Demokratizimi i përgjithshëm dhe drejtësia, vetëm stabilizon shoqërinë dhe jam i sigurt se edhe ky ligj kështu do të funksionojë.

Ju ftoj, kolegë të nderuar deputetë, që ta votoni ligjin kështu dhe më vonë ta përmirësojmë bashkërisht. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shpresoj se gjatë amendamentimit të Ligjit të futen edhe vërejtjet e atyre që i dhanë më herët, por besoj se do të kihet parasysh edhe gjendja ose moralisht të merren institucionet e Kosovës edhe me të pushkatuarit me gjyq dhe pa gjyq pas luftës së dytë botërore dhe para luftës së dytë botërore që nuk janë pak dhe ata që kanë vdekur burgjeve dhe janë helmuar burgjeve nga regjimi, me qëllim se meqë iu kemi futur kësaj rruge edhe familjet e atyre që nuk kanë deputetë këtu po iu kanë pushkatuar nga 5 e 6 vetë në familje nga bandat e ish regjimit të Tito-Rankoviqit, të ndriçohen duke u përfshirë edhe ato pse jo të regjimit të mëparshëm që dikush e quajti demokratik, po unë po them totalitar dhe antishqiptar dhe shumë të egër të ish-Jugosllavisë.

Prandaj, meqë tani diskutues tjerë nuk ka, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani.

Në sallë janë 78 deputetë. A ka pa kartelë? 1 nuk ka votuar!

Do të thotë, 77 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për të drejtat e ish të burgosurve politikë.

Në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe
- Komisionet e përhershme.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë në Kuvend, t'i paraqesin raportet me rekomandimet.

Baca Adem, faleminderit që na ke vizituar dhe ke qenë prezent!

Kthehemi te pika e tetë e rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e natyrës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Mahir Yagcillar, që nuk është këtu, atëherë të autorizuarin në këtë rast ministrin e Tregtisë dhe Industrisë që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin. Zoti Zharku, e keni fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryesues,

Zëvendëskryeministër,

E nderuar ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni shumë shkurt të paraqes Projektligjin për mbrojtjen e natyrës, nxjerrja e të cilit është e nevojshme për faktin se në ligjin ekzistues shumë çështje nuk janë të përfshira duke filluar nga transfuzimi i direktivës për mbrojtjen e shpezëve dhe direktivës për mbrojtjen e vendbanimeve natyrore të faunës dhe florës së egër, e të cilat vërejtje janë inkorporuar në Projektligj.

Legjislacioni në fuqi, si ligjet dhe rregulloret e UNMIK-ut, nuk janë zbatuar plotësisht për faktin se janë në kundërshtim me rrethanat e reja të krijuara dhe në kontradiktë njëra me tjetrën, kështu që duke penguar ushtrimin e përgjegjësive të institucioneve kompetente për mbrojtjen e natyrës.

Projektligji është i hartuar në harmoni me standardet e Bashkimit Evropian dhe plotësisht në harmoni me konventat, direktivat dhe marrëveshjet nga lëmi i mbrojtjes së natyrës dhe me një koncept fleksibil e të zbatueshëm në sistemin juridik të Republikës së Kosovës.

Projektligji për mbrojtjen e natyrës në mënyrë përmbytësore dhe më të saktë adreson rregullimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e natyrës, faunën, florën dhe vlerat e trashëgimisë natyrore.

Të nderuar deputetë,

Dispozitat e këtij projektligji lidhur me mbrojtjen, ruajtjen, zhvillimin dhe përparimin e natyrës përcaktojnë:

- shfrytëzimin racional të natyrës, të mirave të saj, pa dëmtimin ose degradimin e pjesëve të saj dhe me sa më pak dëmtim të përbërësve të saj;
- mënyrën e parandalimit të veprimtarive të dëmshme të njerëzve dhe çrregullimeve në natyrë si pasojë e zhvillimit teknologjik të vendit dhe sigurimi i kushteve sa më të volitshme të zhvillimit të lirë të natyrës;
- aktet përcjellëse dhe planet hapësinore me destinim të veçantë;
- masat e mbrojtjes dhe dispozitat e tjera përcjellëse të cilat garantojnë mbrojtjen dhe shfrytëzimin e natyrës dhe të mirave të saj;
- mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e pjesëve të mbrojtura të natyrës dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të atyre hapësirave me vlera të shumta dhe të ndjeshme të natyrës.

Gjatë hartimit të këtij projektligji për bazë është marrë legjislacioni i vendeve rajonale e posaçërisht ai i Sllovenisë dhe Kroacisë.

Projektligji nuk përmban elemente diskriminuese kurse për zbatimin e tij nuk nevojiten mjete të konsiderueshme buxhetore.

Projektligji për mbrojtjen e natyrës në masë të plotë do të ndikojë në krijimin e infrastrukturës ligjore për mbrojtjen e natyrës dhe do të jetë bazë për mbrojtjen e vlerave të natyrës, si rezervat strikt i natyrës, parku kombëtar, zona e veçantë, parku i natyrës, monumenti i natyrës, peizazhi i mbrojtur, monumenti i arkitekturës së parkut si dhe llojet e bimëve dhe shtazëve dhe vendbanimet e tyre.

Projektligji rregullon edhe procedurat e ndërhyrjeve në natyrë, tregtinë me llojet e bimëve dhe kafshëve si dhe vendos masa ndëshkuese për shkeljet në këtë fushë si për personat fizikë edhe juridikë.

Projektligji definon gjithashtu edhe përgjegjësitë e institucioneve për mbrojtje të natyrës.

Të nderuar deputetë,

Duke qenë të vetëdijshëm për rezultatet e pritura me miratimin e këtij projektligji i cili është në funksion të zhvillimit dhe përmirësimit të jetës të qytetarëve tanë, ju rekomandoj që ta miratoni në këtë seancë të Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Tani të nderuar deputetë hap debatin lidhur me Ligjin e prezantuar. Kryetari ose raportuesi i komisionit funksional për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapësinor e do fjalën? Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Po diskutojmë për një ligj tejet të rëndësishëm i cili është i përfshirë edhe në agjendën evropiane për Kosovën dhe i cili i pat kaluar të gjitha procedurat e nevojshme në fund të sesionit pranveror të punimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës por Komisioni parlamentar për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapësinor e kthen prapa në Qeveri pasi që ministri e pati arsyetuar këtë projektligj në Kuvend me 177 nene kurse në Komision na pati ardhur materiali me 203 nene që ishte një diskrepancë e madhe dhe u pa haptas se grupe të caktuara të interesit kanë tentuar që në zonat e mbrojtura dhe në projektligjet e ardhshme që kanë të bëjnë me këtë – me parqe nacionale të futet konsensioni. Për Komisionin parlamentar ishte e papranueshme dhe kam kënaqësinë që në mënyrë unanime kemi vendosur si komision, të gjitha grupet politike që përfaqësohen në komisionin tonë funksional, andaj jemi sot këtu ku jemi. Në kuptimin më pozitiv, unë i bëj apel të gjithë kolegëve deputetë, edhe pse nuk është ligji në tërësi në harmoni me aquicomunitaire dhe direktivat që i rregullojnë këto çështje të Bashkimit Evropian, është një ligj i mirë, është një ligj i strukturuar dhe dua të besoj se në amendamentimin e më tutjeshëm do ta kompletojmë dhe do t'i plotësojë edhe këto kritere të rëndësishme.

Andaj, në cilësinë e kryetarit të Komisionit bëj apel që ky projektligj të mbështetet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani sipas radhës, kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare e kanë fjalën. Në emër të PDK-së e ka fjalën zoti Berat Luzha.

BERAT LUZHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ligji për mbrojtjen e natyrës i cili na ka ardhur tash në shqyrtim zëvendëson ligjin për mbrojtjen e natyrës të vitit 2006 nga se ligji i vjetër i vitit 2006 nuk i plotëson të gjitha kërkesat për mbrojtjen e natyrës, si dhe nuk kishte përfshirë detyrimet që dalin nga aktet ndërkombëtare nga lëmia e mbrojtjes së natyrës, kështu që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, e miraton në parim këtë projektligj.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kush është paraqitur? Zef Morina.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin në fjalë dhe vlerëson se me këtë ligj do të rregullohet më mirë mbrojtja e natyrës përkatësisht ruajtja e larmisë biologjike dhe peisazhore si dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i të mirave të natyrës.

Me këtë projektligj përcaktohet sistemi i mbrojtjes së natyrës, i cili është kontabël me ligjet, standardet dhe praktikat evropiane. Andaj, Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah në parim dhe përmes anëtarëve të komisioneve parlamentare do të kontribuojë në amendamentimin gjatë shqyrtimit në komisione. Ju faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr zoti Sabri Hamiti, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Morina! Në emër të AAK-së ose Naimi ose Gjylnazja. Zoti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj se kryetari i Komisionit e tha që ky ligj në njëfarë forme materia e këtij ligji ka kaluar një herë në parim në këtë Kuvend, është kthyer për shkak të disa problematikave që është dashtë të pastrohen në ligj, janë hequr mbi 30 nene dhe ligji është pastruar nga disa nene në të cilat janë paraqitur dilema edhe në debatin në parim në sesionin pranveror por edhe në debatin e përfaqësuesve të partive politike, të grupeve parlamentare në komisionin parlamentar.

Prandaj, mendoj se nuk ka nevojë për ndonjë debat dhe Grupi parlamentar i AAK-së e mbështet në parim dhe normalisht do të kontribuojmë që sa më shpejt të vjen në lexim të dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Maloku! Në emër të AKR-së, besoj Heset Cakolli.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re e ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e natyrës. Edhe pse kemi pasur disa vërejtje në nene të caktuara, ne jemi pajtuar që në parim ta mbështesim këtë projektligj, ndërsa kontributin tonë do ta japim në komisionet funksionale ku do të shqyrtohet ky projektligj deri në leximin e dytë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për LDD-në, Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë në parim e mbështet procedimin e Projektligjit për mbrojtjen e natyrës në procedura të mëtutjeshme. Është një ligj i mirë, është një ligj i strukturuar mirë dhe i cili përfshin fusha të caktuara që kanë të bëjnë me rregullimin e shumë fushave që kanë të bëjnë me zonat e mbrojtura, florën, faunën dhe biodiversitetin në përgjithësi.

Kontributin tonë do ta japim në procedurat e mëtejshme të amendamentimit të këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin “7+”, Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala vam, gospodine predsedavajući!

Dozvolite da pozdravim zamenika premijera i prisutne ministre,

Mi smo takođe izvršili analizu Nacrta zakona o zaštiti prirode i mogu ovom prilikom kazati da postoji velika razlika između ovog nacrta zakona i onog kojeg smo ranije imali pred sobom.

Ovaj nacrt predstavlja napredak u izradi u odnosu na prethodni i vidi se da je dosta ozbiljno shvaćen posao tako da odgovorno i posebno je data jedna bojaznost kada je u pitanju uticaj budžeta.

Ovaj nacrt je dosta razumljiv, sveobuhvatan, jasno definiše i reguliše problematiku i načine kako bi se zaštitila priroda. Ako se ovaj zakon dosledno sprovede, izvesno je da moraju doći rezultati u stopiranju jednog stanja narušavanja prirode akcijama čoveka, kako je to do sada bilo, te će se doći sigurno do unapređenja, tako potrebnog, naše životne sredine.

Ja bih rekao da kaznene odredbe možda treba malo da se pojašne. Naše reke, iako ih nema mnogo, veoma imaju mnogo štetnih otpadaka, nedovoljno vodenog sveta, riba i tako dalje, ali ipak ponavljamo da se radi o visokokvalitetnom i sveobuhvatnom nacrtu zakona i mi ga u načelu prihvatamo. Hvala vam!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Murati! Kemi tre diskutues me këtë radhë: Naim Rustemi e merr fjalën, pastaj është Gjynaze Syla dhe Riza Smaka. Tani, Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

Unë do të jem shumë i shkurtër dhe s’marr shumë kohë, por desha të komentoj pikën – nenin 11, kur kemi të bëjmë me parkun kombëtar.

Ne edhe ashtu nuk e kemi respektuar shumë, dhe nuk e di se çka në të vërtetë do të ndodhë me të gjithë ata që kanë bërë keqpërdorime në ambiente, ku kanë qenë të emëtuara si parqe kombëtare. Juve shumë mirë u kujtohet në një prej seancave që ka mbajt Kuvendi, kur kemi diskutuar për rastin e Prevallës me të cilën komisioni parlamentar deshi të krijojë një komision hetimor për ndërtime që ndodhën në Prevallë, ndërtime që i lejoi Kuvendi Komunal i Prizrenit, kuvendi jo i tanishëm por i mëparshëm, totalisht në kundërshtim me ligjet dhe që u shkatërrua një park dhe një pasuri kombëtare.

U premtua nga udhëheqësit e Kryesisë së Kuvendit se do të kthehet prapë çështja e Prevallës në Kuvend por një gjë e tillë nuk ndodhi kurrë.

Në rast se keqpërdoret kështu ligjshmëria në Kosovë, atëherë unë po propozoj që me u heq ky nen krejt për paqe kombëtare. Në rast se ne me vendime komunale keqpërdorim parqet kombëtare atëherë së paku ta riemërtojmë, mos t’i bëjmë parqe kombëtare por t’i bëjmë parqe komunale. Sepse, juve ju kujtohet shumë mirë diskutimet që ishin bërë në atë kohë në Kuvendin e Kosovës, ku filluan të dalin shumë keqpërdorime në parkun kombëtar të Prevallës nga udhëheqësit komunalë, por edhe nga strukturat e nivelit qendror të atëhershëm dhe filloi për t’u diskutuar aq shumë që deshën të dalin thuaja se të gjithë udhëheqësit e Kosovës janë të pajisur me parcela në parkun e Prevallës.

(Ndërrhyrje: Jo, unë s’kam!)

Po, shumica! Nëse s'ke atëherë, po propozojmë që le t'ua ndajnë të gjithë deputetëve dhe Qeverisë, s'janë 5-6 hektarë. Ka Kosova bjeshkë sa të duash. Kështu që t'i bëjmë parqe komunale ose së paku, së paku të jemi pak më të ndershëm dhe më të moralshëm në krijimin e pikave të rendit të ditës. Kur themi do të kthehet prapë në Kuvend, të kthehet e jo të manipulohet me njëfarë tog fjalësh – do të diskutohet radhën e ardhshme.

KRYESUESI: Fjalën e merr Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar qeveritarë,

Deputetë të nderuar,

Projektligji për mbrojtjen e natyrës është një ligj bazik dhe ka një rëndësi shumë të madhe për rregullimin, ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e natyrës dhe të vlerave të saj.

Duke marrë parasysh se në Kosovë po dëmtohen gjithnjë e më shumë resurset natyrore, se nuk po ruhet balanca dhe laramania biologjike, e po ashtu edhe peizazhi, ka gjithnjë e më shumë mungesë të hapësirave të gjelbra, paraqitet nevoja urgjente që rregullativa ligjore jo vetëm të jetë adekuate për përmirësimin e gjendjes por edhe të zbatohet në praktikë.

Këtë po e them meqenëse kjo fushë aktualisht është rregulluar me Ligjin 02/L-18 dhe Rregulloren 2006/22.

Kolegët e mi më parë shpjeguan se në seancën e Kuvendit të Kosovës, pra në muajin maj, në parim ishte aprovuar, po për shkak të vërejtjeve të Komisionit më tej, sepse Qeveria e ka sjell një version tjetër, në Komision nuk është aprovuar.

Unë kisha dashur që të jetë ministri këtu për arsye se kur të bëhen ndryshimet e tilla, deputetët duhet të kenë informatë të saktë se cilat dispozita të Ligjit aktual nuk janë zbatuar në praktikë që tash të kemi nevojë për një ligj të ri. Unë së paku për dispozita të caktuara të ligjit e di që nuk janë zbatuar dhe kjo është sidomos mbikëqyrja ose zhvillimi i kapaciteteve të inspektoratit.

Zoti ministër, në seancën e majit patë thënë se ndryshimet që i ka sjell ose ligjin e ri e sjell për shkak të përafrimit me legjislacionin e BE-së, përmbushjes së kërkesës që ka dal nga Raporti i progresit të BE-së për Kosovën dhe se ligji aktual nuk i plotëson në këtë fushë të gjitha nevojat që ka Kosova dhe është pengesë për ushtrimin e përgjegjësive të institucioneve kompetente për mbrojtjen e natyrës.

Konsideroj se këto janë sqarime shumë të pakta për të ditur se pse duhet të kemi një ligj të ri.

Meqenëse nuk janë sqarime të nevojshme dhe në qoftë se ministri Zharku ndoshta mund t'i përgjigjet dilemave të mia, unë do t'i parashtroj.

Dilema e parë është që, nëse qëllimi i këtij projektligji është që t'i përafrohemi legjislacionit të BE-së atëherë ky qëllim nuk arrihet për arsye se Projektligji është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Mjedisit në Komisionin Evropian në Bruksel, është analizuar dhe rezultati përfundimtar ka qenë se nuk është projektligj i përafëruar me legjislacionin e BE-së. Domethënë atëherë ky qëllim nuk po arrihet.

Dilema tjetër, ka të bëjë se kemi të bëjmë me një ligj mjaft voluminoz që parasheh edhe kosto buxhetore mjaft të madhe për zbatimin e ligjit. Për vitin 2010 Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor për këtë Projektligj janë caktuar 8.5 milionë euro. Megjithatë, shihet nga Projektligji se do të ketë kosto shtesë buxhetore duke marrë parasysh se janë paraparë formimi i mekanizmave të reja gjegjësisht i organeve të reja siç është themelimi i drejtorive për administrimin e zonave të veçanta, formimi i këshillit drejtues të institucionit për mbrojtjen e natyrës, pyllëzimi i sipërfaqeve, kompensimet e tjera.

Megjithatë, çështjet që kryesisht adreson ky projektligj, që kanë të bëjnë me ripërtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, mbajtjen e baraspeshimit natyror, ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazheve, kompensimin për dëmet, caktimin e rrjetit të zonave të mbrojtura, krijimin e sistemit për planifikim, udhëheqje e monitorim me qëllim të mbrojtjes së natyrës.

Zbatimi i këtij projektligji nuk është thjeshtë vetëm punë e Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor por është punë dhe koordinim i punëve të Qeverisë, Kuvendit dhe komunave. Përgjegjësia primare natyrisht i takon Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor.

Kisha shtruar edhe disa vërejtje të veçanta. Neni 136, paragrafi 4 thotë se, citoj: Në parkun e natyrës dhe monumentin e arkitekturës së parqeve, koncesioni mund të jepet sipas dispozitës së veçantë me pëlqimin e Ministrisë. Propozoj që në rastet e koncensionimit vendos Kuvendi dhe jo ministria që realisht i bie ministri, sepse dëshiroj të parandaloj shfrytëzimin në këto vende ose zona me rëndësi nacionale por edhe komunale për aktivitete ekonomike ose veprimtari të natyrës tjetër.

Neni 162 që ka të bëjë me mbikëqyrjen inspektuese konsideroj se sidomos ky nen duhet të zbatohet në praktikë sidomos kur ka të bëjë me inspektorin e mbrojtjes së natyrës që gjendet në kuadër të Inspektoratit Mjedisor. Dhe jo vetëm niveli qendror por edhe komunat do të kenë kosto shtesë buxhetore. Neni 173 pika 3 thotë se komunat të cilat nuk kanë themeluar drejtoritë për menaxhimin e natyrës janë të detyruar t'i themelojnë brenda një viti. Kjo do të thotë se parashihen kosto shtesë buxhetore për komuna.

Një mangësi që e shoh në këtë projektligj është se duhet të definohen shumë qartë se cilat janë kompetencat e komunës.

Megjithatë, për shkak të rëndësisë së kësaj fushe, në parim e përkrah këtë projektligj. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: Të nderuar, zotëri kryesues,
Zëvendëskryeministër, ministra,
Deputetë,

Disa vërejtje parimore, shkurtimisht. Me nenin 3 të Ligjit për mbrojtjen e natyrës pa nevojshëm madje me dispozitë ligjore fillestare është përcaktuar zbatimi i tij në tërë territorin e Kosovës. Në radhë të parë nga se akti ligjor i miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, kurdoherë aplikohet imperativisht, deshëm ose s'deshëm – nollens – vollens, jo vetëm në territorin e Kosovës por edhe në objektet fluturuese e lundruese të saj, jashtë territorit kosovar duke përfshirë edhe eks-territorialitetin.

Së andejmi dispozita e tillë është e panevojshme dhe do të duhej të fshihej, madje-madje eventualisht të zhvendosej në fund, se kjo hy në kuadrin e dispozitave përfundimtare.

Me Projektligjin për mbrojtjen e natyrës, është bërë punë e mirë, veçanërisht referuar specifikimit të parimeve themelore të nevojshme për aplikimin efikas të tij.

Veçanërisht ia vlen për ta mbështetur dispozitën e nenit 5, paragrafi, 1 alineja 6, me të cilën është normuar aplikimi i subdialitetit, me të cilin kurdoherë sigurohet zhdëmtuesi, se shpeshherë zhdëmtuesi nuk sigurohet, prandaj i dëmtuari/e dëmtuara e pëson padrejtësisht e me këtë rast do të ishte në instancën e fundit shteti, edhe zgjidhje e mirë.

Çështja e ristiksioneve pronësore, se me këtë ligj preket, kurrëdoherë ishte, është dhe do të jetë shumë senzitive prandaj edhe me këtë do të duhej t'i kushtohet kujdes i veçantë të ekspropriumit dhe të valorizimi i tyre dhe mos të dominojë komponenta oportune por racionalja dhe ligjorja, në radhë të parë kriteret e ekonomisë së tregut.

Me dispozitat e nenit 164, 170 të këtij ligji janë përcaktuar normat ndëshkimore të shprehura në dënime me të holla të quajtura gabimisht gjoba, por nuk është bërë specifikimi i autoritetit të përcaktimit, jo shqiptimit, se thotë gabimisht prapë, por caktimin dhe zbatimin e atyre masave. Kjo aq më parë kur ekziston mundësia teorike dhe praktike, i marr standardet evropiane, mundësia teorike dhe praktike që dënimet me të holla t'i caktojë gjatë zbatimit të këtij ligji ministria eventualisht gjykata speciale, gjithsesi duhet të specifikohet, aq më parë kur ndodhemi në prag, në vigjilje të reformimit të sistemit gjyqësor e mos të lëmë vakume juridike që në praktikë mund të paraqiten problematike.

Dhe, përfundimisht, me këtë dokument nuk ka dispozita që e garantojnë. Të marr një shembull pak a shumë bizar, që edhe pronari i arës që e ka në arën e vet apo në kopshtin e vet apo në livadhin e vet një trup molle, një trup arre, një të dardhës që, nëse i teket për ta prerë, ta marrë lejen më parë sepse ani pse është pronë private ekskluzive gjithsesi druri si i tillë është e mirë e përgjithshme – res publika dhe së andejmi vjen edhe shprehja republika, apo jo, që mos ta presë arrën, e mora shembull, apo plepin kur i teket por atëherë kur i lejohet dhe atë do të duhej medoemos, sepse kjo është substancë, zotëri ministër, kolegë të nderuar, kjo çështje e ndjeshme, se natyra në Kosovë dëmtohet frontalisht prandaj na duhet të bëjmë instrumente juridike në këtë rast me të vërtetë efikase dhe adaptable që ta mbrojmë, ta përparojmë natyrën. Ju falënderohem!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Lulzim Zeneli është paraqitur për fjalë.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zotëri kryesues! E pata një pyetje por pasi ministrin e mjedisit nuk e kemi këtu dhe nuk e kemi as ministren e energjisë dhe të minierave, nuk e di a është e rrugës ta ngrisim, por prapë se prapë konsideroj se duhet të jepet një përgjigje nga ana e Qeverisë në këtë rast sot ose në seancat e ardhshme.

Ne kemi të bëjmë me nenin 11 pikë 4. Në parkun kombëtar ndalohet shfrytëzimi ekonomik i të mirave të natyrës. Deri kur do të vazhdohet eksploatimi i gurëve në parqet nacionale të Kosovës?

Çështja e eksploatimit nga ana e gurrthyesve është bërë problem i madh në Kosovë dhe thuaja se është zgjeruar ky rrjet në nivel të grupeve mafioze. Ajo çka duhet të theksohet me këtë rast, se Qeveria e Republikës së Kosovës ose duhet të ndërmarrë masa, t'i parandalojë këto veprime të cilët po e degradojnë natyrën nga këta eksploatues legalë dhe ilegalë, me leje dhe pa leje dhe të kundërtën nëse

vazhdojnë kështu është e kotë të ndërtojmë legjislacion, të miratojmë ligje deri sa në praktikë natyra është degraduar dhe të gjitha këto resursa natyrore të cilat sot i kemi dhe mund të flasim nesër do të jetë vonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj se nuk ka më të paraqitur për diskutim. Në sallë janë 64 deputetë. Ftoj regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim dhe votojmë tani.

Konstatoj se me 58 vota me kartelë, 1 pa kartelë “për” dhe 1 abstenim Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për mbrojtjen e natyrës. Faleminderit!

Tani, sipas radhës, është: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Komisionin e pavarur të mediave dhe transmetimin, që është në radhë në pikën 10 dhe pastaj janë dy ligje ose projektligje të cilat mendoj se do të na marrin kohë pak më shumë dhe në kushtet që jemi pak edhe ndoshta të lodhur, propozojmë që ligji ose pika 11 ose 12 të shtyhen për nesër, që të diskutohet lidhur me to edhe nesër dhe të miratohen nesër dhe sot ta shqyrtojmë pikën 10 dhe 13 të rendit të ditës dhe ta fillojmë për sot seancën. Mendoj që është më produktive se sa të futemi në çështje të cilat vërtet janë për t’u debatuar dhe do të na marrin kohë shumë dhe s’mundemi t’i përfundojmë.

Atëherë, po fillojmë me pikën 10 të rendit të ditës, që është:

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetimin

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj kryetarin e Komisionit për administratë publike, pushtet lokal dhe media Esat....Atëherë, ftoj deputeten Rysha që ta prezantojë Projektligjin para deputetëve. Zonja Rysha e ka fjalën.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të kabinetit qeveritar,

Në emër të Komisionit për administratë publike, pushtet lokal dhe media, si dhe Grupit punues në cilësinë e kryesueses së grupit, i cili është marrë me hartimin e Projektligjit, kam nderin të paraqes para jush një ekspozitë të shkurtër për Projektligjin e Komisionit të pavarur të mediave dhe transmetimin.

Në pajtim me nenin 79 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Rregulloren e Kuvendit, paragrafi 33 pika 1 dhe pika b) të Rregullores së punës të Kuvendit dhe me vendimin e Kuvendit numër 035-55 të datës 19 shtator 2008, Komisioni për administratë publike, pushtet lokal dhe media ka hartuar Projektligjin për Komisionin e pavarur të mediave dhe transmetimin, qëllimi i të cilit është promovimi i shoqërisë demokratike në Kosovë nëpërmjet medias së pavarur të angazhuar për arritjen e standardeve më të larta të informimit dhe të etikës profesionale, zhvillimin e balancuar të transmetuesve publikë dhe privatë, rritja e tregut konkurrent, korrekt, të ndershëm e objektiv mediatik, mbrojtjen e të drejtave profesionale dhe etike të gazetarëve.

Me qëllim të realizimit të punës sa më të suksesshme dhe arritjes së rezultateve të pritura nga radhët e anëtarëve të komisionit është formuar grupi punues prej 5 anëtarëve për amendamentimin e Ligjit për Komisionin e pavarur të mediave dhe transmetimin numër 02/L-15.

Do theksuar se gjatë hartimit të tij, komisioni është ballafaquar me sfida nga më të ndryshmet, si mungesën e kushteve për punë dhe sfida tjera.

Grupi punues ka mbajtur mbledhje të rregullta, një dëgjim publik dhe një tryezë dyditore ku të pranishëm kanë qenë aktorë kyç nga institucionet e vendit si KPM-ja, pastaj mediat, shoqëria civile, organizata ndërkombëtare dhe ekspertë.

Gjatë fazës së amendamentimit nga ana e anëtarëve të grupit punues është parë e nevojshme ndërhyrja si në përmbajtjen ashtu edhe në strukturën e projektligjit dhe ka rezultuar me 93 amendamente. Është ndërhyrë në më tepër se 2/3 e Ligjit apo mbi 70% të tij.

Bazuar nga ky fakt dhe me qëllim të zbatimit sa më të mirë në praktikë të tij, gjithherë duke u mbështetur në ligje, Komisioni në pajtim të plotë nga anëtarët e vet ka vendosur që Ligjin për KPM-ën ta procedojë në seancë plenare si projektligj i ri.

Projektligji është i strukturuar në përputhje me standardet e kërkuara dhe në përmbajtjen e tij ngërthen gjithsej 36 nene, të ndara në 6 kapituj, ku përveç tjerash flet edhe për themelimin e komisionit të pavarur për media, ndarjen e frekuencave dhe licencimin e transmetuesve, themelimin e bordit për ankesa të mediave, për financimin e KPM-së e tjera.

Vlen të theksohet se çështje që synon të rregullojë ligji në fjalë nuk cenojnë parimet e përgjithshme të aqvi comunitaire dhe standardet tjera ndërkombëtare.

Në nenin 5 të Projektligjit parashihet që politikat e transmetimit të jenë në përputhje me standardet e pranura ndërkombëtarisht të transmetimit dhe të drejtave të njeriut, duke respektuar plotësisht demokracinë dhe sundimin e ligjit si dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes, qasja e publikut në dokumentacionin e KPM-së të mbështetet në praktikat më të mira evropiane si dhe dispozitat e ligjit për qasje në dokumentet zyrtare.

Ky projektligj i përgjigjet sfidave dhe rekomandimeve të specifikuara në raportin e progresit 2009 të Komisionit evropian, të datës 14 tetor 2009.

Projektligji përmban në vete implikime buxhetore gjatë implementimit të tij, por nuk ka implikime buxhetore shtesë. Mjetet financiare për komisionin e pavarur të mediave dhe transmetimin janë ndarë me Ligjin e buxhetit të republikës së Kosovës për vitin 2010, janë të pasqyruara në memorandumin shpjegues.

Pas finalizimit të tij dhe aprovimit nga Kuvendi, Ligji për Komisionin e pavarur të mediave dhe transmetimit e shfuqizon Ligjin numër 2/L-15 për Komisionin e pavarur të mediave dhe transmetimin, shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/34 të datës 8 tetor 2005.

Me besimin se arritëm të japim sqarime të nevojshme rreth hartimit dhe përmbajtjes së Projektligjit për Komisionin e pavarur për media dhe transmetimin dhe duke e mirëpritur kontributin tuaj gjatë procedurave të mëtutjeshme, ju ftojme që ta përkrahni në parim Projektligjin në fjalë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

(Ndërhyrje e deputetes)

Urdhëro? Po thuaje, edhe për grupin, menjëherë. Ju lutem, ia vazhdoni mundësinë të diskutojë deputetja.

SYNAVERE RYSHA: Atëherë, po shfrytëzoj rastin që edhe në emër të Grupit parlamentar të LDD të shpreh qëndrimet për Projektligjin për Komisionin e pavarur për media.

Duke e shqyrtuar dhe duke u marrë me materien që përmban ky projektligj, kemi vlerësuar se Projektligji në fjalë i plotëson kushtet e nevojshme dhe e përkrahim në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit shumë! Fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së deputeti Abdyl Ymeri.

ABDYL YMERY: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin për Komisionin e pavarur të mediave dhe transmetimit dhe konsideron se është i një rëndësie të veçantë që synon të rregullojë promovimin e një shoqërie të lirë, të hapur, tolerante, demokratike në Kosovë përmes mediave të lira, të pavarura në përputhshmëri me standardet më të larta evropiane.

Po ashtu ky projektligj rregullon zhvillimin e balancuar të transmetimit publik dhe privat si dhe rritjen e konkurrencës në treg, mbrojtjen e të drejtave profesionale të gazetarëve. Gjithashtu rregullon themelimin, funksionimin, detyrat dhe obligimet e Komisionit të pavarur për media dhe organeve të tij.

Ne do të japim kontributin tonë në komisionin funksional. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah në parim këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së nuk është paraqitur askush. A e do dikush fjalën? Zoti Morina dhe nëse s'pritoni, e shtypni atë sustën e mikrofonit.

ZEF MORINA: Zoti kryesues,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe e mbështet në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Gjylnaze Sylja e ka fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara ministre,

Deputetë të nderuar,

Mediat si në botë ashtu edhe në Kosovë duhet të jenë shtylla e demokracisë dhe të luaj një rol vendimtar në krijimin e një demokracie të shëndetshme.

Duke marrë parasysh demokracinë tonë të re, krijimi i një kornize efektive në këtë sektor dhe sidomos formimi i autoritetit rregullator të pavarur, siç është Komisioni i pavarur për media ka një rëndësi zë madhe.

Aktualisht në Kosovë rregullimi i kësaj fushe është bërë përmes Ligjit numër 02/L-15 për Komisionin e pavarur të mediave dhe transmetimin, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/34. Megjithatë, është evidente se korniza aktuale nuk ka rregulluar sa duhet këtë sektor në praktikë.

Po përmendim disa arsye të rëndësishme.

E para, liria e mediave dhe e shtypit, megjithëse e garantuar me Kushtetutë, në praktikë nuk po zbatohet. Dihet se ekziston kontrolli i mediave nga Qeveria dhe këtë tani e kanë vërtetuar edhe raportet e vlerësimeve të organizatave ndërkombëtare. Dëshiroj të kujtoj vetëm shkresën e EBUS, drejtuar kryeministrit Thaçi.

E dyta, në bazë të raporteve të shumta, mediat në Kosovë, në përgjithësi kanë vështirësi të mëdha financiare, e me këtë edhe vetë Komisioni i pavarur për media.

E treta, nga puna e deritanishme dhe raportet e vetë Komisionit të pavarur për media del se ky komision nuk ka arritur të përmbushë tërësisht obligimet ligjore që dalin nga ligji, si legalizimi i operatorëve ilegalë që veprojnë në veriun e Kosovës, por gjithashtu edhe monitorimin e transmetuesit publik RTK-së, sidomos atë që ka të bëjë me emetimin e reklamave.

Duke marrë parasysh arsyet e lartpërmendura, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e kupton Projektligjin e propozuar nga Komisioni për administratë publike, pushtet lokal dhe media si përpjekje për të filluar reformën në këtë sektor duke propozuar ndryshimet për evitimin e pengesave funksionale dhe financiare për zhvillimin e sektorit të mediave. Kjo është e nevojshme, por është e pamjaftueshme për të krijuar një sektor të mediave i cili e mbështet demokracinë. Prandaj, po aq e rëndësishme është zbatimi praktik dhe i tërësishëm i Ligjit për të kuptuar funksionimin e tij praktik dhe veprimet për përmirësimet e nevojshme.

Nëse krahasohet Projektligji aktual dhe Projektligji i ri, mund të vërehet se janë bërë ndryshime qenësore të cilat mund të përmbliidhen në dy fusha, një është: mënyra e financimit dhe dy: funksionimi më efikas i KPM-së.

Derisa me Ligjin aktual KPM-ja është financuar nga taksat e licencave të mbledhura dhe mjetet shtesë nga buxheti i Kosovës, me Projektligjin e ri financimi kryesor bëhet nga buxheti kurse ai shtesë nga taksat gjegjësisht të hyrat që i realizon KPM-ja. Mënyra tjera shtesë të financimit janë paraparë donacionet dhe projektet.

Grupi Parlamentar i Aleancës angazhohet për fuqizimin, funksionalizimin dhe efikasitetin në pavarësinë e KPM-së dhe konsideron se një ndër elementet më me rëndësi për këtë qëllim është financimi i qëndrueshëm, pikërisht ajo që çka është paraparë me këtë projektligj.

Po ashtu, është e rëndësishme se në procesin e zhvillimeve në vetë sektorin e mediave, dihet se në vitin 2015 duhet të ndodhë edhe procesi i digjitalizimit dhe këtu rolin kryesor e ka Komisioni i pavarur i mediave, prandaj edhe mbështetja financiare e qëndrueshme është e rëndësishme. Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës e përkrah zgjidhjen e propozuar me Projektligj të ri, duke marrë parasysh se KPM-ja realizon edhe vetë të hyrat e veta brenda një viti 190.000 euro.

Mirëpo, duhet marrë parasysh se mund të ketë edhe implikime buxhetore për krijimin e disa trupave të KPM-së, prandaj në mënyrë që Projektligji të arrijë qëllimin e vet, Grupi Parlamentar i AK-së, u

sugjeron deputetëve që nenet të cilët kanë të bëjnë me mënyrën e financimit të definohen qartë, saktë dhe precizë ashtu që të evitohet çdo paqartësi dhe pengesë në zbatimin praktik të tij.

Projektligji synon rregullimin e medias në interes të publikut, arritjen e standardeve të larta, siç thuhet në Projektligj – standardeve ndërkombëtare dhe atyre të BE-së, krijimin e një procesi të drejtë dhe transparent, promovimin dhe sigurimin e konkurrencës së drejtë transmetuese, qëndrueshmërinë ekonomike të subjekteve transmetuese, promovimin e produksionit lokal si dhe promovimin e qasjes publike në informata.

Gjithashtu, janë paraparë dispozitat ndëshkuese.

Sa i përket përputhshmërisë me aquì comunitaire, kjo është një fushë që është shumë më mirë e rregulluar, natyrisht, me legjislacionin e BE-së dhe se nevojitet një punë shumë më e madhe se sa që është vetëm përmendja e një neni, që është neni 5, i cili thotë se Projektligji do të mbështetet në standardet ndërkombëtare të transmetimit.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës sugjeron që të merren parasysh alternativa tjera, si bashkërrregullimi ose vetërregullimi, sepse mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në mbrojtjen e konsumatorit. Vetërregullimi mund të jetë një metodë plotësuese për zbatimin e dispozitave të caktuara të këtij projektligji dhe njëkohësisht të direktivës evropiane. Të përcaktohet me dispozitë ligjore e drejta e personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit për ofrimin e shërbimeve në dispozicion të medias audiovizuale.

Meqenëse projektligji zgjidh edhe disa çështje me rëndësi, siç është licenca e transmetimit dhe ripërtëritja që për transmetuesit digjitalë dhe kabllorë bëhet për një afat shtatëvjeçar për radio dhe dhjetëvjeçar për televizion.

Mendoj se çka duhet ndryshuar, Grupi Parlamentar konsideron se atë çka duhet ndryshuar është edhe mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të pavarur për media sepse parashihet që procedura e përzgjedhjes nga Kuvendi, domethënë njëri prej tyre emërohet nga Kuvendi, bëhet ashtu që votojnë 50% të deputetëve prezentë në seancë, ndërsa është paraparë procedura e shkarkimit me 60% të deputetëve. Grupi Parlamentar i Aleancës, propozon që kjo të bëhet në mënyrë të njëjtë, numri i njëjtë i deputetëve për emërim, por po ashtu edhe për shkarkim.

Evitimi i ndikimit politik dhe raporti në mes politikës dhe mediave në këtë projektligj është rregulluar ashtu që nuk mund të jepen licenca për personat apo organizatat politike dhe ato vendimmarrëse.

Komunikimet komerciale janë rregulluar me përpilimin e akteve nënligjore, që bazohen në standardet dhe praktikën e mira evropiane.

Neni 4.3 dhe 21.1 parasheh nxjerrjen e akteve nënligjore. Sugjerimi ynë është që të definohet koha e nxjerrjes së tyre dhe propozojmë që ajo të jetë 6 muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Grupi Parlamentar i Aleancës përkundër disa mangësive formale dhe përmbajtjesore të Projektligjit, e përkrah në parim dhe do të kontribuojë në hartimin e ligjit që do t'i përmbushë kërkesat e publikut në sektorin e medias. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

Unë do të jem i drejtpërdrejt, pak sa me humor, por sigurisht që ligjet kanë nevojë edhe që të jenë shumë më rigoroz në zgjidhjen e problemeve që mund të paraqiten gjatë implementimit të tyre.

Komenti im është në nenin 8, rreth papajtueshmërisë. Edhe pse kjo fjalë “papajtueshmëri” na ka shkaktuar shumë probleme, posaçërisht me pozicionin e presidentit të vendit dhe kryetarit të partisë, gjë që po reflektohet ngjashëm edhe në këtë ligj. Dhe mirë kishte me qenë, i propozoj komisioneve, që të jenë më kreativë, edhe pse nuk ka të drejtë të mbaj post publik të zgjedhur, që të jenë më kreativë që të mos lënë mundësi për koment, pra, që të tregojnë me sa gradë ngrihet dhe shkrihet dhe kur mund ta ngrijë pozicionin nëse dëshiron. Pra, që të jenë zhonglerë kreativ, inovativ në identifikimin e një terminologjie që deri më tani nuk është përdorur në shkencat juridike, kështu që do të i minimizoj mundësitë për manipulim në një kohë të ardhshme.

Dhe, gjithashtu kam edhe koment në nenin 11, pika 11.2 që të jenë pak më rigorozë edhe këtu. KMP me shumicë votash e zgjedh kryetarin e vet nga KPM. Zgjedhja e kryetarit bëhet me vota të fshehta, ose edhe publike. Të jetë më recidivë! Ose me vota të fshehta ose vota publike...

(Reagim)

Ose edhe, qysh dikush qysh dëshiron, qysh t’i konvenon, qysh te bëjë ndonjë pazar me vota, “ose edhe”, ose le të mbetet njëra me vota të fshehta ose me vota publike, ose “edhe” as gjuhësisht nuk e besoj që ekziston, se njëra është përjashtuese në rast se zgjedh metodën e parë, kurse tjetra është përmbledhëse. Mundësi të tretë nuk ka: ose me votë publike, ose me votë të fshehtë.

Gjithashtu edhe në nenin 11 pika 4, kuorumi për mbajtjen e mbledhjes... Terminologjia e përdorur nuk është shumë adekuate për legjislacion, posaçërisht për ekspertë që e kanë përpiluar këtë legjislacion, mund të thuhet, vendimet merren me shumicën e thjeshtë, sepse me të vërtetë këtu përshkruhet shumica e thjeshtë e votave.

Gjithashtu, edhe në nenin 13, në metodën e zgjedhjes së kryeshefit ekzekutiv. Sikur kanë harruar që Ministria e Administratës Publike tash u dalë me projektin virtuoze – punësimin elektronik dhe kryeshefi ekzekutiv zgjidhet nëpërmjet konkursit të shpallur publik. Është mirë me shtua edhe: përmes punësimit elektronik dhe me iu falënderuar Ministrisë së Administratës Publike me ato zgjedhje kreative, inovative dhe mos me qenë diskriminues ndaj ideve të reja dhe punësimi elektronik të jetë pjesë përbërëse edhe e këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Brajshori, të kërkoj falje, është gabim i imi se e kam shkruar emrin dhe mendova... U bë, tash po e kupton? Mendova që u kryen grupet parlamentare, por tash e ka fjalën zoti Brajshori, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar Ministre,

Unë po flas në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së por njëherit edhe si kryetar i Komisionit, i cili e ka sponsorizuar këtë projektligj. Nuk do të doja të shtoj asnjë gjë nga ato që thanë kolegët lidhur me gjithë procesin deri sa e kemi sjell këtë projektligj këtu, por për të sponsorizuar një projektligj një komision parlamentar nuk është dhe lehtë.

Sido qo të jetë, unë mendoj që ky projektligj krijon mundësi të jashtëzakonshme dhe garanton lirinë e fjalës, një balancim të mediave qoftë publike qoftë ato private dhe them me bindje të plotë se është një Projektligj i cili avancoi të drejtën dhe lirinë e fjalës, po edhe sa i përket licencimit të mediave të ndryshme.

Ne e dimë dhe jemi dëshmitarë se Komisioni i pavarur i mediave këto kohët e fundit ka treguar një performancë gjithnjë e më të mirë dhe jam i bindur se edhe ky projektligj, që shpresojmë të bëhet ligj shpejt, do t'i jap mundësi edhe më tepër këtij organi të pavarur që të ketë një performancë edhe më të mirë.

Në emër të Grupit Parlamentar dhe si anëtar i Komisionit përkatësisht kryetar i Komisionit, ne e përkrahim në parim këtë projektligj dhe presim çdo vërejtje e sugjerim të mundshëm por që të jetë profesional nga ana e kolegëve deputetë. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi 7+, nuk ka të paraqitur. SLS, nuk ka të paraqitur. Grupi Parlamentar për Integritet s'është paraqitur, e tani as deputetët tjerë.

Lus regjinë që t'i bie ziles me qëllim që të bëhet kuorumi për votim, sepse nuk ka të paraqitur tjerë për diskutim. Nuk ka kuorum në sallë.

(Ndërhyrje)

OK. Bën, por unë e di se janë këtu, rreth e përqark dhe mund të vijnë. Dhe, nëse vinë, mirë, nëse jo, atëherë po kalojmë....OK. Nuk donë të vinë të votojnë, unë s'kam çka të bëjë më tutje, s'kam masa represive! E lëmë që nesër në mëngjes t'i votojmë apo nëse vinë, gjatë votimit...

(Ndërhyrje)

Po, po e diskutojmë Ligjin – pikën 13 të rendit të ditës, siç u morëm vesh:

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave

dhe pastaj i lus deputetët që mundësisht të vinë në sallë për të votuar.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministren e Administratës Publike, Edita Tahiri që në emër të Qeverisë, para deputetëve ta prezantojë Projektligjin. Faleminderit!

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar deputetë,

Regjistrimi i popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave paraqitet si nevojë e domosdoshme dhe prioritare për Republikën e Kosovës, me qëllim të planifikimit dhe të zbatimit të politikave të drejta zhvillimore, të joshjes së investimeve të huaja, të përcjelljes së lëvizjeve demografike, për hulumtime shkencore dhe analiza të tjera të nevojshme në fusha të ndryshme të shoqërisë.

Qëllimi kryesor i Projektligjit është të krijojë bazën ligjore dhe parakushtet për realizimin e statistikave zyrtare mbi realitetin demografik, ekonomik dhe social në vend. Ky regjistrim do të bëhet pas një periudhe tridhjetëvjeçare dhe ne këtë e konsiderojmë si projekt më madhor pas pavarësisë së Kosovës. Andaj, e shohim të nevojshme që sot para jush ta paraqesim për aprovim Projektligjin për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave.

Projektligji në fjalë, përcakton mënyrën e organizimit dhe të zhvillimit të procesit të regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë, regjistrim ky që do të zhvillohet prej datës 01-15 prill 2011. Projektligji krijon kornizën ligjore për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në pajtim me standardet e Bashkimit Evropian dhe standardet ndërkombëtare.

Me këtë Projektligj parashihet formimi, përbërja, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve, të cilat mundësojnë organizimin, e ndihmojnë procesin dhe zhvillojnë regjistrimin.

Përveç këtyre çështjeve, në Projektligj është përcaktuar edhe dokumentacioni i nevojshëm për kryerjen e regjistrimit, procedura për sistemimin, përpunimin, publikimin, ruajtja e fshehtësisë së të dhënave individuale, ruajtja e të dhënave të dala nga rezultatet e regjistrimit dhe masat administrative, që ndërmerren në rast të shkeljeve të dispozitave të këtij Ligji.

Regjistrimi, sipas këtij projektligji, është gjithashtu një pikënisje për një sistem të qëndrueshëm të statistikave aktuale të popullsisë sipas metodave të vrojtimit dhe metodave të tjera statistike. Regjistrimi i popullsisë do të jetë një investim i rëndësishëm afatgjatë në të gjithë sistemin statistikor të vendit tonë në aspektin ndërtimit institucional të tij.

Nevoja për legjislacion të kësaj natyre është me interes të veçantë, ngase regjistrimi mundëson përcaktimin e saktë të numrit të përgjithshëm të popullsisë, si bartës i sovranitetit të vendit dhe të dhënave të tjera, që ndihmojnë hartimin e politikave zhvillimore.

Projektligji përbëhet prej 27 neneve.

Ky Projektligj është aprovuar nga Qeveria e Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 04 gusht 2010 (Vendimi Nr. 03/136) dhe sipas procedurës së përcaktuar po i parashtrohet Kuvendit për miratim.

Projektligji është hartuar në përputhje me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Kosovës, nr. 01/2007.

Projektligji ka formën dhe strukturën standarde, në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr.14/2008 për hartimin e projektligjeve dhe të akteve nënligjore. Në hartimin e tij kanë marrë pjesë zyrtarë nga institucione të rëndësishme vendore dhe ndërkombëtare, të përcaktuara me nenin 32 të kësaj rregulloreje. Gjithë puna e hartimit të Projektligjit është bërë nga një frymë e transparente si dhe duke i respektuar procedurat.

Projektligji është në pajtim me Kushtetutën dhe me standardet, marrëveshjet, konventat dhe detyrimet ndërkombëtare, si dhe është i përafuar me dispozitat e detyrueshme të acqui communautaire.

Andaj, të nderuar deputetë, ju që në parim ta aprovoni këtë projektligj sot!
Ju faleminderit për vëmendje!

Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Para se të fillojmë me diskutimin në emër të grupeve parlamentare, i paralajmëroj deputetët që mund edhe të na shikojnë, ata që nuk janë në fund të seancës për sot i humbin mëditjet e tyre.

(Ndërhyrje)

Vërtet, nuk është demokratike dhe edhe lënia e sallës thatë, nuk është demokratike, bile as e kulturuar dhe e përgjegjshme. Vazhdojmë!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Arsim Bajrami, e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

E nderuara ministresh,

Kolegë deputetë,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike t'i jap mbështetje parimore miratimit të Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave dhe t'i japim mbështetje tërë procesit i cili është duke u finalizuar drejt një momenti historik regjistrimit të popullsisë dhe padyshim se miratimi i këtij ligji do të finalizojë këto përpjekje, është vetëm një segment – segmenti legjislativ, sepse po bëhen edhe përgatitje tjera që ky proces të shkojë mirë, të shkojë me standarde ndërkombëtare dhe ky proces i cili do të mbahet në fund të marsit të vitit të ardhshëm dhe deri më 15 prill padyshim se është edhe një sfidë për shtetin e ri të Kosovës në mënyrë që ne ta kryejmë këtë proces, që nuk është vetëm një operacion i thjeshtë demografik por edhe një parakusht për zhvillim ekonomik.

Ligji i rregullon të tëra proceset, që nga data e regjistrimit e deri te procesi që do të përfshin një proces i gjithanshëm i regjistrimit dhe mendoj se me miratimin e këtij projektligji do t'i jipet hapësirë e mjaftueshme institucioneve përkatëse kompetente për regjistrim, që të finalizohen përpjekjet. Është një fat i mirë që ky ligj po vjen 6 muaj para regjistrimit dhe mund të bëhen edhe përgatitjet e fundit, të funksionalizohen të gjitha komisionet komunale për regjistrim dhe në mënyrë të veçantë të funksionalizohet plotësisht komisioni qendror i regjistrimit që është një organ i Kuvendit të Kosovës në mënyrë që të përfundojnë përgatitjet rreth këtij procesi.

Do t'i jap nja dy sugjerime parimore që ndoshta nuk janë pjesë e ligjit, por janë me rëndësi, sidomos për ministren që t'i ketë parasysh. Pakoja e Ahtisarit pak a shumë afekton procesin e regjistrimit dhe është jashtëzakonisht me rëndësi që ndoshta brenda ligjit të përcaktohet se regjistrimi përfshin tërë territorin e Kosovës. Në mënyrë shumë eksplicite është thënë se përfshin qytetarët rezidentë dhe është mirë që është përfshirë edhe lista subsidiare, mundësia e një fotografie complete të popullsisë së Kosovës edhe me qytetarët që janë në diasporë dhe emigracionin, por është me rëndësi që të thuhet në mënyrë të qartë se regjistrimi do të bëhet në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Kjo nuk paragjykon mundësinë e një regjistrimi diku tjetër por është shumë me rëndësi që kjo të jetë në ligj dhe të kemi një pasqyrë complete.

Edhe një çështje teknike. Është një çështje që të gjitha aspektet teknike të regjistrimit, prodhimi i mostrave, i dokumentacionit tjetër në mënyrë të padyshimtë duhet të përmbajnë simbolet e Republikës së Kosovës. Unë e di, zonja ministresh, meqenëse vetë kam negociua për datën e regjistrimit të ri që do të ketë sfida, kam parë që ka edhe presione sa i përket dokumentacionit të regjistrimit, por nuk duhet të pranojmë kurrfarë presioni që dokumentacioni i regjistrimit që nga mostrat dhe dokumentacionet tjera mos të kenë stemën e Republikës së Kosovës. Është

jashtëzakonisht e rëndësishme të kuptohet se ky është një proces shtetëror. Është një proces i një shteti të ri dhe nuk duhet të pranohen kurrfarë presione eventuale që mos të vendosen simbolet e Republikës së Kosovës.

Jam i sigurt se me miratimin e këtij ligji, ne po kryejmë një punë të fundit, e quaj punë të fundit, e cila definitivisht po e fut Kosovën në procesin e regjistrimit dhe tanimë është më se e qartë se ky proces do të realizohet me sukses në vitin e ardhshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Sabri Hamiti, e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Natyrisht që do ta përkrahim nxjerrjen e këtij ligji, si domosdo, bile duke kërkuar që aprovimi i tij të bëhet me një, po them, intensitet të shtuar të punës.

Ky ligj ka rëndësi të jashtëzakonshme që prodhon regjistrimin e popullsisë, të pasurive dhe, fundi i fundit, jep përgjigje në ato pyetje fundamentale sa jemi, kush jemi, çka kemi në kuptimin më elementar të fjalës, të kalojmë nga niveli i hamendësive në nivelin e të vërtetave dhe, e dyta, krijon parakushtet për të gjitha llojet e planifikimeve dhe të zhvillimeve qofshin ato demografike, sociale, ekonomike e tjera.

Edhe një herë po e vë theksin te afatet. Ky ligj është shumë specifik sepse që në fillim, në krye herës, përcakton detyrimin madhor që ka regjistrimin e popullsisë dhe e definon datën, niset më 1 prill dhe mbaron më 15 prill 2011. Çdo gjë tjetër, qoftë si kodifikim në nene të veçanta, i detyrohet kësaj date. Prandaj, ju thërras që t'i lexoni, edhe propozuesi, po edhe deputetët, nenet që i detyrohen kësaj, sepse nganjëherë nuk korrespondojnë me të, edhe pse pretendojnë të korrespondojnë.

Për ta bërë më të qartë problemin që duhet ta jap në vëmendje të komisioneve që do të merren me të, po ju them që ky ligj do të duhej të kalonte në fund të këtij muaji në mënyrë që kufijtë e fundit të përcaktuar të veprimeve t'i kapë, e që janë 6 muaj para regjistrimit, qoftë me ndërtimin e komisioneve komunale, qoftë me fillimin e propagandës së vërtetë, qoftë me ndërtimin e komisionit qendror. Bile, çështja e ndërtimit të komisionit qendror zgjedhor i ka dy dysi, atje ku formohet dhe jepet struktura nuk tregohet kur formohet, ndërsa në një nen tjetër – në nenin 22 thuhet: “Një muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Qeveria i jep Kuvendit të Kosovës”, domethënë “propozimin dhe emërimin e këtij komisioni”. Nuk ka mundësi që një komision që është burimi i të gjitha detyrimeve, aprovimit të gjitha dokumenteve për regjistrim, të formohet një muaj pasi që të hyjë në fuqi ligji.

Zonja ministre keni të bëni me nenin 22 dhe lidhjen e këtij neni me nenin 12. Duhet të studiohen.

Po ashtu, “Komisioni qendror i regjistrimit 6 muaj para datës së regjistrimit aprovon dokumentet”. Nuk ka shans i njëjti komision të formohet një muaj pasi të hyjë në fuqi ligji, 6 muaj para regjistrimit t'i aprovojë dokumentet. Kemi të bëjmë me saktësim të kohës!

Unë nuk dua të shkoj nëpër specifikime të tjera, por po them edhe një herë: e mbështes fuqimisht këtë ligj, e mbështes fuqimisht regjistrimin e popullsisë. Fundi i fundit para çfarëdo zgjedhjeve të reja dhe nacionale të Kosovës, është mirë të kemi regjistrim të popullsisë dhe të shohim pamjen e numrave dhe mos të ketë hamendësime të natyrave më ekstreme të përdorimeve dhe të keqpërdorimeve.

Dhe, thërras Kuvendin dhe grupet parlamentare e komisionet që do të jenë funksionale, që ta kryejnë sa më shpejt punën në mënyrë që fundi i shtatorit të na ketë me këtë ligj, që të jemi saktë me datë, 6 muaj të gatshëm për ta bërë regjistrimin nga 1 deri më 15 prill. Faleminderit! Ky ishte mendim i Grupit Parlamentar të LDK-së

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Melihate Tërmkolli e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Edhe si Aleancë, por besoj edhe si Parlament në tërësi, edhe si subjekte politike dhe qytetarë të Kosovës jemi në përkrahje të plotë të procesit të regjistrimit të popullsisë duke e konsideruar, ashtu siç e tha edhe zonja ministre, ndër projektet më madhore të vendit, mbase edhe ndër projektit më të madh pas pavarësisë së vendit.

Mirëpo, fatkeqësisht ne nuk po sillemi me këto projekte madhore ashtu çfarë e kanë rolin dhe rëndësinë në jetën tonë, jo veç politike, por në jetën tonë të përgjithshme.

Po sillemi me një absurditet jashtëzakonisht të lartë, në fakt, duhet saktësuar që Qeveria po bën absurde pas absurdit. Ndërrohet një ministër, ndërrohet komisioni qendror dhe mos dhashtë zoti me u ndërrua edhe një herë ministrja se duhet me bë edhe një herë një ligj, duhet me bë edhe një herë edhe një komision qendror. Është i treti komision që parashihet me ligj. Është bërë në qeverinë e kaluar një komision, ka ardhur kjo Qeveri, në ministri është bërë një komision qendror i regjistrimit të popullsisë dhe tash me këtë ligj prapë duhet me u bë edhe një komision tjetër. Ky është një absurd! Kjo nuk i lejohet kurrkujt.

Mirëpo, kjo ndodh sepse kemi absurdin tjetër. Ju e dini që para 2-3 muajsh ky Parlament ka vendosur për datën e regjistrimit të popullsisë dhe ka bërë mirë që e ka bë një vendim të tillë dhe pas vendosjes së datës së regjistrimit neve na vjen ligji. Në Shqipëri thonë: jeni të paparë! Qeveri e nderuar, jeni vërtet, të paparë! Pas, vendimit për regjistrim, Qeveria e sjell ligjin për regjistrimin e popullsisë. Kjo nuk ndodhë kurrkund në botë! Ky absurd ndodh vetëm në vendin tonë, fatkeqësisht. Ndodh vetëm me këtë Qeveri. Dhe kjo Qeveri po bën shaka, për mos me thënë, po i nënçmon qytetarët e vendit, po i nënçmon institucionet, po e nënçmon edhe këtë Parlament.

Do të ndalem në dy-tri çështje, që mendoj janë të rëndësishme. Po ndalem në përbërjen dhe strukturën e Komisionit qendror të regjistrimit. Shumë të nderuar, kushdo që e ka lexuar ka pa që ka brenda një absurd të vonësës, ka një absurd tjetër në kuadër të këtij komisioni.

Me këtë projektligj Qeveria na ka kthyer në kohën e UNMIK-ut, që tash i bie pak më zi. Përderisa në kohën e UNMIK-ut ka qenë e obligueshme, në dashit me Kushtetutë në dashit me Rregullores, sepse autoritet kompetent i fundit ka qenë UNMIK-u – PSSP-ja, tanimë nuk na ndalon neve kurrkush që të jemi autoritet i vetëm që duhet me bë regjistrimin e popullsisë. Dhe komisioni qendror nuk guxon të ketë asnjë anëtar tjetër përveç anëtarëve të institucioneve legjitime të Republikës së Kosovës. Në këtë projektligj është paraparë që anëtar i Komisionit të jetë edhe përfaqësuesi i ICO-s, që nuk ka as mandat e as kompetenca, besoj, dhe njësoj nuk ka as mandat dhe as kompetenca as përfaqësuesi i Komisionit Evropian. Mund të bëhen komisione ose grupe punuese profesionale në të cilat do të mund të merrnin pjesë përfaqësuesit e këtyre institucioneve por le të jetë e qartë se Komisioni qendror i regjistrimit është një organ politik. Ky është një organ politik! Dhe si i tillë, unë mendoj që nuk ka vend që në të të jenë edhe këta përfaqësues. Njësoj, siç mendoj që nuk ka vend ndoshta edhe

për përfaqësues të ndonjë ministrie që nuk ka fort lidhje me çështjet e regjistrimit, siç është Ministria e Drejtësisë, Ministria e Jashtme e tjera.

Dhe, krejt kjo demagogji, se ne, se kjo Qeveri po lufton dhe po bën përpjekje për me përfunduar mbikëqyrjen ndërkombëtare është vetëm demagogji, mos me thënë, pallavër e madhe, sepse po kjo Qeveri me vullnet të vet, edhe duke qenë shumë servile ndaj ndërkombëtarëve, po bën shkelje të madhe, edhe të Kushtetutës edhe të ligjeve.

Një çështje tjetër, desha të flas, për komisionet komunale. Në këtë projektligj iu janë dhënë kompetenca dhe prerogativa, zonja ministre, kisha me të lutur shumë, që ta rishikoni – prerogativa, edhe zotëri Arsim Bajrami e di shumë mirë, që janë të palejueshme. Nuk mund komisioni komunal me bë përpunimin e të dhënave të regjistrimit të popullsisë. Komisioni komunal është një mekanizëm i një niveli tjetër nga Komisioni qendror që po ashtu ka prerogativa pak a shumë të mbikëqyrjes por jo edhe prerogativa profesionale për me bë përpunimin e të dhënave. Dhe kjo është katastrofave për një vend i cili pretendon me bë një regjistrim në harmoni me standardet ndërkombëtare. Kjo është jashtë çdo normaliteti të standardit, të zbatimit të standardeve ndërkombëtare. Dhe në këtë pikë duhet me bë jashtëzakonisht shumë, duhet me pa me shumë seriozitet që kjo nuk shkon dhe nuk bën.

Tek afatet. Qeveria e ka paraparë që 2 vjet pas përfundimit të popullsisë, të jepet publikimi i të dhënave. Mendoj që është një afat jashtëzakonisht i gjatë. Nuk ka shans që brenda një muaji ose brenda 6 muajve, ndërsa të dhënat e përgjithshme, publikimi, është i mjaftueshëm një vit, për një institucion të përgjegjshëm.

U përmend këtu çështja e territorit. Mendoj se në ligj është paraparë dhe është paraparë mirë që mbahet në gjithë territorin e Kosovës, por ka edhe një element shumë të rëndësishëm që lidhet po ashtu me çështjen e statusit dhe ajo është institucioni kredibil që e bën regjistrimin e popullsisë. Fatkeqësisht, në këtë ligj, ky institucion mungon. Çdokund në botë, institucioni i vetëm kredibil në nivel kombëtar është enti i statistikës, diku quhet instituti i statistikave, diku me emra tjerë, por është, domethënë mekanizmi i cili ka kompetenca statistikore.

Në këtë projektligj, është dalë, është përjashtuar Enti i Statistikës i Kosovës dhe është hartuar njëfarë lloj mekanizmi i cili është në kuadër të Entit, por që thjeshtë nuk është ent, është Zyra – kanë thënë institucioni përgjegjës për regjistrim, e që është Zyra për regjistrim, por kjo është një zyrë të cilën mund të them e themeloi veç Enti dhe jo ashtu siç është paraparë në ligj që të jetë një institucion i pavarur. Thjeshtë, është bërë përpjekja që me këtë projektligj krejt procesi i përpunimit, i mbledhjes dhe tjera, të dhënave, të përjashtohet nga institucionet të cilat janë të parapara dhe të bëhet njëfarë forme tjetër, e cila është e palejueshme dhe e papranueshme, i shkel krejt standardet ndërkombëtare.

Me thënë të drejtën, me krejt këto, mendoj se është bukur një pikëpyetje e madhe që me këtë qasje a do të mbahet fare regjistrim apo jo në kohën e paraparë, se një herë do ta bëjmë këtë regjistrim, por për mua është shumë pikëpyetje a do të bëhet në këtë kohë të paraparë, sepse shumë afate që janë paraparë këtu, që i përmendi edhe më herët, edhe zotëri Hamiti e tjerët, interferojnë në njëra tjetrën dhe nuk mund të përputhen bash mirë.

Natyrisht, ne do ta përkrahim dhe e përkrahim si Projektligj, të vetëdijshëm shumë se do të ketë shumëçka të punohet, ndoshta shumëçka edhe të ripunohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli. Më falni, se edhe ti e ke emrin këtu, e ndoshta u përzie. Esat Brajshori e ka fjalën.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re është i vetëdijshëm për rëndësinë që e ka regjistrimi i popullatës, i ekonomive familjare dhe në këtë drejtim shpreh përkrahjen e vet në parim të këtij projektligji dhe do të jep kontributin e vet në hapat e mëtutjeshëm.

Një gjë që më solli deri te një moment që të flas është çështja e afatit, ose më saktë, puna që duhet kryer në komisione për të qenë sa i përket afateve në rregull.

Realisht, përpara se të shkojmë në pushime, unë e kam ngre çështjen e ardhjes në Kuvend të këtij projektligji duke ditur se pastaj do të ngelet një kohë shumë e shkurtër që të punohet mirë e saktë projektligji dhe të jetë sa më funksional.

Si do që të jetë, në këtë rast them unë, edhe grupet parlamentare duhet të jenë më azhure në këtë drejtim.

Edhe një herë po them, Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet në parim këtë projektligj dhe do të japë kontributin e vet.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së? Deputetja Synavere Rysha e ka fjalën.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, me kujdes e ka shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave.

Duke e vlerësuar si mjaft të rëndësishëm, ndiejmë obligim që ta mbështesim në parim.

Shqetësimet tona mbesin për shkak të mungesës së buxhetit për këtë projekt, kaq madhor dhe të shumëpritur për qytetarët e Kosovës dhe kërkojmë nga Qeveria e Kosovës që të jetë shumë e kujdesshme dhe e përgjegjshme në këtë aspekt, për sigurimin e buxhetit të nevojshëm sepse janë vetëm 6 muaj para fillimit të procesit të regjistrimit dhe kërkojmë që ky proces të përfundojë me sukses.

Prandaj, e mbështesim në parim dhe kontributin tonë do ta japim në komisionet funksionale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar 7+, s'është kurrkush këtu! Në emër të Grupit të SLS, s'e kanë kërkuar fjalën! Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, s'ka. Atëherë, fjala është për deputetët. Kemi të lajmëruar 3 deputetë. Fjalën e ka fillimisht, sepse u shtua edhe numri tash, fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Zonja ministre,

Deputetë të nderuar,

Që në fillim dëshiroj të theksoj se e përkrah procesin ose projektin e regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave. Por, duke mos e përsëritur atë që kolegët e mi më parë e thanë, unë do t'isha përqendruar më tepër në rëndësinë që ka zbatimi i dispozitave ligjore. Konsideroj se sfidat do të jenë:

Një. Në intensifikimin e procesit brenda vetë Kuvendit të Kosovës, që do të thotë Komisioni të punojë ashtu që të sigurojë se ligji do të jetë i aplikueshëm por edhe do t'i përmbajë të gjitha standardet ndërkombëtare dhe sidomos ato evropiane, duke përfshirë edhe rregulloret të cilat i ka legjislacioni evropian për këtë fushë, dhe

Dhe e dyta, është që dispozitat të cilat parashihen jo vetëm që të jetë zbatimi i tyre por që rezultatet e këtij projekti të jenë të pranueshme edhe për bashkësinë ndërkombëtare, do të thotë të jenë të pranueshme në botë sepse janë shumë të rëndësishme që të pranohen.

Nga aspekti i brendshëm ose vendor, ky projekt dhe sukcesi i tij ka një rëndësi të madhe, jo vetëm për aspektet demografike por edhe për aspektet ekonomike dhe shoqërore, për arsye se të dhënat të cilat grumbullohen do të jenë shumë të rëndësishme për zhvillimin në përgjithësi të politikave të ndryshme edhe nga vetë institucionet, përfshirë edhe Qeverinë, Kuvendin e tjera, por edhe për hulumtimet e ndryshme shkencore, pastaj të OJQ-ëve dhe të tjerët që janë të interesuar për këto të dhëna.

Në aspektin ndërkombëtar, po qe se nuk do të arrijmë që të përmbushim aspektet e respektimit të normave ndërkombëtare ose standardet ndërkombëtare, natyrisht, se nuk do të pranohemi dhe atëherë do të na qet në telashe shumë të madhe.

Sa i përket kësaj, unë isha ndalur edhe në zbatimin e aspekteve kohore. Mendoj, ministre, që duhet me qenë shumë e rëndësishme se përgatitja dhe parapërgatitja është po aq e rëndësishme sa edhe vetë rezultati. Domethënë i tërë procesi duhet të jetë jo vetëm që të sigurohet mbarëvajtja e tij por që të jetë edhe mbikëqyrja e vazhdueshme e tij dhe në këtë aspekt mendoj se rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet edhe vetë procesit të informimit –qytetarët e Kosovës, ashtu siç parashihet edhe në ligj, por unë kërkoj që zbatimi i tij në praktikë të jetë shumë intensiv që qytetarët e Kosovës të informohen me kohë për procesin e regjistrimit.

Në Projektligj janë paraparë edhe ndëshkimet, ashtu që zyrtarët të cilët i shkelin ligjet ose dispozitat e caktuara të ligjit, do të ndëshkohen diku 500 deri 1000 euro, ndërsa personat të cilët refuzojnë zyrtarin t'ia japin zyrtarit të dhënat, atëherë parashihet që gjithashtu edhe ata të dënohen me gjobë.

Zonja ministre, unë e kam një dilemë lidhur me zbatimin sa i përket buxhetit. Këtu thuhet se janë siguruar diku 3.9 milionë euro, nga të cilat 2.6 milionë euro për mallra dhe shërbime, kurse 1.3 milionë për shpenzime kapitale dhe nëse kësaj i shtohet edhe 2 milionë e gjysmë, nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian, del se janë siguruar 6.4 milionë euro, ndërsa janë të nevojshme 9.8 milionë euro për zbatimin e këtij projekti, që do të thotë se mungojnë 3.4 milionë euro.

Unë kisha dashur të di se sa është Qeveria e përkushtuar ose a është që tani ndonjë buxhet i caktuar, i ndarë prej 3.4 milionë eurove, i cili do të mundësonte suksesin dhe rezultatet e këtij projekti.

Dhe unë, gjithashtu pajtohem me atë se në qoftë se rezultatet preliminare duhet të shpallen me 30 qershor të vitit 2011, ndërsa rezultatet përfundimtare diku më 31 dhjetor 2013, konsideroj se kjo

periudhë duhet shumë të shkurtohet, gjegjësisht procesi përfundimtar duhet të jetë pas një viti të mbledhjes së këtyre të dhënave. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Unë nuk do të hy në çështjen se sa është i rëndësishëm ky projektligj dhe sa është i rëndësishëm regjistrimi në Kosovë, por vetëm dua të shtroj këtu një çështje, përgjigjen e së cilës si deputetë, do të dëshiroja me marrë nga ana e ministres, sepse kjo shoqëri e jona është sikur ai mësuesi i shkollës fillore që asnjëherë nuk del në klasë të pestë sa për ta përfundojë të katërtën kthehet në klasë të parë dhe te na është një moto që gjithçka fillon me mua dhe duhet të përfundoj me mua.

Ministre dhe kolegë, po e shtroj një pyetje këtu: Para disa muajsh Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka zgjedh, e ka emëruar Komisionin qendror të regjistrimit dhe mesa kam njohuri unë, ai komision ka punuar disa muaj. Kush dhe kur ka marrë vendim që ky komision të zhbëhet? Kush e ka marrë kompetencën e Kuvendit të Republikës, sepse mandati i këtij komisioni kur është zgjedhur këtu ka qenë trevjeçar. A nënkupton kjo që sa herë të ndërrohen ministrat, duhet të vijnë komisione të reja dhe unë po e shtroj një çështje, ministre. Është dashur disa muaj që ky komision të konsolidohet dhe të fillojë punën. Po njëjtë, edhe një komisioni që ju do ta sillni pas disa muajsh, do t'i duhen nja dy-tre muaj me u zgjedh në Kuvend dhe do t'i duhen së paku edhe dy-tre muaj për me filluar punën. A mundeni me qenë të përgatitur me filluar me kohë regjistrimin dhe po them edhe një herë, si deputet që kam votuar këtu, po dua të di se kush e ka anuluar vendimin e Kuvendit për Komisionin qendror të regjistrimit. Sepse, është votuar në këtë Kuvend dhe nëse ju kujtohet ka pasur mjaft vërejtje. Këtu kemi pasur një arsyetim të ministrit në atë kohë dhe të tjerëve se në krye të këtij komisioni është vendosur njeriu që më së miri e njeh këtë lëmi. A do të duhej tash, mos keni filluar me i kuptuar si tendera, mos doni me ia dhënë ndokujt ndonjë tender me bë regjistrimin e popullatës dhe të amvisnisë në Kosovë. Thjeshtë, po dua si deputet që kam votuar për, po dua me dit kush e ka marrë këtë vendim me anuluar vendimin e Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi.

MARK KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Ju përshëndes të gjithëve!

Ligji për regjistrimin e popullsisë ka rëndësi multidimensionale, madje implikohet me shumë ligje tjera të cilat së bashku duhet ta parashohin një zhvillim normal të shtetit. Parashihet se koha dhjetëvjeçare është e mjaftueshme për të parë ndryshimet esenciale në një shoqëri. Në Kosovë nuk kanë kaluar dhjetë vjet, por kanë kaluar 30 vjet që nuk është bërë regjistrimi i popullsisë dhe i ekonomive familjare. Prandaj, kjo ka shumë rëndësi se si Parlamenti të angazhohet në mënyrë të posaçme që ky regjistrim të jetë sa më i suksesshëm dhe të japë pasqyrën sa më të vërtetë të gjendjes faktike demografike në Kosovë.

Është një problem i madh i Kosovës çështja e punëtorëve tanë të përkohshëm në botën e jashtme. Duhet bërë çmos që një numër aq i madh që e kemi përjashta mos të mbesin në asnjë mënyrë jashtë mundësive që të regjistrohet si banorë të përhershëm dhe si banorë rezidencial të shtetit të Kosovës.

Këtu duhet interesuar sidomos edhe ambasadat tona që i kemi tash në botën e jashtme, që ta mobilizojnë atë masë shumë të madhe të punëtorëve tanë që të kërkojnë dhe të përpiqen që të mos

mbesin jashtë regjistrimit. Regjistrimi është si njëfarë lloj votimi, ku bëhen shpeshherë edhe malverzime.

Në regjistrimin e popullsisë gjatë gjithë periudhave të kaluara është bërë një padrejtësi shumë e madhe ndaj popullsisë shqiptare në ish Jugosllavinë, qoftë ajo kapitaliste, socialiste dhe çfarë do. Janë bërë gjithmonë përpjekje që numri i shqiptarëve, i pakicave, jo vetëm i shqiptarëve, por sidomos i shqiptarëve të jetë sa më i vogël. Kjo ka mundësi gjithmonë që të bëhen malverzime në këtë mënyrë, por më duket se tash është koha që s'kemi nevojë, dhe jo që s'kemi nevojë, por në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që të bëhet kurrfarë malverzimi ndaj asnjë bashkësie etnike që e kemi ne këtu në Kosovë.

Regjistrimi i popullsisë, për sa di unë, gjithmonë është në kuadrin e Entit Statistikor. Jo vetëm regjistrimi, por edhe përpunimi. Këtu po shoh se Enti Statistikor, që u përmend edhe më parë, nuk përmendet fare. Nuk di kujt i ka rënë ndërmend që të bëhet një komision, ta zëvendësojë Entin Statistikor, që është me shumë rëndësi për zhvillimin ekonomik dhe për dhënien e pasqyrës së vërtetë të popullsisë dhe të ekonomisë në vend.

Prandaj, edhe afati se kur duhet t'i shohim ne rezultatet e botuara që priten me padurim.... Këtu më duket parashihen bile 3 vjet. Ne nuk jemi Kina me 1 miliard e 200 milionë banorë. Kjo mund të bëhet brenda vitit, në qoftë se angazhohen forcat që janë ekspertë dhe që kanë dëshirë dhe që kanë mundësi ta kryejnë këtë punë.

Prandaj, Parlamenti duhet të marrë masa në këtë drejtim dhe gjatë amendamenteve, grupet parlamentare ta thonë fjalën e vet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Bujar Dugolli, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, kryetar!

Unë nuk do të flas gjatë pasi që shumë u thanë këtu. Unë do të ndalem... Rëndësia e këtij ligji është shumë e madhe. Unë shpresoj se do të zbatohen këto data që janë paraparë se ne e dimë që regjistrimi i popullsisë në Kosovë është shtyrë deri tash për çështje politike, por mendoj që tanimë nuk ka interes as bashkësia ndërkombëtare ta pengojë këtë proces sepse bëhet fjalë për funksionalizimin e shtetit dhe të ekonomive familjare dhe ky duhet të kryhet për të pasur planifikimin në të gjitha fushat Qeveria e Kosovës dhe institucionet e Kosovës.

Unë dua të kërkoj një sqarim nga ministrja sa i përket pikës të nenit 3 të përkufizimet, pika 1.1 ku thuhet se popullsi rezidente nënkupton individët që kanë jetuar për një periudhë kohore të vazhdueshme në vendbanimet e tyre të zakonshme më shumë se 12 muaj. Ne e dimë se çka nënkupton fjala rezidentë dhe e dimë se si mund të fitohet shtetësia e Kosovës në çfarë periudha. Unë do të dëshiroja që ky regjistrim i popullsisë të jetë i argumentuar, i faktografuar, me dokumente siç parashihet në Republikën e re, në shtetin tonë dhe të mos ketë devijim nga ligjet tjera që janë miratuar në këtë Kuvend.

Ne e dimë që është edhe lista suplementare që nënkupton regjistrimin e atyre që nuk janë në territorin e Republikës së Kosovës në procesin e regjistrimit dhe të cilin mund ta dëshmojnë anëtarët e familjes që janë apo kanë qenë shtetas dhe banorë të Kosovës, por regjistrimi i cili duhet të jetë për popullatën rezidente atëherë duhet t'i përmbahemi fjalës rezidente dhe janë kriteret çka e parashohin, çka quajmë rezident dhe nuk duhet të ketë dallime në mes të ligjit të shtetësisë apo ligjeve tjera të

Republikës së Kosovës. Edhe këtë çështje unë e kam vërejtur dhe shpresoj se do të rregullohet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe diskutuesi i fundit, është deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryetar!

Kolegë të nderuar,

Në parim dy-tri pika, konsideroj se janë kyçe. Te neni 6, paragrafi 2, është përcaktuar anketimi pas regjistrimit, bazuar në mostrën reprezentative të qarqeve regjistruese deri në 0,5% të popullsisë. Gjykoj se kjo kuotë është tepër e ulët dhe nuk do të reflektonte, nuk do të rezultonte pasqyrë përafërsisht adekuate. Është një standard, së paku sipas sistemit të Gallupit, ai është për hulumtimin e opinionit, por se edhe këtu mund të aplikohet, që është 2%. Ndoshta do të ngritej kostoja por do të justifikohet kostoja financiare sepse na jemi të interesuar për ta pas një pasqyrë të saktë apo përafërsisht të saktë.

Prandaj, do të isha angazhuar që jo 0,5% po 2%.

Te neni 19, medoemos duhet të rishikohen pozicionet dhe të definojnë qartë, se gjatë procedurës së regjistrimit mund të paraqiten dhe do të paraqiteshin pa evitueshëm, pa marrëveshje ndërmjet regjistruarit dhe regjistruarit rezervë, kontrolluesit e mbikëqyrësit dhe koordinatorit. Duhet të them që të përcaktohet në mënyrë taksative puna, obligimi i regjistruarit, i atij rezerv, që të mos paraqiten probleme, jo kjo është e imja, s'është e imja, se e zhagisin procedurën zgjedhore.

Edhe Komisionit qendror të regjistrimit duhet t'i përcaktohet qartë me ligj funksioni dhe pozicioni, do të jetë organ i instancës së parë apo i instancës së dytë, për vendosje të çështjeve kontestimore në procedurë, e më pastaj, varësisht siç themi ne juristët mutadis – mutandis, nëse i instancës së parë, atëherë ankesa do të shkonte në komisionin e pavarur për ankesa, eventualisht të instancës së dytë, atëherë medoemos do të duhej konflikt administrativ e jo kontekst siç quhet gabimisht se na e kemi edhe ligjin për konfliktin administrativ.

Dhe, kaptinë e veçantë, konsideroj që do të duhej dedikuar emigrantëve. Ne jemi shtet emigrant, bile – bile sa unë di, kështu, përafërsisht, mund të them se nuk është asnjë shtet në Evropë më emigrantë se ne. Kemi numër të madh të qytetarëve tanë që me dekada punojnë, jetojnë e gjallërojnë në botën e jashtme, them kështu popullorçe - pa letra, që të bëhen rezidentë të ndonjë shteti tjetër. Ata janë sikur ne që jetojmë këtu 24 orë dhe 365 ditë, prandaj duhet, meritojnë ata dhe obligim moral dhe politik i yni është që t'ua dedikojmë një kaptinë të dispozitave rregullative në këtë dokument. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pasi janë bërë disa pyetje, unë kisha kërkuar nga ministrja që t'u përgjigjet disa pyetjeve. E keni fjalën, ministre.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, më lejoni t'ju falënderoj për debatin dhe për idetë kreative të cilat dolën si rezultat i ekspertizës që disa prej jush i keni, meqenëse keni punuar në lëmi nga nivele edhe më të larta, deri te ministrat, por edhe deputetët të cilët dhanë kontributin edhe profesional, edhe politik, në mënyrë që ky projektligj pra të dalë sa më i mirë në procesin e finalizimit në kuadër të shqyrtimit të dytë dhe të miratimit.

Meqenëse u shtruan disa pyetje, më lejoni të përpiqem t'i jap disa përgjigje lidhur me to dhe po ashtu të them se kam mirëpritur sugjerimet, sidomos të dy ish ministrave të cilët kanë pasur përvojë në këto çështje dhe dolën me disa propozime shumë të rëndësishme.

E dyta, unë besoj se të gjithë e dini se për të qenë një projekt i pranuar, qoftë në planin vendor, qoftë në planin ndërkombëtar, do respektuar standardet ndërkombëtare dhe ky projektligj dhe i tërë procesi i regjistrimit do të realizohet dhe po realizohet në bashkëpunim të ngushtë me Eurostat-in, pra si partner kryesor e këtij procesi, por edhe me të gjitha institucionet tjera ndërkombëtare.

Prandaj, në kuadër të kësaj dhe në kuadër të koordinimeve, në fakt kanë ndodhur edhe disa vonesa që mund të tingëllojnë si kontradikta kur po shikohen afatet dhe ardhja e këtij projektligji në shqyrtim sot. Mirëpo, unë mendoj se tejkalimi apo ikja nga këto kontradikta mund të ndodh në qoftë se Kuvendi do të angazhohet maksimalisht, ashtu siç disa kolegë tuaj edhe u thirrën, pra për rritje të intensitetit të punës, në mënyrë që gjatë shtatorit ta miratojmë dhe pastaj do të jemi në gjendje t'i realizojmë këto, me afate.

Sigurisht, çështja e mospërmendjes së Entit Statistikor të Kosovës, por vetëm përmendjes së vetëm një institucioni kompetent dhe po ashtu edhe të Zyrës për regjistrim, krijoi një lloj konfuzioni, por më lejoni t'ju them se arsyeja pse s'u përmend Enti Statistikor është sepse Ligji për statistikat zyrtare është në procedim dhe Enti Statistikor do të ndryshojë emri – nga Enti do të bëhet Agjencioni Statistikor i Kosovës dhe po ta përmendnim emrin këtu me ent, atëherë do të na dilte punë pasi që të kalojë Ligji për statistika dhe përsëri të hymë e të bëjmë ndryshime këtu.

Ndërsa, Zyra për regjistrim është pjesë e Entit të Statistikave dhe ju do të shihni kur do të vjen projektligji në shqyrtim që kompetencat e ESK-së do të jenë ato që i ka çdo institucion statistikor sipas standardeve ndërkombëtare, pra, kompetenca për realizimin dhe përpunimin, si dhe publikimin e të dhënave.

Po ashtu, më lejoni të përmend se arsyeja pse kemi në përbërje të Komisionit Qendror të Regjistrimit përfaqësim nga ICO dhe BE-a, ndërlidhet me Kushtetutën tonë dhe me planin e Ahtisarit dhe rëndësinë e saj që e ka në Kushtetutë. Ju e dini mirë që Kushtetuta jonë, në disa aspekte, i subordinohet këtij plani. Është shumë e qartë, të gjithë e kemi votuar kështu, ndoshta dikush s'e ka votuar, por ne të gjithë e kemi votuar një Kushtetutë e cila ngërthen në vete këtë plan.

Për sa i takon çështjes së buxhetit, shqetësimi ishte me vend. Më lejoni t'ju jap një lajm të mirë, megjithëse ndoshta nuk mund të shpaloj gjithçka që është arritur, por megjithatë t'ju them se, e para, Qeveria e Kosovës ka kontribuar me 3.9 milionë euro; Bashkimi Evropian është zotuar për 2.5 milionë euro dhe këto ditë kemi marrë sinjale pozitive nga Qeveria Britanike me 1 milionë funta dhe në ndërkohë disa shtete të BE-së po ashtu kanë dhënë pra sinjale për zotime, kështu që ne jemi optimistë që lartësia prej rreth 11 milionësh do të realizohet dhe nuk do të kemi nevojë, pra, të marrim edhe më shumë nga buxheti ynë.

Tutje, më lejoni të shkoj, sa i takon – pse po ndërrohet Komisioni Qendror i Regjistrimit sa herë që ndërrohen ministrat. Desha të them, nuk po ndërrohen këtu dhe s'është punë ministrash në këtë rast, por po ndërrohet ligji, prandaj rrjedhimisht ndërrohen edhe organet sepse dalin organe të reja nga ligji i ri.

Për sa i takon diasporës, sigurisht se do të ishte ideale që ky projektligj, pra, të adresojë edhe popullsinë rezidente të Kosovës edhe diasporën por, siç e dini, në bazë të standardeve ndërkombëtare

ne gjetëm këtë zgjidhje që popullsia rezidente të regjistrohet drejtpërsëdrejti, ndërsa diaspora të regjistrohet përmes listës suplementare dhe me këtë rast familjarët e atyre që janë në diasporë, pra këta që janë në Kosovë, kanë të drejtë të deklarohen plotësisht për familjarët e tyre. Po unë me këtë rast më lejoni të ftoj diasporën që ashtu-kështu kur vinë çdo verë në Kosovë, është mirë të vijnë prej 1 deri më 15 prill në Kosovë dhe të regjistrohen si popullsi rezidente sepse ashtu-kështu na vinë edhe për vitin e ri, vinë edhe verës, kësaj radhe le të vinë tri herë dhe unë besoj që është një kontribut shumë i rëndësishëm.

Kishte edhe shumë pyetje tjera, por unë besoj edhe herëve tjera do të jem këtu për përgjigje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në sallë kemi 73 deputetë. Hymë në procedurë të votimit. Diskutimet janë kryer. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave.

Në bazë të Rregullores së Kuvendit ngarkohen këto komisione:

- Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, si komision funksional, dhe
- Komisionet e përhershme.

Komisionet duhet që, brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime. Në fakt kërkojmë që brenda afatit sa më të shkurtër të mundshëm të bëhen raportet me rekomandime.

Votojmë edhe pikën e dhjetë: - **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetimit.**

Pika e dhjetë e rendit të ditës. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Me 68 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Komisionin e pavarur për media dhe transmetimin.

Në bazë të Rregullores Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, si komision funksional dhe
- Komisionet e përhershme.

Komisionet duhet që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

Mirupafshim nesër në ora 10:00!

E martë, 7 shtator 20010, ora 10:00, vazhdimi i seancës

Mbledhjen drejton: kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë seancën plenare, të filluar dje. Në rend dite kemi pikën e njëmbëdhjetë:

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prokurimin publik

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

Në sallë kemi 67 deputetë.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kam nderin që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës të paraqes këtë ligj sot para jush për aprovim. Ministria e Ekonomisë dhe Financave nuk ka qenë e involvuar në hartimin apo procedimin e këtij ligji, por në mungesë të përfaqësuesve të kryeministrit, unë jam i autorizuar që ta paraqes këtë projektligj para jush dhe i cili besoj se është një hap përpara në përmbushjen e obligimeve tona ndaj strukturës legjislative dhe natyrisht të përmirësimit në përgjithësi të standardeve të ligjeve tona, e sidomos në fushën e prokurimit, që është një nga fushat tepër të rëndësishme për shpenzimin e parasë publike.

Andaj, kompletimi i kësaj infrastrukture është nevojë, siç e thash, imediate në kontekstin e përmbushjes së detyrimeve kushtetuese nga plani i rregullimit të materies juridike të prokurimit, gjithnjë me qëllim që duke i përcaktuar kushtet, rregullat dhe procedurat më efikase të sigurojmë dhe garantojmë një mënyrë sa më efikase dhe efektive të prokurimit, transparencë dhe shfrytëzim më të drejtë të fondeve dhe burimeve publike, si dhe të gjitha burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Hartimi i Projektligjit për prokurim publik është iniciuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh kërkesat dhe nevojat e zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit, si dhe kërkesat nga faktorët ndërkombëtar e në veçanti nga Komisioni Evropian për përmirësim në këtë fushë.

Ky projektligj është bërë në koordinim të plotë dhe në mbështetje të ekspertëve vendorë dhe të atyre të Komisionit Evropian pas analizimit të situatës së përgjithshme në sektorin e prokurimit publik, si dhe pas marrjes së komenteve dhe sugjerimeve nga autoritetet kontraktuese në Kosovë.

Projektligji për prokurim publik në Republikën e Kosovës është përgatitur në pajtim me procedurat dhe hartimin e legjislacionit dhe është harmonizuar me ligjet e standardeve të BE-së dhe me standardet e aquie-comunitaire.

Ky projektligj është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 7.7.2010, me Numër 02/133 dhe sipas procedurës së përcaktuar po i parashtrohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim.

Projektligji përmban 10 pjesë, me gjithsej 127 nene dhe me hyrje në fuqi të këtij ligji do të shfuqizohen rregullat e prokurimit publik në Kosovë, paraprake.

Qëllimi i këtij projektligji është të sigurojë mënyrë më efikase, më transparente dhe me të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve në Kosovë, duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushin nga personat, operatorët ekonomikë, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen për aktivitetin e prokurimit ose që përfshihen apo kanë të bëjnë me fondet ose burimet e tilla.

Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të sigurojë integritetin dhe përgjegjësinë e plotë të zyrtarëve publikë, nëpunësve civilë dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar që vendimet e individëve të cilët, të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohet nga interesat personale, të karakterizohen me jodiskriminim dhe me një shkallë më të lartë të transparencës si dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

Me Projektligjin për prokurim publik, pra me këtë projektligj, synohet krijimi i një kulture institucionale, të profesionalizuar, të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, të gjithë personave zyrtarë që kryejnë ose janë duke u përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sillen duke ndjekur parimet e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe më të drejtë të fondeve dhe burimeve publike, ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Andaj, pa zgjatur, kërkoj nga ju që ta apromoni këtë ligj në procedurë sa më të shpejtë të mundshme, ndërsa Ministria e Ekonomisë dhe Financave, së bashku me institucionet tjera sponzoruese do të jetë në dispozicionin tuaj për çfarëdo sugjerimi, kritike apo ndonjë përmirësimi të mundshëm, që besoj se ka nevojë sepse janë dhënë edhe vërejtjet në parim nga Qeveria për përmirësimin e disa neneve të cilat neve në bashkëpunim me komisionin, besoj, do të gjejmë zgjedhje më racionale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Në emër të komisionit nuk ka të paraqitur. Vazhdojmë me grupet parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, e ka fjalën Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari ministër,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për prokurimin publik dhe është mendimit që ky projektligj duhet të përkrahet në parim.

Problematika e prokurimit publik ka qenë e rregulluar me Ligjin e mëparshëm të prokurimit publik, por ligji i mëparshëm ka pasur mangësi të cilat kanë sjell në vështirësi në zbatimin e këtij projektligji.

Është mirë që sot e kemi në shqyrtim këtë projektligj, sepse ka qenë kërkesë e vazhdueshme e institucioneve që janë marrë me problematikën e prokurimit që ky ligj të ndryshohet dhe njëkohësisht që të tejkalohen dobësitë që e kanë përcjell sistemin e prokurimit publik dhe njëkohësisht ka qenë edhe një nga sfidat kryesore të Raportit të progresit.

Sistemi i prokurimit publik ka nevojë për reforma dhe fillimi i kësaj reforme është që të kemi një ligj të mirë dhe të zbatueshëm të prokurimit publik, një ligj të avancuar dhe në pajtim me parimet themelore të legjislacionit të Bashkësisë Evropiane.

Projektligji që na është ofruar, rregullon aktivitetet e prokurimit, procedurat, kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, të drejtat dhe detyrimet që duhet të përmbushen në mënyrë që të kemi sistem efikas dhe transparent në shfrytëzimin e fondeve publike.

Ligji i cili na është afuar është një ligj i cili i plotëson shumë zbrazësi të ligjit të mëparshëm, prandaj ne si Grup Parlamentar kemi edhe vërejtjet tona, sidomos të përcaktimit të detyrave të Agjencionit Qendror të Prokurimit, ku është bërë shndërrimi i APP-së – Autoritetit të Prokurimit Publik dhe ne do të japim vërejtjet tona përmes anëtarëve të cilët i kemi në komisionin funksional, kurse e përkrahim në parim Projektligjin.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Në parim, përkrahim çdo përmirësim të Ligjit që ka për qëllim që në mënyrë më efektive dhe me të drejtë të shfrytëzojë mjetet e fondeve publike, respektivisht mjetet e buxhetit të Republikës së Kosovës.

Ne e përkrahim Projektligjin e harmonizuar me legjislacionin e BE-së dhe rregullat mbi financat e Këshillit të BE-së, të Komisionit Evropian si dhe direktivat për procedurat e kontratave për punë, furnizim dhe shërbime.

Në parim, ne përkrahim draftligjin e ofruar për shqyrtim që ka përfshirë në vete në mënyrë specifike përgjegjësitë e zyrtarëve të prokurimit, autoriteteve kontraktuese dhe menaxhimin e kontratave.

Do të jemi shumë të vëmendshëm për ato procedura që kanë të bëjnë me kontratat njëburimore, respektivisht ajo që ka të bëjë me kontratat me procedura të negociuara.

Konsideroj se edhe ligji ekzistues ka qenë në përputhshmëri me direktivat e BE-së, mirëpo mosimplementimi i saktë ka ndikuar që ky ligj të jetë njëri nga prodhuesit më të mëdhenj të dukurive negative në Kosovë. Prandaj, konsideroj që me angazhime shtesë që parasheh edhe ligji, me përgatitjen e kuadrit të mirë që do të bëjë implementimin e këtij ligji, konsideroj se ky ligj do të ketë zbatim, por vetëm atëherë kur komisioni funksional për buxhet dhe financa në nivelin më të lartë të përgjegjësisë e bën që ky ligj të jetë funksional.

Grupi Parlamentar i LDK-së do të japë kontributin e vet dhe e përkrah ligjin në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Haki Shatri e ka fjalën.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Rritja e shkallës së korrupsionit dhe keqpërdorimi i parasë publike në këto dy-tri vitet e fundit që me gjuhë tjetër më të sofistikuar po quhet si mungesë e efektshmërisë së shpenzimit të parasë publike nuk ka qenë krejtësisht pasojë e ligjit të keq, që është në fuqi, por sipas vlerësimit tonë kanë qenë njerëzit ata të cilët nuk e kanë respektuar ligjin në fuqi prandaj e kemi këtë shkallë të keqpërdorimit

të parasë publike të konstatuar edhe në Raportin e progresit. Por, si do që të jetë, edhe ndërkombëtarët që na përcjellin, ndihmojnë dhe monitorojnë kanë konstatuar se ka nevojë për një përmirësim në sferën e prokurimit publik, e në këtë kontekst të kësaj problematike edhe të ndryshimit apo plotësimit të Ligjit për prokurimin publik.

Edhe përvoja të cilën e kemi fituar në dhjetë vitet e fundit në sferën e prokurimit, tregon se ligji aktual, që është në fuqi, ka disa mangësi të cilat në punën e përditshme paraqiten si pengesë, prandaj edhe ka arsye, ka nevojë që këto mangësi të evitohen me qëllim që kur domi, të mund të punojmë mirë dhe mbarë.

Ky projektligj, që na është ofruar sot, i ka disa përmirësime që mund të spikaten në relacion me ligjin aktual në fuqi. Këto ndryshime synojnë pozitivizëm kryesisht të një pjesë që nuk ka qenë më parë në ligjin aktual, siç është përcjellja e implementimit të kontratës, pastaj pjesa për ndërmarrjet ose kompanitë publike. Duket që është pozitive edhe zvogëlimi i numrit të ofertuesve të përgjegjshëm, si kusht i kontratës, nga 3 në 2. Pastaj, përcaktimi i përgjegjësive të nivelit më të lartë dhe politik në lidhjen e kontratës, ministri ose vartësit e tij në pjesën e procedimit ose të procedurës së lidhjes së kontratave.

Mirëpo, në projektligj ka edhe disa mangësi të cilat në procesin e miratimit patjetër duhet të ndryshohen. Për shembull, është thënë që vendimet e KRPP-së duhet të merren me konsensus. Unë mendoj që kjo formë është e pamundur të arrihet në atë strukturë, pastaj afati i ankesës 15 ditë nga pala e pakënaqur, mendoj se është tepër i gjatë dhe e zhagit pa nevojë ose e vonon procedurën e lidhjes së kontratës. Pastaj ka edhe disa të meta tjera, për shembull, nuk janë ndryshuar kriteret për kushtet që duhet t'i plotësojë anëtarë i bordit të OSHP-së. Kemi atje 5 anëtarë të bordit, që të pestë duhet të jenë juristë. Ne mendojmë, që për ta vlerësuar një ankesë në mënyrë kompetente profesionale, në këtë bord duhet të ketë edhe struktura tjera profesionale, jo vetëm juristë.

Pra, këto janë disa lëshime më të imta që mund të korrigjohen më lehtë të vërejtjeve që ne i kemi dhe si Grup Parlamentar jemi të gatshëm që të ndihmojmë në kompletimin e përmirësimit të këtij varianti të ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuari, zotëri kryetar,

Të nderuar ministra dhe deputetë,

Grupi Kuvendor i Partisë Politike AKR e mbështet në parim miratimin e këtij ligji, me kusht që ky gjatë leximit vijues të përmirësohet dukshëm në pikat e caktuara.

Ndër të tjera, ja disa vërejtje parimore. Po e zëmë, ju lutem, që çka shkaruan, që është një antishkrim. Pika 4, faqe 2, “Arsyeja për nxjerrjen e këtij projektligji vjen si kërkesë e moszbatimit të dispozitave dhe procedurave të ligjit në fuqi.” Dhe këtë e kanë shkruar ata/ato që vetë quhen ekspertë dhe ata/ato që edhe ministria edhe shumë të tjerë i quajnë ekspertë. Kjo është diçka skandaloze. Do të thotë, nuk është zbatuar ligji i mëparshëm dhe tash po e bëjmë ligjin tjetër! E, ky është arsyetim. Kjo domethënë është diçka indikativ, se sa dobët, sa cekët dhe sa në mënyrë kontraproduktive konsiderohet qasja e miratimit, e bërjes së këtij ligji.

Pika 9. “Risitë dhe avancimet e projektligjit”. Ja cilat janë risitë. Projektligji është i avancuar dhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me praktikat e mira.

Tash disa çështje parimore, kështu, substanciale. Te neni 3, janë normuar shumë përjashtime, të cilat nuk do të hynin nën regjimin e aplikimit të këtij ligji. Ne konsiderojmë se ato duhet të rishikohen dhe mundësisht të minimalizohen. Mundësisht edhe të eliminohen, porse disa pika eventualisht të mbeten ama jo shumë sa këtu, po e zëmë.

Ose, bie fjala, e marr paragrafin 3 të nenit 3, alineja e fundit, ku thotë “Ligji nuk do të aplikohet në prokurorim ekskluzivisht të orientuar në përfaqësimin në formë të ofrimit të ushqimit dhe të pijeve. E marrim vetëm QKUK-un, zotëri ministër, me qindra mijëra euro paguhen faturat për pije dhe për ushqime dhe aty tenderat janë makro-tendera dhe mundësitë për spekulacione a abuzime janë fantastike. E mora si shembull, mundësitë janë. Dhe nuk do të duhej kurrësi që këto të përjashtoheshin nga procedurat e rregullta. Në tekst nuk janë dhënë shprehjet konsistente. Herë përdoret termi “sipërmarrje” herë “ndërmarrje”, në gjuhën shqipe, flas. S’po hy në gjuhë tjera.

Te neni 38. Ekziston ky term juridik “kontratë publike – kornizë”. Po ka, kontrata preliminare, po. Prandaj, është fjala për terminologji standarde, juridike. Korniza më tepër asociacion dhe diksion për termat teknike.

Te neni 60, te paragrafi 2, ne do të kishim propozuar që përpos te autoriteti kontraktues do t’i japë kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm, tenderin ekonomikisht më të favorshëm, plus medoemos së paku 3 rekomandime afirmative. Kjo është shumë me rëndësi se ku ka punuar, si ka punuar, çfarë note ka marrë. Mos të ndodh, bie fjala, sikur te gurthyesit 55 gurthyes thejnë gurë, dërrmojnë gurë, shkatërrojnë ambient dhe marrin para të mëdha nga buxheti jonë dhe nuk janë fare të licencuara.

Te neni 63, ju lutem, te siguria e ekzekutimit. Kjo është pikë neuralgjike te tenderimet, te kontraktimet publike. Kontratat tona zakonisht nuk janë siguruar për atë edhe pëson punëdhënësi, do të thotë në këtë rast është fjala për paranë publike, buxhetin.

Këtu duhet medoemos të inkludohen edhe advansi, edhe pagat për tërheqje e sidomos penali. Penali, ju lutem! Bie fjala, për një ditë vonesë 10.000 euro... Do të punonte 3 turne. Jo more, mos të punon 3, a po se janë kështu, ne punojmë. E ka për punë të penalit. Mos të ndodh që e kontraktujmë punën për t’u bërë për 6 muaj e bëhet për 2 vjet e gjysmë e 3. Pikërisht për shkak se dispozitat ligjore janë të mangëta dhe kontratat edhe më të mangëta, japin hapësirë që punëkryerësit të bëjnë spekulacione mëse të ndryshme.

Këtu, te neni, bie fjala... Nenet janë shumë të gjata dhe nuk janë praktike, nuk janë fare... Neni 63, po e zëmë, paragrafi 7. Këtu përmendet konfiskimi. Ky duhet të zëvendësohet me term tjetër se konfiskimi bëhet në procedurën penale dhe në zbatimin e ligjit për konfiskimin. Është fjala për terma që e ndryshojnë substancën dhe dalin kontrare me vetë karakterin dhe me përmbajtjen dhe synimin e ligjit.

Te neni 119 duhet të bëhet riformulim, ashtu që gjykata supreme të jetë ajo që është dhe në konformitet me ligjin për konfliktet administrative e jo – nëse parashtuesi i ankesës mendon se... vendimi përfundimtar, ose konstatimi i njëfarë neni. Çfarë konstatimi? Konstatimi nuk është akt juridik, prandaj nuk do të mund të atakohet me mjet juridik dhe do të ishte si me thënë një zgjidhje partizane, analfabetike... Kurrësi, duhet çdo vendim a akt që vendoset duhet me vendim nëse organi kolegjial, nëse është individual aktvendim.

Zotëri kryetar, këto janë disa nga vërejtjet. Po ka shumë vërejtje tjera, ne do të përpiqemi në procedurat tjera dhe ju kisha lutur, zotëri ministrit Shala që mundësisht këto ose t'i japi më vonë, që t'i marrë t'ua jap atje atyre atë që e kanë bërë këtë dhe disa vërejtje tjera që ta përmirësojmë, ta bëjmë... Ky është një ligj shumë me rëndësi dhe aplikimi i këtij ligji me siguri do të shprehet pozitivisht në kontraktime dhe në transaksione të ardhshme. Ju falënderohem!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Nejse, vërejtjet i merr komisioni. Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo fushë, siç është pra fusha e prokurimit është një ndër fushat kryesore për menaxhimin e parasë publike.

Shtrohet pyetja se si menaxhohet paraja publike në Kosovë dhe sa funksionon ose sa ka funksionuar Ligji i prokurimit në Kosovë? Kjo realisht, nuk do koment. Me keq menaxhimin dhe shpërdorimin e parasë publike ne takohemi apo atakohemi çdo ditë dhe qytetarët apo niveli i zhvillimit ekonomik në Kosovë dhe varfëria në Kosovë është një ndër faktorët por edhe një ndër faktorët është edhe mosrespektimi i ligjit të prokurimit në Kosovë. Natyrisht se për prokurimin në Kosovë kemi vërejtje, siç është edhe raporti i Komisionit evropian por ne jemi të vetëdijshëm se çdo ligj ndoshta duhet të përmirësohet gjatë zbatimit të tij. Dhe, shtrohet pyetja, vërtet – a kemi pas nevojë që decidivisht ta ndryshojmë ligjin apo realisht nuk është respektuar fare ligji i prokurimit në Republikën e Kosovës. Dhe përgjigja është se nuk është respektuar as ligji i cili ka qenë, ka pas ndoshta edhe mangësi, por vërtet ai është shkel çdo ditë nga Qeveria në radhë të parë dhe çdo organizatë buxhetore e Republikës së Kosovës.

Pajtohem që ky ligj të ketë përmirësime, plotësime dhe dobësitë e tij të eliminohen, por realisht kërkojmë që ligji të respektohet dhe të gjejë mekanizmat, Qeveria të marrë përgjegjësinë që të gjejë mekanizma për të respektuar ose për të zbatuar dhe implementuar Ligjin e prokurimit publik.

Ne kishim propozuar, më mirë kishte me qenë që Qeveria të përgatitet decidivisht që të bëjmë prokurimin elektronik, sepse po e shohim që vërtet në këtë aspekt në këtë fushë tërësisht është e dështuar kjo Qeveri, dhe është fusha kryesore për menaxhimin e parasë publike, se sa të na bie një ligj me pak ndryshime apo me ndryshime sipërfaqësore, te të cilat unë nuk do të ndalem, sepse do ta japim kontributin tonë natyrisht përmes komisioneve funksionale, por do të ndalem sot, edhe pse nuk më pëlqen shumë të flas për çështje teknike, por është edhe ky një shembull se sa e përgatitur është Qeveria jonë kur sjell ligjet para deputetëve, sa i respekton ata, sa mundohet t'i vejë në lajthitje e kështu me radhë.

Po marr shembull, memorandumin shpjegues të këtij ligji. Zoti ministër, dhe deputetë të nderuar, duhet ta dimë të gjithë se një ligj kur vjen për t'u ndryshuar, memorandum shpjegues duhet decidivisht të japë arsyet pse ndryshohet ky ligj, ku ndryshohet, në cilin nen, konkretisht. Ndërsa ne, shih çfarë kemi memorandumin shpjegues. Ky memorandum shpjegues na e jep qëllimin, titullin e projektligjit nën një, dy qëllimin, mos të ju marr kohë me lexua, tre fushëveprimin dhe nën katër, edhe përkundër që unë nuk pajtohem që vërtet ky grup punues që e ka hartuar këtë ligj është munduar me lajthitë Kuvendin, këtu pajtohem që ka marrë guximin me thënë publikisht pikën 4, që nevoja dhe arsyet e nxjerrjes së këtij projektligji janë ose vjen si kërkesë e moszbatimit të dispozitave dhe procedurave të ligjit në fuqi. Kjo nuk do koment. Domethënë sot ne e shqyrtojmë

këtë ligj dhe duhet secili nga ne të kërkojmë nga kjo Qeveri pse nuk është zbatuar Ligji i prokurimit publik dhe a duhet vërtet të zbatohet Ligji i prokurimit publik.

Pastaj, zotni kryetar, ky memorandum bartet komplet në ligjin dhe fillon me nenin 1. Dua të ua lexoj këtë memorandum shpjegues për qëllimin dhe thotë: “Ky ligj ka për qëllim të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike”... s’po shkoj më tutje me ju marrë kohë dhe del në nen, e bartë të njëjtin tekst, por nuk thotë ky ligj, por thotë “qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit...” e kështu me radhë.

Kjo, zoti ministër, është e papranueshme. Definitivisht, ata njerëz, ata ekspertë tuaj, me ju bashkë, paguhën me i hartua ligjet dhe ju duhet të keni përgjegjësi edhe morale edhe profesionale sepse vërtet paguheni nga paraja e këtij populli të varfër dhe nuk duhet të na bini kështu në këtë situatë edhe me lajthitje edhe në tekst, mos të flasim për zbatueshmërinë e ligjeve në përgjithësi.

Nuk dua të zgjas më shumë. Natyrisht, e dimë të gjithë rëndësinë e këtij ligji. Lidhja Demokratike e Dardanisë do të japë kontributin e vet në komisionet funksionale, por do të kërkojë që ligji të zbatohet, të moskeqpërdoret paraja publike, mos të shpërdorohet dhe kërkon që sa më shpejtë Qeveria të përgatitet që të vë në funksion prokurimin elektronik. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Megjithatë, e keni parasysht, ligji është i ri. Nuk është plotësim i ligjit paraprak. Fjalën e ka deputeti Xhezair Murati, në emër të Grupit “7+”.

ĐŽEZAIR MURATI: Hvala, predsedniče!

Dozvolite da pozdravimo i mali broj prisutnih ministara!

Parlamentarna grupa “7+” je analizirala predloženi Nacrt zakona o javnoj nabavci i smatra da je ovaj zakon jasan i relativno čitak. Obzirom na materiju koju reguliše, ovaj nacrt je obiman i obuhvata regulisanje čitavog procesa javne nabavke od početka do kraja.

Ovaj nacrt zakona jeste da na neki način omogućava i transparentnu nabavku, a samim tim i doprinos smanjenju korupcije.

Takođe, što možemo da pohvalimo je da je ispoštovano pravo jezika i ono je utvrđeno članom 13. ovog nacrta, gde je navedeno da dokumenti o nabavci se pripremaju na oba službena jezika, ali zašto ovo navodim? Smatramo da za opštinu Prizren bi trebalo navesti i turski jezik kao obavezan za proceduru tendera. Ovaj stav potkrepljujemo time da ovoj državi ne škodi da pospeši veća prava od onih koja predviđa Ustav, nego da ona budu manja, ali smatramo da treba obavezno da se u tvrdi i načelo ravnopravnosti učesnika tendera po etničkoj osnovi, jer na osnovu informacija koje imamo, a one postoje, bilo je do sada te neravnopravnosti kod tendera.

U poglavlju VI, kad se govori o Regulativnoj komisiji javne nabavke, i u članu 86. i u članu 90. nisu postavljeni mehanizmi za ostvarivanje multietničnosti, odnosno ravnopravnosti. Ista je situacija i kod poglavlja VIII kad se govori o telu za reviziju nabavke, gde takođe nisu postavljeni mehanizmi zaštite multietničnosti učesnika tendera.

Po nama, ovo nisu nimalo beznačajne primedbe i bolje je da ih otklonimo u ovoj fazi izrade zakona, nego da to urade oni koji prate Skupštinu.

U svakom slučaju, mi prihvatamo u ovoj fazi ovaj zakon i smatramo da će nedostaci o kojima govorimo biti u nastavku izrade ovog zakona otklonjeni. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, deputeti Slllobodan Petroviq e ka fjalën.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, predsedniče!

Uvaženi ministri,

Poštovane kolegice i kolege narodni poslanici,

Imajući u vidu važnost ovog zakona, Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke razmatrala je Predlog zakona i u načelu je saglasna za predlog ovog zakona shodno prilici da ćemo dati svoj doprinos u jačanju zakona kroz amandmane, kroz funkcionalne komisije i na taj način ćemo dati svoj doprinos.

Još jednom da ponavljam da Samostalna liberalna stranka u načelu podržava Predlog zakona.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, deputetja Vezira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Danas je pred nama Zakon o javnoj nabavci. Ovaj zakon smo mi kao Grupa pažljivo razmotrili. Znamo da smo imali prethodni Zakon o javnoj nabavci i bili smo jako zabrinuti da se taj zakon u opšte ne sprovodi, da kažem, zakonski ne sprovodi.

Smatramo da će sa ovim novim zakonom, barem, ako ništa drugo, da proradi svest kod nas da se zakon ne radi zbog zakona nego zbog funkcionalnosti i sređivanja tržišta.

Ovo je jako bitan zakon. Mi kao grupa, imamo jednu inicijativu. Prvo, da bi postojao ovaj zakon o javnim nabavkama, pošto je u pitanju javni novac, javni fondovi, mi moramo prvo da imamo bazični zakon o javnim sredstvima – Zakon o fondovima. Koje fondove? Kako ćemo da čuvamo? Kako ćemo da trošimo? A onda je ovo nadgradnja Zakona o javnim fondovima.

Interesantno je da uvek dobijamo zakon koji reguliše materiju, da kažem, koji reguliše zidove, a nema temelj. Smatramo da ovakve stvari više ne treba da se događaju Vladi, kada priprema zakon, kada je u pripremi, da uvek mora, kao što postoji azbuka, tako postoji i redosled zakona i mislim da ako stvarno imamo nameru kao institucije, naročito Skupština, koja posmatra i pred kojom dolaze svi zakoni, da jednom zauvek znamo kako se zakonski štite i zašto je zakon namenski potreban. Rekli smo zbog javnih sredstava i mora da postoje javni fondovi. Mi ovde svi dobro znamo da nemamo zakon o fondovima.

Jedno što bi mi kao Grupa hteli da damo do znanja, samo pozdravljamo osnivanje na ime ovog zakona Regulativne komisije za javne nabavke. Neću da zamaram kolege oko načela ove javne komisije. Dolazi do osnivanja još jedne znači zakonske institucije koja će biti budžetski isplaćivana, znači opteretice budžet Kosova i smatram da oko osnivanja ove javne komisije da mora da se vodi računa i oko zapošljavanja i učešće da uzmu i ostali manjinski predstavnici. Ja ne znam tačno koliko komisija imamo, i znam da je jako mala zaposlenost u tim komisijama, a ovo bi posebno trebalo da se vodi računa od strane Vlade kada je u pitanju zapošljavanje a ovo, verujte mi, samo će biti u prilog države a ne na štetu. Toliko od naše grupe. Mi ćemo zakon da podržimo. Hvala na pažnji!

KRYETARI: Tani kemi deputetët e lajmëruar për fjalë! Fillojmë! Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari, zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari, unë përshëndes iniciativën e Qeverisë për me ndryshuar ligjin aktual dhe ndoshta krejt iniciativa ka qenë me ndryshuar sepse ligji aktual ka qenë i shkruar në atë mënyrë që ka qenë i pakuptueshëm dhe ndoshta në shumicën e rasteve ka qenë arsye se për shkak të normave që i ka pas të pakuptueshme ndoshta edhe nuk i ka zbatuar plotësisht në praktikë. Por, edhe tani në këtë projektligj konsideroj që është shkruar në atë mënyrë që nuk është shumë e qartë dhe do të jetë prapë në një situatë që zyrat e prokurimit të mos kenë shumë sukses në zbatim praktik.

Po e filloj nga fillimi dhe nëse e merrni e lëxoni qëllimin e ligjit, del se projektligji i ka tre qëllime. Qëllimi, do të thotë, në fillim flet si me shfrytëzuar parane publike, që është krejt normal. Paragrafi tjetër flet për integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve civilë që nuk është qëllimi i ligjit, do të thotë ligji nuk po nxirret me ruajt integritetin e askujt sepse zyrtarët qofshin të prokurimit qofshin zyrtarë tjerë e kanë të rregulluar statusin me ligjin e shërbimit civil dhe nëse shkojmë më poshtë flet edhe për çështjen e përfshirjes së autoriteteve apo aktiviteteve tjera në prokurim për transparencën. Prandaj, do të ishte me interes ta kemi një qëllim të shkurtër, të qartë dhe krejt qëllimi i ligjit është se si shfrytëzohet paraja publike dhe fondet publike.

Neni 6, mandej neni 7, flet për çështje të parimeve, jo për norma, ekonomiciteti, efikasiteti, barazia, transparenca, jo diskriminimi... të cilat janë parime. Nuk kanë kurrgjë të bëjnë me çështjet normative dhe nuk kemi nevojë me bë ligin mbi 200-300 faqe sepse vetëm po e bëjmë si kallabllak fjalë dhe në të vërtetë nuk thotë kurrgjë as efikasiteti, as parimi i jo diskriminimit. Duhet të jetë me norma të qarta dhe duhet të jetë ligj. Nuk duhet me u diskriminua, jo në parim, sepse janë parimet të cilat rregullohen dhe besoj se ministri pajtohet me këtë çështje.

Do të dal pak te disa çështje konkrete të cilat do të duhej ndoshta Komisioni për buxhet e financa, por edhe komisionet tjera parlamentare, me i pas parasysh.

Nënshkrimi i kontratave publike. Është mirë që me këtë ligj nuk do të krijohet situata që çdo organizatë buxhetore me pas departament e drejtori sepse ka qenë e palogjikshme, për shembull, një organizatë buxhetore e ka pas një zyrtar të prokurimeve dhe me pas drejtorinë, mirëpo nënshkrimi i kontratave publike do të jetë prapë pengesë.

Thuhet se... Neni 26 paragrafi 1, “Kontratat do t’i nënshkruajë zyrtari i prokurimit. Mandej, nën paragrafin 2 thuhet “për kontratat e mesme dhe të mëdha do të nënshkruhen nga zyrtari i lartë ekzekutiv dhe në këtë rast edhe nga ministri”. Do të ishte shumë me rregull me dhënë përgjegjësi ministrave me i nënshkruar kontratat, por nëse i japim përgjegjësi me nënshkruar kontratat natyrisht ua kemi çel rrugën pak më tepër me u ngjitë në zyra të prokurimit. Sepse, nuk mundet vetëm me nënshkruar kontratën dhe mos me përcjell edhe procesin e prokurimit, kurrkush nuk do ta nënshkruaj, askush nuk i beson askujt sot. Prandaj, këtë çështje është mirë ta diskutojmë. Nëse i japim përgjegjësi ministrit, që është krejt në rregull, me nënshkruar kontratën, duhet t’u japim përgjegjësi edhe me u njohur edhe me procedurat e prokurimit, por jo vetëm me ardhur i gatshëm dhe me firmosë, sepse nesër a pasnesër para ligjit do të përgjigjet njëjtë sikur zyrtarët të cilët marrin pjesë gjatë gjithë procesit të prokurimit.

Kalojmë në nenin 35. Ju e dini që ndoshta një prej pengesave në ligjin aktual të prokurimit ka qenë që konsulatat, ambasadat që i kemi kanë procedura shumë burokratike dhe pas dy viteve ende nuk

kanë ndoshta vetura mu për shkak të procedurave burokratike. Konsideroj se kjo çështje nuk zgjidhet edhe me këtë ligj. Përderisa thotë, konsulli apo zyrtari i përgjegjës apo ambasadori i shkruan një letër zyrtarit të ministrisë përkatëse të prokurimit, për kërkesën në fjalë, e mandej zyrtari vendos me aprovua kërkesë... Unë nuk po e kuptoj, nëse është vetëm çështje teknike sa me i shkruar dhe aprovuar, mirëpo konsideroj se nuk e kemi zgjidh problemin. Kjo ka qenë dashur të zgjidhet shumë qartë. Kanë të drejtë apo nuk kanë të drejtë ambasadat dhe konsullatat me udhëheq procedurat, apo me bë diçka të veçantë që nuk kanë nevojë me kalua përmes zyrtarëve tash të ministrisë, sepse vetëm rrugëtimi, vetëm bartja e letrave sjell në situatë që të kemi situatën çfarë e kemi sot aktualisht, ambasadat dhe konsullatat janë në situatë që për një shërbim duhet me prituri me muaj të tëra. Domethënë, duhet të zgjidhet ky problem.

Neni 44 flet për afatet. Është mirë që ligji aktual tash, projektligji që e kemi para veti, i ka shkurtuar afatet dhe ndoshta krejt esenca e ndryshimit të ligjit ka qenë që me i shkurtuar afatet. Nuk janë shkurtuar aq shumë, janë vetëm me pak ditë, nuk e di sa. Mirëpo, tash, neni 46 flet për procedurat e posaçme të shkurtimeve të afateve dhe pikërisht neni 46 ka me dhënë mundësinë që si të duash me veprua me prokurimin. Domethënë, janë do procedura të posaçme nëse ka raste të jashtëzakonshme, nëse ka raste që nuk janë paraparë në afatin e domosdoshëm të prokurimit apo në aktivitetin e prokurimit dhe lë mundësinë që kushdo në çfarëdo kohe për 10 ditë me shpall sepse e arsyeton me një letër. Është mirë ta specifikojmë qartë, kur duhet me u shkurtuar afati në 10 ditë dhe mos të lejojmë hapësirë që kujt t'i teket tash e parashih një arsyetim, e konsideron se është i qartë dhe mandej vepron me procedurën e shkurtuar dhe nuk do t'i ndihmojë procesit.

Neni 57 flet për sigurimin e tenderëve dhe sigurimi më i mirë do të ishte që garancitë bankare... natyrisht se ne e dimë që lënë garanci bankare por t'i jipet e drejta e autoritetit me i shfrytëzuar këto garanci bankare nëse shfrytëzuesi apo përfituesi i tenderit nuk e realizon punën sepse sa për me lajmëruar një garancion bankar, sa për me fitua punën, nuk do të ishte shumë në rregull por ta lë një garancion bankar dhe nëse nuk i del zot punës të cilën e ka marrë në këtë rast kontraktuesi me shfrytëzuar mjetet nga garancioni bankar për humbjet që i ka pas qoftë si qeveri qoftë si ministri përkatëse apo komunë.

Neni 93, që duhet gjithsesi të ndërrohet, është largimi dhe suspendimi i anëtarëve të KRPP-së ta bëjë gjykata. Kjo është kundërligjore. Nuk kemi mundësi me ia lënë gjykatës me larguar anëtarët e KRPP-së. Pse? Gjykata nuk mundet dhe ia duhet me i bë akuzë... nuk ka mundësi gjykata me marrë vendim me larguar një anëtar të KRPP-së. Kjo është situata vetëm me sjell një situatë që kurrë mos me u largua. Nëse konsiderojmë se ka shkelje, nëse konsiderojmë që e ka shkel detyrën zyrtare me larguar qoftë ministria përkatëse, organi përkatës, qoftë Qeveria, qoftë Kuvendi, por nuk ka mundësi t'ua lëmë gjykatave dhe t'ia bartim një barrë për të cilën nuk janë kompetente, me u marrë tash me çështje disiplinore. Gjykata mund të fillojë procedura, mund të fillojë iniciativa, por për shkelje të detyrës zyrtare, por jo për me larguar zyrtarin pse nuk e ka kryer punën mirë apo ka një ankesë rreth çështjeve tjera.

Dhe ndoshta krejt, te neni 100, plotësimi i kriterëve për anëtarë të OSHP-së. Nga kriteret që janë paraparë për anëtar të OSHP-së parashihet edhe kriteri për me qenë gjyqtar. Nuk e di a e kanë pas të qartë. Për me qenë kriteri për gjyqtar, duhet të jepet edhe një provim për gjyqtar dhe nuk ka nevojë, ajo është diçka jashtë normales. Është me rregull që e kanë paraparë provimin e judikaturës, sepse ka të bëjë me situata që duhet mirë me njohur legjislacionin por nuk duhet me dhënë provimin për gjyqtar për me qenë me punuar në OSHP, sepse nëse e jep provimin për gjyqtar ai punon në gjykatë, punon në njërin nga gjykatat dhe provimi për gjyqtar nuk është bash i lehtë qysh e kanë menduar por për me dhënë provimin për gjyqtar duhet me i bë do trajnime në institut, me i kaluar... që faktikisht

është e panevojshme dhe është një kriter që vështirë do të pranonte dikush me lënë punën e gjyqtarit pasi ta kalojë këtë situatë.

Prandaj, është mirë me modifikuar dhe me dhënë vetëm provimin e judikaturës, domethënë që është përgatitje për gjyqtar por pa u lëshua tash për provimin për gjyqtar, me specifikuar sepse do të ishte shumë një element që ne nuk do ta zbatonim mandej në praktikë, sepse nuk do të ketë njerëz, kë ta emërojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuari kryetar i Kuvendit!

Zëvendëskryeministër, ministër,

Kolegë deputetë,

Padysim se ky ligj pretendon të përmirësojë performancën e prokurimeve publike dhe përgjegjësitë e proceseve administrative dhe duke e përkrah në parim unë do të jap 3 momente të cilat duhet t'i kemi parasysh.

E para, ky ligj hap hapësirë për me shtua efikasitetin e prokurimeve publike si procese të rëndësishme administrative, me vetë faktin se përcakton afate të qarta të përfundimit të prokurimeve publike në nivel të shkallës së parë dhe shkallës së dytë dhe kjo është shumë e rëndësishme sepse në të kaluarën, jo rallë, këto procese kanë zgjatur kohë të gjata dhe kanë krijuar probleme në menaxhimin e fondeve publike.

Momenti i dytë dhe më i rëndësishëm, pritja më e madhe prej këtij ligji është të ndërrojë tërësisht konceptin e prokurimeve publike dhe të fillojë të praktikojë prokurimet elektronike, një proces që është pjesë e strategjisë së Qeverisë – elektronike, të miratuar tanimë nga Qeveria e Kosovës.

Dëshiroj të përkujtoj se Qeveria e Kosovës e ka një draft ideor të prokurimeve publike dhe po shpresoj se Ministria e Administratës Publike do ta përfundojë edhe teknikisht këtë projekt në mënyrë që prokurimet elektronike të bëhen një praktikë e rregullt.

Do të them vetëm 3-4 fjalë pse janë të nevojshme prokurimet elektronike. Për faktin që ato do të krijojnë disa favore të rëndësishme, do të shkurtojnë shpenzimet e proceseve të prokurimeve publike, do të krijojnë një sistem plotësisht transparent dhe janë një mjet që e kanë aplikuar shumë shtete të Evropës Juglindore, të cilat kanë treguar suksese të jashtëzakonshme, unë po përkujtoj vetëm praktikën e mira që i kemi në Slloveni, por edhe në Shqipëri. Shqipëria ka një vit e gjysmë që po praktikon prokurimet elektronike, si pjesë të reformës së administratës publike dhe si mjet të luftës kundër korrupsionit, rezultatet impresionuese. Rezultatet janë impresionuese edhe pse vetëm një vit nga aplikimi, po tregohen rezultate shumë të mira në shtimin e transparencës, në luftimin e korrupsionit dhe në ofrimin e gjasave të barabarta për të gjithë operatorët ekonomikë në proceset administrative.,

Unë mendoj se tani për prokurime elektronike ekziston edhe buxheti. Ministri i financave e di shumë mirë se Banka Botërore në donacionin e modernizimit të sektorit publik, të cilin ende Parlamenti për fat të keq nuk po e voton, padrejtësisht nuk po e voton, ka paraparë një donacion prej 2 milionë dollarësh, i cili donacion kryesisht ka të bëjë me përgatitjen e prokurimeve elektronike.

Në planet e Qeverisë, më parë është menduar që në shtator ta pilotojmë prokurimin elektronik, por unë vlerësoj se edhe mos votimi i marrëveshjes me Bankën Botërore pak e ka vështirësuar... Banka

Botërore ka qenë e gatshme që të sjellë ekspertët më të mirë, të cilët e kanë bërë këtë projekt në shumë shtete të Evropës Juglindore, edhe në Kosovë, që ne të fillojmë fillimisht në disa njësi të mëdha buxhetore ta praktikojmë prokurimin elektronik, e për 2 – 3 vjet atë ta bëjmë një standard të rregullt në nivelin republikan e pastaj ta shtrijmë edhe në nivelin komunal, lokal në mënyrë që të kemi standarde unike sa i përket proceseve të prokurimeve elektronike.

Unë po shpresoj që megjithatë do të votohet kjo marrëveshje me Bankën Botërore dhe ne do të marrim këtë donacion që do të ofrojë për 2 vjet asistencë në përgatitjen e stafit vendor, në përgatitjen teknike për fillimin e praktikimit të prokurimeve elektronike.

Dhe momenti i tretë, që është objektiv i këtij ligji, është të precizoj në mënyrë të qartë kompetencat e institucioneve që merren me prokurime publike. Megjithatë, ne kemi një rrjet të madh të institucioneve që merren me prokurime publike, kemi katër nivele. Niveli i parë janë njësitë buxhetore. Kemi OSHP-ën, kemi APP-ën dhe kemi KRPP-ën dhe unë mendoj që ky rrjet nganjëherë e ngadalëson efikasitetin e proceseve të prokurimeve elektronik dhe është shumë me rëndësi që me këtë ligj të precizohen qatë kompetencat, të definohen kompetencat në mënyrë që të sigurohet një sistem më efikas i menaxhimit të buxhetit, i menaxhimit të fondeve publike, por edhe një efikasitet më i madh në proceset e prokurimit publik që është shumë i rëndësishëm edhe për realizimin e buxhetit por edhe për realizimin e investimeve kapitale të parapara me buxhetin e Kosovës. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr zoti Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Ju përshëndes, kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Vërtet çështja e prokurimit publik është çështja gati që ka sfiduar për krejt këtë periudhë zhvillimet edhe ekonomike edhe administrative dhe publike në Kosovë qoftë kur është fjala për shfrytëzimin e parasë publike, qoftë kur është fjala për transaksionet tjera ekonomiko-financiare të cilat kanë dëmtuar projektet.

Duke marrë parasysh se qoftë buxheti qendror, buxheti i Republikës së Kosovës, që ka pas vërtet suficite gjatë viteve, qoftë buxhetet komunale që kanë pas suficite në fund të periudhave kanë ardhur krejt si rezultat i mosrealizimit të projekteve që kanë ardhur së fundi, kanë pasur apo kanë efektuar nga shkalla e efikasitetit të prokurimit publik.

Duke marrë parasysh se vërtet çështja e prokurimit publik sot është bërë halë në sy, qoftë për pjesën politike, qoftë për pjesën administrative, vërtet është momenti i fundit që ne të nxjerrim një ligj i cili vërtet iu mundëson të njëjtën kohë edhe efikasitet të projekteve, mundësohet edhe realizimi efikas dhe me kualitet i punëve që vijnë si rezultat i transaksioneve ekonomiko-financiare dhe të njëjtën kohë definohet saktë përgjegjësia e zyrtarëve që janë autoritet respektivisht të përgjegjshëm për këtë proces.

Andaj, edhe pse ligji i mëparshëm ka pasur shumë dobësi, nuk është ndoshta krejt në nivel të ligjit sa është në nivel të mendësisë së këtyre njerëzve që merren me këtë fushë. Duke marrë parasysh se bashkësia ndërkombëtare ka trajnuar shumë zyrtarë të prokurimit publik, qoftë në nivel lokal, qoftë në nivel qendror, padyshim, prapë kanë reflektuar afektimet, respektivisht ndikimet e strukturave

joformale, qoftë ato që janë struktura politike apo jo politike në tërë këtë proces. Andaj, edhe një herë shfrytëzojmë rastin që edhe komisioni funksional dhe të gjitha trupat të cilët do të punojnë në këtë ligj të inkuadrojnë ekspertë edhe të natyrës juridike por edhe ekspertë të natyrës administrative dhe ekonomike se vërtet duhet të definohen saktë çështjet me qëllim që shkalla e mundësive për keqpërdorim të zvogëlohet, mos të them absolutikisht të hiqet, sepse kjo është sfidë edhe për vendet tjera.

Mirëpo, në qoftë se vërtet e shohim se te procesi i prokurimit publik në agjencione të ndryshme ndërkombëtare, për shembull siç është rasti i USAID-it dhe shumë agjencie që dalin si rezultat i Komisionit Evropian, te ata nuk ka problem të kësaj fushe shumë. A është në pyetje tash, njerëzit, apo është në pyetje ligji? Këtu shtrohet. Mos t'u japim shans njerëzve që të mbështeten në moralitetin e tyre në këtë fushë. Kjo fushë është e ndjeshme, kjo duhet të definohet saktë. Unë pa dashur t'i përsëris edhe një herë gjërat, pajtohem shumë me kolegët e mi deputetë të cilët vërtet e preken çështjen e prokurimit elektronik. Vërtet çështja e prokurimit elektronik në një mjedis ku veprojnë të gjitha strukturat elektronike, ka efekte shumë të mëdha. Por, në mjedis kur nuk është i zhvilluar ende një infrastrukturë, unë shtroj prapë dilema në këtë aspekt. Ne duhet të ndërtojmë një infrastrukturë të plotë elektronike, infrastrukturë të përpunimit elektronik të shënimeve dhe pastaj prokurimi elektronik ka me d hënë rezultate të mira.

Unë padyshim, këtu, në këtë aspekt, kisha me përmendur mosndërhyrjen respektivisht definimin e saktë të shkallëve të përgjegjësisë. I kemi zyrtarët e prokurimit, kemi pjesët politike në agjencion, por kemi edhe shumë nivele të ndryshme të mbikëqyrjes.

Kur është fjala te kontratat... Deri tash, ligji i vjetër i prokurimit vërtet ka mundësuar një kohë, një definim kohor të shfrytëzimit të të gjitha mjeteve ligjore në kuptimin edhe të nënshkrimit të kontratës, edhe të ankesave, edhe të gjitha ato komponente të cilat e bëjnë më efikas projektin. Mirëpo, unë mendoj se kemi pasur shumë defekte. Vetë fakti, kur ne na mblidhen të gjitha projektet e natyrës kapitale në fund të vitit ose nuk mund të realizohen procedurat e prokurimit deri në fund të vitit buxhetor tregon se ai ligj ka pasur defekte. Andaj, edhe një herë bëj apel, edhe në nivel deputeti dhe nivel të ekspertit, që në fakt, të inkuadrojmë ekspertë të kësaj fushe që të zvogëlojmë shkallën e keqpërdorimeve në fushën e prokurimit publik sepse vërtet kjo është sfidë për të gjithë zyrtarët të të gjitha niveleve padyshim dhe të gjitha agjencineve, qoftë atyre agjencineve buxhetore që janë në nivel publik qeveritar qoftë atyre të tjerave. Ju faleminderit, edhe një herë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, për fjalën e dhënë!

Unë pikësëpari, po çuditë me shqyrtuar në këtë ligj kur Qeveria në prononcimet e veta në këtë Kuvend, konkretisht, zëvendëskryeministri disa herë e patë arsyetuar se ka pas të drejtë të bëjë ndryshim të ligjit me udhëzime administrative. S'ka pas nevojë hiq! Secilin problem, që është paraqitur në terren, ka mund me zgjedh, duke nxjerrë udhëzime administrative, sepse ka mund ta përdor si një mjet për me u shërbyer interesave të veta duke afruar vetëm një argument – na ka thënë dikush. Edhe argument jo shumë i qëndrueshëm, po ata në mënyrë shumë banale e kanë arsyetuar. E kanë arsyetuar me mendjen e vet.

Po edhe folësit e mi paraprak u konsultuan në një prej pikave në memorandum shpjegues, një fjali, që unë i falënderohem shumë atij që e ka dhënë një arsyetim të tillë, sepse na ka lënë me kuptuar se atje ka shumë të bëjë, prokuroria ka shumë raste dhe e ka bërë si fakt se ka pasur keqpërdorime dhe nuk është zbatuar ligji. Dhe tash kjo është qasje e drejtpërdrejtë në opinion publik, sigurisht se edhe

prokuroria i dëgjon fjalimet tona dhe prokuroria e Eulex-it, edhe ajo speciale, se këtu kemi të bëjmë me një fakt se ligji paraprak i prokurimit publik nuk është zbatuar. Nëse nuk është zbatuar ligji, atëherë dikush duhet me paguar për fajin që e ka bërë, apo me bërë me gisht kush nuk e ka zbatuar ligjin.

Për që nuk është zbatuar ligji ne për çdo ditë shohim raste të tilla, raste të tilla shumë-shumë të shpeshta, posaçërisht kur kemi të bëjmë me pozicione ku ka shpenzime marramendëse të parasë publike dhe kjo na tregon se normalisht ndoshta edhe kanë nevojë që të pasurohen në kurriz të popullit të varfër të Kosovës.

Tash do t'i referohem nenit 57 kur kemi të bëjmë me sigurimi e tenderit. Është shumë e çuditshme kujt i ka shkuar mendja që ta vendos fjalën “mund të”! “Gjatë një aktiviteti të prokurimit që shpie drejt dhënies së kontratës së vogël, të mesme dhe të madhe, autoriteti mund të kërkojë nga tenderuesi që të depozitojë siguri garantim”. Merre me mend, kërkon “mund të”. Nuk ka nevojë me pas “mund të”. Me fshi “mund”. Për mua automatikisht ma zgjon mendjen, dhe kjo ndoshta është njëfarë kërkesë për alibi, njëfarë kërkesë për me i ik makinacioneve që i ka bërë Ministria e financave dhe e ekonomisë, departamenti i thesarit, makinacionet që i ka bërë ndoshta edhe kryetari i Kuvendit, sepse ministri e çoi te kryetari i Kuvendit përgjegjësinë rreth sigurimit të tenderit të “Kosmocelit” 16.200.000 euro, që edhe pas shumë përpjekjeve, pas shumë brengave të ngritura nga ana e deputetëve, ende mbetet si pezull ky 16.200.000 euro.

KRYESUESI: Përmbaju rendit të ditës!

NAIM RRUSTEMI: Rendi i ditës është sigurimi i tenderit. Ligji paraprak nuk është zbatuar dhe e kanë pa që ligji paraprak paska mundësi me na shkaktohet telashe sepse ka qenë shumë recidiv që konfiskohet siguria e tenderit. Dhe tash, vihet, me disa fjalë të mbajtura pezull “mund të”, “do t'ia bëjë”, “mund t'ia bëjë”. Nuk ka mundësi me pas “mund”, sepse po e lëmë në dëshirën e dikujt tjetër. Dhe ky kreativitet me këto fjalë, në këtë ligj, më shtyn të mendoj se sigurisht janë të përzier në procesin e mosfunksionimit të 16.200.000 euro të sigurimit të tenderit të “Kosmocelit” gjatë operatorit të dytë, dhënies së licencës për operatorin e dytë mobil. Kjo nuk mbetet në harresë, nuk ka arsye. Kërkoj që të jemi më decidivë gjatë këtij neni, në pikën 57, në nenin 57.

Dhe, gjithashtu, po flasim për shumë parime, për transparencë e për tjera. Kemi të bëjmë me publikimin e njoftimeve. Edhe gjëja se prokurimi elektronik do ta bëjë zgjidhjen e të gjithave.

Të nderuar, të gjithë ata që e kanë përcjell punën e OSHP-së, punën e KRPP-së, punën e organit të agjencisë së prokurimit publik e shohim se atje ka pasur manipulime në ueb-faqet e tyre. Nëse ka dikush me u pajisur me informacion se çka bëhet në fushën e prokurimit nga ueb-faqet e tyre le ta tregojë. Kurrë nuk iu kanë funksionuar. Gjithmonë në mënyrë selektive i kanë paraqitur të dhënat nëpër ueb-faqet zyrtare të veta. Edhe me prokurim publik elektronik është një tendencë me iu qit hi syve dhe ndoshta mos me bërë transparencë ndaj opinionit publik dhe me i ndalë mos me i lënë në gazeta. Lei edhe gazetatat pak, le ta shoh qytetari i Kosovës se ka po bëhet lëvizja dhe qarkullimi i parasë publike. Ndoshta edhe këtu ka makinacione që tentohet se ky ligj e përcakton që agjencitë që janë përgjegjëse në fushën e prokurimit të bëjnë njoftimin jo nëpër gazeta por edhe nëpër ueb-faqet e tyre zyrtare. Dhe më pastaj, bëhet shumë e vështirë kërkesa për transparencë.

Këto ishin disa prej kërkesave të mia që ka nevojë ky ligj të rishikohet dhe normalisht se edhe ndodhitë e kaluara, që të na mbushin mend, që në të ardhmen mos të ndodhin, por kurrësi të harrohen. Sepse, ne nuk mund ta harrojmë sigurinë e tenderit 16.200.000 euro.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Rexhep Hoti.

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar zonja e zotërinj,

Unë pata vetëm një ndërhyrje, është fjala për nenin 35 ku autoritetet kontraktuese mund të përdorin edhe prokurimet njëburimore. Në fakt keqpërdorimet më të mëdha në gjithë parën publike në Kosovë janë bërë te prokurimet njëburimore. Do të thotë, unë kujtoj këtu se prokuroria ka punë edhe këtu duhet, këtu është ai kooperimi më i madh. Kjo çështje duhet të rregullohet sepse si është kështu, kjo çështje i jep mundësi autoriteteve do të thotë që ata t'i rregullojnë prokurimet vetëm duke e njoftuar KRPP-ën, pa aprovime shtesë.

Mendoj se është një çështje që duhet të ndalet në mënyrë urgjente dhe nuk guxon të shkojë kjo, sidomos e kam parasysh menaxhimin e parës publike te ndërmarrjet publike ku atje mund të bëhen edhe abuzime dhe keqpërdorime shumë të mëdha të pares publike. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, kryesues!

Për mos me u përsërit nga shumë ato që u thanë, unë do të ndalem në disa çështje specifike. Konsideroj se përsosmëria e ligjeve është në proces dhe do të vazhdojë edhe më tutje. Unë jam pak skeptik që janë zbatuar edhe me këtë draftligj që ka ardhur në Parlament eksplicit standardet e Bashkimit Evropian, po që i lexon me kujdes shumë ligje, vëren që nuk besoj se mund të jenë standarde të BE-së, disa praktika që janë paraparë dhe këtu konsideroj se është problemi dhe ka qenë problemi edhe në të kaluarën sepse nuk janë zbatuar në përpikëri standardet e Bashkimit Evropian sa i përket prokurimeve publike. Dhe këtu shfaqen problemet mandej edhe në moszbatueshmërinë dhe punëve që nuk janë në nivel.

Unë i bashkohem qëndrimit që e patën edhe disa deputetë, që neni 26 pika 2, ku implikon të ngarkuarit politik në çështje teknike, administrative, profesionale, konsideroj që bie ndesh me legjislacionin tjetër në Kosovë dhe ndarjen e kompetencave sepse nuk është detyrë e stafit politik të përzihen në prokurime qeveritare qoftë edhe ajo nën pretekstin se gjëja mund të bëhen punët më mirë sepse implikimi i të emëruarve politikë në këto çështje shkakton pengesa në zhvillimin e drejtë të këtyre proceseve, shkakton vonesa në prokurimet qeveritare dhe në përfundimin e kontratave dhe pa dyshim ndërhyrjet politike do të jenë pavarësisht se çfarë qeverie është në pushtet dhe unë mendoj që është gabim ky amendament, ky nen, kjo pikë dhe konsideroj se nuk është standard evropian, prandaj duhet të eliminohet.

Ne kemi probleme edhe sa i përket afateve, ditëve të punës. Ju i vëreni do me thënë në rrugë, po që dilni, punime ku kryhen pavarësisht nga autoriteti qendror apo nga ai lokal, ndodh ditëve më tumira, për shembull ku ka trafik më pak të dielave askush nuk punon, mandej ditëve kur janë ditë pune që mund të shfrytëzohen për shkak të kushteve atmosferike, nuk punojnë dhe këtu thuhet me ditë të punës dhe kjo çështje mendoj që duhet të rregullohet me këtë ligj që operatorët ekonomikë në punët, në prokurimet dhe në kontratat që kanë për qëllim përmbushjen e afateve të përfundimit të punimeve në sezona të caktuara të stinëve të vitit t'i përmbahen dhe të mos ndodhin kaoset urbanistike dhe problemet që i hasin qytetarët.

E kam edhe një çështje, tek neni 70 – standardet për sigurimin e cilësisë. Konsideroj që paragrafi 1, ku thotë bazohen në standardet përkatëse kosovare, evropiane dhe ndërkombëtare, është mirë shumë, por paragrafi 2 ku flet për certifikimin e autoriteteve kontraktuese, thotë do t'i pranojnë certifikatat e

barazvlefshme të lëshuara nga cilido organ certifikues pavarësisht nga vendi nëse organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i BE-së. Kjo është në rregull, që vërteton se autoriteti i certifikuar në rast se është pranuar nga një anëtar i BE-së ky mekanizëm që i certifikon cilësitë e punëve, produkteve, është në rregull, por vazhdon më tutje dhe kjo mendoj se është shqetësuese ku thotë autoriteti kontraktues, po ashtu pranon të dhëna tjera të besueshme për masat e barasvlershme të sigurimit të cilësisë nga autoritetet ose autoritetet ekonomik që nuk kanë qasje ose mundësi për sigurimin e certifikatave të tilla brenda afateve të caktuara. Dhe mendoj kjo pjesë u lejon mundësi që kompanitë të cilat nuk janë të njohura që aplikojnë standarde kosovare ose evropiane për kualitet të punëve të tyre, iu lejon mundësi që të marrë çdo kush punë, të jep çmime të paarsyeshme që nuk përputhen me kualitetin e produkteve ose prodhimit ose punëve që i kryejnë t'i shkakton probleme edhe buxhetit të Kosovës po t'i shkakton probleme edhe qytetarëve për shkak se cilësia e këtyre punimeve do të thotë vërehet pas disa muajve se nuk ka qenë në nivel.

Konsideroj se pjesa e fundit e këtij paragrafi 2, të nenit 70, sa i përket sigurimit të cilësisë të largohet dhe kështu ky ligj edhe me vërejtjet që i dhanë deputetët të jetë më i përsosur se ai i kaluari. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Koci e ka fjalën.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Shumë çështje të cilat isha fokusuar të flas i thanë parafolësit. To të përpiqem që të përmbledh disa çështje të cilat nuk janë thënë këtu.

Ne kemi një përvojë bukur të gjatë me bërjen e ligjeve të prokurimit. Kemi pas një ligj fillestar që kanë qenë po këto institucione që sot kanë punuar në këtë projektligj dhe kur e kemi pas miratuar kanë thënë është ligji më i avancuar në Evropë ose në këtë pjesë të Evropës dhe shumë pak kohë shkoi dhe nuk na doli ligji më i avancuar dhe u dashtë ta ndryshojmë dhe nuk kemi ndryshuar asgjë vetëm ideja ishte për t'u dhënë kompetencë disa prokurimeve që ishin të nevojshme atëherë dhe të mos përfillen disa nga procedurat, standarde të prokurimit.

Ky projektligj sot që na është ofruar, po të shikohet në aspektin teknik të bërjes së normave është një koment, komentime të bërjes së ligjit, sepse dispozitat e këtij ligji, nenet janë aq të zgjatura, të stërzgjatura, me kuptime të dyfishta, që atij që i zbaton i jep mundësi, i lë një hapësirë vërtet të veprimit të shprehjes së një vullneti ndoshta edhe personal rreth këtyre çështjeve, por kjo i mbetet komisionit që ta shqyrtojë dhe vërtet ta bëjë ligjin si duhet.

Ajo që mua më preokupon dhe që nuk është në këtë projektligj, kanë qenë çështjet për të cilat është thënë disa herë në këtë sallë, për sa i përket prokurimit në përfaqësitë tona diplomatike dhe në ndërmarrjet publike. Unë kam qenë në një mbledhje të grupit punues gjatë këtij projektligji dhe kam shtruar këtë nevojë që duhet të ketë një kapitull të veçantë për prokurimet në ndërmarrjet publike, por unë nuk e kam pa në këtë ligj absolutisht një nen përkatës atje kur thuhet për përjashtimet, përjashtohen vetëm ndërmarrjet shoqërore që janë në kompetencë të Agjencionit Kosovar të Privatizimit, por jo edhe ndërmarrje publike që janë në kompetencë të Qeverisë respektivisht të Ministrisë së Ekonomisë e Financave.

Nëse ideja ka qenë se nesër nuk do të kemi ndërmarrje publike, se do të jenë krejt të privatizuara, atëherë mirë është ajo, por për deri sa ekziston edhe vetëm një ndërmarrje publike atëherë konsideroj se do të duhej të kishte dispozita të veçanta për prokurimet që kryhen në ndërmarrjet publike për vetë faktin se këto ndërmarrje publike të jenë konkurrencte në tregun me sektorin privat të fushës

përkatëse, gjë që sot ne nuk e kemi, absolutisht, se për derisa një prokurim e kryen një ndërmarrje private, një ndërmarrje publike duhet gjashtë muaj të njëjtin ta kryej dhe kështu ajo nuk mund të jetë konkurrense me sektorin privat dhe sikur ne me qëllim domi ta mbysim ose ta pengojmë zhvillimin e sektorit publik, pikërisht duke e avancuar vetëm sektorin privat që nuk mendoj se është e drejtë dhe është e arsyeshme në këtë çështje.

Çështja tjetër që është shumë preokupuese është çështja e asaj që e thanë shumë parafolës këtu, te ai nënshkrimi i kontratave dhe involvimi i faktorit ose i subjektit politik, në këtë rast udhëheqësit politikë në nënshkrimin e kontratave, gjë që është e papranueshme dhe është një precedent te ne. Ndoshta kjo krijon një siguri më të madhe në menaxhimin e parasë publike por nuk mendoj se siguria mund të krijohet në këtë formë.

Dhe çështja tjetër, që ka të bëjë pikërisht me këtë, është involvimi ose dhënia e një përgjegjësie ekzekutive, në këtë rast, në prokurimin publik edhe të presidentit të shtetit edhe kryeministrit në raste të përjashtimit nga ky ligj të prokurimeve që mund të na ndodhin.

Nuk mendoj se presidenti dhe kryeministri duhet të bien vendime të tilla që të implikohen në çështjet e prokurimit dhe kjo që t'i jipet, si me thënë, përgjegjësi ekzekutive institucioneve ose bartësve të institucioneve të caktuara që nuk e kanë as me Kushtetutë, më duket një ide ose një përpjekje jo e qëlluar dhe jo e drejtë.

Çështja tjetër, që e tha edhe kolegu im i nderuar, Bahri Hyseni, te prokurimet të përfaqësive tona diplomatike. Neni 35, paragrafi 4, 5, 6, 7 e deri në 13, atje, përcakton format e prokurimit në përfaqësitë diplomatike. Përfaqësitë diplomatike në qoftë se në prokurimet e tyre janë të lidhura ngushtë me Ministrinë e Punëve të Jashtme për të gjitha llojet e prokurimeve, mendoj se do të jetë pengesa më e madhe e aktivitetit të tyre dhe e kryerjes së shërbimeve dhe veprimtarisë së tyre që e kanë në përgjegjësi sipas ligjit. Ndarja në vlera të mëdha dhe të vogla, pikërisht te këto përfaqësi ku mbi 150.000 euro si quhet vlerë e madhe deri në 150.000, nga 10.000 – 150.000 është vlerë e mesme dhe në këto vlerat e vogla tash nuk ka asnjë dispozitë që në këto vlera të vogla se si duhet të veprojnë përfaqësitë tona diplomatike. Dhe vërtet, më falni se ndoshta mund të jem shumë banal, por në qoftë se një përfaqësi diplomatike duhet të pyet ministrinë e punëve të jashtme dhe sa letër, kilogram letër të merr ose letra për toalet atje, ku do t'i blejë dhe si duhet t'i blejë, po më duket është kjo vetëm një pengesë që mund të bëhet për përfaqësitë tona diplomatike dhe mendoj që kjo duhet të rregullohet.

Dhe, çështja e fundit, ne i kemi tri institucione, tre mekanizma që merren me prokurimin publik, i kemi pas sipas të gjitha ligjeve, po them ligji i prokurimit publik që ka pësuar edhe ndryshim, dy ligje, ky është i treti. Roli i Agjencionit të Prokurimit Publik që ka qenë deri tash dhe tash është bërë Agjencioni Qendror i Prokurimit Publik, roli i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe roli i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik. Ideja gjatë bërjes së ligjit të dytë, ose ndryshimit të ligjit të parë ka qenë që organi rregullativ i prokurimit publik si organ ka qenë krejt i panevojshëm por për shkak të një ekzistimi të tij është lënë që në këtë ligj të mos ekzistojnë të gjitha këto organe dhe në vend që ndoshta organi rregullativ i prokurimit publik që bënë rregullat dhe rregullat janë ligji dhe këtë ligj duhet ta zbatojë Agjencioni i Prokurimit Publik, tash në këtë rast me këtë projektligj vjen dhe shuhet roli që ka Agjencioni tash qendror i prokurimit publik. Nuk përshkruhet se cili është funksioni i saj, me çka merret, cilat janë përgjegjësitë, kujt i përgjigjet, pos asaj se është një drejtor dhe ai drejtor emërohet sipas njëfarë rregulli të caktuar që nuk është krejt njësoj.

Dhe çështja, po në këtë kuadër, KRPP-së i jepen disa kompetenca që deri më tash i ka pas dhe i ka Agjencioni a çka është ky i Adminsitratës Publike të Kosovës rreth certifikimit të auditorëve, të certifikuesve e të tjera, gjë që këtë rol nuk duhet ta ketë Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, por mua më duket se kjo çështje ka dalë pikërisht për shkak të vetë angazhimit të njerëzve që kanë punuar në këtë organ në bërjen e këtij ligji dhe sikur ia kanë përshtatur vetvetes edhe rregullat, rolin dhe misionin që e ka. Se, organi rregullativ i prokurimit publik në këtë rast na del si organ më i lartë ndoshta edhe se vetë OSHP-ja ose vetë Agjencioni tash qendror i prokurimit publik. Prandaj, rreth kësaj çështjeje propozuesi, po në këtë rast bashkë me Komisionin për buxhet e financa duhet të rregullojë dhe të mos u jepen kompetenca të tepërta, të shtuara dhe të panevojshme organeve vetëm sa për të thënë se në emër të funksionimit ose funksionalitetit, përkundrazi, këto vetëm e pengojnë.

Dhe ajo, që e tha edhe Bahri Hyseni këtu, mënyra e zgjedhjes së njerëzve në këto organe nënkupton edhe mënyrën e shkarkimit të tyre.

Prandaj, në qoftë se Kuvendi sipas një procedure të caktuar përzgjedh këta persona në këto organe, Kuvendi është ai që i shkarkon dhe asnjë gjykatë tjetër. Gjykatat mund të veprojnë vetëm në raste kur këta kryejnë vepra të caktuara që ndiqen sipas ligjeve, por jo edhe për shkak të keqpërdorimit të detyrës zyrtare ose për shkak të nevojës së ndërrimit të tyre duhet tash të presim një vendim të gjykatës, përdërisa në përzgjedhjen e tyre s'e kemi marrë këtë mendim ose vendim të gjykatës.

Këto ishin ato vërejtjet për të cilat desha të flas. Ndoshta kam qenë i përsëritshëm por sinjoralisht çështja e prokurimit në ndërmarrje publike është lënë pas dore dhe kjo çështje duhet të rregullohet. Duhet të gjendet një modus ose ministri mund të na thotë se do të nxjerrim një ligj të veçantë për prokurimin e ndërmarrjeve publike, por në këtë ligj, të përjashtimet duhet të fusim, se nga ky ligj përjashtohen ndërmarrjet publike. Nga ky ligj, do të thotë, edhe ndërmarrjet publike përjashtohen nga ky ligj, me kusht që të kemi një ligj tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Muzejene Selmani.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përhëndetje për ministrat që janë prezentë dhe deputetët,

Duke marrë parasysh se të gjitha u thanë për Projektligjin për prokurimin publik dhe Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah në parim Projektligjin për prokurimin publik dhe njëkohësisht vërejtjet më esenciale u potencuan vetë nga kryetari i Komisionit për buxhet e financa, të cilat unë desha t'i flas, mirëpo isha e fundit që të flas për këtë projektligj, duke marrë parasysh se paraja publike është shumë e rëndësishme dhe ministri është në dijeni për këtë çështje dhe ky projektligj i ri i cili është sot në shqyrtim të parë, duke marrë parasysh se projektligji i mëparshëm nuk ka gjet zbatueshmëri apo nuk është zbatuar nga vetë personat të cilët kanë qenë të autorizuar të zbatojnë projektligjin, projektligji i ri i cili është sjell sot në Kuvend u potencuan mjaft vërejtje por vërejtja më e madhe e imja do të ishte çështja e prokurimit të ndërmarrjet publike, të cilat ju jeni dëshmitarë dhe ne jemi dëshmitarë që aty keqpërdoret paraja publike mjaft mirë.

Dhe çështja të neni 26 i këtij projektligji, të kontratat e mesme, ku ministri vetë është deklaruar që do të ketë ndryshim-plotësim edhe në mbledhje të Qeverisë mirëpo këtu me ardhjen e Projektligjit në Kuvend, nuk paska ndodhur kjo.

Edhe pse në Raportin e progresit të Komisionit Evropian vitin e kaluar Kosova është kritikuar ashpër për aspektet e abuzimit në procesin e prokurimit, midis tjerash, është obliguar dhe i është rekomanduar Kosovës që Ligji i prokurimit të ndryshojë, mirëpo siç dihet, është esenca që njerëzit

duhet të mësohen të ekzekutojnë ose t'i zbatojnë ligjet dhe gjyqësia të merret me çështjen e shkeljes së ligjit, e njëkohësisht të ligjit për prokurimin publik. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Driton Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Me të vërtetë të jesh i fundit për të folur, ndonëse paska edhe një pas meje, është vështirë, por megjithatë po ndalem në dy pika esenciale, mendoj, dhe veç këtu janë përmendur – te neni 1, që mendoj se të gjithë ata që e kanë lexuar këtë ligj, neni 1 nuk jep kuptim. Arsyeja është se ne e kemi një ligj në fuqi dhe ky ligj, projektligj, më falni, nëse e krahasojmë me atë ekzistues, në këtë ekzistuesin nuk ka në esencë dallime pos disa, si të them, tentimeve të disa individëve që edhe më shumë ta centralizojnë prokurimin.

Neni 1 thotë se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente. Mirëpo, nëse shkojmë e i lexojmë nenet të cilat kanë të bëjnë me transparencën, do të shohim se fare nuk ka të bëjë me atë në realitet, madje-madje ky ligj – Projektligj është më i koklavitur se sa ligji në fuqi.

Ta marrim nenin 10. Thotë, “mjetet për promovimin e transparencës...”, nuk po e lexoj për mos t’ua marrë kohën... Pastaj pikën 2, thotë “shënimet për secilin aktivitet të prokurimit duhet të përmbajnë së paku të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë”, nën një. Pastaj, nën dy, “nëse aktiviteti i prokurimit”... domethënë, e shpjegon gjerë e gjatë.

Mirëpo, pika 3 e këtij neni i rrëzon të dy këto dhe e ngushton transparencën sepse thotë “me kërkesën e cilit do person, autoriteti kontraktues i siguron qasje të menjëhershme”... Po të ishte kështu, do të ishte shumë bukur, shumë transparente, por më pastaj e shkatërron këtë fjali dhe këto fjali tjetra. Thotë, “edhe të arsyeshme”, të arsyeshme në çfarë kuptimi, në kohor apo cilësor personit të tillë i cili kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në nenin 10.1 dhe në nenin 10.2 ku janë të përshkruara gjerë e gjatë. Pastaj vazhdon edhe me një periudhë të panevojshme apo të qëllimshme, në realitet, ku thotë “përveç informatave sekrete afariste”... bla-bla-bla, bla-bla-bla. Domethënë, mënyra e mbylljes së informatës apo të mosdhënies së informatës për cilindo tender dhe për të gjitha këto nene që kanë të bëjnë me transparencën është kështu, kështu janë të përshkruara, që sigurisht se bien në kundërshtim me nenin 1, me qëllimin e këtij projektligji sepse është hartuar, të paktën sipas këtij neni 1, për ta përmirësuar efikasitetin, për ta përmirësuar transparencën. Sigurisht se bien pastaj në kundërshtim të drejtpërdrejtë edhe me nenet 6 të ekonomicitetit dhe efikasitetit, pastaj neni 7 – barazisë në trajtimin – jo diskriminim dhe transparencë, që është ankesa kryesore, zoti ministër shumë mirë e di këtë, të njëjste afariste, të ndërmarrjeve dhe ndërmarrësve të cilët konkurrojnë në tenderet e ndryshme publike e të cilët ankohen për diskriminim të qëllimshëm.

Pastaj, këtu vijmë edhe te një përkufizim, te tenderët e papërgjegjshëm. Konform asaj që thash dhe neni 1, përsëri nuk na garanton neve se këto tenderet e papërgjegjshme, rasti ishte me operatorin që u përmend këtu dhe disa herë e kemi përmendur operatorin e dytë mobil, tenderi ku për shkak të këtyre neneve sot e asaj dite ne s’e dimë se ku kanë mbetur 16.200.000 euro. Dhjetë herë kemi pyetur këtu në Parlament. “Jo kemi informatë sekrete, jo ajo, jo kjo” nuk e informojnë qytetarin e Kosovës edhe pas 3 vjet e gjysmë duke u thirrur në këtofarë ligje që i kanë bërë dhe tash ne nuk e dimë kush është kompetent për atë 16.200.000 euro, a është Ministria e Ekonomisë dhe Financave, a është Qeveria, a është Kuvendi, a është Eulexi, a është ICO, madje-madje më ekspertit shumë i mirë i SHBA-së – ambasadori Kristofer Dell, s’un po bën kurrgjë hiq. Merre me mend! Po them, ekspertin, se veç po përzihet shumë apo po kontribuon në këtë procesin e privatizimit. Por, te 16.200.000 eurot

është i paaftë, për shkak të, po them, ligjeve të cilat po na sjellin në Parlament në vend se me ligje të cilat do të duhen t'i qartësojnë disa gjëra, po shkojnë edhe po i turbullojnë edhe më shumë.

Pastaj, këtu kemi një numër të llojeve të kontratave, por një kontratë të famshme që shpeshherë e kemi përmendur këtu, është kontrata mbi vepër, nuk na ka dhënë shpjegim, ndonëse ministri i Ekonomisë dhe Financave disa herë është munduar të na shpjegojë se çka është kontrata mbi vepër, por kontratat – llojet tjera të kontratave, si them po e zbehin atë kontratë, po edhe ajo kontratë nuk është ende në legjislacionin e Kosovës.

Sidoqoftë, unë këtë projektligj nuk do ta votoj, sepse nuk bën prurje esenciale, pos disa ndryshimeve kozmetike që mbase diku i shkojnë në interes por nuk ka në esencë që do ta përmirësojë prokurimin publik, do të thotë, do ta ulë korrupsionin, do t'i ndihmojë ambasadorit Kristofer Dell për ta gjetë atë 16.200.00 euro, apo edhe për të ndërhyrë nganjëherë në ministrat e përfolur për korrupsion dhe t'i ndihmojnë pak Kosovës për shkak të miqësisë që e kemi me SHBA-në. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Zef Morina, e ka fjalën.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Që nga Rregullorja e UNMIK-ut për prokurimin publik dhe gjer te ligji aktual vërtet fushën e prokurimit publik e kanë përcjell shumë vështirësi dhe mangësi të cilat kanë qenë ndoshta edhe shkak i mosefikasitetit të duhur në këtë fushë nga ana institucioneve apo e agjencive të ndryshme që janë marrë me këtë, që e kanë kryer detyrën sipas prokurimit publik.

Projektligji në fjalë ka disa ndryshime pozitive, por shihet që ende ka shumë nevojë për ndryshime edhe më tutje në mënyrë që vërtet kjo fushë shumë e ndjeshme të jetë më efikase dhe më transparente. Sido që të jetë shihet se këtu ka shumë gjëra pozitive që janë ndryshuar dhe shpresojmë që ky projektligj do të jetë më efikas në kryerjen e detyrave sipas asaj që e përcakton.

Ajo që shihet dhe që është shumë me vend që është bërë, është tek kategorizimi i kontratave sipas vlerave të parashikuara, gjë që në ligjin aktual nuk kanë qenë, të cilat vërtet kanë një rëndësi shumë të madhe sepse mbi bazën e kësaj është më lehtë edhe të merren vendime.

Ajo që mendoj se është dashur të bëhet një ndryshim më i theksuar është tek afatet, duke pasur parasysh se pikërisht afatet kanë qenë shkak kryesor që shumë agjenci nuk kanë arritur të kryejnë dhe të jenë efikase në kryerjen e detyrave ose kryerjen e projekteve apo programeve që janë parashikuar. Shkurtimi është bërë për një kohë shumë të shkurtër dhe unë mendoj që afati më i gjatë duhet të jetë 30 ditë, bile për investime kapitale nuk duhet t'i kalojë 30 ditë. Pikërisht për këtë arsye mendoj që kishte me qenë kohë e mjaftueshme që edhe ofertuesit t'i përmbyllin të gjitha kërkesat të cilat paraqiten me ofertë apo me kontratë në mënyrë që të përshpejtohet kryerja e punëve sidomos tek investimet kapitale.

Ndryshimi tjetër që është shumë pozitiv, mendoj, është edhe te nënshkrimi i kontratës. Unë e dëgjova kolegun më herët që tha se ministri nuk duhet ta nënshkruaj kontratën. Përkundrazi, ministri është përgjegjësi kryesor, ose shefi, ose ai i cili është përfaqësues kryesor i një institucioni dhe ai

duhet të jetë përgjegjës dhe ai duhet ta firmosë i fundit kontratën pas firmosje së personave që janë përgjegjës apo personave zyrtarë siç janë ata profesionistë.

Mendoj që duhet të bëhet edhe një ndryshim te neni 35, të bëhet do me thënë ndarja e kontratave sipas asaj që parashihet te kontrata për furnizim, kontrata për shërbime dhe kontrata për punë ose për investime kapitale. Këtu e kam fjalën për procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit të kontratës që përfshin deri 10%. Tek investimet kapitale është një rregull teknike që është e pamundur që çdo projekt të jetë i saktë 100%. Dhe për këtë arsye ka shumë raste kur janë paraqitur ndryshime të mëdha në praktikë dhe pikërisht për shkak të këtij 10% punët nuk janë krye si duhet dhe është dashur që projekti të jetë i mangët. Për këtë arsye mendoj se tek pika 2.4 e nenit 35, në fakt 2.3. të ndryshohet dhe të mos jetë 10% por të përcaktohet sipas vlerës që e përcaktojnë organet përcjellëse gjegjësisht ekspertët gjatë kryerjes së punimeve.

Mendoj se ky ligj është mjaft i mirë dhe unë e përkrah në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti, Hajdin Abazi, e ka fjalën.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Në parim unë konsideroj se edhe ligji i mëparshëm nuk ka qenë shumë defektoz krahasuar me atë aspektin që ndoshta më tepër duhet të kërkojmë përgjegjësinë tek mekanizmat e zbatimit të kriterëve të parapara e jo të ligjit, sepse ligji është thjeshtë një udhëzues, një lloj direktive që tregon çka mund e çka s'mundet, por ata që e zbatojnë pastaj aty bëhen ato për të cilat gjithë ne jemi të shqetësuar.

Unë, meqë shumë gjëra u thanë për të cilat pajtohem, do të ndalem kryesisht në dy aspekte. Zakonisht kur i shohim tenderët të cilët janë shpallur, janë dy mundësi sipas të cilave duhet të bëhet vlerësimi. E para, ose zakonisht, është çmimi më i ulët dhe tjetri çmimi më i favorshëm ekonomikisht. Dhe, kam shumë kolegë nëpër komuna të cilët thonë se zakonisht e aplikojnë çmimin më të ulët për shkak të ikjes së mundësive për korrupsion dhe për manipulim. Mirëpo, problemi shtrohet, a është kjo zgjidhja e vërtetë. Unë di raste, për shembull, në komunën e Ferizajt kur një shkollë është dashtë të ndërtohet, 3 inxhinierë kanë dhënë vlerësime të ndryshme që çmimi i saj për t'u ndërtuar nuk mund të jetë nën 120.000 euro, kurse është marrë ose e ka fituar tenderin për 70.000 euro. Problemi këtu shtrohet, me çfarë kualiteti do të bëhet ai objekt? Prandaj mendoj se këtu është një shqetësim serioz dhe mendoj se përpjekja për ta zgjidh këtë në atë formën që secili institucion që e shpall tenderin të bëjë paraprakisht kalkulime dhe të caktojë një limit nën të cilin nuk mund të jepet tenderi. Atëherë, kjo besoj, të paktën do ta ruante kualitetin e ndërtimeve dhe jo të bënin të dështonin shumë ose qysh ka rate për shembull që marrin ndërmarrësit me çmim të lirë, për shkak të konkurrencës jolojale dhe në fund, dështojnë, nuk arrijnë ta bëjnë ose ndodh që pastaj objektet bien, dëmtohen, sharrohen, futen në tokë ose edhe dëmtohen shumë seriozisht.

Mendoj se nëse ne do ta institucionalizojmë këtë çështje që institucioni që e shpall tenderin, ta bëjë një vlerësim preliminar dhe të caktojë plus – minus sa mund të lëviz diçka, dhe, vetvetiu, të paktën, nëse asgjë tjetër nuk bëjmë, bëjmë që ato që do të ndërtohen, ato që do të bëhen, të bëhen me kualitet dhe sipas kërkesave e standardeve që kërkohen. Faleminderit!

Diskutim i dorëzuar me shkrim

ABDYL YMERI: Krahasuar me ligjin e mëparshëm, ky projektligj ka ndryshime substanciale dhe është më i avancuar, sigurisht që me angazhimin edhe të deputetëve dhe ekspertëve të kësaj fushe do të kemi një ligj të kompletuar i cili do të mundësonte zgjidhjen e problemeve dhe sfidat me të cilat përballen zyrat e prokurimit publik qoftë në nivel lokal apo në nivel qendror, dhe në përputhshmëri të plotë me standardet dhe praktikatat e njohura ndërkombëtare të prokurimit publik.

Është mirë që përmes këtij ligji të ketë përmirësime të dukshme në politikat e kësaj fushe, duke e rritur edhe më shumë transparencën, konkurrencën, pa anshmërinë, që do të mundësonte zhvillimin dhe ekzekutimin e projekteve të ndryshme që financohen nga buxhetet komunale dhe buxheti i Qeverisë së Kosovës.

Në kuadër të kësaj, unë do të ngre disa çështje:

E para, në nenin 10 ku flitet për transparencën, konsideroj që në këtë drejtim të punohet më shumë në ngritjen e kapaciteteve të teknologjisë informative në kuadër të organeve përgjegjëse të prokurimit duke zhvilluar, ngritur si dhe funksionalizimin e e-prokurimit i cili do të mundësonte krijimin e kushteve dhe proces më të lehtë për të gjithë operatorët ekonomikë që kanë interes të marrin pjesë në procesin e tenderimit.

Aplikimi përmes e-prokurimit do të hiqte të gjitha dilemat dhe nuk do të ketë hapësirë për devijime, fshehje apo mosdhënie të dokumenteve operatorëve ekonomikë.

E dyta, kriteri për dhënien e kontratës, në nenin 60, kemi dy variante: çmimin më të ulët dhe çmimin ekonomikisht më të favorshëm.

Në variantin e parë operatorët ekonomikë, janë të detyruar që të kenë çmimin më të ulët nëse donë të kenë kontratë. Mirëpo, çmimi më i ulët në praktikë po shihet se dëmton cilësinë e punëve.

Edhe në variantin e dytë çmimi ekonomikisht më i favorshëm, cilësia e punëve të projekteve është më e mirë por krahasuar me çmimet e tregut, çmimet janë më të larta.

Mendoj se autoritetet kontraktuese në këto raste patjetër duhet të kenë vlerësimin e tyre nga ekspertët se sa kushton projekti dhe në bazë të kësaj duhet të kenë një tolerancë plus, minus 10% nga çmimi i përgjithshëm, e pastaj të përzgjedhin kompaninë e cila është në kuadër të çmimit të vlerësuar.

Dhe, e treta, kriteret e vlerësimit duhet të jenë më rigorozë gjatë përzgjedhjes, ta zëmë një kompani e cila është e specializuar për ndërtim të ulët, nuk mund të merr projekte të ndërtimit të lartë, apo në raste tjera kompania tregtare të marrë projekte infrastrukturore. Po e them këtë me qëllim të profilizimit të kompanive.

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj se diskutues tjerë nuk ka. Ministri, e do fjalën prapë, apo jo? Nuk ka nevojë, nuk dëshiron ta marrë fjalën. Sa deputet i kemi në sallë? Në sallë janë 72 deputetë. Tani sipas radhës, bëhet votimi. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

48 vota me kartelë, 1 pa kartelë – 49 vota “për”, 4 “kundër”, 10 abstenime, konstatoj se Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për prokurimin publik.

Në bazë të Rregullores, Kuvendi i ngarkon këto misionin:

- Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, dhe
- Komisionet e përhershme.

Komisionet duhet që në afatin sa më të shpejtë të mundshëm, Kuvendit t'i paraqesin raporte me rekomandime.

Kalojmë në pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK- së, të viktimave civile dhe të familjeve të tyre

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj zëvendëskryeministrin, si përfaqësues i Qeverisë, që para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë Projektligjin. Zoti Kuçi, e keni fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryesues i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Zonja dhe zotërinj,

Jam i nderuar sot që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës mund të prezantoj para jush për miratim në parim Projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

Ky akt ligjor që po e prezantojmë sot është i një rëndësie të veçantë, sepse për objekt trajtimi ka kategoritë e dala nga lufta e fundit në Republikën e Kosovës, të cilat janë dëshmorët dhe familjet e tyre, invalidët e luftës dhe ata civilë, veteranët pjesëtarë të UÇK-së, të zhdukurit dhe familjet e tyre dhe viktimat civile të luftës.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në procesin e hartimit të këtij projektligji ka qenë dhe ka angazhuar jo vetëm ekspertë nga ana e Qeverisë por edhe nga shoqatat e dëshmorëve, veteranëve dhe invalidëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Hartimi dhe shqyrtimi i këtij projektligji është bërë në përputhje të plotë me të gjitha procedurat për hartimin e legjislacionit, të cilat përcaktohen me Rregulloren e punës së Qeverisë.

Qëllimi kryesor i nxjerrjes së këtij ligji është rregullimi dhe përcaktimi i statusit të gjitha kategorive të dala nga lufta si dhe përkrahja financiare përmes dhënies së pensioneve dhe beneficioneve të ndryshme të cilat sadopak do të ndikojnë në përmirësimin e jetës së tyre.

Sipas dispozitave të këtij projektligji, i cili sot është për shqyrtim në Kuvend, kategoritë e trajtuara në këtë projektligj, varësisht nga statusi i tyre, do të përfitojnë këto pensione:

- pensionin familjar, të cilin e realizon familja e dëshmorit, familja e të zhdukurit, të pagjeturit të UÇK-së, familja e viktimave civile të luftës si dhe familja e të zhdukurit civil;

- pensionin invalidor personal, të cilin e realizon invalidi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe invalidi civil i luftës, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë ligj;
- pensionin invalidor familjar, të cilin e realizon familja pas vdekjes së invalidit, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj;
- pensionin personal të luftës, të cilin e realizon veterani i luftës së UÇK-së pas moshës 55 vjeçare;

Përveç realizimit të të drejtave të këtyre pensioneve, kategoritë e lartpërmendura në këtë Projektligj do të përfitojnë edhe një varg beneficimesh në shërbimet shëndetësore, në aftësimet profesionale, në procesin e punësimit, lehtësimet tatimore, lehtësimet doganore, arsim, energji elektrike dhe tjera.

Para se të ju ftoj që ta miratojmë këtë projektligj në parim, më lejoni të them se është një projektligj që sublimon vlerat e luftës dhe sakrificën për liri, e legjitimon përpjekjen individuale dhe kolektive të secilit individ që e ka dhënë për Republikën e Kosovës, për lirinë dhe pavarësinë e vendit, tonë, krijon një siguri juridike dhe materiale po edhe privilegje për të theksuarit, dhe unë do të thoja e forcon dinjitetin e familjeve dhe popullit tonë në tërësi.

Dhe, krejt në fund, e them me bindje të plotë dhe në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës – ky ligj nuk i ndanë dëshmorët, nuk i ndanë invalidët, nuk i ndanë viktimat civile, nuk i ndanë veteranët dhe as të pagjeturit, por i bashkon ata.

Ky ligj nuk ka për qëllim të hapë debate për të kaluarën e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe sakrificën për liri, por ka për qëllim që t'i sublimojë ato dhe t'i mbyllë të gjitha debatet, duke dhënë një kontribut të mirë për luftën dhe sakrificën që e kanë bërë.

Të gjithë e dimë që njerëzit në këtë vend, për shekuj me radhë, kanë dhënë shumë për vendin tonë, por asnjëherë s'e kanë marrë bekimin e shtetit. Mendoj se kësaj radhe është radha që të bëhet një gjë e tillë.

Dhe, krejt në fund, besoj se ju do ta jepni kontributin tuaj, secili prej jush veç e veç dhe jam i bindur se debatet do të jenë në të mirën e këtij ligji, familjeve të dëshmorëve dhe atyre që, do të thosha, përfitojnë nga ky ligj por njëkohësisht, besoj, do të jenë në të mirën e kohezionit politik nacional të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër! Pas prezantimit të projektligjit, hapim debatin për diskutim në parim. Sipas radhës së diskutuesve, kryetari ose raportuesi i komisionit funksional për legjislacion dhe gjyqësi, apo Komisioni për punë dhe mirëqenie sociale, kush e do fjalën? Cili do të marrë fjalën? Urdhëroni, e ka fjalën Bahri Hyseni!

BAHRI HYSENI: Faleminderit shumë, zoti kryesues!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari, është një fat i madh që sot Kuvendi i Kosovës ka mundësi që të miratojë në parim Projektligjin i cili do të rregullojë statusin e kategorive të cilat më së tepërmi kanë dhënë për Kosovën dhe është fat i mirë që do të kemi mundësinë edhe ne si komision por edhe komisionet tjera parlamentare e sidomos edhe Komisioni për çështje sociale të japin ndihmën rreth modifikimeve apo çështjeve të cilat duhet ndoshta t'i rregullojmë në projektligj.

Së pari është mirë që e gjithë puna të koncentrohet që Projektligjin ta bëjmë për me u zbatua në praktikë dhe në kuadër të kësaj unë do të ngre vetëm disa çështje të cilat ndoshta gjatë hartimit janë përvjedhur dhe është mirë që si komisione parlamentare por edhe si deputetë të mos i lejojmë që, së paku, të shkojnë në kolizion me paragrafët të cilët janë brenda këtij ligji. Zëvendëskryeministri mendoj që e sqaroi komplet edhe përmbajtjen, edhe nenet përkatëse të cilat rregullojnë statusin e të gjitha kategorive që i përmenda po unë do të ndalem pak te neni 7 pika 2 ku flet për kategorinë apo anëtarët e familjes së ngushtë të cilët përfitojnë nga Projektligji, domethënë edhe për familjet e veteranëve dhe familjet e dëshmorëve mirëpo i cili nen bie ndesh me paragrafin 3, me pikën 1.17 ku flet për: në rast se veterani nuk ka trashëgimtarë, siç është paraparë në nenin 3.17 te familja e ngushtë, thotë benificionet do t'i takojnë motrave dhe vëllezërve dhe konsideroj që kjo po bie ndesh, neni 7.2 po bie ndesh tash me nenin 3.1, paragrafi 17 sepse atje flet për kategorinë të cilët kanë të drejtë t'i gëzojnë këto të drejta.

Një çështje tjetër me interes është e po të njëjtës situatë, domethënë në nenin 2 pika 1.3 ku flet për të drejtat dhe benificionet e invalidëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për kohën të cilën e kanë kaluar në burg, ku i dihet stazhi i dyfishtë dhe kjo është shumë mirë që po ndodh për këtë kategori mirëpo më pastaj në paragrafin 2, i njëjti nen, domethënë paragrafi 2 flet për këtë stazh t'u njihet edhe anëtarëve të familjes. Dhe këtu mendoj që është bërë një lëshim sepse stazhi i takon atyre të cilët janë invalidë, të cilët kanë qenë në burg dhe të radhitur në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, por jo tash te stazhi, të kalojë edhe në anëtarët e tjerë të familjes sepse nuk do të kishte logjikë. Mendoj që gjatë përshkrimit të paragrafëve ka qenë një gabim.

Kurse në nenin 12, është mirë të përqendrohemi te paragrafi 1.5 ku flet për pjesëtarët e trupave mbrojtëse të Kosovës, ish pjesëtarët e Trupave Mbrojtëse të Kosovës apo për ata të cilët tani janë në Forcën e Sigurisë së Kosovës ku nuk i njihet e drejta në pensionin e veteranit të luftës. Këtu konsideroj që Kuvendi duhet të marrë vendim parimor. Kjo e drejtë nuk mund t'i mohohet askujt, pavarësisht që punon qoftë në Forcën e Sigurisë së Kosovës apo si pjesëtar i Trupave mbrojtëse të Kosovës sepse pensioni si veteran i luftës duhet t'i takojë edhe kësaj kategorie. Çështja është a duhet t'i njihet komplet pensioni apo t'i njihet një 40% siç është paraparë edhe për kategoritë tjera të cilat punojnë, mbetet çështje që duhet ta diskutojmë bashkërisht në komisionet parlamentare, mirëpo gjithsesi kësaj kategorie duhet t'i njihet pensioni i veteranit të luftës, sepse do të ishte e palogjikshme që vetëm që është pjesëtar i Forcës së Sigurisë apo ka qenë pjesëtar i ish Trupave Mbrojtëse të Kosovës të mos i njihet pensioni i veteranit të luftës. Dhe, askush, unë konsideroj që asnjë pjesëtar nuk do ta pranonte që të mos e merr pensionin si veteran i luftës dhe ta merr pensionin e ish Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Unë e kuptoj që buxheti i Kosovës nuk do të ketë mundësi të ndajë dy pensione, por të ndajë një përqindje që i takon si veteran i luftës.

Do të thotë, këto do të ishin pika të shkurtra, dhe është mirë që neni 22, ku flet për gjokat kundërvajtëse, e kemi diskutuar disa herë në Kuvend por edhe një herë duhet të ngrehim shqetësimin. Ne nuk mund të parashohim, ne mund të parashohim shkelje të dispozitave ligjore që mund të jenë shkelje kundërvajtëse por nuk mund t'i parashohim gjokat. Sepse, po biem ndesh me ligjin aktual për kundërvajtje i cili i ka paraparë gjokat dhe mandej e kemi një situatë që me të drejtë kryetari i Gjykatës për Kundërvajtje është drejtuar disa herë te komisioni për legjislacion ku thotë: ju lutem gjokat që po i shqiptoni me ligjin na keni sjell në situatë që ne nuk po mund praktikisht t'i zbatojmë në gjykatat kompetente. Prandaj, këtu është mirë të parashihen veprat por jo edhe gjokat sepse gjokat do të shqiptohen në bazë të ligjit bazik, që është, edhe pse, ju e dini që tani kemi hyrë në sistem të riorganizimit të gjykatave dhe nuk do të ketë as gjykata për kundërvajtje por së paku sa do të jenë të mos biem në këtë situatë. Me këto ndryshime natyrisht se ne do ta përkrahim ligjin dhe ne

do të japim kontributin maksimal që projektligjin ta sjellim në afatin e caktuar dhe ta rregullojmë këtë kategori të njerëzve që kanë pritur dhe kanë dhënë shumë për Kosovën. Faleminderit!

KRYSUESI: Faleminderit! Në emër të Komisionit për punë dhe mirëqenie sociale, deputeti Sadik Idriz e ka fjalën!

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedavajući!

Pozdrav članovima kabineta, poslanicima!

U ime Komisije, par rečenica u nastavku i u ime Parlamentarne grupe „7+“.

Komisija kojoj predsedavam, nije razmatrala ovaj Nacrt zakona prije prvog čitanja zbog toga što je on u Parlament, u proceduru došao tokom avgusta, a Komisija još nije održala sastanak, ali sam siguran da će Komisija dati sve od sebe da ovaj zakon na vreme bude, jasno ako bude danas usvojen, u periodu koji je predviđen da izvrši analizu ovog zakona i da da svoje amandmane i da uradi zakon kako bi bio što kvalitetniji.

U ime Parlamentarne grupe „7+“, mi smo proučili ovaj nacrt zakona i smatramo da je nacrt zakona koji je neophodan, mada u evropskom zakonodavstvu ne postoji, nije ova materija regulisana, od zemalja u okruženju jedino Hrvatska ima nešto bolju zakonodavnu tradiciju u ovoj oblasti i vidimo da je u izradi ovog zakona korišćeno iskustvo Hrvatske.

Radi se o jednom zakonu koji daje određene beneficije i prednosti u raznim segmentima života ljudima koji su dali doprinos za ovu zemlju. Najvažnije je da ovom zakonu što se tiče njegove pripreme i provođenja da će, da su predviđeni rokovi za donošenje podzakonskih akata, takođe je predviđeno da mnoga ministarstva budu uključena, pored ovog Ministarstva koje je sponzor pri Ministarstvu za rad i socijalno staranje, i druga ministarstva imaju svoju obavezu prema Ministarstvu zdravlja i još neka druga ministarstva koja moraju da obezbede trgovinu i tako dalje, koja moraju da obezbede određene beneficije koje su predviđene ovim nacrtom zakona.

Predlagač je dao određene rezerve kada su u pitanju budžetske implikacije. Zaista ovaj zakon ima određene budžetske implikacije, primena jednog dela ovog nacrta zakona, odnosno zakona će biti od januara 2011. godine, dok se određeni stavovi, određeni članovi ovoga zakona predviđa se da će biti početak realizacije tek od 2014. godine, zato što su potrebna značajna sredstva. Ministarstvo za rad i socijalno staranje je predvidelo da će u prvoj godini dodatna budžetska sredstva iznositi od 4,8 miliona eura i to je ključni problem koji mora Vlada da obezbedi da bi ovaj zakon počeo da se realizuje i to nije od prilike precizno, jer postoji mogućnost da ta sredstva budu i veća nego što je predviđeno ovim zakonom. Još oko 4,5 miliona bi bilo potrebno da se ovaj zakon realizira, a to od 2014. godine, ako bi svi članovi bili realizovani.

Podnosilac, odnosno sponzor zakona - Ministarstvo je dalo jedno obrazloženje da osnovni elementi Nacrta zakona podrazumevaju potrebu povećanja tekućeg godišnjeg budžeta Ministarstva za najmanje 4,8 miliona eura. Mora se priznati činjenica, citiram: „da je prisutan ozbiljan rizik da aktuelni potrebni iznos bude i veći u nemogućnosti ušteda u okviru postojećih penzijskih programa zbog većeg broja korisnika, obuhvaćenih u programu, zbog povezanosti sa nivoom plata, stoga ovi se rizici moraju pažljivo razmatrati prilikom usvajanja ovog zakona, odnosno njegovom primenom. Jedno mora biti jasno da je Ministarstvo za rad i socijalno staranje dužno da menadžira i sprovodi zakon u okviru postojećih raspoloživih fiskalnih sredstava“.

Govorim o tome, ovo sam citirao šta je predlagač zakona rekao i mislim da Ministarstvo finansija mora biti garant ili Vlada ukoliko želi da ovaj zakon bude sproveden. Sa postojećim rizicima biće teško i zato i pozivamo i Vladu, znači mi ćemo raditi zakon kao komisija, ali da implementacija odnosno sprovođenje ovog zakona svakako da zavisi od toga kolike su mogućnosti i koliko je snaga Vlade da ga podrži. U svakom slučaju, mi pozdravljamo ovaj nacrt zakona i daćemo svoj doprinos, kao Parlamentarna grupa „7+“ podržavamo ovaj zakon. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sipas renditjes, kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit parlamentar PDK-së, kryetari i Grupit Ramë buja e ka fjalën

RAMË BUJA: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar, zotëri kryeses,

Kabinet qeveritar,

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dua të falënderoj Qeverinë për sjelljen e këtij projektligji në Parlament, i cili besoj shpejt do të bëhet ligj, bile dua ta marr guximin që ta falënderoj Qeverinë edhe në emër të kategorive që janë të trajtuara në këtë ligj, dhe dua të them që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, gjithsesi e mbështet këtë projektligj, por natyrisht, krahas mbështetjes, me dëshirën më të mirë që ky projektligj të bëhet ligj i mirë, i zbatueshëm dhe funksional, kemi disa vërejtje ose disa përplotësime që konsideroj do të duhej të bëheshin, për arsye që mund të jenë edhe gabime teknike, por herë, herë edhe logjike të lëshuara pa qëllim.

Konsideroj që e para që do të duhej përmirësuar në këtë projektligj është data se kur, kush do të cilësohet si dëshmor kombi? Dhe, ajo është, konsideroj është bërë gabim 9 maji i '45 sepse le jashtë një periudhë shumë të dinjitetshme të luftës për çlirim, pjesën e rezistencës dhe luftës të Shaban Polluzhës, prandaj duhet të jetë besoj nga janari i vitit '45.

Ka edhe disa lëshime të tjera që i përmendi edhe zotëri Hyseni, për Bahri Hysenin është fjala, tek çështja e pjesëtarëve të TMK-së, që nuk e gëzojnë të drejtën dhe mundësinë që të jenë edhe veteranë, domethënë, që unë besoj përsëri është një lëshim dhe lajthitje logjike, por ajo duhet të rregullohet gjithsesi në fazën tjetër, në procedurën tjetër të amendamentimit. Ka diçka, po kështu që është për mua lëshim besoj, dua të besoj se është lëshim, çështja e pjesëtarit të UÇK-së, që kur bëhet shpjegimi, e unë dua ta lexoj për hir të sqarimit: “pjesëtari i UÇK-së, është qytetar i Kosovës dhe shtetas i huaj i cili është radhitur në radhë të UÇK-së dhe është regjistruar si ushtar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, të cilët përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së të cilët kanë lëshuar radhët e UÇK-së para datës 12.06. '99 pa marrë parasysh kohën sa kanë shërbyer në UÇK.

Pjesëtari i UÇK-së, dhe ky cilësim i kësaj forme dhe ky shpjegim, ka një emërtim tjetër. Ata që i lëshojnë radhët e UÇK-së para 12 qershorit '99, kanë emërtimin dezertorë. Kështu duhet të sqarohet kjo përfundimisht. Është sqaruar njëfarë forme në nenin 5, nëse nuk gabohem, por megjithatë nuk është sqaruar mjaft edhe kjo gjë.

Diçka që po kështu është lëshuar dhe besoj do të përplotësohet në fazat tjera, është çështja e atyre njerëzve që e bënë të mundshme zhvillimin e tërë luftës në Kosovë, ishin të angazhuar në Përfundim për ta bërë krejt mundësinë e zhvillimit të kësaj lufte dhe nuk janë futur fare në këtë projektligj, e që duhet menduar mirë ata që në faza të vazhdimit, do të bëjnë punën e tyre, që këta njerëz, që unë konsideroj që ishin pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të futen si kategori që edhe të gëzojnë të drejtën e veteranëve ose veteranit të luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Diçka, po kështu tjetër që do të duhej të përplotësuar. Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare dhe veteranët tjerë, gëzojnë të drejta dhe benificione që duhet të përshëndetur gjithsesi, por e dimë të gjithë bashkë që veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sot kanë gatishmërinë dhe kurajën, por kanë edhe vullnetin e mirë që të vazhdojnë ngritjen e tyre intelektuale, shkencore dhe konsideroj që është bërë lëshim, por kështu që atyre nuk iu ofrohet një mundësi në formë burse ose ndihmesë e veçantë për t'u avancuar në këtë drejtim dhe kjo duhet të jetë gjithsesi si plotësim i domosdoshëm. Edhe diçka që, mbase nuk bëhet tepër thuhet veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe ai do të gëzojë të drejtën e pensionit kur t'i bëjë 50 dhe 55 vjet. Ai është veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës edhe tash edhe pas 55 vjetëve kur t'i bëjë. Ai duhet të pushojë të jetuarit tash në këtë fazë derisa t'i bëjë 55 vjet, ai me njëfarë forme apo një tjetër do të duhej t'i gëzonte këtë benificion që duhet të mendohet ligjërisht, të sanksionohet në mënyrë më të mirë të mundshme, por të pres ai, e kemi pasur fatin që në radhë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kemi pjesëtarë shumë të rinj e sot janë po kështu të rinj, por nuk janë 50 edhe 55 vjet, të mendohet edhe kjo formë se si të bëhet ky përplotësim i kësaj zbrazësie që është lënë në këtë projektligj, por të mos jetë zbrazësi kur bëhet ligj. Ne gjithsesi si grup po e përsëris e mbështesim dhe kontributin tonë do ta japim në komisionet funksionale ato që do të kenë ndikimin për ata përmirësuar dhe plotësuar për atë që duhet të plotësohet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Adem Hajdaraj.

ADEM HAJDARAJ: Zotëri kryesues,

Ministra dhe deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, është shumë i interesuar për rregulluar për rregullimin e statusit dhe të drejtave të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, të ithtarëve të UÇK-së, viktimave civile dhe familjeve të tyre njëkohësisht.

Përshëndesim ardhjen, domethënë prurjen këtij projektligji në Kuvend, por Grupi Parlamentar i LDK-së, konsideron:

1. Ky projektligj nuk i plotëson kriteret e nevojshme dhe nuk i përfshinë të gjitha kategoritë që i kontribuuan lirisë dhe pavarësisë së Kosovës;
2. Përjashton strukturat e tëra institucionale të përfshira në radhët e UÇK-së.

Grupi Parlamentar i LDK-së, konsideron se ka ndarje dhe përjashtime të shumë luftëtarëve për realizimin e të drejtave të tyre e që numri i tyre është i madh.

Nëse dikush ka qenë në regjistër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, por ka qenë pjesëtarë i Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, që nga viti 1991, kjo kategori e fundit përjashtohet sipas këtij projektligji, pa të drejtë. Është publike dhe notore fakti se ne kemi pasur edhe Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, por edhe Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, dhe me këtë projektligj përjashtohen të gjithë ata që kanë qenë pjesë e këtij organizimi institucional dhe që kanë luftuar nën emblemën e UÇK-së.

Teksti i projektligjit nuk i plotëson kushtet as substanciale dhe as teknike për rregullimin e statusit të gjitha kategorive të luftës. Grupi Parlamentar i LDK-së, nuk pranon që të ketë ndarje të luftëtarëve të UÇK-së. Nuk përkrahim selektimin e luftëtarëve të UÇK-së, në të pranueshëm dhe të

pa pranueshëm që është bërë me këtë projektligj.... Luftëtarët kanë qenë të institucionalizuar, qoftë në SHPK të UÇK-së, qoftë nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës. Këta dy mekanizma nuk mund të përjashtojnë njëri-tjetrin. Ato kanë pasur synimin e përbashkët në luftën për lirinë e Kosovës. Është e pakuptueshme për ne që ky ligj i trajton edhe periudhat e mëhershme që prej '45 e këndej, që ne nuk i kemi asgjë kundër, por ne jemi që të përfshihet edhe kategoria që sipas nesh është përjashtuar nga ky projektligj.

Nuk besojmë se cilido prej përfituesve të këtij projektligji, kategoritë me të cilat ka të bëjë e që ta ndiente veten mirë që ata ta rregullojnë statusin e tyre dhe të familjeve të tyre, e që bashkëluftëtarët e tyre, familjet e tyre të mos e gëzojnë këtë të drejtë.

Grupi Parlamentar i LDK-së kërkon që ky projektligj t'i kthehet Qeverisë për eliminimin e mungesave që i thamë më parë e që edhe konkretisht do të thonë deputetët e LDK-së gjatë debatit. Kjo jemi të bindur se mund të bëhet shpejt, pa asnjë prolongim dhe Kuvendi, në mos seancën e radhës, menjëherë të dytën pas saj, mund ta miratojë. Duhet të gëzojë vetëm vullneti politik dhe asgjë më shumë, shkurt ta bëjmë këtë ligj, por të mos e përjashtojë askënd i cili ka dhe duhet t'i ketë të drejtat e tij. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Kadaj.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në parim Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e përshëndet sjelljen në Kuvend të këtij projektligji edhe pse me shumë vonesë, kur kemi parasysh që iniciativat e para për hartimin e këtij projektligji janë marr po thuaj se 5-6 vjet më parë nga atëherë nga Kabineti Haradinaj dhe vetë kryeministri Haradinaj, ka filluar një zbatim i një përkujdesjeje institucionale në atë kohë për këto kategori dhe është dashur të presim mjaft gjatë që ta kemi këtë projektligj sot kur Kosova po hyn vetëm në, pothuajse në vitin e tretë të pavarësisë së saj. Dhe, sot, këto kategori që janë faktori kryesor për çlirimin e vendit, me të drejtë presin që në Kosovën e pavarur, familjet e tyre, invalidët, veteranët, të gjithë ata që sakrifikuan shumë apo u bënë faktorë kryesor për çlirimin e vendit, ta kenë një përkujdesje shtetërore, sepse tani Kosova është shtet.

Mirëpo, na lejoni të theksojmë që përkujdesje shtetërore, duhet të kenë dhe të gëzojnë edhe heronjtë e gjallë ata të cilët po vazhdojnë të mbrojnë luftën e pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kjo përkujdesje shtetërore, fatkeqësisht po mungon, e kemi thënë edhe dje dhe do të vazhdojmë ta themi dhe ata kërkojmë nga kjo foltore e Parlamentit.

Thamë që jemi pro, mirëpo na vjen shumë keq që një projektligj i rëndësisë së veçantë siç është ky projektligj, sillet me kaq shumë gabime dhe lëshime në Kuvendin e Kosovës. Deputetët në vijim nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, do të japin edhe të dhëna konkrete, mirëpo unë do të përmend me theks të veçantë nenin 3 dhe pikat 1.6, pika 1.7, që u referohen dëshmorëve të kombit. Gjithashtu, do të thotë edhe në dispozitat e tjera të këtij ligji, ka elemente shumë konfuze, të paqarta dhe jofunksionale. Na bënë për të dyshuar që është sjellë në Parlamentin e Kosovës vetëm sa për t'u arsyetuar para këtyre kategorive dhe jo me të vërtetë për të rregulluar do të thotë jetën e tyre.

Si Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës, do të angazhohemi fuqishëm në komisionet përkatëse që sa më mirë të rregullohet statusi i të drejtave të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve të Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës dhe jo të kemi një projektligj i cili do të mbetet në letër, i cili nuk do të mund të funksionalizohet apo zbatohet ashtu qysh po ndodh fatkeqësisht në Kosovë me shumë ligje të tjera. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, kryesues!

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë,

Unë do të kërkoj falje, sepse do të bëj një shmangie nga rendi i ditës, besoj që do ta kem mirëkuptimin. E kam fjalën për një çështje shumë të rëndësishme që është lënë në harresë të plotë nga institucionet e Republikës së Kosovës. Në ditën e sotme, para 20 vjetëve, delegatët e Kuvendit të Kosovës, në rrethana krejt të jashtëzakonshme në të cilën ishte Kosova, bënë një akt historik dhe heroik, por edhe një akt me të cilën u vendosen bazat e shtetit dhe të lirisë të Kosovës.

Sot është përvjetori i 20-të i Kushtetutës së Kosovës të miratuar në Kaçanik, e quajtur Kushtetuta e Kaçanikut, andaj, duke u bazuar në rëndësinë që ka kjo datë historike, në historinë më të re të Republikës së Kosovës, mendoj që ky institucion, pra Kuvendi i Republikës së Kosovës, e ka pasur për obligim që të mbajë një seancë solemne në shënimin e këtij akti madhor. Sidoqoftë ajo sot nuk po ndodh, andaj më lejoni që unë në emër të grupit të cilin e përfaqësoj, t'i falënderojë ata deputetë dhe t'i urojë qytetarët e Republikës së Kosovës për këtë datë historike. Edhe një herë po kërkoj falje për shmangie nga rendi i ditës, do t'i kthehem projektligjit të cilin po e debatojmë.

Projektligji në fjalë, rregullon një prej fushave shumë të rëndësishme, prandaj edhe ne si grup parlamentar e mbështesim në parim, natyrisht me disa përmirësime shumë të nevojshme që do të duhen. Vërejtjet tona janë parimore dhe kemi shumë dilema, nëse në këtë projektligj përfshihen të gjitha kategoritë. Së pari, konsiderojmë se është fyese për luftëtarët e lirisë që të llogariten si raste sociale. Nuk na bënë nderë as neve dhe i fyen ata, sepse në projektligj për t'i gëzuar disa benificione ata duhen të jenë raste sociale. Të drejtat duhet t'u njihen dhe të realizohen si luftëtarë e jo si mjeranë. Së dyti, projektligji kështu si është ka rrezik t'i përjashtojë ata luftëtarë të cilët u kanë takuar formacioneve të ndryshme. Në fund të fundit, luftëtarët nuk janë fajtorë pse nuk ka pasur unifikim dhe pse nuk ka pasur luftë në një ombrellë. Luftëtari nuk ndahet, ai është luftëtar edhe duhet të trajtohet si i tillë.

Së treti, projektligji nuk parasheh një status për ata të cilët nuk kanë qenë luftëtarë të drejtpërdrejtë, por kanë qenë pjesë e logjistikës, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, të cilët kanë qenë pjesë e luftës. U përmend edhe nga zoti Buja, diaspora. Së katërti, Ligji po ashtu nuk parasheh një kategori shumë të ndjeshme në vend e që janë viktimat e luftës e që janë femrat e dhunuara, që në Kosovë nuk kanë qenë të pakta.

Së fundi, pensionin personal të luftës, luftëtari duhet ta gëzojë, pavarësisht moshës e jo sikurse figuron në draftligj pas moshës 50 vjeç. Dhe, përfundimisht konsideroj se ky ligj duhet të na bashkoj dhe jo të na ndajë edhe neve këtu që jemi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Gani Geci e ka fjalën.

GANI GECI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetët,

Unë që në fillim pajtohem me fjalën e zotit Adem Hajdaraj, por më duhet të them se Lidhja Demokratike e Kosovës i ka 6 ministra në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe një zëvendësministër. Shtrohet pyetja: Pse ministrat e LDK-së nuk e kundërshtuan këtë ligj atëherë, dhe dal te kërkesa e kryetarit të Prishtinës se, dhe ministri i Shëndetësisë që LDK-ja në këtë Qeveri është e poshtëruar.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, pajtohet me vërejtjet e paraqitura dhe nga parafolësit, por argumentet tona janë. Disa pretendojnë dhe thonë një mjetet e shkruara se Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës e kanë formuar në vitin '93, disa në vitin '94 e disa në vitin '95, ndërsa në ligj thuhet se pjesëtar ose veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është prej 30 dhjetor 1991. Shtrohet pyetja: veteran të kujt janë ata, nëse UÇK-ja nuk ka ekzistuar në vitin 1999, atëherë veteranë të kujt janë? Do të thotë është një pyetje vetvetiu që mund të dalë. Disa thonë se UÇK-në e kanë formuar, por ndoshta flasin për atë UÇK-n që e kanë formuar në Zvicër, por unë po ju them se Ushtria Çlirimtare e Kosovës i ka rrënjët në kullën e komandantit legjendar Adem Jashari, dhe për të shkuar në ushtrime ushtarake në Shqipëri, urdhrat i ka dhënë Ministria e Mbrojtjes. Urdhrat që i ka dhënë Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, unë nuk kam qenë fajtor pse i ka dhënë Ministria e Mbrojtjes. Unë nuk kam qenë fajtor se sot është 7 Shtatori, Dita e Kushtetutës të Kaçanikut, dokumentit më të lart zyrtar të Republikës së Kosovës edhe më i lartë se ky që e kemi bërë tash, por dikush nuk e ka dashur atë, ndërsa tash na dalin probleme. Na dalin probleme sepse nuk kemi luftuar institucionalisht, sepse nuk e kemi dashur shtetin instituacionalisht, s'e kemi mbrojtur instituacionalisht shtetin tonë, por e kemi mbrojtur me grupe dhe tash na dalin probleme, vetvetiu. Disa grupe parlamentare janë kundër disa për, sepse faktikisht mbesin disa grupe jashtë përfshirjes në sistemin ligjor të veteranëve dhe të invalidëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. .

Unë them sinqerisht që në ligj si dëshmor shkruhet se dëshmor i kombit është edhe ai që ka rënë nga 7 maji 1945, pajtohem me zotëri Ramë Buja që kjo duhet të ndryshohet, duhet të ndryshohet sepse kjo është një parim komunist, mbetet jashtë lufta e Shaban Polluzhës, mbetet jashtë lufta e Mehmet Gradicës dhe mbetet jashtë komplet Lufta e Drenicës, dhe vetvetiu lind pyetja që hero më i madh ata që e vranë Shaban Polluzhën e Mehmet Gradicën se ata që u flijuan për lirinë e sodit. Dhe, domosdo duhet të pajtohemi me këto, nuk kemi qare pa u pajtuar sepse dikush dëshiron për t'i bërë ligjet për dajë, për tezet e për hallat, nuk bëhen ligjet dajë, ligjet që kanë ndikim dhe janë mjaft të prekshëm për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare për ata që dhanë gjymtyrët, për ata që dhanë jetën, duhet të bëhen për nderë të tyre, për nderë të familjeve të tyre dhe për ndihmën e familjeve të tyre që ta kalojnë sa më këtë jetë dhe të respektojmë ata që kanë dhënë jetën për lirinë e vendit.

Fatmirësisht gjatë kohës së luftës, unë kam pas shkruar. Kam pas shkruar se nuk mbaj mend shumë, i kam pas shkruar shënimet që i kam pas shkruar, i kam pas shtie në një shishe të plastikës dy a tri dhe tash i kam të gjitha, dhe nëse doni unë mund t'ua lexoj me emër e me mbiemër kush ka shkuar në ushtrime ushtarake, kush kur ka ardhur prej Zvicre, në cilën datë, ku në cilën odë ka hyrë në Drenicë dhe unë i pyes disa këtu: Pse nuk e formuan Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në vitin 1994 në Vitomiricë, por erdhën në kullën e Adem Jasharit? Edhe atje ka pasur shqiptarë edhe atje ka pasur farefis, i ka pasur të afërmit, dhe në kullën e Adem Jasharit, kur erdhën ta formojnë Ushtrinë Çlirimtare, nja tre muaj ditë nuk ua kallëzuan as emrat se si i kanë, erdhën me pseudonime, Luli e Plaku e Curri, që me kohë disa muaj i shkuan Hamzë Jasharit për t'ua ditur emrat. Megjithatë, lufta i ka rrënjët në Prekaz, nuk e ka në Zvicër. Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës e ka formuar komandanti legjendar dhe prej asaj dite doemos po duhet ta shtimë si datë e fillimit të luftës, sepse atë ditë, me 31 dhjetor 1991, është derdhur gjak pas kashtës në lemën e Adem Jasharit dhe atë nuk po e përmend emrin se është gjallë ai.

Megjithatë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë kërkon ndryshime rrënjësore, kërkon një gjithëpërfshirje të të gjithë atyre që dhanë jetën për liri. Ne kemi edhe disa probleme tjera, probleme shumë të mëdha që nuk janë zgjidhur. Ne kemi edhe një ministër të Mbrojtjes të vrarë në Shqipëri, ministër që unë besoj që në Shqipëri nuk ka mundur të vijë e ta vrasë UDB-a, por edhe nëse e ka vrarë UDB-a, e ka vrarë me dorë shqiptari e ai është ministri Ahmet Krasniqi dhe me zbulimin e vrasjes së Ahmet Krasniqit, zbulohen të gjitha vrasjet e pasluftës këtu te ne, sepse ajo është bërë një vrasje në mbrëmje dhe ka protagonistë që e dinë se si ka ndodhur vrasja e Ahmet Krasniqit, por Lidhja Demokratike e Kosovës është një parti që flet atë që e ndien, ndërsa politikën e tyre i bënë tjetër kush, i bënë Partia Demokratike e Kosovës. Dhe, kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, më tepër është nënkryetar i PDK-së, se kryetari i LDK-së dhe këtu ka filluar nga sot të kuptohet nga elektorati i Presidentit Rugova. Elektorati i Presidentit Rugova sot po e sheh mendimin e saktë të elektoratit të vet nga zoti Adem Hajdaraj. Prandaj, ne si grup parlamentar e mbështesim ligjin që i futë të gjitha kategoritë e jo ligjin që i ndanë kategorisë e luftës, sepse të gjithë ata që kanë luftuar për Kosovën ata e meritojnë të trajtohen njësoj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Grupit Parlamentar “7+”, kush e do fjalën? Numan Baliq. Okej, ka folur deputeti Sadik Idriz.

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk ka të paraqitur.

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, fjalën e ka deputeti Numan Baliq.

NUMAN BALIQ: Ju faleminderit, zotëri kryetar i Kuvendit!

Po ashtu, faleminderit edhe parafolësit të Kryesisë që i ka ngatërruar grupet parlamentare.

Dopustite mi najpre da selamim sve prisutne u sali, da kažem nekoliko riječi o ovoj vrlo važnoj temi. Nazvao bih je jednom od vrućih tema ili važnih tema koja preokupira ukupnu kosovsku javnost, sve političke partije, mnoge javne delatnike ali i sve zajednice koje žive na Kosovu, jer sva ona pitanja koja se tiču rata i mira su uvek konfliktuoza pitanja, izazivaju i pažnju ali i mimoilaženje onih koji se njime bave.

Ono što bih na početku istakao, jeste slaganje sa nekoliko prethodnika da je ovaj zakon trebao biti donijet mnogo ranije i da je to bila obaveza počev od prvog parlamenta koji je ustanovljen posle rata, a onda i svih narednih i da je zaista veliko kašnjenje, da zaista puno kasnimo u donošenju ovog zakona. Ali sada se nalazimo tu gde jesmo i u prilici smo da napravimo jedan zakon koji se tiče nekoliko kategorija koja su zastupljena u njemu, znači najprije boraca, naravno prije svega se misli na borce UČK, odnosno Oslobođilačke vojske Kosova, zatim invalide, veterane, potom civilne žrtve rata, stradale i posebno nestale osobe. Radi se o mnogo kategorija, radi se o mnogo kategorija i sve su ove kategorije važne. Osobno pripadam, to želim da istaknem sada ovde, osobno pripadam onima koji apsolutnu prednost daju onima koji su se borili i nikada nisu jednaki oni koji se bore sa puškom u ruci sa onima koji se ne bore ili koji samo pričaju, ili to rade na neke druge načine, pokušavaju da kažu da je to isto. To naravno nikada nije isto i ne može biti isto. Ali, naravno da svaka kategorija treba imati svoje mjesto i ne treba biti predimenzionirana bilo koja kategorija. Mislim da se u ovom zakonu suviše prostora daje svim onim pravima koja se tiču OVK u odnosu na druge kategorije i da je trebalo posvetiti mnogo veću pažnju zato što postoje neke kategorije, kao

što smo čuli, postoje politička neslaganja vezano za borce, vezano za žrtve. Ovo je pitanje koje traje istorijski najmanje 100. ili 150. godina, ali ako se odnosi na žive zainteresovane, ono se odnosi najviše na zadnju kategoriju od zadnjih nekoliko desetina godina.

Dakle, mi smo imali ljude koji su se borili 80-tih godina, i stradali, i oni su stradali takođe, počev od prvih demonstracija koje su bile, koje smo mi podržavali, zatim 90-tih godina, kada su osnovane partije, organizacije, sindikati, udruženja žena, mnoge organizacije, kada je takođe bilo mnogo ljudi koji su stradali, ne samo ubijani, nego na razne načine, izdržavali zatvorske kazne, pretučeni, premlaćivani, koji su uzeli učešće na mnogo načine. Naravno, i moja SDA je tu učestvovala, s obzirom malo sam ponukan time što je prethodnik pomenuo Vitimiricu. Dakle, ne može se tako lako presjeći i reći koliko je ko apsolutno zaslužen u čemu, ali ne mora biti cilj da obuhvatimo sve kategorije koje su uključene u ovo i da svaka od tih kategorija, dobije pravedan tretman.

Ono pitanje koje bih posebno obratio ovde, jeste pitanje nestalih osoba. Mislim da nestale osobe nisu dovoljno tretirane u ovom zakonu. Ovo je pitanje koje se provlači najmanje 11. godina iza rata. Osobno sam bio uključen u pitanje nestalih. Odmah iza rata je bilo oko 4.200 nestalih osoba, znači to je 4.000 familija. Danas imamo 1.800 familija, i molim vas, ne radi se samo o tome da su familije iz redova nestalih većinske zajednice, nego su u pitanju sve zajednice koje su tu nalaze, i Bošnjaci, i Romi, i Aškalije, i Srbi i svi, to su sve građani Kosova.

Dakle, ovaj zakon mora naći načina da nađe odgovor na zastupljenost i prava svih kategorija, bez obzira dali su borci OVK koji, ponavljam, imaju posebno mjesto, ali ne jedino i isključivo, nego mora naći načina da nagradi i da da beneficije koje se ovde spominju, jer su mnoge beneficije za one koji su stradali u raznim periodima, u 80-tim, 90-tim, u toku rata, posle rata. Moramo imati na umu da je jedan broj ubijenih, posebno među drugim zajednicama, i nestalih, je u zadnjim danima rata ili u prvim danima poslije rata, u periodu kada je trajalo bezvlašće. Radi se o stotinama ljudi i oni moraju biti briga ovoga zakona ili trebamo napraviti neki poseban zakon. Oprostite, ima stotina familija koje su krajem rata ili nakon oslobođenja Kosova nestali i nema ih, ili su ubijeni. Oni moraju biti briga ovoga zakona i njima se moraju omogućiti jednake beneficije, povlastice koje imaju i ovi koji su pobrojani. Napominjem da su te beneficije vrlo važne, da se tiču zdravlja, da se tiču znači liječenja, tiču se škola, stipendija, školovanja na svim nivoima, tiču se penzija i raznih drugih plaćenih povlastica, odnosno primanja, zatim stanova i drugih stambenih povlastica, potom carina, poreza, uvoza i mnoge druge beneficije koje se spominju u zakonu.

Napominjem da smo mi voljni kao Grupa za integraciju, govorim u ime zato što mislim da jesmo i smatramo sebe pravom multietničkom grupacijom, koja je zainteresovana za sve zajednice. Mislim da oni nisu dovoljno obuhvaćeni u ovome i da ovaj zakon mora obuhvatiti pored onog najznačajnijeg dela koji jeste obuhvatljiv i koji je veoma dobar, koji se tiče OVK i koji mi potpuno podržavamo, ali druge kategorije stradalih, nestalih žrtava na bilo koji način i u bilo u kojim periodima, moraju biti obuhvaćeni u ovom zakonu ako on hoće imati našu podršku. U ovom momentu nema našu podršku, da budem veoma jasan. I na kraju ću citirati član 1. ovo se odnosi posebno na onoga koji pravi ovaj zakon. S obzirom da po pravilu i dalje imamo loš prevod na srpsko-hrvatskom, odnosno bosanskom, ja ću pročitati član 1. na albanskom i on kaže ovako: „Qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji është përcaktimi i statusit dhe përkrahja financiare përmes pensioneve dhe beneficioneve të veçanta për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, të cilat me sakrificën dhe kontributin e tyre ishin faktorë vendimtarë për lirinë dhe çlirimin e vendit”.

Moje pitanje koje će postaviti svaki građanin Kosova, ako se ova konstatacija odnosi samo na faktore unutar Kosova, onda je ona tačna, ali ako se odnosi na ukupan proces oslobođenja Kosova,

ona nije tačna, jednostavno ne stoji tako. Istina je da su odlučujuću ulogu imali avioni Američki i NATO-a i njegovih saveznika, a da su tek potom Oslobođilačka vojska i svi mi koji smo se na razne načine borili, neki sa puškom a neki sa jezikom ili na neki drugi način ili koji smo stradali, prebijani, bili u zatvorima, takođe imali svoj doprinos. Hvala vam lijepa! Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Ne e përfunduar me shefat e grupeve parlamentare. Konsideroj që kemi nevojë për pauzën e drekës dhe fillojmë në orën 14:30, nëse jeni dakord.

Vazhdimi i punës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë debatin. Tani është radha e deputetëve. Fjalën e ka kërkuar deputetja Melihate Tërmkollli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Ju faleminderit, të nderuar deputetë!

Ne e dimë që edhe më herët janë bërë përpjekje që këto çështje që janë të parapara me këtë projektligj të rregullohen, mirëpo dyshoj që edhe me këtë ligj do të rregullohen këto çështje ashtu siç meritojnë këto kategori për sakrificën e tyre të madhe që e kanë bërë dhe sigurisht meritojnë më mirë se që është paraparë.

Në fakt, unë do të bëjë një pyetje në dy pjesë që do t'i drejtohet Qeverisë. Unë e shtroj pyetjen për Qeverinë, më saktësisht e shtroj pyetjen për koalicionin qeveritar se me cilin ligj do të rregullohet statusi i shumë atdhetarëve dhe familjeve të tyre të cilët u vranë prej vitit '91 deri '98? Kjo periudhë është fshirë nga ky ligj dhe sikur në këtë periudhë nuk ka ndodhur asgjë në këtë vend, madje sikur është vendosur vendi ynë diku tjetër në Hënë apo në Mars, e nuk mbaj në mend që ka pasur zhvendosje të tilla, na kemi qenë këtu, populli ka qenë këtu edhe ata që kanë punuar, kanë luftuar për këtë vend, kanë qenë këtu. Ndoshta nuk ka pasur anëtar të Qeverisë që janë angazhuar në atë kohë, por kjo nuk ndryshon situatën.

E tha zëvendëskryeministri që ky ligj nuk ka për qëllim t'i ndaj dëshmorët, në fakt janë bërë ndarje jashtëzakonisht të mëdha. Pjesa tjetër e pyetjes të cilën ia parashtroj koalicionit qeveritar PDK-LDK, ka të bëjë me statusin e atdhetarëve dhe të atyre që janë vrarë pas vitit 1999, ata njerëz janë atdhetarë të mëdhenj që kanë qenë në pozita të larta, nuk janë vrarë duke i ruajtur dhentë, por janë vrarë si atdhetarë, as që kanë qenë në bela me dikë.

Xhemajl Mustafa, ka qenë këshilltar i lartë politik i presidentit Rugova; Shaban Manaj, kryetar shumëvjeçar i degës së LDK-së në Istog; Ukë Bytyçi, kryetar i Kuvendit të Suharekës; Ismet Raci, kryetar i Kuvendit të Klinës; Smail Hajdaraj, deputet i këtij Parlamenti të Kosovës. Le që nuk u bë asgjë për t'u zbuluar vrasësit e tyre, por ata tash po përjashtohen edhe nga çdo përkujdesje institucionale. Sa i përket Qeverisë, hipokrizinë është mirë ta lë anash, në këtë Qeveri është edhe LDK-ja, janë edhe ministra të LDK-së, madje është edhe Bujar Bukoshi dhe unë nuk kam dëgjuar që dikush të ketë reaguuar në këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, që në fillim duhet të them diçka që unë e kam pritur një ligj më të dobët për ta trajtuar këtë çështje shumë të domosdoshme. Fillimisht më vjen mirë që më në fund institucionet e Kosovës kanë marrë për obligim ta trajtojnë dhe t'ia japin vendin e merituar Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Unë kam dy- tri vërejtje të vogla, që mendoj se janë të vogla, them janë të vogla, por janë shumë domethënëse për shkak se, nëse ligjet lihen me këso zbrazëtira, mendoj se në të ardhmen ata që i interpretojnë ligjet pastaj interpretojnë sipas shijeve.

Në fakt, edhe zotëri Buja foli për një temë, por jo shumë në detale dhe te neni 12, domethënë kur folët për veteranët e luftës, lufta ka pasur përmasa të jashtëzakonshme dhe përmasat e luftës, me këtë ligj nuk janë trajtuar në detale. E them për një kategori që në asnjë formë nuk është përmendur, unë para se të futëm në luftë edhe gjatë luftës, por veçanërisht pas luftës ne kemi qenë të vetëdijshëm se lufta do të lë pasoja. Në foto është një kategori e djemve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që pas luftës, për shkak të traumave dhe situatave të rënda që kanë kaluar në luftë, domethënë me dhjetëra prej tyre dhe kanë bërë vetëvrasje, që sot nuk janë në gjendje të dëshmojnë domethënë që kanë qenë veteranë dhe unë mendoj që, bile së paku familjarët e ngushtë të tyre, duhet ta kenë një trajtim për shkak të kaluarës së tyre edhe kontributit të tyre në luftë.

Gjithashtu mendoj se është edhe një kategori e pa përfshirë, domethënë në këtë ligj, njerëzit të cilët kanë qenë hallka kryesore e mbështetjes së luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Unë do ta përmend një emër që do të jetë nderë për mua dhe për të gjithë qytetarët e Kosovës, si do të trajtohet Jashar Salihu në këtë rast me këtë ligj, kur e dimë, domethënë e përmenda si emër për me e simbolizuar atë kategori, domethënë që e ka mbështetur luftën.

Gjithsesi, unë mendoj se neni 13 kur flitet për viktimat e luftës dhe neni 14 për invaliditet civilë të luftës, mendoj që të shtohet edhe një pasus “nga okupatori”. E them këtë, sepse në fakt ne e dimë se lufta ka pasur dy palë dhe në luftë janë vrarë edhe shumë paramilitarë serbë që pas luftës janë shpallur si viktimat civile. Në fakt unë dua ta banalizoj, por ta marrë një shembull nga Lufta e Dytë Botërore, kur kanë filluar partizanët edhe ata që kanë qenë me fashizmin të marrin pensione dhe në një takim krejt të rastësishëm, domethënë e pyet ai partizani: Kah ti? Po thotë: ”Po mos të isha unë, ju nuk ishit veteranë”. Unë nuk po dua ta sjellë këtë situatë në këto rrethana. Të flasësh, domethënë për këtë ligj, është nderë edhe ta mbështetësh është edhe ma nderë, por gjithsesi nuk mund të jesh indiferent ndaj disa fjalimeve që u dëgjuan, veçanërisht të Grupit Parlamentar të LDK-së. Unë zotin Ademaj që foli në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, nuk e kuptova, në fakt ky ligji, domethënë trajton dhe është i përcaktuar për ata që jon kon nën emblemën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ne jemi dëshmitarë të zhvillimeve, domethënë gjatë luftës dhe para luftës dhe ka pasur fraksione nga më të ndryshmet. Në fakt edhe fraksionet që kanë vepruar jashtë Kosovës për Kosovën, me deklaratat siç është një nga deklaratat e pas shpërthimit të luftës e zotëri Bukoshit për forcat e armatosura, forcat e armatosura që asnjëherë nuk kanë qenë në Kosovë, por edhe ato që ka në qenë, kanë qenë nën emblemën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe për vetë faktin që kanë qenë nën emblemën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ky ligj i ka parasysh. Prandaj, unë po mendoj se mos të krijojmë klima politike që politikën rreth luftës ta sjellin në pikën zero ose në gjendjen e vitit '99-2000 e cila gjithsesi ka qenë me pasoja të jashtëzakonshme dhe ne po mendojmë se jemi në një moment ku duhet të mendojmë me gjakftohtësi, sepse kjo klimë që ka tendencë të krijohet 10 vjet pas luftës, 12 vjet faktikisht i ka kushtuar dikujt dhe ne e dimë domethënë se shumë luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për shkak të ndërskamcave politike, kanë vuajtur vite të tëra nëpër burgje nën regjimin e UNMIK-ut dhe në fund, faktikisht domethënë gjykata i ka thënë, na falë se nuk ka gjë.

Unë i përmenda këto gjëra duke kërkuar nga të gjithë që rreth luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të jemi unik. Ne e dimë që ky ligj nuk mund të jetë i përkryer, mund të ketë edhe,

domethënë lëshime, mirëpo gjithsesi mekanizmat të cilat do të punojnë, veçanërisht komisionet parlamentare thjesht edhe shqetësimet që ngritën këtu, t'i trajtojnë edhe ky ligj më në fund të aprovohet dhe sigurisht duke u aprovuar ky ligj, domethënë do t'i jepet edhe një vlerësim nga Parlamenti luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputeti Shkumbin Demalijaj, le të përgatitet Armend Zemaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Sot po e shqyrtojmë këtë plotësim - ndryshim të ligjit, u tha edhe më herët, por me një konotacion krejt ndryshe, më të afirmuar nga i kaluari, sepse nuk iu ka dhënë respekti luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës më herët për shkak se Kosova ka qenë nën protektoratin ndërkombëtar dhe kryesisht është dashur të jetë vlerësimi më i madh për këto kategori, kanë ndodhur që ato, nuk është quajtur lufta e armatosur e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por është quajtur konflikt i armatosur, gjëja që të gjithë ata që e kanë ndier vetën brenda një mekanizmi që ka ndikuar edhe ka ardhur sot deri te themeli i ndërtimit të pavarësisë dhe shtetit të Kosovës, kanë qenë ndier jashtëzakonisht shumë keq lidhur me atë çështje.

Sot po e shqyrtojmë këtë projektligj, projektligji duhet të marrë rrugë edhe të vazhdojë me aprovimin edhe gjatë shqyrtimit në komisionet e mëtutjeshme. Më vjen shumë keq se është viti i tretë pas pavarësisë së Kosovës dhe për këto kategori Qeveria apo as presidenti i Republikës së Kosovës nuk ka qenë në gjendje asnjë familje të dëshmorit apo invalidit të luftës apo diçka t'ia ofrojë, bile një mirënjohje me rastin e përvjetorit të shpalljes së pavarësisë, që nuk do të kishte kushtuar shumë. Është një letër nga Qeveria e shtetit të pavarur të tyre deri me tash, por kanë hartuar raporte tjera që kanë kushtuar ndoshta edhe me qindra - mijëra euro për t'u dukur një raport i ilustruar më mirë në fotografi. Këtë asnjë nga familjet e dëshmorëve nuk e posedojnë. Kemi pasur rastin kur janë dekoruar njerëz për merita të jashtëzakonshme në luftë...por neve si shoqëri nuk e kemi parë ata në proceset e luftës edhe besoj se ky ligj duhet ta përfshijë edhe anën e dekorimit për çështjen madhore që ka qenë lufta e UÇK-së edhe të trajtohen mirë, ndoshta ndonjëherë edhe ta tërheqim ndonjë dekoratë për shkak se po shkelet gjaku i atyre që me vullnetin dhe sakrificën e tyre më të madhe bënë për lirinë e Kosovës. Do të thotë, gjithmonë shikuar në këndvështrimin politik, neve është duke na kushtuar. Ne, brenda këtij ligji, kemi të gjitha kategoritë, të gjithë ata që e kanë dashur luftën, askund nuk shkruan se dikush dikën nuk e ka lënë për të ardhur në luftë, ose nuk besoj që dikush, po nganjëherë edhe vetë themeluesit e mekanizmit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e kanë lënë gjithë këtë makineri të njerëzve, por edhe ata që kanë në prapavijë për shkak të interesave të tyre politike për të fituar ndonjë votë.

Kur flasim për luftën, mendoj se duhet të flasim për luftën, ku flasim për politikën, ne kemi programet tona politike që duhet të dalim para qytetarit për ta organizuar një jetë më të begatshme të saj. Kështu që u tha më herët se kemi pasur formacione të ndryshme të organizimit brenda luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Më vjen shumë keq, ne nuk jemi as aq shumë të rinj, por aq shumë të vjetër sepse një diçka e tillë ka ndodhur më herët.

Unë për dhjetë vjet pothuaj se nuk them dhjetë vjet, por gjashtë vjet, në familjen time kam pasur në sirtarin më të lartë Kushtetutën e Republikës së Kosovës- 7 shtatorin, që sot është 20 vjetori i themelimit të saj. Por askund brenda, asnjë amendamenti apo asnjë dispozite të asaj Kushtetute, nuk ka pasur të shkruar se ekziston Ministria e Mbrojtjes me Kushtetutë edhe në mënyrë institucionale e organizuar. Dihet fillimisht me 7 shtator, si është bërë kërkesa, mirëpo në këtë rast, kur themi te Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, besoj se askush nuk ka qenë i përjashtuar të jetë pjesët e tij. Këtë në konotacion historik duhet ta dëshmojnë të gjithë ata që i

kanë pri këtij mekanizmi e jo të merremi në ulëset e parlamentit për të dëshmuar se kush ka qenë më i zoti.

Data 31 janar i vitit 1991, besoj se duhet të ndryshohet. Njerëz ka pasur të organizuar me dekada të ndryshme, por kanë qenë edhe të armatosur për t'u mbrojtur nga pushtuesi serb. Mirëpo, besoj se data më e kapshme, është data e daljes publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, më 28 nëntor të vitit 1997 në Llaushë, jo në Prekaz, por është pikërisht në fshatin e zotit Geci, dalja e parë publike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku të gjithë qytetarët edhe rinia kosovare u mëshiruan me një realitet të ri që ndodhi në Kosovë edhe u rreshtuan pas Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të arritur deri këtu ku jemi sot.

Unë, besoj se çdo ndarje politike në mes të asaj apo të kësaj, sepse edhe vetë vizioni ne Presidentit Rugova, janë duke e shkelur njerëzit që i la ai pas, sepse zotëri Rugova ka qenë i përcaktuar në politikë paqësore e jo në politikë ushtarake. E dimë mirëfilli, pozicionin politik të zotit Rugova si President i Republikës, ndërkaq në konotacionin tjetër, organizimet individuale edhe të papërshtatshëm nuk besoj se ku do të na qojnë. Unë mendoj se në natyrën institucionale, meqë jemi të vendosët për ligj, nuk jemi duke vendosur për çështjet e interesit individual se kush do ta mund tjetrin me deklaratë që e ka lexuar 2000-n në gazetë.

Unë mendoj se lufta për çlirim i ka obliguar të gjithë dhe askush kurrkujt nuk mund t'ia mohojë, por as t'i japë më shumë, por aq sa ka bërë. Ju faleminderit, zoti kryetar! Ligjin do ta votoj.

KRYETARI: Ju kisha lutur, se prej fillimit po dilet jashtë temës, jashtë rendit të ditës. Unë kërkoj nga secili deputet që të jetë në rend të ditës. Në rend dite kemi, po e lexoj, po ua përkujtoj.

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

Ky është rendi i ditës që e kemi sot dhe po kërkojë që secili t'i përmbahet këtij rendi të ditës. Replikë ka kërkuar Gani Geci.

GANI GECI: Ju faleminderit, kryetar!

Është shumë e vërtetë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka dal në skenë më 28 nëntor të vitit 2007, në fshatin tim, në fshatin Llaushë dhe atë me aprovimin e vëllezërve Geci dhe të atyre që kanë qenë aty, por është shumë e vërtetë se lufta ka filluar më 31 dhjetor dhe ka filluar në Prekaz dhe nuk ka filluar në Llaushë. Prandaj, ne duhet ta lëmë datën ajo që është, sepse data është ajo që është, por Ushtria Çlirimtare e Kosovës, është formuar në vitin '94 dhe çfarë veteranësh kanë qenë ata të '91-tesh, këtu është problemi. Dhe, nëse ushtria është formuar në vitin '94, Shtabi ka bërë komunikata në të 94-tën, dhe lufta ka filluar dhe është derdhur gjak pas kashtës së komandantit legjendar Adem Jashari, atëherë aty ka filluar lufta, atëherë ka filluar derdhja e gjakut dhe nuk është ajo data në pyetje, është problemi që ata në ushtrime ushtarake kanë shkuar me urdhrin e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës. Ky është realiteti dhe nuk mundet kurrkush për ta ndryshuar dhe ju, zoti Krasniqi, e dini shumë mirë mbas asaj lufte, Adem Jashari ka ndejë 3 javë te ju. Gani Koci e ka pru. Ky është realiteti, ne nuk mundem ta ndryshojmë këtë...

KRYETARI: Po, histori nuk po bëjmë sot, o Gani!

GANI GECI: Jo, ne po bëjmë, sepse po shkruajmë data, si të shkruash data, ka histori. Në momentin që shkruajmë data, ka histori. Prandaj, zoti kryetar, këto janë realitete. Unë i kam shënuar,

sepse nuk mbaj shumë në mend, por i kam shënuar mirë. Prandaj, ju lutem, ne duhet t'i përfshijmë të gjitha kategoritë që kanë marrë pushkën për të luftuar kundër Serbisë. Edhe ata që kanë vrarë shqiptarë në emër të luftës kundër Serbisë, e kanë pasur gabim, sepse të gjithë ata që e kanë marrë pushkën për të luftuar kundër Serbisë, kanë luftuar kundër Serbisë...

KRYETARI: Po këtu dikush nuk ka të drejtë të flasë këtë që po thua tash.

GANI GECI: Është shumë e vërtetë që dikush nuk ka të drejtë të flasë. Edhe pajtohemi plotësisht edhe pajtohemi me atë që thotë zoti Ramë Buja, se ata që e kanë lënë pushkën e kanë ikur, e kanë emrin dezertorë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Armend Zemaj e ka fjalën. Pas Armend Zemajt, deputeti Jakup Krasniqi e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit shumë, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është e vërtetë që sot po e shqyrtojmë një ligj i cili është i rëndësishëm së veçantë dhe po kuptohet edhe nga debatet e kolegëve deputetë, por është kuptuar edhe që nga viti 1999 me çlirimin e Kosovës dhe duke marrë parasysh se kjo fushë është munduar apo ka qenë e rregulluar me një ligj, i cili ka qenë i mangët dhe jo i zbatueshëm, është menduar po ashtu dhe premtuar dhe çështja e rregullimit të statusit dhe të drejtave të kësaj kategorie, do të rregullohet në mënyrë sa më të aplikueshme, por edhe të drejtë e meritore.

Grupi punues në nivel qeveritar ka theksuar se janë konsultuar konventat e Gjenevës, si dhe Ligji kroat i luftës. E para, është me të drejtë, sepse ka të bëjë me të drejtat universale, të rregulluara sipas Konventave të miratuara në nivel ndërkombëtar, por kur të konsultohesh me ligje të gabuar, këtu ka edhe oficerë që kanë qenë të armatës dhe i njohin se si i rregullon çështjet ligji kroat i luftës, i marrë si matës, tregon kryekëput krijimin e monopolit mbi luftën çlirimtare, duke dhënë jo në mënyrë institucionale dhe gjithëpërfshirëse, por në shërbim të një krahu politik dhe në shërbim vetëm të një pjese që kanë kontribuar për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Për ta argumentuar këtë, do t'i marr dy-tri nene të këtij projektligji, sepse të tjerat i thanë edhe kolegët dhe do t'i thonë, që tregojnë edhe vërejtjen time që e dhashë më lart. Neni 3, të përkufizimet, që ka të bëjë me tërë tekstin dhe strukturën e që ndikon edhe në përmbajtjen, konsiston se nuk përfshihet Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, apo njësitë operative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të udhëhequra nga kjo ministri. Nëse dikush del i konteston apo i kundërshton, ne kemi argumente dhe dokumente të fuqishme që fatmirësisht ruhen nga njerëzit e gjallë, apo mbrojtja territoriale e Republikës së Kosovës, organizuar që nga viti 1991, njerëzit e burgosur të asaj kohe, njerëzit e emëruar të asaj kohe, që fatmirësisht nuk kanë vdekur në burgje të Serbisë, por kanë vdekur natyrshëm pas çlirimit të vendit. Nuk do të hyjë në emra, sepse i takon historisë, është e vërtetë, t'i elaboroj në mënyrën më të mirë.

E dyta, është dhe ka të bëjë me veteranët e Luftës së UÇK-së, është në njëjës. Nuk thuhet organizatat, nuk thuhet shoqatat, që domethënë sipas këtij projektligji nuk mund të jenë shoqata apo organizata tjera që janë organizim vullnetar si OJQ që mund të kenë qasje institucionale, po ashtu e lë në njëjës e që krijon kryekëput monopol mbi këto vlera, ku kemi shumë shembuj se si përdoren dhe për çfarë qëllime, të cilat tani nuk do t'i thosha.

Kjo, po ashtu lidhet edhe me paragrafët 1.10 dhe 1.11 dhe këtu është esenca, ndoshta që, ajo që i përjashton njerëzit që kanë kontribuar dhe jep kuptimin se mobilizimi dhe demobilizimi duhet të jenë të regjistruar vetëm nga shtabi i UÇK-së.

E dyta, te neni 15, njohja dhe rregullimi i statusit, lidhet shumë me këto të parat, por pika 7 ka të bëjë me komisionet.

Po të ishte kërkuar krijimi i një departamenti të luftës në kuadër të Ministrisë së Forcës së Sigurisë, që do të mbante dhe rregullonte statusin e veteranëve të luftës dhe me këtë mos të jenë organizuar vetëm nga shoqatat apo ministritë individuale dhe njerëz dhe mekanizma tjerë të përjashtohen, konkretisht i lihet hapësirë formimit të një komisioni qeveritar. Pra, me këtë përbërje që është paraqitur, prapëseprapë nuk është korrekt dhe është i njëanshëm e që mund të keqpërdoret apo mos t'u jepet të drejtë të gjithëve ashtu siç u takon. Ne dëshirojmë që të jetë e vërteta se legjitimiteti i kontributit të secilit, të jetë në formën e duhur, por si dhe në çfarë forme, si dhe nga kush duhet të jetë shumë mirë e përcaktuar në ligj.

Për fund, të nderuar kolegë deputetë, njohja e sakrificës dhe kontributi që i është dhënë komandantit legjendar Adem Jashari, i bën nder Kuvendit dhe institucioneve të Republikës së Kosovës, por historia do ta përmirësojë pasi të kuptojë të drejtën historike se Adem Jashari, Salih Çekaj dhe Zahir Pajaziti si themelues të parë të bërthamave të mbrojtjes çlirimtare që janë tri shtyllat kryesore të luftës së armatosur për çlirimi në Kosovës, janë një dhe të pandashëm dhe jam shumë i bindur se ne sot pa vullnetin e tyre po i ndajmë. Ju faleminderit!

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,

Unë do të përpiqem të flas mbi bazën e asaj që e ndiej dhe që konsideroj se secili nga ne e ka përgjegjësi. Në rend të parë kemi përgjegjësi kombëtare, në rend të dytë kemi përgjegjësi institucionale, kemi përgjegjësi edhe intelektuale dhe përgjegjësi njerëzore për të folur ashtu siç duhet të flasim dhe jo ashtu siç na tekton.

Ne e kemi në shqyrtim një projektligj që ky Kuvend e ka miratuar në një formë paksa më të kufizuar dhe tani është në një formë shumë më të zgjeruar, që personalisht unë do të isha që ky ligj të ndahej së paku në tri ligje, jo kështu siç na është ofruar. Pse po e them këtë? Jam i vetëdijshëm që Kosova, ne si qytetarë, mbi të gjitha buxheti i Republikës së Kosovës nuk mund t'i shpërblejë të gjithë njerëzit që kanë kontribuar që ne të jemi në këtë sallë dhe t'i përfaqësojmë qytetarët e Kosovës. Dhe, po të shkojmë sipas kësaj logjike, jam i bindur që brenda tri vjetëve dhe nuk to shkonin tri vjet, shteti i Kosovës do të bankrotonte.

Prandaj, ne duhet t'i themi vetvetes, duhet t'iu themi edhe të gjithë qytetarëve të Kosovës, nëse shpëtim i të gjithë atyre që kanë punuar për këtë Kosovë të lirë, nuk është liria e saj dhe mundësia që secili ta gjejë veten në mundësitë që janë krijuar financiarisht, kjo Qeveri dhe asnjë qeveri dhe në asnjë kohë nuk do të ketë mundësinë t'i financojë dhe t'i vlerësojë me të holla meritat dhe sakrificën e këtij populli që është bërë, jo nga viti 1945, por nga tetori, nëntori i vitit 1912 e këndeje. Dhe, shikuar nga kjo, si nganjëherë po flasim në këtu, ne duhet t'i fusim në njerëzit, në familjet, që duhet t'i vlerësojmë të gjithë qytetarët e Kosovës, pa përjashtim. Mendoj se ne si institucion duhet të kemi parasysh, obligimi i parë yni është të mendojmë për një jetë të dinjitetshme, jo për dëshmorët, se dëshmorët kanë shkuar, për familjet e tyre dhe fillimisht ne kemi obligim për dëshmorët e luftës së fundit në Kosovë.

Unë, në organizimin e lëvizjes kombëtare jam prej vitit '73 -'74. Kam qenë edhe në luftë, por nesër nëse vdes, unë nuk do të jem dëshmor i Kosovës. Është periudha e dëshmorit dhe përfundimi i

periudhës e koha që krijon dëshmorë dhe që këtë duhet ta kemi të gjithë parasysh, a është një periudhë e dëshmorëve të caktuar?

Ne kemi nevojë tash dhe do të duhej edhe kur e kemi miratuar ligjin e parë, unë kam qenë ai që jam angazhuar që të zgjidhim statusin fillimisht të familjeve të dëshmorëve. Duhet të jetë një ligj i veçantë për invalidët dhe veteranët e luftës çlirimtare. Duhet të jetë një ligj i veçantë për familjet që janë viktimë të luftës. Pastaj, ne duhet t'i kufizojmë edhe në hapësirë. Ne e dimë se nga '45-ta, deri '68-ten, deri '81 dhe deri në vitet '90 ka qenë një periudhë që ka prodhuar sakrifica, ka prodhuar flijime, ka prodhuar vështirësi dhe ata njerëz së paku normalisht kemi obligim me një ligj t'ua njohim angazhimet e tyre, sakrificën e tyre, mundimet që i kanë përjetuar. Kemi vitet '81, '90, '91, që është një periudhë tjetër 10 vjeçare, që ka prodhuar sakrifica të shumta, mbi 600 shekuj burg janë, pa numëruar sakrificat e tjera. 700.000 veta kanë kaluar në sigurimet e shtetit. Së paku ne kemi obligim t'i njohim këto sakrifica. Po a mundemi t'i paguajmë këto sakrifica me mjete financiare? Kurrë. Nuk mund t'ia shpaguajmë popullit tonë të gjitha ato sakrifica që i ka pasur.

Prandaj, ne duhet të shkojmë dhe t'i vlerësojmë cilët janë dëshmorët dhe familjet që duhet t'i ndihmojmë?

Tjetër, invalidët dhe veteranët e luftës. Unë do të flas për veteranët. Sigurisht që lufta jonë nuk ka vetëm veteranë të luftës. Ndoshta, ne duhet ta bëjmë një ligj për veteranët e lëvizjes kombëtare në Kosovë dhe ajo përfshin periudhë të gjerë të historisë. E keqja është që vërtet ne nuk kemi mundësi të krijojmë statistika të sakta për dëshmorët e luftës. Ne nuk kemi mundësi të krijojmë statistika të sakta për invalidët e luftës, aq më pak nga kjo që po flasim, kemi mundësi t'i përcaktojmë cilët janë veteranët e luftës? Por edhe veteranët e luftës duhet ndarë në kategori. Ju e dini se të gjitha luftërat kudo që janë zhvilluar, kanë qenë veteranët e një viti të themelimit, pastaj kanë ardhur duke u krijuar veteranë pas veterani. Jo të gjithë veteranët, që janë veteranë, e kanë filluar luftën në vitin 1991, apo '94, apo '96, apo '98, kemi veteranë edhe një muaj nëse ka qenë në luftë. Prandaj, nuk është lehtë ne ta krijojmë një rend pasi, në fund të fundit, ne jemi këtu për të krijuar një mirëqenie dhe për ta njohur moralisht, por kur ka mundësi edhe financiarisht, për ta shpërguar angazhimin dhe sakrificën e njerëzve. Këtë obligim e kemi, ne duhet të mendojmë për të gjithë, por vërtet ligji mban dispozita që Kosova e ka shumë vështirë t'i përmbushë ato.

Unë e di që unë nuk po flas të më duartrokisni as ju që jeni këtu, as ata që janë jashtë, por në listat e veteranëve të luftës ka më shumë veteranë se sa që ka pasur në të vërtetë dhe kjo është e saktë dhe s'mund ta mohojë kurrkush. Prandaj, nuk është lehtë, prandaj duhet të kemi parasysh, duam t'i shpërblejnë ata që kanë qenë në luftë, por nëse e zgjasim listën, ne nuk do ta shpërblejmë askënd. Ne, do të thotë, krejt angazhimi ynë është që, ose thotë veterani i luftës ose pjesëtari i luftës lirohet nga doganat dhe nga tatimet, atëherë kush duhet të paguajë dogana dhe tatime në këtë vend?

Nëse kjo qeveri i jep një shpërblim veteranit të luftës, të burgosurit politik a kujt do tjetër, ai do t'i kryejë obligimet e veta mbi bazën e asaj që e ka marrë. Prandaj, unë po dua të them dhe ne qytetarëve do t'ua themi drejt kështu siç është bërë ky ligj, e aq më pak kështu siç po flitet në këtë sallë, dikush mund të shpërblehet për sakrificën që e ka bërë. Ne e dimë që edhe disa që kanë qenë veteranë të luftës, edhe disa që nuk kanë qenë veteranë të luftës e janë veteranë të luftës, nuk ka nevojë për t'i liruar nga doganat, se nuk e kanë bash keq ose nuk e kemi bash keq. Edhe këtë duhet ta themi, prandaj qëllimi ynë është që ta vlerësojmë sakrificën ashtu siç ka qenë, do të thotë, të kufizohet me kohë, se fundi i fundit këta dëshmorë dhe këta invalidë dhe këta veteranë na sollën këtu ku jemi, natyrisht duke pasur mbështetjen e fuqishme edhe të komunitetit ndërkombëtar. Por, mos të shikojmë as ne që jemi këtu, as ata që janë, unë po ju them sinqerisht, unë për veti kam qenë i

angazhuar herët. Nuk kam luftuar për të pasur benificione pas lirisë ose në liri, nuk kam menduar në benificione. Unë jam i bindur që të gjithë dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk kanë menduar në benificione, benificion e kanë pasur çlirimin e Kosovës dhe Kosova e lirë ka krijuar benificione për të gjithë dhe të gjithë duhet t'i shfrytëzojmë. Dhe, jo tash në këtë sallë ne të shtyhem i kush është në listë, kush nuk është në listë. Për juve është, dihet ata që kanë rënë pas qershorit të vitit '99, nuk mund të jenë dëshmorë të luftës. Ata mund të jenë viktimë, mund të jenë njerëz që i janë dashur Kosovës, iu janë dashur familjeve të tyre, por viktimë, vrasje të ndryshme ka në gjithë botën, kanë ndodhur edhe në Kosovë dhe është një fatkeqësi që kanë ndodhur dhe është një fatkeqësi tjetër që nuk janë zbardhur ato vrasje që janë bërë.

Për t'u përgjigjur ata që kanë bërë ato dhe për t'u ditur pse janë bërë ato vrasje, pse jo gjithëherë janë bërë për qëllime më të mira të Kosovës? Prandaj, mendoj që ne duhet të krijojmë ose të kërkojmë krijimin e një komisioni që vërtet verifikon cilët janë dëshmorët e luftës, cilët janë invalidët e luftës, se kanë hyrë invalidë që nuk kanë qenë në luftë, e as nuk janë invalid të luftës, cilët janë veteranët dhe veteranët të ndahen në kategori.

Tjetër, duhet të ndahen edhe në dy- tri grupe, ndoshta, veteranët që vërtet kanë qenë veteranë një kohë më të gjatë, veteranët që kanë qenë një kohë më të shkurtër, por edhe veteranët që i kanë kontribuar luftës, por që Qeveria nuk ka obligim t'i paguajë ata, por e njëj moralisht kontributin e tyre në luftën çlirimtare. Kështu, mendoj që kemi mundësi që, në fund të fundit, dikujt moralisht t'ia njohim angazhimin dhe sakrificën që ka bërë për këtë vend që e kemi. Prandaj, edhe në herë po kërkoj që ne si Kuvend të angazhohemi për t'i zgjidhur problemet e njerëzve që kanë nevojë dhe kemi obligim t'ia ndryshojmë kualitetin e jetës. Por, po ju them sinqerisht si Kuvend, si Qeveri, jo vetëm tash, por edhe 10, 20 vjet nuk do të kemi mundësi materialisht nëse nuk e pranojmë si shpërblyer kryesor Kosovën e lirë, shtetin e lirë të Kosovës, pavarësinë e saj. Do të thotë, asnjë mundësi tjetër për t'i shpërguar sakrificat e njerëzve në këto momente nuk kemi dhe ne duhet t'iu themi njerëzve edhe një herë se po të shkojmë me këtë logjikë edhe si është hartuar ligji dhe me logjika që po flasim, po ju them, ky shtet nuk mund të jetë më shumë se 3 vjet, bile as 3 vjet jo.

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Deputeti Ibrahim Gashi e ka fjalën.

IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Zëvendëskryeministër, ministra të pranishëm,

Ne sot po diskutojmë një projektligj shumë të rëndësishëm për shtetin e Kosovës, sikundër edhe dje që diskutuam në parim Projektligjin për të burgosurit politik dhe sigurisht që një pjesë të madhe të asaj që do të quhej, në njëfarë mënyre këshillë rreth se si të sillemi ndaj këtyre ligjeve, pajtohem me fjalën e Kryetarit. Këto ligje nuk janë shty ndoshta pse nuk ka pasur kush t'i iniciojë edhe më herët, por gjithmonë ka pasur dron se janë vështirë të përballueshëm për buxhetin e kufizuar që ka shteti i ri i Kosovës dhe ndoshta ajo shqetësimi dhe droja se a do të mundemi me i përmbushur detyrimet tona karshi këtij ligji, mbetet edhe më tutje për të gjithë neve dhe është shumë keq nëse aprovojmë ligje dhe nuk arrijmë me i implementuar, me i zbatuar sepse me vetë faktin që e krijojmë ligjin, ngremë shpresat te kategoritë e caktuara dhe në njëfarë mënyre, me të drejtë ju krijojmë të drejtën që të kërkojnë prej shtetit për diçka që nuk do të thotë që në çdo rast është i mundshëm me e përmbushur.

Unë në parim e mbështes edhe kështu si është ky ligj, do me thënë por sigurisht që gjatë amendamentimit ka shumë çka që të korrigjohet, që të korrigjohet në kuptimin edhe për t'u bërë

edhe më e përballueshme kostoja financiare e tij edhe po e potencoj këtë sepse pash që janë disa shpenzime që nuk lidhen drejtpërdrejtë me aktoret që duhet në njëfarë mënyre të fitojnë benificione nga ky ligj, por shtrihet ajo, si me thënë e drejta e përfitimit material në një rreth më të gjerë familjar. Për shembull, shërimet jashtë vendit, ato kanë kosto të shtrenjtë dhe na e dimë sa i kushtojnë sot Republikës së Kosovës këto dhe, nëse e zgjerojmë listën e njerëzve që mund të përfitojnë në emër se kanë, domethënë e gëzojnë statusin e një familjeje të veteranit, më duket që është, dhe aq më tepër që nuk precizohet familja e ngushtë që dihet se çka nënkupton, por te familja janë lënë edhe do kategori që i përmendi një deputetë para folës, që duhet me u specifikuar sepse të gjitha tërheqin një kosto financiare.

Natyrisht që ky ligj, mendoj unë se duhet të ketë qasje si me thënë inkluzive, gjithëpërfshirëse, integruese dhe nuk guxon të krijojë dallime. Është mirë që përkufizimi për kategori të caktuara që lidhen me Luftën e fundit çlirimtare e cila dihet ekzaktesisht sa ka zgjatur dhe kur ka filluar, është mirë që të lidhen ekskluzivisht me atë luftë, sepse nuk mund të quhen as pjesëtar i luftës as veteran i luftës në një periudhë kur de jure së paku nga aktorë tjerë ndërkombëtar që merren me zhvillimet në Kosovë, nuk pranohet se ka pasur luftë para fitit '98 në Kosovë dhe ka pasur përpjekje të grupeve, por ato duhet me i specifikuar sepse, atëherë me siguri e krijojnë këtë problemin në njëfarë mënyre që po na del tash këtu se dikush ka qenë, me një fjalë luftë të organizuar nuk kemi pasur më herët dhe duhet, nëse domi me hyrë te kategoritë e caktuara më herët se data e fillimit të luftës që merret si datë zyrtare që u përmend këtu, atëherë duhet me gjet specifikën se si me i kategorizuar, sepse dihet mirëfilli kur ka filluar dhe kur ka përfunduar lufta.

Nëse shkojmë në nene veç e veç, unë i vërejta disa, për shembull te përkufizimet neni 3, pika 1.7 unë mendoj se nuk ka nevojë të jetë 1.7, por që të futet dëshmori i kombit edhe një kategori, që nënkupton se është fjala për veprimtarët që kanë kontribuar në çështjen kombëtare, do me thënë nga 9 maji i vitit '45, për çka po ashtu pajtohem se kjo datë duhet të shtyhet më herët. 9 maji, natyrisht nënkupton fundin e Luftës së Dytë botërore në Evropë, por në Kosovë, në fund të Luftës së Dytë Botërore kanë filluar në njëfarë mënyre abuzimet e mëdha tek çlirimtarët dhe në thonjëza që i dimë të gjithë, dhe është një luftë që ka, që dihet me datë të fillimit, dihet me aktivitete dhe dihet me bartës, përkatësisht protagonistë kryesor që u përmendën këtu të cilët nuk guxojmë me i privuar nga e drejta e përfshirjes në këtë kategori. Pra, bëhet fjalë për luftën që një kohë të gjatë për dike, ose dikush e ka quajtur me tendencë kundërrevolucion, por ajo ka qenë luftë çlirimtare për me e parandaluar instalimi në një diktaturë të re, ani pse e pasuksesshme.

Kam vërejtje te neni 6, pika 2 dhe 3, domethënë te shkallët, të këto lehtësirat. Sigurisht që duhet të kihet parasysh, sepse këto kanë kosto dhe u tha edhe këtu, por është pika 2.4, për shembull pak e ekstremizon, nëse thuhet invaliditeti të luftës të UÇK-së, me shkallë invaliditeti 100%, ai 100% është domethënë as nuk i vyen vetura as kurrgjë, domethënë nuk e kanë 100%, e kanë prej 81% dhe së pakut është dashur filluar prej asaj shkalle e jo 100% se 100% është maksimumi.

Te neni 12, të drejtat e veteranëve është një diçka që ndoshta, nëse hyjmë, në njëfarë mënyre të krijojmë bazë për kompensim material të kategorive të caktuara, një kategori po na del shumë, për shembull thuhet se baza e pensionit personal të luftës për veteranët, është 80% e pagës minimale. Kjo, dhe kur t'ia shtosh kësaj se është 40% për ata që punojnë, është më mirë disi për ta rregulluar për këta që nuk punojnë, në mënyrë që të jetë më e lartë sepse është tepër nënçmuese nëse jepet 90 euro një veterani të luftës, ajo është në fakt, unë e kuptoj, por diku tjetër duhet bërë reduktimet financiare e shpenzimeve të këtij ligji e jo këtu, sepse këtu është dinjiteti i një veterani të luftës, nëse ia le me 80 euro, ai atë tretman e ka në një shoqëri të ekonomisë të tregut, njerëzit trajtohen sipas xhepit dhe ne po e shohim këtë përditë.

E kam edhe një vërejtje, mendoj te neni 15, njohja dhe rregullimi i statusit. Mendoj se ky ligj do të duhej që ta rregullonte njohjen e statusit dhe jo Komisioni Qeveritar. Komisioni mund të bëjë verifikimin në statusit mbi bazën e këtij ligji, por jo edhe njohjen, sepse me vetë faktin që i lihet një komisioni me e bë njohjen, atëherë në njëfarë mënyre nuk krijohen mundësi, domethënë për, si të them për vërejtje që se ka pasur përcaktim subjektiv për dike, dikujt i është mohuar, dikujt i është mundësuar ajo. Dhe e njëjta në njëfarë mënyre edhe te këto aktet nënligjore që rekomandohen për zbatim të këtij ligji, thotë se Qeveria nxjerr rregullore për përcaktimin e kushteve, të kriterëve dhe procedurat për njohjen e statusit të dëshmorit të kombit. Mendoj që ky ligj në parim, duhet ta përcaktojë statusin e pastaj janë çështje të drejtave që mund t'i realizojë ai mbi bazën e statusit, por jo statusin t'ia përkufizojë një akt nënligjor i cili nxirret jashtë këtij Parlamenti.

Sigurisht që edhe njëherë, domethënë, me sugjerimin shumë të sinqertë dhe qëllimshëm, është mirë shumë që ka ardhur ky ligj, por ky ligj duhet t'i nënshtrohet një përshtatje për ta bërë të përballueshëm për mundësitë që i ka Kosova, në mënyrë që edhe për ta bërë njëfarë mënyre gjithëpërfshirës. E tash mbetet obligim i komisioneve, mbetet obligim ynë në leximin e dytë edhe në ndërkohë të kontribuojmë me propozim amendamente që kishin me e bërë këtë ligj edhe të dinjitetshëm po edhe të aplikueshëm, në mënyrë që t'i përmbushë një obligim institucional dhe shtetëror që ka Kosova ndaj kategorive që i përfshinë ky ligj edhe që janë natyrisht shumë kontribuuese për këtë që e kemi sot. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Ministra,
Kolegë deputetë dhe të pranishëm,
Përsëritet ardhjen në Kuvend të Projektligjit të shumëpritur për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre.

Gjithë kemi kërkuar që të vijë sa më shpejtë që të jetë e mundur për shqyrtim, varësisht prej këndvështrimit, janë duke u dhënë vlerësime edhe gjatë kësaj seance edhe më herët. Pavarësisht vërejtjet që mund t'i kemi, marrë në tërësi me plotësime projektligji e ka materien e duhur, ka nevojë për amendamente si çdo ligj tjetër dhe ato me siguri do të bëhen në procedurën e mëtejshme. Parimisht, ata që përfshihen në këtë ligj, duhet të trajtohen me përkushtim dhe dinjitet. Padyshim do të mbahet edhe dëgjimi publik lidhur me këtë ligj dhe të gjithë të interesuarit do ta kenë rastin që të japin mendimet dhe amendamentet e tyre.

Përkufizimi i drejtë çka quajmë veteranë dhe siç u tha këtu me të drejtë kategorizimi i tyre, çka pjesëmarrës i luftës, definimi i drejtë i datave në pajtim me këto përkufizime, do të mundësonte trajtim dinjitoz të veteranëve dhe njëherit ligji do të bëhej i përballueshëm për buxhetin e Kosovës. Në projektligj janë paraparë krijimi i trupave të nevojshëm si dhe nxjerrja e akteve të domosdoshme për zbatimin në këtij ligji, sikurse që janë paraparë edhe që është paraparë gjobitje, që me siguri do të rregullohet në mënyrën e duhur.

Të nderuar kolegë deputetë,
Ju thërras që ta votojmë Projektligjin në parim dhe të punojmë të gjithë konkretisht edhe me shkrim, ta ndihmojmë komisionin përkatës të Kuvendit të Kosovës që ligjin t bëmë sa më të mirë.

Për ato çështje që mbërrihet konsensus, të votojmë dhe ta nxjerrim me kohë në lexim të dytë dhe në implementim ashtu siç është paraparë nga 1 janari 2011, përkatësisht nga 1 janari 2014 për disa kategori që parasheh ky ligj.

Nuk ka asnjë kuptim që pas aq kohe që e kemi kërkuar këtë ligj ta kthejmë në ripunim. Kjo do të merrte kohë sado që mund të thuhet se do të kthehet shpejtë, ne e dimë praktikën sa shpejtë kthehen kur refuzohen. Njerëzit janë duke pritur që ligji të bëhet dhe të fillojë zbatimin. Nuk mund të pretendohet se ligji është perfekt siç u tha edhe këtu, por ky ligj është bashkues, nuk është ndarës. Të gjithë ata që kanë qenë në UÇK, pavarësisht orientimit politik të ardhur nga poshtë apo nga lart, të gjithë kanë pasur emblemën e UÇK-së, emrin e UÇK-së dhe të gjithë ata që kanë luftuar me emër dh emblemën e saj, kanë qenë të radhitur, shumë mirë dihet në zonat operative dhe në brigadat e njësitë ushtarake, njësi logjistike, në njësi financiare, në përfaqësim politik dhe nuk ka nevojë për kurrfarë shqetësimi se do të mbetet dikush që e meriton jashtë ligjit.

Nëse mendohet se nuk është përfshirë ndonjë kategori, për ata bëhen amendamente konkrete dhe t'i propozojmë komisioneve përkatëse funksionale të Kuvendit, por jo edhe kur ka mundësi të përmirësohet, ta rikthejmë. Me siguri që lufta çlirimtare e UÇK-së, si çdo luftë tjetër e ka historinë e vet. Nuk ka nevojë për brengosje siç po dëgjohet këtu, sepse lufta çlirimtare i ka gjurmët e veta dhe gjithashtu është monitoruar shumëfish dhe çdo gjë dihet dhe do të dihet saktë, por ne jemi ligjvënës dhe e kemi për detyrë jo qasjen historike, por qasjen ligjore në mënyrë që ligjin ta bëjmë sa më mirë dhe sa më parë që të jetë e mundur.

Unë i kam plotësimet e mija, vërejtjet e mija konkrete të bëra në formë amendamentesh, nuk ka nevojë të lexohen këtu, sepse nuk mjafton koha, por do t'i paraqesë në Komisionin përkatës. Ja këtu e kam materialin. E disa prej vërejtjeve edhe u thanë këtu. Ju ftoj edhe një herë që të jemi sikurse dje se është e njëjta kategori si e djeshmit, por edhe shumë më e dhimbshme që të bëhet ligji dhe pastaj të punojmë së bashku. Më mirë është të punojmë së bashku se sa forma që të debatohet pa u bërë këto. Ju faleminderit!

KRYETARI: Naser Rugova e ka fjalën, le të përgatitet Xhavit Haliti.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Vërtet sot në Parlamentin e Republikës së Kosovës po shqyrtohet një projektligj i rëndësishëm, i cili deshëm, nuk deshëm në vete ngërthen edhe një pjesë të historisë shumë të rëndësishme të vendit dhe të popullit tonë, gjithnjë në kuptimin më pozitiv. Qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji duhet të na ofroj, duhet të krijojmë konsensus dhe duhet ta kemi një qëllim të njëjtë, pa marrë parasysh ndarjet konceptuale cilat do të kenë qenë ato. Luftëtarët e lirisë nuk janë ndarë, ata kanë luftuar për një qëllim dhe janë flijuar për një qëllim për ato ideale dhe për lirinë dhe pavarësinë që e gëzojmë sot.

Ligji është gjithëpërfshirës, e thatë edhe ju me të drejtë mbase kanë mundur të nxirren edhe nja dy apo tri ligje tjera dhe deshëm s'deshëm nganjëherë ka edhe konfuzion edhe në kohë edhe në data edhe në limite kohore, por ka edhe probleme financiare dhe vështirësitë e përmbushjes së atyre kërkesave dhe zbatimit të drejtë dhe praktik të këtij projektligji. Nuk ka një bazë të dhënave zyrtare, nuk ka një kategorizim të këtyre kategorive të dala nga lufta, por edhe rezistenca dhe sakrificat e përgjithshme. Por, duhet thënë edhe një gjë, në këtë projektligj unë i kam vërejtjet e mia edhe në data, por vërtet duhet të punojmë bashkë dhe me konsensus dhe që në vitin e 11-të në prag të vitit 12-të në liri, vërtet të veprojmë si Parlament i shtetit të pavarur me një logjikë shtetërore dhe nacionale dhe mos të krijojmë ndasi. Këtu u hapën disa tema dhe po shihet që gjatë punës së

mëtuftjeshme në këtë projektligj, nevojitet konsensus politik i të gjitha grupeve politike. Dëshëm, nuk dëshëm, dikush tenton të mohojë njërin koncept, dikush konceptin tjetër.

Është e vërtetë që nga vitit 1991, ka pasur veprime luftarake, përpjekje për lirinë e Kosovës, po është edhe një e vërtetë e pastër si loti dhe ato nuk mund ta kontestojë askush, që nga viti 1991, kur ne e kemi shpallur një republikë dhe sot është 7 shtatori dhe është keq që kurrkush në këtë Parlament në prag të fillimit të seancës nuk i tha nja dy fjalë për atë ditë të rëndësishme, ka pasur një Ministri të Mbrotjtjes dhe institucione relevante të Republikës së Kosovës që janë marrë me ato çështje. Që të dy këto koncepte janë unifikuar nën një emblemë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe, tani është koha që vërtet ka pas zotëri nënkryetar i Kuvendit dallime konceptuale, dikur kur demilitarizuar UÇK-ja dhe është bërë njëfarë TMK-je, janë bërë disa zona, sepse ne kemi qenë këtu, dikush ka qenë akter, këtu ka edhe akterë e tjera e tjera, por nuk mund askush t'i mohojë përgatitjet, profesionistët, njerëz që kanë sakrifikuar dhe kanë rënë në altarin e lirisë. Çdo tentim për ndarje, çdo tentim për eliminim, qoftë të atij grupacioni ose të tjetrit, ne do të bimë në provim si parlament dhe si deputetë. Ne si të zgjedhur të popullit thjesht nuk do të mund të krijojmë një qetësi edhe institucionale edhe nacionale edhe të idealeve, por edhe ligjore. Tek e fundit ligjin që e nxjerr një Parlament nacional, është për të gjitha kategoritë të cilat i mbulon, i rregullon kjo fushë ligjore dhe është për të gjithë popullin e Kosovës. Andaj, unë i ftoj të gjithë kolegët, të gjitha grupet parlamentare, e në veçanti komisionet parlamentare kompetente që të arrijnë konsensus dhe vërtet ata njerëz që kanë kontribuar, sakrifikuar dhe që po na shohin sot kur po debatojmë për këtë ligj, për këto kategori jashtëzakonisht të rëndësishme të shoqërisë kosovare, të dalim unik dhe në fund ta kemi një konsensus institucional, nacional dhe t'i respektojmë vlerat sublime për të cilën edhe po e nxjerrim këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Xhavit Haliti, le të përgatitet deputetja Teuta Hadri.

XHAVIT HALITI: Zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Është e vështirë të flasësh sot për historinë, meqenëse jemi mbledhur që ta miratojmë ligjin dhe është e paarsyeshme që të futemi në çështjet me të cilat do të merren historianët e vërtetë të Kosovës, do të merren sociologët e vërtetë të Kosovës, do të merren profesionistët e ushtrisë dhe do të merren kronikët të cilët kanë qenë prezentë gjatë gjithë procesit, si dhe protagonistët që do të flasin në detaje për të bërat e tyre dhe do të shërbejnë ato që nesër ta ndriçojmë të vërtetën për historinë.

Unë dua t'i drejtohem zotëri Hajdin Abazit, i cili në vitin '95 e ka shkruar një komunikatë bashkë me Xhavit Hazirin kur kemi qenë ilegal në vitin '85 dhe asnjëherë nuk jemi thirr në atë komunikatë, meqenëse ka qenë një përleshje e rastësishme. Të gjithë protagonistët kryesorë të UÇK-së kanë qenë në kontakt njëri me tjetrin, jo nga viti '91, por shumë më herët dhe procesi është zhvilluar gradualisht dhe mendoj që nuk kemi nevojë asnjëri nga ne që të bëhemi heronj përmes atyre që kanë dhënë jetën për lirinë e Kosovës, sepse veç ata janë hero. Ne jemi deputetë këtu të zgjedhur nga populli dhe e kemi sjellë një ligj në Kuvendin e Kosovës, i cili duhet t'ua lehtësojë jetën familjeve të dëshmorëve, i cili duhet t'ua lehtësojë jetën veteranëve të luftës, i cili duhet t'i marrë parasysh kontribuesit e Luftës Çlirimtare të Kosovës dhe përmes marrjes parasysh të atyre që luftuan dhe kërkesave dhe nevojave që kanë familjet e tyre, në fund të fundit edhe të bëjmë dallime për ata që kanë më shumë nevojë.

Buxheti i Kosovës është shumë i vogël për t'i përmbushur të gjitha nevojat që i ka Kosova. Aq më të vegjël jemi ne këtu, në qoftë se në këtë Kuvend merremi me këngën "Kush e nisi luftën ma i pari". Urdhëroni, ka vende tjera, urdhëroni, ka historianë, shkruani kujtimet secili është i lirë që të shkruhen kujtimet, shkruani librat e juaja, debaton në media, debaton në televizione, por mendoj se Kuvendi i Kosovës nuk ka thirrur sot pikë të rendit të ditës për të trajtuar kush ka qenë në luftë dhe kush nuk ka qenë. E tha saktë mendoj edhe kryetari, e tha saktë edhe Emrush, që njerëzit që kanë qenë në luftë, janë të evidentuar. Ata që kanë qenë në proces dihet, ata që kanë kontribuar për këtë vend dihet. Prandaj, mendoj që jam kundër zërave që u ngritën këtu që mos të miratohet ligji, por jam që të miratohet sot në parim dhe vërejtjet, kërkesat e secilit prej nesh, kërkesat dhe nevojat që kanë veteranët, familjet e dëshmorëve, luftëtarët e UÇK-së dhe të gjitha ato kategori, të sillen përmes amendamenteve, si amendamente përmes nesh nga goja dhe nevojat e tyre. Nuk është, papë po them, nuk është vendi sot dhe nuk është koha sot që të merremi me çështjet të cilat i takojnë historisë. Prandaj, po ju bëjë thirrje edhe një herë përmes këtij ligji, qoftë edhe jo i plotë ne po ju vijmë në ndihmë atyre që janë në vështirësi, janë në zor, dhe po dua t'ua them se dje kur u shty sot ligji, po sot ligji ma dërgoj dikush një SMS nga këto kategori dhe më tha: "O burrë mos i dëgjo ata që nuk donë ta miratojnë se ne vdiqëm urie, nuk kem bukë" Dhe, ju lus që ta keni parasysh që ne të gjithë jemi mirë në një farë forme, por ata që kanë luftuar, veteranët, shumica e veteranëve të luftës janë edhe pa punë, edhe pa kushte për jetën, prandaj ju ftoj ta miratojmë ligjin.

KRYETARI: Teuta Hadri, le të përgatitet. Mimoza Ahmetaj.

TEUTA HADRI: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar ministra dhe ju deputetë,

Projektligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së, të viktimave civile dhe familjeve të tyre është një projektligj që edhe më parë është proceduar, por nuk është miratuar për shkak të implikimeve buxhetore, kështu thuhej atëherë. Dhe ligji si i tillë për t'ju përshtatur implikimeve buxhetore ka pësuar një ndryshim 40% dhe e ka humbur rëndësinë si ligj. Kështu, grupi punues dhe Ministria përkatëse ka parë të arsyeshme që të hartohet si ligj i ri. Shpresoj sot se ky ligj do të gjejë përkrahjen nga kolegët e mijë deputetë dhe do të kalojë në miratim në parim se ky ligj tani është përpunuar më mirë, është analizuar më mirë, duke përfshirë të gjitha kategoritë e luftës, pa marrë parasysh individit a është dëshmor, a është invalid, pjesëtar, viktimë apo i zhdukur i luftës.

Të them të drejtën të nderuar deputetë,

Kam qenë i interesuar dhe kam përkrahur idenë që ky ligj të jetë si ligj i veçantë dhe vetëm për dëshmorët, invalidët, veteranët dhe pjesëtarët e luftës së UÇK-së e të jetë një tjetër i veçantë për viktimat civile dhe të zhdukurit, por deputetët janë ata që miratojnë ligjet, por është e drejtë secilit prej nesh të japë mendimin e vet se ky ligj me këtë ngritje të buxhetit në 4 milionë e 800 mijë si dhe ngritje të numrit të pjesëmarrësve nga 12 mijë e 522 tani në 13 mijë e 573 do të ngarkojë buxhetin e Kosovës dhe mundet përsëri ky ligj të vonohet. Prandaj, them se e kam përkrahur atë ide për një ligj të veçantë, nuk mund të jetë një ligj i njëjtë dëshmori, invalidi, pjesëtar i luftës me kategorinë të njëjtë të atyre që e kanë mbyllur derën dhe nuk u kanë dhënë ndihmë ushtarëve, në fund armiku i ka mbytur dhe i ka zhdukur.

Por, si anëtarë e Komisionit, së bashku me anëtarët e tjerë do të jap kontributin tim edhe me këtë formë që është paraqitur ligji që sa më shpejtë të veprohet nga Qeveria për kategorinë e luftës kur dihet çfarë gjendje ekonomike ka kjo kategori e nderit të kombit.

Unë në kontributin tim do të kem parasysh t'i jap vërejtje organit të themeluar tani nga Qeveria për njohjen e statusit për kategorinë e luftës së UÇK-së , si dhe Shtabit të Luftës, Shoqatës së Invalidëve dhe atyre që kanë qenë komandantë të zonave të mos japin rritje të numrit të ushtarëve duke i futur mixhallarët e dajallarët duke i bërë luftëtarë, kur dihet ku e kanë pasur vendin ata. Prandaj, mos na detyroni neve si pjesëtarë të dalim përball atyre që manipulojnë me shifra, por punoni drejtë se kështu e nderoni luftën dhe do t'i ndihmoni Qeverisë që buxheti i saj i ndarë për këtë kategori ky ligj të miratohet sa më shpejtë. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr zoti Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka Mimoza Ahmetaj.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Shumëçka nga ato që u përmendën deri tash, që e pata ndërmend t'i përmend, deri tash u thanë nga parafolësit, nuk dua t'i përsëris, të gjitha i përkrah. Projektligjin në fjalë është diçka mjaftë e qëlluar dhe më në fund kjo kategori shumë meritore do ta ketë respektin dhe trajtimin institucional, ashtu siç e meritojnë. Nuk dua t'i përmend të gjitha të tjera që u përmendën deri tash, po e përmend vetëm një detal që e kam hasur gjatë leximit të projektligjit, sigurisht është gabim teknik. Në asnjë nga nenet nuk përmendet fjala “dëshmore”, përmendet “dëshmor”. Shpresoj të ketë qenë gabim teknik dhe të ketë rrëshqitur, sepse luftës në të gjitha periudhat kohore të çlirimit të këtij vendit krahas burrave, meshkujve u kanë dalë ballë edhe gratë në forma të ndryshme në të gjitha periudhat e historisë tonë.

(Ndërhyrje e kryesuesit: Shkumbin Demaliaj, të lutem tani jemi në sallë të Kuvendit, e ke pasur fjalën.)

Edhe një herë po them, të gjithë, përveç burrave, krah u kanë dalë edhe gratë në të gjitha periudhat historike të çlirimit të vendit, pra, propozoj që në secilin vend ku përmendet fjala “dëshmor” të shtohet edhe “dëshmore”.

Vlen ta përmendim që nga koha e Marie Shllakut e deri te koha e Xhevë Lladrovci, pa dashur t'u hyjnë në hak edhe dëshmoreve tjera si Antigona, Ganimetja dhe të gjitha të tjerave, që në formë aktive kanë marrë pjesë në çlirimin e vendit, nuk e vlen t'u mohohet kontributi i tyre. Prandaj, kisha vetëm këtë propozim, domethënë të shtohet në secilin vend ku përmendet fjala “dëshmor” edhe “dëshmore”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Zoti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,

Unë do t'iu bashkohem disa diskutimeve shumë të arsyeshme që u dëgjuan në këtë sallë, disa diskutime që vërtet janë në nivel të çështjes që po trajtojmë. Definitivisht, ky ligj nuk është një debat për historinë edhe definitivisht historinë duhet ta shkruajnë historianët, bile me kohë kaq të ftohta kur ke një distancë kohore dhe nuk duhet përmes këtij ligji ne as ta inaugurojmë një debat historik që s'mund të na çojë askund. Thjeshtë, ne duhet të përmbushim një obligim, një obligim si shtet, një obligim kombëtar ndaj këtyre kategorive dhe duhet të jemi në nivel të këtij misioni. E tha edhe

kryetari i Parlamentit nuk do të ketë asnjë satisfaksion material që do të përmbushë përgjegjësitë e shtetit ndaj këtyre kategorive, por miratimi i këtij ligjit tregon një përkujdesje shtetërore dhe institucionale ndaj atyre që dhanë aq shumë për Kosovës.

Për këtë arsye unë mendoj që ne duhet ta përkrahim në parim këtë ligj dhe t'i lëmë hapësirë diskutimeve në leximin e dytë ku duhet të apelojmë për një konsensus. Ky është ligj i cili nuk është ligj i mazhurancës, nuk është i pozitës apo i opozitës, është një ligj mbi të cilën ne duhet patjetër të ndërtojmë një konsensus të plotë politik, sepse duke ndërtuar konsensus politik për këto kategori ne tregojmë që jemi të denjë për të respektuar historinë tonë, sakrificën tonë. Pra, vetëm duke respektuar sakrificën tonë ne do të jemi edhe të denjë për të ndërtuar shtetin tonë, i cili u ndërtua mbi bazën e sakrificave të këtyre kategorive.

Kështu që ne duhet të bëjmë përpjekje që në leximin e dytë të arrijmë konsensus të plotë, nuk besoj që datat do të jenë problematike dhe nuk besoj që duhet të pretendojmë që tash gjysmën e popullit apo gjysmën e kombit ta përfshimë në këtë ligj, sepse ligje të tilla kanë pru edhe shtetet tjera pas luftës, kanë pru edhe vendet tjera që janë çliruar nga okupimi dhe dihet cili është misioni i këtij ligji. Andaj, unë apeloj që ne ta përkrahim në parim këtë ligj të lirohemi nga debatet historike, emocionale dhe të mundohem të ndërtojmë një konsensus të plotë, në mënyrë që të përmbushim këtë obligim dhe të fillojmë t'u japim satisfaksion fillimisht kategorive më të rrezikuara, pra familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës. Debatet për veteranët e luftës nuk duhet të shkojnë në pakufi, nuk duhet ta devalvojmë edhe nocionin veteran i luftës, por duhet të kemi arsye për shkak se duke pasur arsye ne vërtet do t'i respektojmë veteranët e vërtetë të luftës. Dihet se çka do të thotë nocioni veteran i luftës, edhe dihet kush në çdo vend trajtohet veteran i luftës dhe mos të bëjmë përpjekje që pikërisht t'i prekim edhe ndjenjat e luftëtarëve të vërtetë, atdhetarëve të vërtetë që më së shumti kanë kontribuar për çlirimin e Kosovës. Nuk guxojmë që në këtë ligj tash të shkojmë në absurde dhe në të vërtetë ta arrijmë efektin e kundërt, në vend që të ofrojmë një mbështetje institucionale dhe një mirënjohje atyre që kanë kontribuar, tani të bëjmë përpjekje që të devalvojmë pikërisht kontributin e të këtyre njerëzve. Për këtë arsye, unë apeloj që të jemi të arsyeshëm, ta votojmë ligjin në parim dhe të bëjmë përpjekje ndoshta jo vetëm në komisionin funksional parlamentar, por edhe në debatet midis grupeve parlamentare të demonstrojmë një unitet çfarë e demonstrojmë dhe me rastin e miratimit të Ligjit të ish burgosurve politikë, sepse duke treguar një kulturë të tillë shtetërore ne, vërtet, si përfaqësues të zgjedhur të popullit tregojmë se jemi të denjë për të çmuar të kaluarën, por edhe për t'u ballafaquar me sfidat e së ardhmes. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputetja Sanije Alijaj.

SANIJE ALIJAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të respektuar deputetë,

Unë konsideroj se sot për Kuvendin e Kosovës dhe për deputetet e Kuvendit të Kosovës është nderë që e kanë shansin dhe mundësinë për të dhënë vlerësimet e tyre për një projektligj që merr, që cakton statusin e të gjithë atyre që dhanë jetën për lirinë dhe çlirimin e Kosovës dhe me vlerësimet e tyre do të kontribuojnë edhe në komisionet funksionale që ky ligj sa më parë të zbatohet në jetë dhe këto kategoritë e luftës të merren në përkujdesje institucionale.

Projektligji, që sot po e shqyrtojmë në lexim të parë, rregullon statusin, të drejtat dhe benficionet e veçanta të kategorive të Luftës të UÇK-së, të cilët me sakrificën dhe kontributin e tyre ishin faktor vendimtar për lirinë dhe çlirimin e Kosovës.

Ky projektligj mundëson që edhe moralisht dhe institucionalisht t'ju njihet sakrifica e tyre. Procedimi i këtij projektligji është sa i domosdoshëm, aq edhe jetik, sepse i merr në mbrojtje institucionale familjet e tyre. Në memorandum shpjegues sqarohet se hartuesi i projektligjit është Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Me këtë rast vlerësoj se po të ishte formuar një ekip i përbashkët i dy ministrive, të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe të Ministrisë së Sigurisë së Kosovës, projektligji do të ishte më përmbajtjesor dhe më gjithëpërfshirës për të gjitha ata që sakrifikuan jetën dhe trupin e tyre për lirinë dhe çlirimin e Kosovës. Këtë do të përpiqem ta argumentoj me këto vlerësime.

Në radhë të parë, duhet riformuluar emërtimi i projektligjit, sepse nuk është i formuluar drejt gjuhësisht, por edhe nuk përkon me përmbajtjen që synon për ta rregulluar. Aktualisht është në fuqi Ligji për kategoritë e luftës, me të cilin afër 40% të kategorive janë marrë në përkuqjesje institucionale. Projektligji që sot po e shqyrtojmë është më gjithëpërfshirës, por dhe pse konsiderohet si ligj bazik, nuk ka nevojë të ngarkohet me rregullimin e statusit dhe të drejtave të personave të zhdukur dhe të burgosurve politikë, sepse kjo materie veç është rregulluar me ligje të veçanta që janë në procedurë për miratim.

Projektligji edhe në përmbajtje, edhe në gjithë përfshirje duhet plotësuar dhe ndryshuar në komisionet funksionale.

Po filloj nga neni 1, i cili definon qëllimin e projektligjit, që synon të rregullojë statusin dhe të drejtat e kategorive të luftës së UÇK-së, por nuk përfshin të gjithë ata që dhanë jetën për lirinë e Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore gjatë aksionit të armëve, të vrarët në demonstrata, vrasja e të rinjve në Ushtrinë Jugosllave, por asnjë dispozitë nuk rregullohet statusi i të gjithë atyre që u vranë padrejtësisht pas luftës që ishin udhëheqës të institucioneve. A është përgjegjësi e Kuvendit të Kosovës që me ligj të merren në mbrojtje institucionale të gjithë ata që u sakrifikuan për liri dhe për çlirimin e Kosovës. Me këtë rast do të potencoj se neni 3 – përkufizime, konkretisht dëshmori i kombit, përkufizimi - dëshmor i kombit, pika 1.6 duhet harmonizuar me pikën 1.7, se është në disharmoni. Prandaj, kërkoj nga komisionet funksionale që të shtohet një kapitull, dispozitat e të cilit rregullojnë statusin, të drejtat dhe benificionet e të gjithë atyre që e kanë sakrifikuar jetën për lirinë e Kosovës.

Neni 15 definon përbërjen dhe kriteret për formimin e komisionit qeveritar që rregullon statusin e të gjitha kategorive në këtë projektligj. Propozoj që ky komision në përbërje të tij të ketë më shumë ekspertë dhe përfaqësues të institucioneve, në mesin e të cilit të jenë edhe përfaqësues të Kuvendit të Kosovës, sepse duhet shpërguar, vlerësuar në mënyrë të dinjitetshme sakrifica e tyre në mënyrë institucionale.

Në paragrafin 2 të nenit 15, statusin i viktimës së luftës dhe të invalidëve të luftës e rregullojnë komisionet homologe në kuvendet komunale. Me këtë rast, sipas kushteve dhe kriterëve që i përcakton me aktin nënligjor ministria, mendoj se kjo nuk është parimore, sepse komisionet komunale duhet të ofrojnë dokumentacionin e domosdoshëm e jo të rregullojnë statusin dhe të drejtat, sepse do të krijohet një laramani e madhe në këtë drejtim.

Një kapitull i tërë i projektligjit trajton me udhëzime administrative e lehtësira dhe benificione të kategorive të luftës. Mendoj se çdo qytetar i Kosovës duhet dhënë kontributin qytetar për t'i kryer obligimet e tij ndaj shtetit. Krejt në rregull, benificionet për të krijuar lehtësira në shkollim, për të

krijuar lehtësira për mbrojtjen e shëndetit, por obligimin shtetëror çdo qytetar i Kosovës duhet ta kryej.

Paragrafi 5 i nenit 24 nuk mundëson trajtim të barabartë, sepse veteranët e luftës dhe familjet e të zhdukurve të drejtën e pensionit familjar e gëzojnë nga janari i vitit 2014. Konsideroj se të gjitha kategoritë që janë të përfshira në këtë projektligj, duhet të kenë trajtim të barabartë, e jo dikush në start ta gëzojë të drejtën, kurse të tjerët pak më vonë.

Projektligjin e përkrah në parim, sepse mundëson marrjen në përkujdesje institucionale të gjithë ata që kontribuan për lirinë dhe çlirimin e vendit, me shpresë se në komisionet funksionale plotësohet dhe ndryshohet, ku të gjithë përfshihen dhe ku të gjithë synohen të kenë përkujdesje institucionale. Do të angazhohem edhe personalisht me amendamente, aty që konsideroj se projektligji bëhet më lehtë për t'u zbatuar dhe mbron të gjithë ata që parashihen me projektligj. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Për rëndësinë e këtij ligji kanë folur shumë parafolës të mi dhe unë nuk dëshiroj aty të humbi kohë. Po ashtu, edhe unë po konstatoj se ky ligj nuk është i përkryer, por është jashtëzakonisht i nevojshëm për kategoritë të cilave po u dedikohet, prandaj shpresoj se ne sot do ta miratojmë dhe pastaj edhe do të kemi mundësi edhe ta amendamentojmë nëse shfaqet nevoja. Por, unë i kam disa sugjerime konkrete në nenet konkrete.

Për shembull, në nenin 11 propozoj që titulli - E drejta në pensionin invalidor familjar pas vdekjes së invalidëve të UÇK-së, të ndërrohet dhe titulli të jetë - E drejta në pensionim familjar pas vdekjes së invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së, meqë në ndërkohë ka edhe shumë veteranë të UÇK-së të cilët kanë vdekur dhe familjet e tyre kanë nevojë ta gëzojnë këtë të drejtë.

Në nenin 12, propozoj që të hiqet pika 1.5, me të cilën parashihet që veteranëve të luftës t'u mohohet e drejta në pension të veteranit për ata të cilët kanë qenë pjesëtarë të TMK-së. Prandaj, propozoj që pika 1.5 të hiqet.

Në pikën 1.8 të saktësohen përparësitë të cilat janë paraparë për kategoritë për të cilat bënë fjalë ligji, edhe në punësim, edhe në çështje tjera dhe të mos mbetet kjo e zgjeruar kështu siç është.

Në pikën 1.13, neni 12, të shtohet teksti “edhe fëmijët e veteranëve”. Në këtë pikë bëhet fjalë për të drejtën e shfrytëzimit të konvikteve për veteranët, por konsideroj se tani shumë fëmijë të veteranëve janë në fazën e studimeve dhe do të ishte mirë që edhe ata ta kenë këtë të drejtë.

Në pikën 3 të nenit 12, të drejtat e përcaktuara nga paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 duhet të hiqen, sepse një gjë e tillë nuk mund të realizohet pasi që bëhet fjalë për stazhin e dyfishtë që mund të pranohet dhe ajo mund t'i pranohet vetëm individit dhe jo edhe të tjerëve.

Për veteranët me këtë ligj duhet të parashihet edhe lehtësi doganore, konsideroj, dhe aplikimi i këtij ligji duhet të fillojë në vitin 2011, e jo në vitin 2014, siç është paraparë në këtë projektligji. Pra, këto ishin vetëm disa nga sugjerimet e mia dhe unë personalisht në parim e përkrah këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka Ibrahim Selmanaj.

IBRAHIM SELMANAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Singerisht, me vëmendje i kam dëgjuar të gjithë parafolësit e mi. Duke qenë se jam marrë pak a shumë dhe atë sa kam mund të shoh dhe ta njoh këtë zhvillim, po përpiqem ta paraqes shqetësimin tim. Në radhë të parë, jam kundër që të përzihen epokat. Kur flasim prej vitit 1945, ne dëshmitarët e gjallë të zhvillimeve, që jemi ne ligjvënësit, po vijmë në kontradikta me njëri - tjetrin kur ka filluar lufta, kush ka qenë më komandant, kush ka qenë më luftëtar, kush ka qenë më dezertor dhe nuk po them të thyejmë epokë në asnjë mënyrë, vitet '45 kanë vlerën e vet, rëndësinë e vet të asaj kohe, por cili do të jetë mekanizmi që ne do të kujdesemi dhe do ta dimë se cilët njerëz meritojnë më shumë ose më pak, ose pa vetëdije dhe pa ndonjë qëllim të caktuar ne po mundemi ta dëmtojmë një proces të kaluar, se dikush mund të mbetet jashtë përfshirjes në përfitime ose njohje edhe morale, tek e fundit.

Unë mendoj se duhet të fokusohemi shumë më shumë te shtrirja ose te aplikimi i ligjit. Është shumë mirë ta njohim për së afërmi si është jeta sot e familjarëve të dëshmorëve, si është jeta e vet invalidëve dhe në mekanizmat që janë qoftë si Qeveri, qoftë si pushtet lokal, qoftë si pushtet qendror sa ne jemi të gatshëm që në raste dhe në kushte të barabarta t'i përgjigjemi drejtpërdrejt një veterani të ndershëm të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që paraqitet për një vend pune dhe e vërteta është se politikisht dëmtohet ose nuk e ka dikë të njohshëm. Kjo është e vërteta që i ndodh Kosovës dhe e vërteta tjetër është se nuk i përkrahim edhe fëmijët e dëshmorëve në zhvillimin që e kanë sot, qoftë në shkollë, qoftë në spital, qoftë në mekanizma tjerë që mundemi drejtpërdrejtë të japim kontributin tonë dhe një farë forme ta shohin dorën e shtetit edhe këta fëmijë. Pjesë e ndejshme edhe në fillim kur ka filluar zbatimi i ligjit të parë, pjesa më e ndjeshme janë qytetarët e Kosovës që janë vrarë në demonstrata, sidomos prej viteve '64, prapë i ka ra në vitet '90, kur nuk ka qytet në Kosovë që në ngjarje të mëdha, sidomos në fillimet e viteve, çdo fillim viti, marsi sidomos, më dhjetëra djem na u kanë vrarë në demonstrata, i kanë prindërit gjallë, nuk kanë benificione dhe data kur fillon zbatimi i ligjit prej viti 91, aty mund ta gjejnë veten familje të caktuara që kanë pasur fatin e hidhur ose edhe krenarinë t'ju vriten djemtë ose edhe vajzat mbas vitit 91. Thjeshtë, me një akt ligjor duhet të rregullohet, me akt të veçantë ligjor duhet të rregullohet çështja e demonstrantëve që janë vrarë në periudha të ndryshme dhe me ligj të përcaktohet edhe benificioni që kanë për ta përfutur. Ndërsa, definitivisht jam kundër që të përfshihen në të njëjtin ligj prej vitit 1945 deri në vitin 2003 a sa ka qenë aty.

Ndërsa, e fundit që do ta them, është ngutur, ligji është i vonuar, por proceduralisht është bërë një gabim, sepse nuk ka kaluar nëpër komisionin parlamentar dhe këtu në ligj tash po na krijon hapësirën që ne ndoshta të flasim pa qëllimin e keq, se po reflekton keq. Unë thërras deputetët që ta votojnë ligjin, po në të njëjtën kohë të monitorohet ky ligj dhe të zbatohet prej nivelit qendror deri në nivelin lokal. Unë do ta votoj ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Hajdin Abazi.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, kryesues!

Vërtet për këtë ligj kemi pasur nevojë kaherë që ta kemi, mirëpo megjithatë më mirë vonë se sa kurrë, por ky ligj pritet dhe besohet që do të rregullojë shumë gjëra për të cilat kemi nevojë.

Unë, fillimisht desha vetëm të nis me një vërejtje teknike që në titull, për shembull, pjesa e fundit të emrit të ligjit shkruan “viktimize civile të luftës së UÇK-së”, kurse tek përkufizimet vetëm shkruan “viktimat e luftës”, sepse edhe kështu është më e drejtë, do të thotë “viktimat e luftës” e jo “viktimat e luftës të UÇK-së”, sepse ka konotacion negativ.

Natyrisht që ligji është vërtet shumë përmbledhës dhe unë konsideroj se i mbulon sferat për të cilat është thirr. Mirëpo, unë desha vetëm të ndalem edhe në disa çështje, sepse këtu nga disa kolegë u shtrua çështja që, thjeshtë të them kështu, pse vetëm emri i UÇK-së është i përfshirë dhe jo edhe emra të tjerë. Me qenë se edhe unë jam që herët i përfshirë në organizim, do të sjell një përvojë timen se pse duhet të jetë kështu e mos të jetë ndryshe. Unë konsideroj se emri i UÇK-së është një emër unifikues që i bashkon të gjitha përpjekjet dhe që ka krijuar fronte në Kosovë, prandaj ku do që është bërë luftë në Kosovë, nuk ka pasur diçka tjetër përpos UÇK, ka qenë ajo emblemë, ka qenë ajo komandë. Dhe, nëse kjo nuk do të jetë kështu, çfarë do të na ndodhë atëherë. Unë do t’i sjell si ilustrim vetëm tri raste.

Në vitin 79, kur më kanë arrestuar mua, pjesa e organizatës që ka qenë do të thotë një institucion që ka vepruar për lirinë e vendit, që ka mbetur, kanë vendosur të marrin një aksion dhe kanë djegur stacionin e policisë. Tash, duhet edhe kjo të rangohet këtu si një pjesëmarrëse, sepse ka pasur një hierarki, ka pasur një komandë, që është marrë vendimi dhe që është zbatuar urdhri. Ose të ngjitemi akoma më lartë në kohë. Në prill të vitit 85, kur janë bashkuar të gjitha organizatat ilegale në Kosovë, organizimi është bërë në dy krahë, ka qenë krahë politik dhe krahë ushtarak. Krahun ushtarak e ka udhëhequr Fehmi Lladrovci dhe prej vitit 1985 ka qenë, do të thotë, një mekanizëm i organizuar që ka ndërmarrë aksione me një strategji, me një veprim të caktuar dhe kundër një cakut të caktuar, kundër regjimit pushtues. Të shkojmë edhe më lartë në kohën, në vitin 89, ne e dimë për shembull, është e njohur ajo që është krijuar “Qeta e Llapit” në Llap, ku kam qenë edhe vet i njohur edhe nga afër me këta dhe këta kanë qenë të armatosur dhe është vrarë Ali Ajeti duke luftuar me forcat serbe. Tash, në këto rrethana sikurse të hiqet sintagma e UÇK-së, faktikisht ne për t’ju hyrë si duhet, të gjitha këto kanë qenë institucione që e kanë marrë ligjitimitetin nga ideali për të cilin kanë luftuar dhe nga qëllimi përse janë nisur, e qëllimi ka qenë i njëjtë, që Kosova të çlirohet, të shkëputet nga Serbia. Dhe, unë do ta them edhe një rast më konkret këtu. Kur them se UÇK-ja ka qenë unifikuese, unë do ta sjell jo për diçka tjetër, po si ilustrim edhe një shembull. Unë e di se në luftën në Logjë është vrarë Skender Çeku. Skender Çeku është njeriu që para se unë të hyjë në radhët e UÇK-së, më ka ushtruar dhe më ka stërvitur dhe më ka përgatitur ushtarakisht. Luftë e Logjes, është udhëhequr nga Tahir Zemaj, por Tahir Zemaj - dihet se unë kam qenë në Junik - ka ardhur me uniformën e UÇK-së dhe me emblemën e UÇK-së dhe ka qenë zëvendëskomandant i zonës operative të Dukagjinit, do të thotë i shtabit të kësaj zone të UÇK-së. Prandaj, në këtë aspekt çdo pretendim për të futur edhe mekanizma të tjerë që nuk kanë qenë në terren, që nuk janë shtrirë në gjithë vendin në Kosovë, unë konsideroj se do të na nxirrte telashe të mëdha edhe do të shkonim pas në histori, sepse duhet gjithsecilit t’ia japim hisen e vetën sipas kontributit që ka dhënë. Kurse, vetë emri i përcaktuar si dëshmor, veteran – por edhe ata që kanë dezertuar pavarësisht rrugës së kyçjes së tyre në UÇK - lë mundësinë që të mos jenë vetëm ata që kanë qenë në radhët e UÇK-së, por edhe ata që janë vrarë më herët nga forcat serbe, qofshin edhe demonstratat e vitit 68, ato 81 apo në periudha të ndryshme.

Për këtë arsye, unë mendoj se ne sot duhet të jemi si deputetë të thirrur që vërtet ta ruajmë unitetin moral të qytetarit, ta ruajmë unitetin kombëtar, sepse kjo është çështje kombëtare dhe nuk është çështje e pazareve politike se cila parti politike sot do të mundet të imponojë diçka, cila jo. Derisa gjatë luftës nuk ka pasur taborre të ndara, dikush e ka pasur një zonë, dikush një zonë tjetër, por gjithkund e ka pas UÇK dhe të gjithë ne që kemi qenë, kemi qenë nën emblemën e UÇK-së.

Konsideroj se titulli dhe përmbajtja është vërtet e plotë dhe shkon në dobi të asaj që e kemi pasur ideal dhe që nga viti 2008 e kemi realizuar dhe tash po përpiqemi ta sendëtojmë. I thërras, pra, ndërgjegjes të të gjithë atyre që vërtet duan të krijojnë një unifikim kombëtar, e të mos qelin gjëra të tjera, kur do të na dalin pastaj 100 mekanizma të cilët kanë qenë. Është reale që kanë qenë, por s'kanë pas fat, se fatin historik e pati vetëm Ushtria Çlirimtare e Kosovës që të përballtet drejtpërdrejt në front me forcat serbe dhe në çdo hap ku ka pas mundësi edhe ta mbrojë atdheun, ta mbrojë popullin, t'i mbrojë qytetarët, t'i mbrojë vatrën tona, shtëpitë tona. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit, kryesues!

Zëvendëskryeministër, ministra,

Deputetë të respektuar,

E kemi një dokument përpara, konsideroj shumë të rëndësishëm, meritë për ta trajtuar shumë seriozisht. Deri tash dëgjuam vërejtje kështu en bloc nga Lidhja Demokratike, nga LDD-ja, nga deputetë të caktuar. Për mua është indikative që Lidhja Demokratike, që është një nga subjektet qeveritare të japë, mendoj që është dashur ju qeveritarë, që këtë bile të dilni unisono këtu. Kjo është një vërejtje e imja në aspektin makro politik. Ndryshe, unë kam marrë edhe një dokument nga Këshilli i Veteranëve të UÇK-së, që kanë shërbyer në TMK, kanë dhënë një varg vërejtjesh, i kam analizua me kujdes. Besomëni, jam krejtësisht i bindur se shumica e objeksioneve të tyre janë të bazuara. Është fjala për zgjidhjet juridike, për formulimet, për konceptimin juridik. Ato janë orientuar në nenin 3, 5, 6, 8, 10, 12. Pleduajenë e kryetarit të Kuvendit të Republikës, zotëri Krasniqi, unë e konsideroj të qëlluar, kam dëshirë që ta mbaj disi edhe, si thuhet, për fjale dhe të influencojë edhe në Kryesi, së andejmi edhe në Qeveri, që të përgatiten projektligje referuar etapave tjera, kështu që ta mbulojmë si të them se, fundi i fundit, historia nuk filloi me neve, as që do të mbarojë me ne dhe ka elemente objektive për ta bërë një periodizim e në kuadrin e periudhave, apo jo, që të bëjmë emërtime adekuate edhe ato do të ishin përafërsisht kështu: viti 1913 – 1919, viti 1919 – 1941, viti 1941 – 45, viti 1945 – 1968, viti 1968 – 1989, viti 1989 – 1999. Do të thotë, në kuadrin e kësaj, ajo që e propozoi edhe kryetari dhe që mendoj që ishte në parim një konceptim i mirë, i qëlluar për ta absolutuar këtë tematikë shumë sensitive.

Unë do të përqendrohem në disa vërejtje parimore. Ju lutem, bie fjala te neni 5, paragrafi 4, ku thotë: “pensionimi personal i luftës, të cilin e realizon veterani i luftës së UÇK-së pas moshës 50 vjeçare”, të fshihet kjo “pas moshës 50 vjeçare”, se është apo s'është, është veteran i luftës, është pa marrë parasysh moshën, ju lutem. Kjo.

Më pastaj, te neni 6, paragrafi 2: “rehabilitimi mjekësor dhe fizikal është e drejtë që e realizojnë të gjithë invalidët me prioritet”, kjo fshihet “me prioritet sipas shkallës së invaliditetit”, se mund të jetë, ka edhe prioritete të tjera, mund të jetë i ri, e re që është plagosur dhe që ka nevojë për rehabilitim ndoshta më tepër, ani pse do ta kishte një gradë më të ulët të invaliditetit, mirëpo moshë në pyetje e tjera e tjera, humaniteti. Po e kaloj këtë, edhe këtë, sepse llogarisë që do të japim kontribut modest edhe në etapën e dytë.

Te paragrafi 5, neni 7: “stazhi i dyfishtë është e drejtë të cilin e realizojnë invalidët dhe veteranët e UÇK-së”, të fshihet ky tekst” si të papunësuar apo të punësuar”. Nuk është me rëndësi a është apo s'është i punësuar. Është e drejtë absolute, se të drejtat absolute nuk janë relative. Prandaj, nëse punësohet, fort mirë që është punësuar, nëse nuk punësohet, nuk është i punësuar, atëherë ajo është e drejtë e padiskutueshme.

Po thuhet, për shembull, te neni 8, paragrafi 1, alineja 8, se “Qeveria përkujdeset për strehim”. Përkujdesje është një formulim shumë problematik, se gjithmonë mund ta gjejë një justifikacion, Qeveria përkujdeset, ama s’po mundet. Fshihet “përkujdeset”. “Bën strehimin familjar” e për këtë natyrisht ne e dimë që ka implikacione buxhetore, impakte buxhetore, po paraprakisht është dashur të bëhet analizë dhe kur të propozohet, të propozohet në mënyrë adapte, se kjo është pikërisht një propozim i kuptimit politik.

Ose te paragrafi 4, këtu duhet të jem korrekt. “Përparësi në regjistrim dhe pranim në institucione arsimore publike” duhet të shtohet “në kushte të njëjta” se kurrësi absolutisht jo nëse është fëmijë i dëshmorit që të regjistrohet, ju lutem, ndoshta atje i ka njëjsha, e ka pasur shkollën e mesme e me interferenca i ka bë dysha e të regjistrohet në fakultet, por “në kushte të njëjta”, e në kushte të njëjta le të ketë prioritet plotësisht me miratim.

Edhe kudo që është mesatarja, ajo minimalja, kur baza për përcaktimin e pensionit qoftë personal, qoftë familjar të luftës, jo minimalja po mesatarja. Fundi i fundit, minimalja apriori e ofendon dinjitetin e pensionuarit, po ne po e dimë që mund të ketë mpakte, po ta adaptojmë këtë, më mirë është së paku në aspektin moral kështu edhe të dinjitetshëm që të themi 50% nga mesatarja, se sa 85 nga minimalja. Do të thotë, të kemi konsiderata se çdo kush është i vetëdijshëm se buxheti ynë çfarë kapacitete ka, çfarë mund të ketë e tjera e tjera dhe nuk është synimi, fundi i fundit, që të kapitalizohet financiarisht, si të them, statusi, por më tepër është edhe pensioni, por edhe mirënjohja, pranimi.

Është një formulim simptomatik kur thuhet, për shembull, neni, nenet e gjata, 9, paragrafi 2 “Vlerësimin mjekësor për shkallën e invaliditetit sipas paragrafit 1 të këtij neni e bën Komisioni mjekësor i shkallës së parë edhe i shkallës së dytë”. Kjo do të thotë, duhet të jenë dy komisione, që duhet të jenë dy komisione dhe që do të duhej sipas këtij formulimi ta përcaktojë shkallën e invaliditetit komisioni invalidor i shkallës së parë, më pastaj menjëherë i shkallës së dytë. Jo asisoj, por nëse do të kishte ankesë, që ashtu do të duhej, domethënë njëherë një komision, edhe komisioni tjetër, atëherë pse të mos ishte vetëm një komision, duhet të jenë dy komisione, instanca e parë, instanca e dytë.

Përfundimisht, te neni 23, ku thuhet: “Të gjitha kërkesat e paraqitura në organin përgjegjës të ministrisë sipas ligjit numër” e tjerë, “për statusin dhe të drejtat e familjeve, të dëshmorëve e të tjera të cilat janë në shqyrtim e sipër pas hyrjes në fuqi të këtij ligji do të rregulloheshin sipas këtij ligji”. Ky formulim problematik, në jurisprudencë i papranueshëm sepse e cenon të drejtën themelore të fituar, se këtu kudo në legjislacionet kontepurare i jepet prioritet palës për t’u përcaktuar për ligjin që është më i favorshëm për te, e kurrësi se mund të ndodhë që sipas..., është nisur procedura, nuk ka përfunduar procedura ndërkohë, është miratuar ligji që do të mund të ishte më i pa favorshëm apo edhe e kundërta. Gjithmonë pra palës duhet t’i jepet prioriteti për opsion, për të zgjedhur, natyrisht gjithmonë e zgjedh normën juridike më të volitshme edhe kjo do të duhej të fshihej krejtësisht, sepse është parim juridik ndërkombëtarisht valid, i aplikueshëm, i padiskutueshëm, ose eventualisht nëse ndokush ka dëshirë që të ketë më shumë nene, le ta riformulojë.

Unë e mbështes dokumentin për miratim, natyrisht do të pësojë ndryshime të caktuara, sidomos në harmoni me kërkesat të cilat i kanë shprehur eksplicite veteranët e UÇK-së që kanë shërbyer në TMK, sepse me disa dispozita ata rezultojnë si të diskriminuar padrejtësisht. Ju falënderohem!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet, zoti zëvendëskryeministër dhe ju dy ministra që akoma po qëndroni burishtë këtu në sallën e Kuvendit, kurse një përsëritje edhe për kuvendarët dhe kuvendaret e Kuvendit të Kosovës!

Të gjithë ne që sot gjendemi në këtë sallë, duhet të kemi pasur fatin e mirë dhe duhet të ndihemi të privilegjuar që sot po kemi mundësi që me votën tonë ta vëmë në vend një padrejtësi të madhe shoqërore që iu është bërë kategorive të ndryshme të shoqërisë sonë, të cilat janë aq të merituar dhe nuk ka kompensim material që i mbulon meritat e tyre për lirinë e vendit tonë dhe krijimin e shtetit tonë të ri.

Ky ligj po vjen në Kuvendin e Kosovës me një vonesë të konsideruar dhe shpresoj se, ashtu sikur dhe, Ligjin për të burgosurit politikë dhe të përndjekurit politikë që e aprovuam me një konsensus të lartë, edhe këtë ligj sot do ta aprovojmë me votat maksimale të të gjithë deputetëve që janë këtu.

Unë desha vetëm të vë në spikamë diskutimin e kryetarit të Kuvendit dhe nuk dëshiroj t'i shtoj asgjë, se në përgjithësi e paraqet tërë disponimin, tërë esencën pse ky ligj duhet të miratohet sot në Kuvendin e Kosovës. Mirëpo, desha të shtoj vetëm disa aspekte teorike mbi luftën, nga e cila buron edhe vetë ky ligj që e kemi këtu, është pasojë e një lufte që ka ekzistuar këtu dhe preteksti është pikërisht lufta që e ka bërë populli ynë, përkatësisht Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Sipas teoricienëve të luftës, lufta është fenomen shoqëror i cili lind dhe zhvillohet në mitrën e politikës. Dhe ju kisha dëshiruar të gjitha atyre deputetëve të cilët dëshirojnë sot këtu në Kuvendin e Kosovës të fitojnë lavditë e luftës në këtë sallë të Parlamentit, të vejnë pak gishtin në kokë dhe të mendojnë esëll, lavdia e luftës fitohet me beteja luftarake, në aksione dhe në përleshje me pushtuesin. Nuk mund të fitojë askush lavdinë as statusin e luftëtarit në Parlamentin e Kosovës. Të gjitha ato lëvizje kombëtare për çlirim, të cilat ekzistojnë prej që ekziston njerëzimi në botë, të cilat me programin e vet e kanë pasur luftën, luftën si një opsion për çlirim nga pushtuesi, nuk kanë dështuar. Subjektet politike të cilat në mitrën e politikës së vet nuk e kanë paraparë luftën si opsion për çlirim kombëtar, ato subjekte kanë mund të ëndërrojnë për çlirim, mirëpo në realitet kontributi i tyre është shumë i vogël në çlirimin e vendit. Është njësoj sikur dikush kur dëshiron të vret dikë ose të mbytë dikë dhe gjykatësi të dënon për atë çka ka dëshiruar e jo për veprën që e ka bërë. Ka shumë subjekte politike në histori të cilët kanë pasur dëshirë të çlirojnë popullin e vet, por nuk kanë bërë veprime luftarake me të cilat edhe e kanë arritur lirinë.

Të jemi të gjithë koshientë këtu që jemi në këtë sallë, më shumë se qytetarët e Kosovës, se shteti gjithmonë në histori ka pasur luftë e rrënjët në gjak, por edhe shteti ynë duhet të dijë, çdo deputet në Kuvendin tonë i ka rrënjët në gjak dhe është pikërisht gjaku i luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe gjaku i invalidëve të luftës, i cili na ka mundësuar ne që sot të ulemi në këtë Kuvend. Nuk kisha dëshiruar ta zgjas, më shumë por ju kisha lutur që ligjin ta aprovojmë dhe gjatë procesit të definimit të statusit të kemi parasysh edhe diskutimin tim, se statusi i veteranit edhe i luftëtarit, edhe i invalidit të luftës fitohet, duhet të jetë fituar në beteja, e jo nëpër ...

KRYESUESI: Të lutem, ligjin, ligjin, vetëm për ligjin.

GANI BUÇINCA: E mbarova zoti kryesues, besoj që e thashë esencën dhe filozofinë time politike mbi të cilën e bazova edhe diskutimin tim politik. Unë do ta përkrah ligjin.

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ka mbetur pak të flitet, sinqerisht, ne si duket kemi kohë boll, domethënë s'na bëhet vonë, e përsërisim njëri - tjetrin tej mase.

Unë dua të ndalem një çështje pak a shumë më konkrete, ndoshta, te vlerësimi i ndikimit buxhetor që ka ky projektligj. Po citoj: "Efektet buxhetore të këtij ligji në qoftë se miratohet, do të fillojnë prej vitit 2011, me përjashtim të drejtave të familjeve të personave të zhdukur, neni 13, paragrafi 10 i ligjit, dhe të drejtave për veteranët dhe pjesëtarët e UÇK-së, neni 12 i këtij ligji, i cili do të zbatohet nga data 2014. 01.01", pra 1 janar 2014. Unë kam një pyetje për sponsorin, ndoshta me qëllimin më të mirë, se përse pikërisht familjet e personave të zhdukur janë shtyrë deri në këtë datë që t'i gëzojnë të mirat e këtij ligji, për faktin se mendoj që janë kategoria që aktualisht, nga të gjitha kategoritë tjera, është më e prekura ngase nuk dinë akoma asnjë gjë për fatin e njerëzve të vet. Ndoshta kjo kategori jo deri në vitin 2014 dhe jo as në vitin e ardhshëm, po që sot ka nevojë shumë për mbështetje institucionale që t'i gjejë njerëzit e tyre, që t'i gjejnë eshtrat, varrezat se ku mund të ndodhen ato. Prandaj, vdekja e familjarëve, e njerëzve të tyre që akoma mbahen si misterioze për shkak se nuk po gjenden varrezat dhe, në anën tjetër, keqpërdorimi i këtyre familjeve nga matrapazët e ndryshëm, nga avokatët e ndryshëm që ju krijojnë shpenzime të larta, unë them se viti 2014 është shumë larg, mos përçon edhe një mesazh tjetër kjo datë se deri në këtë vit, pra edhe tre vite e diçka i bie, nuk do të ketë mundësi të gjenden varrezat apo eshtrat e këtyre njerëzve të zhdukur.

Unë edhe në formë pyetjeje, por edhe si elaborim timin them se data 2014, 1 janar, për këto familje është shumë vonë dhe mbështetja institucionale duhet të pasojë më shpejtë. Ndoshta sponsori do ta shpjegojë se përse kjo kategori është shtyrë deri në këtë datë. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Luljeta Shehu e ka fjalën.

LULJETA SHEHU: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Zëvendëskryeministër, të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së, të viktimave civile të luftës së UÇK-së dhe të familjeve të tyre është pritur dhe pritët që 11 vjet nga këto familje. Pasi parafolësit folën mjaft, kisha disa vërejtje në vlerësimin e ndikimit buxhetor që ka ky projektligj. Nëse miratohet ky projektligj, do të fillojë prej vitit 2011, por me përjashtim të të drejtave të familjeve të personave të pagjetur, i cili do të zbatohet nga viti 2014. Them, pse gjithë kjo shtyrje dhe ky dallim për familjet e të pagjeturve që gëzojnë vetëm një pension prej 135 euro, pavarësisht se a kanë të humbur 1, 2, 3, 4 e më tepër anëtarë të familjes. Prandaj, kërkoj që kjo të përmirësohet dhe të vlejë edhe për këto familje të zbatohet prej vitit 2011.

Gjithashtu, në nenin 13, Të drejtat e anëtarëve të familjes së viktimës civile të luftës, duhet të shtohet edhe një paragraf 1.8, bursa për shkollim të mesëm dhe të lartë, sikur që vlen për fëmijët e dëshmorëve të UÇK-së. Unë mendoj që komisionet gjegjëse duhet t'i kenë parasysh këto vërejtje në shqyrtimin e mëtejshëm të këtij projektligji, sepse janë vërejtje mjaft të rëndësishme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Driton Tali, e ka fjalën.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Për shkak se shumë gjëra u thanë, unë do të ndalem në dy çështje. Paraprakisht më lejoni të deklaroj se e mbështes, në parim, këtë projektligj, me gjithë këto mangësi që i ka. Por, me të drejtë këtu shumë herë u parashtrua pyetje se cilët janë dëshmorët, cilët janë invalidët, cilët janë veteranët dhe rrjedhimisht familjet e tyre. Unë nuk do t'i përjashtoj kategoritë kohore, që u folën këtu, pra edhe të gjitha strukturat do ti inkorporoj, pra edhe të atyre që para të 90-tave na mbanin ligjërata për Jugosllavinë vetëqeverisëse, e që më pastaj në vitet e 90-ta u kthyen mbarë, tash a u kthyen ata për shkak të vetëdijes, apo i ktheu Millosheviqi, është çështje të duhet ta mendojmë. Mbase edhe u inkadruan disa, kështu të paktën na thonë, edhe në luftë dhe ka fakte që kanë luftuar, por që pas lufte ky grup i njerëzve, që tash kanë filluar të njihen me atë nofkën "komandant Ranq Roveri" apo "komandant BMV X5, apo "komandant Audi Q7", apo ata komandantët të cilët Kosova i ka shpërblyer me shtëpia, pallate, pasuri, qoftë në QKUK, që kanë marrë hisen e tyre, pra shpërblimin e tyre për kontributin që e kanë dhënë, qoftë në Universitetin e Prishtinës, në pronat e Universitetit të Prishtinës, qoftë edhe në pronat e komunave apo ish ndërmarrjeve shoqërore, të gjithë këtë kategori të këtyre njerëzve pa parapërkashtim, po them edhe një herë, apo pa kategorizim, duhet ta sjellim ligjin për mercenarët e luftës, shpresoj se Qeveria së shpejti do të na bien atë ligj dhe aty do të rregullohen të gjithë këta, kështu që s'kemi nevojë ne edhe të ngatërrohemi, pra, për të gjithë këta mercenarë, po them, dhe të merremi me veteranët e vërtetë, pra edhe të atyre që bëjnë vetëvrasje. Sipas një shënimi që e kam unë, janë 42 ish ushtarë të UÇK-së që kanë bërë vetëvrasje për shkaqe ekonomike dhe rrjedhimisht domethënë socialo-politike, pra të personave që me të vërtetë kanë bërë shumë për këtë vend, por që nuk ua kemi kthyer as dinjitetin njerëzor, e lëre më diçka më tepër, pra të atyre përpara pranojnë që të bëjnë vetëvrasje se sa të bëhen "komandant Audi x 5" apo "komandant BMV", më falni x 5 është, BMV X5, gjersa Audi është Q7, apo "komandant pasaniku" atje që ka uzurpuar gjysmën e Prishtinës e kallëzojnë pallavra, domethënë të këtyre komandantëve që kanë shkelur në ato vlerat e luftës, nëse i kanë pasur vlerat kombëtare dikur. Pra, të gjithë këta, pa marrë parasysh se a i kanë shërbyer dikur UDB-së, e që më vonë janë kthyer mbarë, shumë na imponohen si patriotë, duhet që të bëhen, të rregullohen me Ligjin për mercenarët të luftës apo mercenarët e lirisë dhe s'kemi nevojë mandej të ngatërrohemi mes veti. Faleminderit!

KRYESUESI: Për ligjin s'ke gjë, po nejse.

Naim Rrustemi e ka fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

Fillimisht, dua të deklaroj se e përkrah ligjin, e përkrah ligjin me plotë zemër sepse është diçka që ka munguar prej kohësh. Është fakt se është problem t'iu dilet haku atyre, t'ju jepen meritat që i kanë të gjithë ata që kanë vdekur, që janë dëshmorë të Kosovës, invalidë të luftës, por edhe veteranë, me të vërtetë veteranë, por jo kategoria tjetër e atyre të dezertorëve, që nuk ka nevojë të jenë në listë si pjesëtarë të UÇK-së fare. Nuk është problemi këtu vetëm financiar, por është problemi edhe i krijimit të një shoqërie etike, një shoqërie të moralshme.

Fillimisht, po e them se neni 24, i cili parasheh që për privilegjet e veteranëve, që ky ligj fillon të implementohet prej vitit 2014, atëherë unë ia përkujtoj Qeverisë se asnjë indikator nuk tregon se do të kemi kapacitet financiar që të fillohet me implementim deri më 2014 dhe propozoj, sinjorisht propozoj që ky ligj të fillojë të implementohet nga 1 janar i vitit 2011, në rast se dëshirojmë që 'u dilet, që t'ju jepen meritat aq sa e meritojnë.

Gjithashtu, propozoj që neni ku parashihet për dëshmitë e rrejshme, parashihen gjopa për dëshmitë e rrejshme, si me rastin e dëshmisë për dëshmorë, por gjithashtu edhe të dëshmisë për veteranë, që të largohet gjopa me të holla, por të shkruhet se do të dënohen sipas Kodit penal të Kosovës, sepse

Kodi i përkohshëm penal i Kosovës gjithashtu e parasheh për dëshmitë e rrejshme në rast se shkelen diçka procedurale, zyrtare të tjera. Kjo kishte për të bërë që ky ligj të jetë shumë më lehtë i implementueshëm, kish për të bërë që shoqëria që të jetë shumë më etike, që listat e veteranëve të ngushtohen shumë, kish për të bërë që lista e dëshmorëve, po më vjen edhe keq ta përmend se të gjithë, kushdo që ka vdekur, është ndjenjë e dhimbshme që ka vdekur, por vdekjet janë të ndryshme, dëshmori është dëshmor, është e definuar në luftë kundër armikut. Edhe ai që ka vdekur me vdekje të natyrshme, ka pasur mundësi që të jetë edhe pjesëtar i UÇK-së, por vdekjen e ka të natyrshme, nuk është dëshmor. Dëshmor është ai që ka vdekur në luftë kundër armikut. Të gjithë ata që kanë dyshime se a ka të dhëna të sakta, unë po ua përkujtoj, hiq më larg se sot i pash shënimet e njëres prej brigadave të Zonës operative të Shalës, me të gjitha shënimet, ekzistojnë shënimet deri edhe më të saktat, deri edhe me kontributin në të holla, numri i dëshmorëve, numri i invalidëve që kanë qenë ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, numri edhe i kontribuuesve deri në hollësitë më të vogla, deri në 10 eruro. Me fjalë të tjera, ata që bëjnë dëshmi të rrejshme, ata nuk e prekin, nuk e dëmtojnë veç buxhetin e Kosovës, na dëmtojnë edhe ne, na dëmtojnë tërë shoqërinë. Përpos sjelljeve të tyre jo të moralshme, jo etike, në afat të gjatë e dëmtojnë shoqërinë e Kosovës. Gjithashtu, edhe për veteranët e luftës. S'kemi nevojë ne të presim deri në vitin 2014 që të fuqizohen privilegjet e veteranëve, sepse edhe atyre është shumë vështirë t'ua japim meritat e veta. E ka vënë veten në disponim dhe tash për shkak të fryrjes së numrit, për shkak të fryrjes së numrit tkurren mundësitë financiare dhe kërkohet që më 2014. Jo, ose mund të prodhojmë alternativë që për shkak të simbolikës mund të kërkojmë që ligji të futet në implementim prej 28 nëntorit 2010, eventualisht në rast se s'është e mundshme, të futet në implementim prej 1 janarit 2011, sepse kategoria e tillë e veteranëve, që është numër i fryrë, ka mundësi që të jetë edhe i fryrë, është pak edhe i pandershëm. Për shembull, a ka mundësi që të jetë veteran i UÇK-së dikush që është futur në kolonë dhe është kthyer prej kufirit të Shqipërisë, e ka lënë armën në mal dhe ka shkuar deri në Shqipëri, u kthye dhe ai tash figuron në letra, figuron ndoshta në regjistra, porse eprorët e tij të drejtpërdrejtë e dinë që ai realisht nuk është veteran i luftës së UÇK-së. Veteran nuk ka mundësi që të jetë dezertori, kështu që plotësisht e përkrah këtë ligj edhe me shpresën që Qeveria do të marrë hapa të nevojshëm që për disa kategori, siç janë veteranët e luftës, të mos pritët për implementim të privilegjeve të tyre deri më 2014, por që të fillojë më 1 janar 2011.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryesues!

Shumëçka u tha nga parafolësit lidhur me projektligjin dhe ajo çka do të duhej të theksoja në këtë rast, ndërlidhet edhe me fjalën e zëvendëskryeministrit, respektivisht me ekspozenë e tij që në fillim, duke e vlerësuar pozitivisht se kemi të bëjmë me një draftdokument me tendencë gjithëpërfshirëse dhe të krijojë kohezionin politik në vend, duke ruajtur edhe dinamikën institucionale, shtetformuese. Mirëpo, ajo çka po dëgjojmë këtu sot, si pjesë e këtij debati dhe ajo çka doli në pah, shihet se ky projektligj nuk i adreson këto objektiva që, në fakt, Qeveria ka pretenduar.

Ajo çka duhet të theksohet me këtë rast, se derisa nuk e krijojnë partnerët e koalicionit kohezionin politik në Qeveri, në ekzekutiv, nuk ka pse të kërkohet nga Kuvendi, duke ditur se këtu doli në pah se njeri partner i koalicionit, por ka edhe subjekte tjera politike në opozitë që kërkojnë që një projektligj i tillë të kthehet në ripunim, në mënyrë që të përfshihen të gjithë kontribuuesit, atyre të cilët ju atribuohet ky projekt.

Nganjëherë po krijohet përshtypja se kemi të bëjmë vetëm me një kategori, që e quajmë veteranët e luftës. Vetë titulli i këtij projektligji është shumë më i gjerë dhe nuk ka të bëjë vetëm me një

kategori, çka po pretendohet këtu të krijohet një kod i meritokracisë se kush dhe çka ka kontribuar në fazat e caktuara të historisë dhe, gjithsesi, si rezultat i të metave të politikës aktuale dhe të koalicionit të shtetit, që nuk ka arritur ta unifikojë një politikë kohezive në raport me këtë materie, atëherë në seancë plenare shfaqen opinione të cilat po e kthejnë rrotën e historisë mbrapa në vitet '99 – 2000 dhe nuk po arrihet të krijohet ajo çka po i pret jo vetëm qytetarët e Kosovës, po i pret edhe proceset politike një kohezion politik dhe një unifikim rreth ndërtimit dhe mbylljes së këtyre kapitujve që janë plagë aq të dhimbshme për qytetarët e Kosovës.

Ajo çka kërkohet sot, janë veprimet institucionale të unifikuara të partnerëve të koalicionit. Nuk mund të logjikohet se derisa kryetari i vendit dekreton individë në bazë të meritave të caktuara dhe jep urdhra të thirrura në kushtetutë dhe në legjislacionin në fuqi dhe një projektligj çfarë është ky t'i përjashtojë individët, veprimtarët të cilët në një fazë të caktuar kanë dhënë kontributin dhe janë shquar për meritat e caktuara. Pra, këtu diçka nuk po përputhet njëra me tjetrën. Prandaj, partnerët e koalicionit duhet të ulen dhe të krijojnë një politikë unifikuese sa i përket kësaj materie. Ne e dimë, u shfaqën këtu, u përmendën edhe me emra e mbiemra, mirëpo edhe me kategori të caktuara, që unë nuk pretendoj tash të kthehem dhe t'i përsërisë, mirëpo është e papranueshme që dikush të përjashtohet nga ajo dhe të thirremi të krijojmë një unitet veprues sa i përket këtij projektligji.

Ajo çka duhet të vë në pah, se nuk ka mundësi dhe nuk i bën nder Kuvendit që debatin ta orientojë duke krijuar kod meritokracie se kush ka kontribuar më shumë dhe kush më pak. Nëse kërkohet që ta marrë edhe epitelin e veteranit të luftës të Kosovës, unë këtu do të kisha propozuar që të gjithë kontribuuesit e NATO-s të futen në këtë projektligj. Mirëpo, nuk bëhet fjalë për një element të tillë. Unë konsideroj se partnerët e koalicionit...

(Ndërhyrje e kryetarit: Deputet, ju lutem, ju lutem!)

...duhet të ulen dhe mos të adresojnë këtë problematikë aq të dhimbshme, që është aq substanciale për të krijuar një kohezion politik në vend dhe ta gjuajnë topin te Kuvendi i Kosovës derisa nuk e kanë krijuar unitetin veprues përbrenda.

Ne, si Lidhje Demokratike e Dardanisë kërkojmë që një projektligj i tillë duhet të kthehet në ripunim dhe të kërkohet që të krijohen standarde të cilat nuk përjashtojnë asnjë kategori, asnjë kontribuues në faza të caktuara të cilët kanë kontribuar për procesin e lirisë dhe të pavarësisë së vendit. Po e them, edhe njëherë po e përsëris, është e papranueshme që derisa një institucion i shtetit të Kosovës dekreton dhe jep urdhra të heroit dhe nderit dhe me Urdhër të Medaljes së Artë të Pavarësisë individë të caktuar për kontributin në luftën çlirimtare dhe në fazat e ndryshme të historisë dhe të mos përfshihen në këtë projektligj, diçka nuk po përputhet. Prandaj, uluni partnerë të koalicionit, bisedoni, tëholloni këto punë pak më mirë dhe kur të dilni në Kuvend, dilni me një gjuhë. Kjo kërkohet sot, në qoftë se dëshironi të shtyni përpara dhe t'i zgjidhni të gjitha këto probleme që janë akumuluar për të gjitha këto kategori që kanë dalë prej luftës. Ju faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr zoti Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Unë po kërkoj që vërtet të debatoni dhe të diskutoni për ligjin. Jemi duke debatuar në parim dhe mendoj që kot po e politizoni. Unë kam thënë edhe në raste tjera, po e them edhe një herë, Kosova është e vogël, nuk i ka tamam 11 mijë kilometra katrorë dhe secili për secilin e dimë ku ka qenë dhe çka ka bërë. Ju lutem, mos e ngatërroni, është fjala për njerëz që kanë dhënë gjak dhe s'janë më hiq. Është fjala për njerëz që nuk e kanë dhënë vetëm një njeri, por kanë dhënë shumë. Është periudha e luftës dhe periudha pas luftës. Në dashi po i bëjmë heronj krejt shqiptarët por,

fatkeqësisht, ne nuk kemi ardhur për t'u çliruar në shekullin XXI pse kemi qenë krejt luftëtarë. Prandaj, mendoj që po e politizoni gabimisht një çështje. Është periudha e luftës dhe dihet kush ku ka qenë. Ne nuk jemi duke i ndarë njerëzit, përkundrazi. Unë mendoj që vetë titulli i ligjit është shumë përcaktues. Gjithë ata që kanë luftuar dhe kanë kontribuar për këtë vend në periudhë të caktuar dhe ajo luftë e ka një emër. Prandaj, nuk e di pse po e politizon kot.

Do të thotë, tash janë edhe dy diskutues, një ishte, po një tjetër erdhi tash. Fjalën po ia jap Besa Gaxherrit, le të përgatitet Sabri Hamiti.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë sot nuk e pata ndër mend për të diskutuar fare për këtë ligj për arsye se deputeti nga LDD-ja, zoti Geci e ka prezantuar mendimin e Grupit Parlamentar të LDD-së, por realisht më nxitën disa diskutime, debate të kolegëve të mi këtu. Unë dua ta bëj një pyetje. Po e lëmë atë që e debatua deri tash se a janë përfshirë të gjitha kategoritë, të gjitha epokat, të gjitha etapat. Unë po ju pyes: A jeni vërtet serioz, jo a jemi, po a jeni ju, Qeveria dhe mazhoranca serioz për ta bërë një ligj të tillë? Unë po jap përgjigje - nuk jeni. Unë po ju them që të gjitha këto kategori të përfshira në këtë ligj, me këto implikime buxhetore që ka, kjo është një hi syve, të bëjë politikë Qeveria me këto kategori, t'i ulë, t'i stabilizojë dhe mos ta realizojë asnjë përgjegjësi që ka ose që e keni të gjithë ndaj familjarëve të tyre sepse, vërtet, ata të cilët e kanë dhënë tashmë jetën, nuk janë këtu e ne jemi këtu dhe vendosim për fatin e familjarëve të tyre, por edhe për punën, kontributin që kanë dhënë ata. Domethënë, për mendimin tim, ky ligj dashur e pa dashur, është para dy sfidave: asaj politike dhe asaj buxhetore, e që realisht të dyja janë aq të ngarkuara që, faktikisht, ky ligj s'ka shans të implementohet. Ne mundemi sot ta aprovojmë, se këtu jemi bërë gjithë patriotë, të gjithë i duam dëshmorët, të gjithë i përkrahim, të gjithë japim propozime, amendamente, por realisht duhet tregua sot që 100% nëse e votojmë, s'ka për t'u implementuar ky ligj, jo, nuk ka për t'u implementuar. Të lutem, sot këtu e ke zëvendëskryeministrin, të çohet e të më tregojë konkretisht sa kushton implementimi i këtij ligji? Nuk ka hajgare dhe patriotizëm këtu me njëri - tjetrin dhe, realisht, asnjë ligji, ne jemi deputetë, nuk thirrmi këtu, nuk e marrim fjalën si ekspertë, por jemi të gjithë të zgjedhur, jemi politikanë. Edhe një herë po them, nuk mund të fshihet asnjë etapë, asnjë epokë e historisë sonë, nuk mund të fshihet as etapa kur vërtet e ka filluar organizimin e ushtrisë Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës së atëhershme, nuk mundet, deshi dikush a nuk deshi. A duan na t'i ikim realitetit çfarë ka ndodhur në Kosovë? Derisa t'i ikim realitetit, ne s'do të mund të bëjmë asgjë. Mos u qesh, se kam qenë edhe unë në luftë, ju kam parë çka keni bërë. Ju lutem shumë, në luftën tonë çlirimtare kanë ndodhur vrasje edhe në mes dy organizimeve të luftës. A duam t'i ikim këtij realiteti dhe sot, kush është më i fortë, do ta legjitimojë atë bajraktarin që ka qenë më i fortë, se ata që kanë vdekur, nuk kanë vdekur cili të jetë bajraktar. Ai ka hyrë në luftë vërtet për të vdekur për Kosovën. Po, ne të gjallët, ne të gjallët tash duam edhe me ligj ta marrim bajrakun, cili do ta marrë? Nuk ka kështu, sepse shumica prej këtu ku jemi ne, jemi kah e bëjmë historinë, shumica prej nesh i ka sot fuqitë ekonomike, politike për ta shkruar historinë e Kosovës, se s'është kah e bën populli i thjeshtë. Në histori po shkruajmë çka po duam ne, jo qysh është realiteti. Prandaj, duhet të keni kujdes me data, prandaj duhet të keni kujdes me ligje, ligji nuk bëhet për një kategori, por ligji bëhet për të gjithë, për t'i respektuar dhe duhet ta dimë që vërtet nuk ka çmim që mund t'i shpaguej ato familje çfarë ka vuajtur, që i kanë dhënë më të dashurit, por realisht së paku të jemi të sinqertë me ta dhe na e dimë, ne s'kemi të dhëna të sakta as sa i kemi, as ku i kemi, as sa kushtojnë edhe sot bëjmë politikë me këta njerëz të tillë dhe kallëzojmë cili kemi qenë më patriot, cili ia ka filluar i pari, cili i mbrami.

Prandaj, zoti kryetar, diskutimin që e patët ju, mua më pëlqeu shumë. Të kisha lutur ta ruash atë, se më pëlqeu, seriozisht. Deri diku u mundove ta mbash një balancë, prandaj të kisha lutur, të kesh

kujdes dhe keni kujdes, kolegë deputetë, ligjin duhet ta bëjmë dhe ta implementojmë, mos të bëjmë hajgare me vetveten, ky ligj duhet të kthehet. Qeveria e Kosovës duhet të na bien urgjent sa kushton, sa kushton dhe ne duhet ta votojmë në buxhet dhe ai ligj duhet të fillojë të implementohet. Mos bëni edhe një vit, edhe dy vjet politikë me këto kategori, se është e padrejtë. Faleminderit!

KRYETARI: Ju kisha lutur, mos u ndikoni nga diskutuesit. Unë ju thashë më parë, diskutuesi i fundit ka qenë Sabri Hamiti dhe Sabri Hamiti e ka fjalën. Pastaj hyjmë në procedurë të votimit, pas fjalës së Sabriut.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit,

Unë nuk kam pasur shansin t'i përcjell diskutimet sepse për arsye të mia s'kam mund ta përcjell diskutimin. Ndoshta është edhe më mirë, sepse megjithatë do të mbetem në 2 – 3 pikat themelore të cilat i kam menduar që t'i them lidhur me këtë ligj. Janë 2 – 3 nene që janë fundamentale, mendoj unë.

Unë po filloj nga neni i fundit, që është neni 25 i këtij projektligji - Shfuqizimi i dispozitave ligjore, mandej e kemi një dispozitë ligjore, dy, tri, katër, pesë. Kur hyn në fuqi, bien të gjitha këto dispozita ligjore të mëparshme. Kjo tregon që kjo materie është ripunuar në këtë Kuvend, zonja edhe zotërinj, është diskutuar gjerë e gjatë 4 – 5 herë në seanca plenare të Kuvendit të Kosovës, edhe ai është Kuvendi i Kosovës edhe pse legjislaturë tjetër, domethënë ka pasur një rregullativë të aprovuar brenda këtij Kuvendi me diskutime shumë më shteruese se një ditë, por ne po duam ligj më të mirë se ky i përparmi.

Desha të them, që mos të mendojnë se po nisemi nga zero. Unë, sa isha këtu, shumë shpejt pashë edhe lamentacione qysh s'u kujtua kush për këtë punë, s'është e vërtetë. S'është e vërtetë, ky Kuvend ka punuar për këto kategori dhe ka nxjerrë edhe ligj. Kjo ishte nga fundi.

Kalojmë te fillimi, më intereson neni 3, ku bëhen përkufizimet e kategorive. Duket si nen i shpjegimeve të nocioneve elementare, por në këtë rast është shumë thelbësor. Dhe unë po ndalem në kategorinë më të fortë, që është kategoria e dëshmorit.

Në këtë nen kemi dy përkufizime të dëshmorit të kombit. I pari është pjesëtari i UÇK-së që ka rënë në luftë kundër okupatorit nga 30 dhjetor 1991 deri më 19 shtator 1999.

- 1.6.2, është plagosur nga forcat e armikut dhe ka vdekur brenda tri viteve nga dita e plagosjes pas datës 19.09.1999.

- 1.6.3, si shtetas i huaj është vrarë në cilësinë e pjesëtarit të UÇK-së për lirinë e Kosovës, dhe

- 1.7 dëshmor i kombit është edhe veprimtari që ka kontribuar për çështjen kombëtare individualisht ose i organizuar në grup, i cili është vrarë nga armiku nga data 9 maj 1945 deri më 30 dhjetor 1991.

Domethënë, i kemi përkufizimet për kategorinë, unë kujtoj themeloren, kryesoren, të dëshmorit të kombit.

Çka shohim ne këtu? Ne shohim një kategori që lidhet me një 10-vjetësh dhe një kategori që lidhet edhe me 40-vjetësh të tjerë, që shkon dhe analizohet në mbrapashikim dhe unë e përkrah edhe herën tjetër. Jam njeri prej atyre që shumë kam insistuar që kjo të shtyhet, domethënë kategoria e dytë për të cilën fola dhe më vjen mirë që është në këtë projektligj.

Por, ne e kemi edhe një deçenie tash, dikush e preki pak a shumë, sa hetova edhe këtë problem. Që kemi njerëz, një deçenie pas luftës, pas konfliktuale si gjendje edhe brenda Kosovës, edhe kundrejt Kosovës, lëvizjeve të jashtme... Ju kujtoni që ky vend tash është i siguruar prej ndikimeve, lëvizjeve përtej Kosovës, as sot, as sot që po flasim. Pra, kemi dhe rënie të njerëzve të tjerë të rëndësisë së veçantë, qofshin të regjistruar si UÇK, qofshin jo si UÇK, të cilët bile kanë marrë edhe tituj - dëshmorë të kombit - dhe iu përkujtohen datat e rëndësishme si dëshmitarë të kombit. E kjo kategori në ligj nuk ekziston. Unë mendoj që duhet të gjendet mundësia të inkuadrohet edhe kjo. Prapë të shkojnë këto - plus një deçenie, ta quaj unë, sepse nëse shkojmë në mbrapa vështrim, nuk ka arsye, edhe ky 10-vjetësh është mbrapa vështrim, derisa ne po nxjerrim ligj sot. Dhe kaloj... ky ishte neni 3, që me këto dy përkufizime zgjidh shumë probleme, për pa hyrë në analiza ose perceptime politike.

Mua më duket që është 15-shi neni që merret me komisionin. Ai është një nen themelor, sepse është komisioni qeveritar i cili faktikisht do të krijojë kategoritë. Ky është komisioni themelor.

Unë mendoj që ai komision themelor duhet të ribëhet si strukturë, si përfaqësim, meqë është propozuar me përfaqësim pak a shumë të një burimsie të formacioneve kryengritëse, unë mendoj që ai mund të plotësohet dhe me dy kategori plotësuese dhe të mund ta kryej prapë punën pa tensione dhe pa perceptime të njëanshme të caktimit të kategorive, sepse zonja dhe zotërinj, ne nuk jemi pos dynjasë dhe nuk jemi popull i lumtur sepse kemi shumë heronj. Dituritë e botës tregojnë që ata që kanë shumë heronj, kanë vajtuar shumë dhe s'kanë pasur faktikisht liri. Kush ka liri, ka pak heronj të luftës. Ne kemi dy lufta çlirimtare të deklaruara në gjysmën e dytë të shekullit XIX, njëri i kemi thënë Nacional Çlirimtare, e kësaj të dytës i kemi thënë Ushtria Çlirimtare e Kosovës, të dyja e kanë atributin brenda. Po ky vend ka pasur formacione kryengritëse ose rebeluese edhe në ndërmjetëza dhe ju të gjithë e dini dhe unë njoh edhe njerëz këtu brenda kësaj sale që ju kanë takuar këtyre formacioneve që nuk kanë mundur të ngrihen në nivelin e organizimit të komandimit të strukturuar, por kanë qenë formacione edhe luftarake, edhe kryengritëse, edhe të rebeluar. Unë kur po flas për atë komision, për atë plotësim, kam parasysh këto elemente të luftës çlirimtare për lirinë e Kosovës, që nuk lidhen vetëm me një formacion, që nuk lidhen vetëm me një vit, që nuk lidhen vetëm me një definim, jo vetëm me një afishim, jo vetëm me një shkurticë.

Këto ishin vërejtjet e mia. Ligji duhet të bëhet për këtë fushë, sepse edhe ashtu një ligj në funksion ekziston në Kosovë. Mirëpo, unë mendoj që ka punë, ka punë dhe nëse juve ju interesojnë këto tri pika, unë do t'juaj shkruaj amendamentet nëse i pranoni. Domethënë, vullnetarisht! Nuk jam në atë komision i cili është. Desha të them që nuk ka nevojë të bëjmë stërhollime politike tash në Kuvend për merita e jo merita. Njerëzit që kanë vdekur për këtë vend, i kanë meritat të gjithë, pa marrë parasysh datën kur janë vrarë, kështu që përfaqësuesit e grupeve parlamentare në atë komision që merret funksionalisht me të, le të përforcohen edhe me kryetarët e grupeve parlamentare dhe le t'i marrin e le t'i saktësojnë këto çështje, se mund të saktësohen. Faleminderit shumë, zoti kryetar!

KRYETARI: Faleminderit!

Diskutimet i kemi kryer. Jo, jo, janë kryer diskutimet.

Në sallë kemi 80 deputetë.

Urdhëro, mbasi je kryetar i grupit të dytë parlamentar, urdhëro, e ke fjalën. Deputeti Ismet beqari.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Unë, në frymën e kësaj që e tha edhe profesori. Unë desha vetëm të na i jepni 10 minuta pauzë për t'u konsultuar, sepse nuk është dëshira jonë që të shkohet të votohet për diçka, nëse krijohet përshtypja që votojmë të përçarë për këtë ose atë. Ne dëshirojmë të kontribuojmë, vërejtjet ne i kemi

thënë. Por, e kam një lutje që ne shefat e grupeve të konsultohemi me ju dhe për 10 minuta kthehemi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

A jeni dakord për një pauzë 10 - 15 minuta? Jo, po e bëjmë një pauzë prej 10 minutash. Shefat e grupeve le të vinë te unë pak.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Në sallë janë 81 deputetë. Ne e patëm një bisedë të shkurtër me shefat e grupeve parlamentare dhe kemi ardhur në një përfundim që për raportin përfundimtar dhe rekomandimet e këtij projektligji të punojnë dy komisione bashkë: Komisioni për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Komisioni për Legjislacion, të ndihmuar nga shefat e grupeve parlamentare. Dhe, nëse e sheh të nevojshme ky grup i punës, i ngarkuar për këtë ligj të nevojshëm, që të bëhet ndarja e ligjeve sipas kategorive, të bëhet dhe mendoj se është zgjidhja më e mirë e mundshme. Por sot, do të thotë, sot miratojmë në parim dhe mbetet në kompetencat e këtij komisioni për të bërë një ligj që vërtetë i përmbush kërkesat e të gjitha kategorive.

Prandaj, lus deputetë dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Në sallë janë 79 deputetë.

Nga këta, 75 deputetë kanë votuar “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi Projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së dhe të viktimave civile të luftës. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e radhës.

Atëherë, vazhdojmë nesër në orën 10:00.

E mërkurë, 8.9.2010, ora 10:00, vazhdimi i seancës

Drejton seancën: kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuari ministër,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar 6 shtator 2010, për pikat e mbetura.

Mund të vazhdojmë me pikën 14 të rendit të ditës.

Para se të fillojmë, pasi nuk e kemi numrin e nevojshëm, duhet të presim edhe pak. Ju kisha lutur, kështu, pa qenë nevoja të votojmë, diskutimet të jenë të shkurtë 3 deri 5 minuta. Ne duhet të përpiqemi që t'i kryejmë pikat e rendit të ditës sot. Nëse nuk i kryejmë sot, duhet t'i kryejmë të premten, duhet të vazhdojmë të premten. Prandaj, unë po kërkoj që në diskutime të jeni më racional sot se sa dje. Po, a jeni dakord që të kërkojmë prej regjisë që mbi 5 minuta kur të bëhe, t'ua ndalë fjalën. Në emër të grupit mund të flasim deri 10, atë nuk po ua prishim ne, por ju të tjerët, pas shefave të grupeve racionalizojeni kohën.

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji. Ftoj ministrin e drejtësisë, zotin Haki Demolli, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI HAKI DEMOLLI: I nderuari kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Në emër të Ministrisë së Drejtësisë po i paraqes për miratim në parim Kuvendit të Republikës së Kosovës Projektligjin për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës.

Ky projektligj është rezultat i punës dhe i përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e saj, pasi që legjislacioni aktual nuk e rregullon në tërësi dhe në nivel të kënaqshëm problemin e rrëmbimit ndërkombëtarë të fëmijëve.

Fillimisht, do të theksoj se dispozitat e këtij projektligji janë në harmoni të plotë me dispozitat e legjislacionit të Bashkësisë Evropiane, fakt ky i vërtetuar edhe me deklaratën mbi pajtueshmërinë me legjislacionin e BE-së, të lëshuar nga Ministria e Integritimit Evropiane.

Ky projektligj ka për qëllim krijimin e një baze ligjore që përcakton themelimin e mekanizmave ligjor për sigurimin e kthimit të shpejtë të fëmijëve që largohen apo mbahen pa të drejtë në shtetin e vendqëndrimit, si dhe sigurimin e respektimit të të drejtës së kujdestarisë dhe të kontaktit të fëmijëve, që janë banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës apo të një shteti të kërkuar.

Më tutje, ky projektligj rregullon procedurën që duhet zbatuar në rastet e rrëmbimit ndërkombëtarë të fëmijëve. Po ashtu, përcakton kompetencat procedurale dhe materiale të Gjykatës së Qarkut dhe të Ministrisë së Drejtësisë për të vendosur lidhur me çështjen e rrëmbimit të fëmijëve.

Përmes zgjidhjeve të këtilla juridike, projektligji krijon një bazë të qëndrueshme ligjore, e cila do të ndikojë në rritjen e efikasitetit të institucioneve përkatëse.

Projektligji është përgatitur nga zyrtarët ligjorë të Ministrisë së Drejtësisë, në bashkëpunim me kolegët e tyre ndërkombëtarë. Bashkëpunimi i tillë synon krijimin e një sistemi të pavarur të drejtësisë, të një sistemi të integruar profesional dhe të paanshëm, i cili garanton mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Gjatë këtij ekspozitimi duhet theksuar se ky projektligj do të zbatohet dhe interpretohet në pajtim të plotë me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me ligjet e tjera të aplikueshme në Kosovë.

Gjithashtu, ky ligj do të zbatohet në pajtim me dispozitat e Konventës së Hagës mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve të vitit 1980, si dhe me praktikat më të mira të siguruara nga Konferenca e Hagës mbi të drejtën ndërkombëtare private.

Për më tepër, ky projektligj zëvendëson dhe shfuqizon Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/24, me të cilën aktualisht është duke u rregulluar kjo fushë e drejtësisë kosovare.

Andaj, i nderuari kryetar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Duke qenë plotësisht i bindur se aprovimi i këtij projektligji nga Kuvendi i Republikës së Kosovës është në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e drejtësisë dhe të avancimit të

standardeve më të larta të të drejtave të njeriut, propozoj që pas diskutimit dhe shqyrtimit në këtë seancë ky projektligj të miratohet, në parim, në mënyrë që të procedohet më tutje për aprovim dhe fuqizim. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Para se t'ua jap fjalën shefave të grupeve parlamentare, ndoshta ka qenë mirë të shikohet ose të krahasohet ndoshta edhe me ndonjë ligj të ngjashëm në Republikën e Shqipërisë titulli i ligjit. Shikoni, siç është: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aspekte civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve. Nuk e di sa vërtetë tingëllon mirë ky emër i ligjit, siç është paraqitur këtu.

Vazhdojmë me shefat e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit parlamentar të Partisë Demokratike, kush e ka kërkuar fjalën? Deputeti Ramadan Gashi e ka fjalën.

RAMADAN GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka shqyrtuar Projektligjin për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve dhe ne konsiderojmë se nga vetë fakti që kjo fushë ende është e rregulluar me një Rregullore të UNMIK-ut, mendojmë se është i domosdoshëm aprovimi i këtij ligji, i cili ka një rëndësi të veçantë.

Rëndësia e projektligjit qëndron edhe në atë se ndër kushtet e përcaktuara me Raportin e progresit të Komisionit Evropian dhe Udhërrëfyesin për liberalizim të vizave është edhe miratimi i ligjeve për bashkëpunim juridik ndërkombëtar, në të cilën fushë hyn edhe rrëmbimi ndërkombëtar i fëmijëve.

Në sistemin juridik të Republikës së Kosovës me aplikimin e këtij projektligji do të arrihen qëllime të shumta, e në rend të parë sigurimi i kthimit të shpejtë të fëmijëve që largohen apo mbahen pa të drejtë në shtetin e vendqëndrimit.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës përkrah votimin në parim të këtij projektligji.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Armend Zemaj e ka kërkuar fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje, zëvendëskryeministër, ministër!

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve, i cili buron nga konventa ndërkombëtare që është për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtarë të fëmijëve, ndoshta edhe këtu e ka burimin edhe si titulli i projektligjit dhe këtu është bazuar. Sigurisht që ndoshta në aspektin gjuhësor mund t'i përshtatet standardeve tona gjuhësore. Grupi Parlamentar e ka shqyrtuar dhe e sheh të nevojshme që të plotësohet kjo infrastrukturë ligjore sipas standardeve më të mira ndërkombëtare.

Ne e përkrahim në parim dhe disa për çështje teknike që kanë të bëjnë me përmirësimin, do të japim kontributin tonë në komisionin funksional. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka kërkuar deputetja Gjylnaze Syla. Mirë, po ju po paraqiteni shumë. Zylfije Hundozi e ka fjalën.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zotërinj ministra, zotërinj deputetë,

Me këtë projektligji rregullohet mënyra specifike, çështja dhe rëndësia e sigurimit të kthimit të shpejtë të fëmijëve që largohen apo mbahen pa të drejtë në shtetin e vetqëndrimit. Gjithashtu, me këtë sigurohet edhe respektimi i së drejtës së kujdestarisë dhe kontaktit me fëmijët të cilët, po ashtu, janë banorë të përhershëm të Kosovës apo të një shteti kërkuar.

Në Raportin e progresit të Komisionit Evropian ka qenë vërejtje mungesa e ligjeve për bashkëpunim juridik ndërkombëtar, në të cilën fushë hynë edhe rrëmbimi ndërkombëtar i fëmijëve, prandaj miratimi i këtij ligji do të ndihmojë që të përmbushen kriteret edhe për liberalizimin e vizave dhe do të ketë një vërejtje më pak në Raportin e progresit të këtij viti.

Ky projektligj është në përputhje me Konventën Evropiane për aspekte civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve, të datës 25 tetor të vitit 1980.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah miratimin, në parim, të këtij projektligji dhe do ta japë kontributin e vet në komisionin funksional. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Suzan Novobrdali e ka kërkuar fjalën.

SUZAN NOVOBRDALI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Shumë të respektuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe është e vetëdijshme për rëndësinë e këtij projektligji.

Rëndësia primare e këtij projektligji është sepse, më në fund, mund të luftojmë rrëmbimin e fëmijëve në mënyrë të kundërligjshme. Rëndësia e dytë është se është kusht për liberalizimin e vizave.

Ne i kemi disa vërejtje në këtë projektligj, të cilat do t'i them tani. Për shembull, në nenin 2 pika 1.7, definicioni i kujdestarit të përkohshëm është i gabuar meqë thotë: “kujdestari i përkohshëm nënkupton personin i cili e ka larguar fëmijën pa të drejtë ose personi të cilit i u është besuar fëmija në Kosovë, siç është përcaktuar me këtë ligj”. Një definicion i gabuar sa i përket kujdestarit të përkohshëm meqë definicionin e kujdestarit të përkohshëm e kemi edhe në ligjet speciale dhe nuk është i tillë. Këtu kemi të bëjmë me një keqpërdorim të detyrës, që i besohet kujdestarit të përkohshëm. Mirëpo, definicioni si kujdestar i përkohshëm është i gabueshëm dhe kjo duhet të rregullohet.

Neni 3, edhe më herët do të them se në këtë projektligj ka gabime gjuhësore, ka gabime me formulim të fjalive të pakuptueshme, që më vonë e bëjnë të pakuptueshme edhe çështjen. Me siguri është një përkthim bukval nga anglishtja në shqip, po supozoj. Këtë do ta dëshmojë se do t'ju lexoj një paqartësi, për shembull, e kemi te neni 3, 1.2, ku thotë: “Në kohën e largimit apo mbajtjes, këto të drejta janë ushtruar qoftë bashkërisht apo individualisht ose që mund të kenë qenë të ushtruar me

përrjashtim të largimit apo mbajtjes”, domethënë në shumë nene haset një pakuptueshmëri e çështjeve, është një vështirësi në kuptimin e çështjeve.

Pastaj kemi një vërejtje në nenin 4, ku e kemi jurisdikcionin e gjykatave, thotë: “Nëse për kërkesën nuk merret një vendim nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë brenda një periudhe 6 javore, nga data e fillimit të procedimit, Ministria e Drejtësisë ka të drejtën të kërkojë nga kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë që brenda 5 ditësh të japë një deklaratë për shkaqe të vonesës”. Do të thotë, periudha 6 javore e nënkupton 45 ditësh, t’ia shtojmë edhe 5 ditë tjera që kërkohet të jepet një deklaratë, këtu kemi të bëjmë me 50 ditë. Derisa një fëmijë i rrëmbyer jashtë ligjshëm është diku, e ne nuk e dimë ku është e i lëmë kohë gjykatës që për një kërkesë të Ministrisë të vendos 50 ditë, çka do të thotë afër 2 muaj ditë, mua më duket një kohë e gjatë edhe e paarsyeshme, çka bie në kundërshtim me nenin 4, ku thotë: “Ministria e Drejtësisë, autoriteti qendror në Kosovë për të kryer detyrat e përcaktuara me këtë ligj”, do të thotë, në pikën 2.2. thotë: “ka për detyrë të parandalojë dhe të mbrojë fëmijën nga veprime të dëmshme duke marrë ose bërë që të merren masa të përkohshme”. Si mund ta mbrojë fëmijën nga veprime të dëmshme në afat prej 60 ditësh, gati 2 muaj ditë, do të thotë mendoj se kjo është një kohë e gjatë dhe duhet të shkurtohet.

Ne i kemi edhe disa vërejtje, por për të mos e zgjatur më shumë, do ta japim kontributin tonë në komisionet përkatëse. Në parim, e përkrahim këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, fjalën e ka Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ne pajtohemi me kryetarin, sepse duhet të bëjmë diçka në ndryshimin e emrit, se është disi i pakuptimtë emri në këtë projektligj dhe ne do të konsultohemi edhe me ligjet e këtilla që i kanë vendet përreth. Duke pasur parasysh se Raporti i progresit na bënë vërejtje që të rregullojmë këtë fushë me anë të ligjit, ky ligj është dashur të vijë edhe më herët në Kuvend dhe tash ne duhet që brenda këtij muaji ta kemi këtë ligj të miratuar. Prandaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë me kohë do t’i japë vërejtjet e veta gjatë amendamentimit të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputetja Shpresa Murati e ka fjalën.

SHPRESA MURATI: Hvala, predsedniče!

Pozdravljam sve prisutne!

I Parlamentarna grupa „7+“ razmatrala Nacrt zakona o civilnim aspektima međunarodne otmice dece. Postoje izvesne nejasnoće skoro u čitavom tekstu nacrt zakona, počivši od definicija. U definicijama u članu 2, stav 1.2, kad se definiše država potražioc, kaže se da znači državu koja je stranka po Haškoj konvenciji. Smatramo da je definicija nedorečena, te da treba detaljnije odrediti šta u stvari označava država potražioc.

Pravo starateljstva takođe nije jasno definisano u članu 2. stav 1., tačka 5. jer ne označava koja lica imaju to pravo. Zatim, u narednom stavu takođe nije jasno definisano pravo kontakta, šta označava udaljavanje ili bespravno držanje, šta znači u državi prebivališta, i konačno koja su u stvari ta lica koja bespravno udaljuju dete. I pored svih ovih naših primedba, Parlamentarna grupa „7+“ u načelu podržaće ovaj zakon i daće svoj doprinos u toku njegove dalje procedure. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Slobodan Petroviq e ka fjalën.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, predsedniče!

Uvaženi zamenice premijera, ministri i poštovane kolege i kolegice narodni poslanici, Samostalna liberalna stranka se pridružuje onim strankama koje u načelu podržavaju predlog Nacrta zakona, s tim što uzimamo za obavezu da one nejasnoće koje su u Predlogu zakona iznešene, odnosno i primetili smo da ima par jezičkih grešaka, da kroz amandmane koje ćemo dati kroz funkcionalne komisije, da damo značaj i doprinos ovome zakonu. Još jednom, Poslanička grupa Samostalne Liberalne stranke u načelu podržava predlog zakona.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar për Integritet, deputetja Vezira Emrush e ka kërkuar fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Ponovo imamo jako važan zakon pred nama. Kao što znamo, danas se radi o Nacrtu zakona o civilnim aspektima međunarodne otmice dece. Kod nas piše da je to Zakon o aspektima međunarodnog otimanja dece, što vidimo ovo iz samog naziva, ovo sam dala dva primerka da je jako, jako loš prevod i ne samo prevod i nejasnoća zakona nisu, nam jasni veliki pojmovi, kao što je naznačila kolegica, neću da zamaram sa ovim pitanjem, ali hoću da dam do znanja da se radi o jako važnom zakonu, kada su u pitanju otmica dece, što svi znamo da je krivično delo od strane počinioca kada su deca u pitanju i koja su zaštićena, da je delokrug zakona jako važan i deca su zaštićena Međunarodnom konvencijom. Na osnovu ove međunarodne konvencije mi imamo obavezu za ovaj zakon, za donošenje ovog zakona i, što je jako važno, on znamo da je na listi zakona za liberalizaciju viza i, to je normalno, osnovni zakon gde mi moramo da potvrđujemo i da obezbeđujemo sigurnost i slobodu kretanja svih građana, naročito dece.

Moram ponovo da kažem da ćemo mi kao grupa, mi smo razmatrali ovaj zakon, doneti pojedince stavove i dati u pismenoj formi funkcionalnim komisijama gde se ovaj zakon radi, jer to je u pitanju Ministarstvo pravde, u pitanju je Policija, u pitanju je i sama Vlada, te ćemo gledati da se pospeši i molim da što više, kada budu doneti amandmani na ovaj zakon, da barem prevod bude dobar ako je to moguće. Hvala lepa na pažnji!

KRYETARI: Ju faleminderit! Kemi dy deputetë për fjalë që janë lajmëruar. Fillojmë me deputeten Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar qeveritarë,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve trajton një çështje shumë të rëndësishme që ka të bëjë me promovimin dhe mbrojtjen e interesave të fëmijëve, që sipas këtij projektligji janë fëmijët nën moshën 16 vjeçare. Kjo fushë deri më tani është rregulluar përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/29 për mbrojtje kundër rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve.

Se sa është nevoja e rregullimit të kësaj fushe brenda në Kosovë, është me siguri çështje që duhet t'i përgjigjet Ministria e Drejtësisë kërkesave të qytetarëve të Kosovës lidhur me vendqëndrimet e fëmijëve në shtetet e caktuara. Gjithashtu, duhet t'i përgjigjet kërkesave të shteteve të huaja që i drejtohen shtetit të Kosovës.

Megjithatë, zoti ministër, e kam një pyetje për ju. Pse projektligji quhet pikërisht me të njëjtin emër sikurse quhet edhe Konventa e Hgës, do të thotë Konventa e Hagës ka pikërisht këtë emër, quhet Konventa mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës. Do të thotë, a është dashur të emërohet si projektligj apo është dashur më shumë Ministria e Drejtësisë t'ia bëjë një propozim Kuvendit që në të vërtetë të miratohet kjo konventë, për arsye se përmbajtja e projektligjit më tepër ka të bëjë si një mekanizëm për zbatimin realisht të atyre dispozitave të cilat i përmban edhe konventa.

Në botë incidenca e rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve është në rritje, sidomos për shkak të mundësive më të mëdha të lëvizjes ndërkombëtare ose të udhëtimit ndërkombëtar, të martesave mbi kulturore dhe rritjes së numrit të shkurorëzimeve. Pra, është një çështje mjaft e ndjeshme. Por, fëmijën, do të thotë mekanizmi i cili është përdorur këtu, domethënë kthimin e shpejtë të fëmijës në shtetin e vendqëndrimit, është një parim që përfshin projektligji. Por, nuk duhet harruar se konventa përfshin, do të thotë, një çështje që ka të bëjë më tepër me mbrojtjen e fëmijëve, do të thotë, parimi i kthimit të menjëhershëm më tepër shërben edhe si pengesë për rrëmbimet dhe largimet e gabuara. Ndërsa, urdhri i cili është dhënë ose që jepet sipas Konventës për kthim, urdhri për kthim pra është rivendosje e status kuos që ka ekzistuar para largimit ose mbrojtjes së gabuar dhe privimin e prindit nga ndonjë avantazh, që përndryshe mund të fitonte nga rrëmbimi.

Konventa e Hagës kërkon që të luftohet rrëmbimi i fëmijëve nga prindërit, pra, duke siguruar një sistem të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve qendrore në një procedurë të shpejtë të kthimit të fëmijës në vendin e banimit të përhershëm të fëmijës.

Të gjitha këto, ministër, i thashë me qëllim që konventa është më e gjerë, përpos kësaj është e plotësuar edhe me konventa të tjera në vitet e mëvonshme dhe me mekanizma të tjera, duke përfshirë gjithashtu edhe praktikën e gjyqeve ndërkombëtare.

Autoriteti qendror, sipas projektligjit, është pa tjetër Ministria e Drejtësisë, e cila është një mekanizëm bashkëpunimi. Mekanizma të tjerë që përfshin projektligji janë gjykatat, por edhe policia.

Projektligji përcakton përgjegjësitë e Ministrisë së Drejtësisë dhe juridiksionin e Gjykatës së Qarkut për të vendosur për çështje.

Projektligji është i ndërruar me projektligje të tjera, me Ligjin mbi procedurën kontestimore. E kuptuam nevojën që projektligji të kalojë, sidomos për shkak të bashkëpunimit ndërkombëtar. Megjithatë, po e përsëris se konventa konsiderohet si një ndër instrumentet më të rëndësishme në të drejtën ndërkombëtare familjare. Përndryshe, ligji ka kosto të përballueshme për buxhetin e Kosovës.

Në parim, e kisha përkrahur, por mendoj se më mirë do të ishte që Kosova të jetë nënshkruese e konventës, duke marrë parasysh se 80 shtete e kanë nënshkruar këtë konventë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

I fundit për fjalë është deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryetar,
I nderuar zotëri zëvendëskryeministër,
Zotërinj ministra, deputetë të respektuar,

Ky është një dokument i mirë, serioz dhe është përgatitur mirë. Mirëpo, do të flas në kontest me këtë dhe me disa raste të tjera, që asnjë ministër nuk mund t'i bëjë as juristët, as gjuhëtarët juristë të mirë, as gjuhëtarë të mirë, së pakut jo përnjëherë, kjo është një.

Dy, as fakultetet e tashme qoftë private, qoftë publike nuk e kanë atë kapacitet. Ndër të tjera, jap se shpallet konkursi për 500 studentë, pranohen 1500 studentë, e kështu. Ky është një problem shoqëror dhe jo vetëm në këtë dokument, por në të gjitha dokumentet ka mangësi, ka dobësi letargjike e kështu, gjuhësore, terminologjike, ju lutem, e për ligjin termi është substancial, se më pastaj vjen aplikimi, kjo është një.

Do të thotë, disa vërejtje që u dhanë këtu, konsideroj që janë me vend edhe natyrisht do të eliminohen gjatë leximit të dytë. Kur është në pyetje Konventa për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar jo “mbi” por “për” të fëmijëve, e miratuar më 25 tetor 1980, unë angazhohem që në të ardhmen, se nuk është ky rasti i parë që ne bëjmë ligje në konformitet me konventat, ne e kemi edhe në kushtetutë atje, konventat, disa i kemi taksativisht të cilat aplikohen drejtpërdrejt, por tjerat që do të duhej të miratoheshin, domethënë do të duhej të ratifikoheshin në Kuvendin tonë. Unë angazhohem që në të ardhmen, në raste të kështilla të aplikojmë ratifikimin e konventave si dokumente origjinale dhe ato automatikisht shndërrohen në burime juridike të drejtpërdrejta, bëjmë ligje natyrisht në pikat, në pjesët, në segmentet të cilat nuk mbulohen apo që janë specifikum për neve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Nuk kemi të tjerë të lajmëruar për fjalë.

Vazhdojmë me votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 53 vota “për”, 1 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve.
Në sallë janë 62 deputetë.

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, ngarkohen këto komisione:

Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional, dhe komisionet e përhershme. Komisionet duhet që brenda 2 muajve, natyrisht, në afat më të përshpejtuar, nga shqyrtimi i parë Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën 15 të rendit të ditës:

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Blerand Stavileci, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: I nderuar kryetar,

Të nderuar dhe të çmuar deputetë,

Unë do ta bëj prezantimin e Projektligjit për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit.

Me këtë ligj përcaktohen parimet e përgjithshme dhe procedurat e veçanta me të cilat rregullohet prodhimi, grumbullimi, përpunimi dhe tregtimi i duhanit të papërpunuar dhe të produkteve të tij në Republikën e Kosovës.

Ky ligj rregullon marrëdhëniet juridike që kanë të bëjnë me procedurat, të drejtat dhe detyrat e subjekteve që merren me prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit.

Mos posedimi i një ligji adekuat që do të rregullonte zhvillimin e kësaj veprimtarie ekonomike në të kaluarën, ka kërkuar nevojën e nxjerrjes së këtij projektligji.

Para dhe gjatë hartimit të këtij projektligji janë bërë hulumtime dhe konsultime të gjëra nga kjo fushë, si dhe janë shikuar ligjet e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të shteteve të tjera të regjionit. Si burime primare janë marrë burime të legjislacionit të BE-së, Rregullorja e Këshillit nr. 2075/92 për organizimin e tregut të duhanit, Rregullorja nr. 1636/98 për ndryshimin e Rregullores nr. 2075/92 për organizimin e tregut të përbashkët të duhanit dhe Direktiva nr. 2001/37 për produktet e duhanit.

Projektligji përmban 10 krerë dhe 40 nene. Nenet 1 deri 3 definojnë qëllimin, fushëveprimin dhe përkufizimet e këtij projektligji.

Nenet 4 deri 9 përkufizojnë subjektet, format e lidhjes së kontratës, farërat e prodhimit të materialit fidanor dhe prodhimet e farës së certifikuar, si dhe kultivimin e deklarimin e subjekteve për prodhimin dhe tregtimin e duhanit të papërpunuar.

Nenet 10 deri 14 përcaktojnë formën e kontratës, regjistrin, marrëdhëniet, tregtimin e duhanit të tharë dhe të dhënat për duhanin e grumbulluar në sasi dhe në cilësi.

Neni 15 përcakton përpunimin industrial të duhanit deri në prodhimin final që kryhet nga subjektet vendore apo të huaja, por me kusht që ato të jenë të pajisura me licencë përpunimi.

Nenet 16 dhe 17 përcaktojnë duhanin dhe produktet e duhanit të fermentuar në tregun e Kosovës, që përmban të dhënat në etiketë për përmbajtjen e nikotinës dhe të katranit.

Neni 18 përcakton ndalimin e tregtimit të duhanit dhe të produkteve të tij për tregtim të duhanit të palicencuar, që nuk kanë të dhëna për cilësinë dhe përmbajtjen e duhanit.

Nenet 19 dhe 20 përcaktojnë licencimin e subjekteve që merren me tregtimin e duhanit dhe të produkteve të tij, duke përcaktuar përmbajtjen e procedurave në rastet e kontrabandës me tregtimin e duhanit.

Nenet 21 deri 33 përkufizojnë çmimet, regjistrimin e markës tregtare, dokumentacionin, banderolat, garancitë bankare, evidentimin, raportet, mbikëqyrjen dhe punën e inspektorëve fito-sanitarë dhe atyre të tregut lidhur me qasjen e tyre në dokumentacion.

Nenet 35 deri në 37 definojnë ndëshkimet për kundërvajtje të personave fizikë dhe juridikë që nuk i përmbahen këtij ligji dhe masat mbrojtëse.

Nenet 38 deri në 40 përcaktojnë dispozitat përfundimtare për zbatimin e këtij ligji, nxjerrjen e akteve nënligjore, shfuqizimin dhe hyrjen në fuqi.

Projektligji përveç se krijon bazën stabile ligjore për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit, përcakton edhe objektivat e masat në kuadër të politikave bujqësore dhe përgjegjësitë e autoriteteve kompetente për zbatimin e këtij projektligji.

Me hyrjen në fuqi të tij, kjo fushë do të begatohet dhe do të rregullohet në pajtim me direktivat e Bashkimit Evropian dhe në përputhshmëri me praktikën më të mira ekonomike dhe bujqësore.

Për zbatimin e këtij projektligji nuk nevojiten mjete shtesë buxhetore, sepse organet e parapara për themelimin ekzistojnë dhe nuk nevojitet plotësimi i tyre me burimet e tjera njerëzore. Përkundrazi, si rezultat i zbatimit të tij do të krijohen të hyra buxhetore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Komisionet, a ka të interesuar? Nuk ka.

Atëherë, kalojmë te shefat e grupeve parlamentare ose në emër të grupeve parlamentare, më mirë të them.

Nga Partia Demokratike e ka kërkuar fjalën deputetja Kaqusha Jashari.

KAQUSHA JASHARI: Faleminderit!

I nderuar kryetar, kryeministër, ministra dhe kolegë deputetë,

Projektligji për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit e ka, sikur që tha edhe vetë ministri në paraqitjen e tij, rregullimin juridik të subjekteve që merren me prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit. Është bërë gjithashtu edhe analiza e nevojshme a është ky projektligj në përputhje me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane dhe janë sugjeruar disa përmirësime dhe ne, si Grup Parlamentar i PDK-së, përkrahim këto sugjerime dhe në procedurën e shqyrtimit të projektligjit do të propozojmë disa plotësime.

Përndryshe, me Rregulloren e Këshillit Evropian është përcaktuar organizimi i përbashkët i tregut të duhanit dhe ky projektligj është në përputhje me këtë rregullore e Këshillit Evropian.

Me këtë projektligj gjithashtu është përfshirë edhe tregtia me vendet e treta dhe detyrime tjera në përputhje me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane, sidomos sipas politikave më të mira bujqësore.

Gjithashtu, është përpunuar mirë dhe propozua licencimi i prodhuesve dhe rregulla tjera deri te raportimi obligativ, ndalesa e reklamimit, mbikëqyrja, puna e inspektoratit dhe masa ndëshkimore.

Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah projektligjin e propozuar për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit dhe do ta votojmë për procedimin e mëtutjeshëm në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kryetari i grupit, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet, në parim, këtë projektligj dhe kontributin e japim në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kryetari i grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zëvendëskryeministër, ministra,

Tash është hera e tretë që flas për të njëjtin ligj, realisht, dhe nuk e kam ndonjë problem se e kam lënë duhanin, Ismet, ka më shumë se 2 vjet, dhe nuk po flas për nostalgji ose për diçka tjetër, por po flas për disa parime të cilat do t'i nxjerr këtu.

Fillimisht, duhet me fol se si është sjell ligji para nesh dhe nëse e merrni dhe e shfletoni materialin, do faqe janë mbarë, do janë mbrapshtë, është problem me i lexue, duhet me i shkoqë edhe me e lexue ligjin. Letra për mbi, do me thanë cover letter, ka qenë e gabueshme dhe kemi pas problem me i gjet cili është. Çka na thotë kjo? Dikujt mundet me ju dok diçka që është e vogël, krejt e vogël, mirëpo po ju them diçka. Po krijohet një bindje që në administratën e Kosovës, në Qeverinë e Kosovës ka humbë ai entuziazmi i shtet ndërtimit. Njerëzit krejt punët po i bëjnë shkel e shko. Sillen dokumentet para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, thu ti që kanë me dal me u shitë me një tezgë diku dhe nuk është me rëndësi kush i blen dhe çka blenë. Edhe realisht ky fakt, kjo humbje e këtij entuziazmi të shtet ndërtimit po na kushton në të gjitha sferat e jetës. Nuk është hera e parë që po flasim për këtë punë, nuk është rasti i vetëm. Edhe në fund të fundit, qysh mos me humb entuziazmi i shtet ndërtimit në administratë, ku këta njerëz me 200 euro ose 250 ose 300 euro rrogë i shohin shefat e vetë tu bo miliona. Jo te shqiptarët, po edhe te popujt më të zhvilluem në botë kish me u shkatërrue ai entuziazëm i shtet ndërtimit që ka ekzistue një kohë. Edhe muj me thanë që tash e shini pse u kon ai 100 ditëshi i para 4 vjetëve i famshëm, jo për naj gjenialitet, vetëm për shkak se është ndërtu ky entuziazëm, se njerëzit kanë besue që po bajnë diçka mirë dhe kanë nis me e krye punën qysh duhet.

Tash po kthehna te një temë tjetër. Jemi tue punue tri herë për të njëjtin ligj, realisht. Sadik Idrizi nuk është këtu, një kohë shumë ma moti i kam pas thanë - pse po na bjen një ligj, i cili në vetvete e ka edhe tregtimin, edhe prodhimin, edhe konsumin e duhanit. Tash ka nis mi nda, po shihni sa i çuditshëm është ky ligj, tash ju tregoj unë juve.

E kini te neni 21, thuhet lejohet shitja në automate, tash ky ligj po thotë për prodhim dhe tregtim të duhanit të grimë, të duhanit material. Çka ka lidhje në automat, domethënë, shitja e duhanit në pako të cigareve me këtë ligj, domethënë devijon krejt, po problemi është që në atë ligjin përpara e kemi ndalu shitjen në automate, e tash me këtë ligj dikush duhet me leju shitjen në automate edhe thotë aty një pjesë që lejohet shitja në automate, po jo ku kanë qasje fëmijët. Po më duket sikur në atë farë filmin ku thotë po shesim drogë, por largoni prej shkollave. Çka ka lidhje ky nen këtu? Edhe ky nen na tregon pse u bë ky ligj dhe, në fund të fundit, pse ministri i Bujqësisë e paraqet para Kuvendit këtë ligj. Ky ligj nuk ka të bëjë me bujqësi, vetëm një ose 2 nene kanë të bëjnë me bujqësi, me fidane, krejt është për tregti dhe industri, pse nuk e paraqet ministri i Tregtisë ligjin pra nesh.

Tjetra, qe po shkoj një temë tepër interesante. Në faqet e para ku na prezantohet ligji, thotë, Qeveria e përcjell me vërejtje ligjin para Kuvendit të Kosovës. Pse bre Qeveria na përcjell me vërejtje ligjin, seriozisht është e pakuptueshme. Pse Qeveria nuk e ka ndalë atë ligj në mbledhje të Qeverisë, me i rregullu vërejtjet e mos me na sjell neve ligjin me vërejtje. Ku dimë na tash çka me bë, cilat janë vërejtjet e Qeverisë. Ku ka pa Qeveria me ia përcjell Kuvendit ligjin e vet me vërejtje, është totalisht gabueshëm, çka u ngutë me prurë këtë ligj këtu, në vend se me i rregullu vërejtjet e veta në Qeveri, edhe atëherë me na përcjell të paktën prej pozitës së vet me na përcjell ligjin pa vërejtje.

Neni 10 dhe 11 janë tepër interesante për shkak se ky është esenca, domethënë, tregtimi, makina edhe neni 10 dhe 11 të cilët krijojnë kushtet për monopolizim të tregtimit me duhan, do të thotë krijohen kushte që një ministri, që tash është e Bujqësisë, nuk është e Tregtisë, Industrisë, çuditshëm, licencon kompani të cilat kanë me grumbullu duhan edhe në të njëjtën kohë i kushtëzon prodhuesit e duhanit të cilët mundën me qenë bujq, se prodhuesit e duhet bujq në fund të fundit janë, mos me bri me nënshkru kontrata për pos se me njerëzit të cilët i licencon Ministria e Bujqësisë, do të thotë realisht kujt i ka shku në mend kaq mirë me ba në bazë të rregulloreve të Unionit Evropian këtë ligj.

Diçka tjetër që është tepër interesante, është kështu. Neni 31, paragrafi 1, nuk po e lexoj, po mundeni me lexu vetë, thotë që inspektorët fito-sanitarë kanë me i krye punët e inspektorëve të tregut, ju lutem, merrni lexoni ligjin! Çka kanë lidhje inspektorët fito-sanitarë se a ka licenca, a i kanë paraqit, a i kanë pagu taksat. Inspektorë fito- sanitarë janë agronomë që këqyrin a janë farnat e mira, a mos kanë ndotje, a është toka në rregull. Pse inspektorët fito – sanitarë, zoti ministër, me na tregu pse ata duhet me i krye punën e inspektorëve të tregut, e keni, po e them edhe një herë, neni 31, paragrafi 1, për çka janë të specializuem inspektorët fito - sanitarë.

Tjetra është se kemi afat për ankesa, krejt në rregull janë këto, mirëpo po flasim për bujqësi dhe ministri i Bujqësisë duhet me i ditë, shihni ju. Afati total për ankesa, nëse një bujk ka prodhu, provu me prodhu dhe ka shku me bë kontrata para se me prodhu, është 45 ditë, 30 ditë për gjykatë e tjera, e tjera, a dini çka do me thanë 2 muaj mos mu mbjell duhani? Shkon sezona, nuk mundet me mbjell më, se nuk mbjelllet kur të duesh, e ka kohën e caktuar kur duhet me u mbjellë dhe Ministria e Bujqësisë duhet me e ditë më mirë se na. Këto çështje ligji duhet me i rregullu. Nëse i lejon me prodhu duhan, e në të njëjtën kohë ia ndalon për një çështje administrative, çka me bë ai i shkreti, shkon sezona, mbet pa mbjell edhe mbet ma hangër.

Në këtë ligj, fundi i fundit, nuk është asgjë e saktë, as kush grumbullon, as kush prodhon, as kush përpunon, kurrë nuk saktësohet, vetëm një gjë saktësohet edhe vetëm një gjë kuptohet në këtë ligj, që është e kuptueshme shumë mirë, është që me këtë ligji provohet me u kriju kushtet për monopolizim prodhimi i duhanit, që është një prodhimtari tepër specifike e cila sjell tepër shumë të ardhura dhe krejt ky ligj që na ka ardhë neve këtu, me krejt këto farë paraqitje, e ka vetëm atë qëllim, dikujt i ka shku ndërmend që mundet me bë shumë pare tue monopolizu prodhimin e duhanit dhe i jep vetes atribut me licencu në Ministri të Bujqësisë, jo në Ministri të Tregtisë, që është edhe më e çuditshme.

Ne mendojmë se ky Kuvend duhet mos me e votu këtë ligj, po e them edhe një herë, është shumë i keq, veç çka shkakton edhe më tepër konfuzion, ka me na ardhë prapë në Kuvend, se provon me rregullu shumë tema të ndryshme prej shumë aspekteve të ndryshme për me e kriju një qëllim që e ka pas Qeveria, që nuk po na tregon neve cili është qëllimi. Po ju them edhe një herë, qëllimi është me kriju kushte për monopolizim të prodhimit të duhanit edhe dikush për me kriju të hyra shumë të mëdha edhe profit shumë të madh. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë. Në emër të Aleancës Kosova e Re, se janë bërë shumë aleanca, deputeti Heset Cakolli e ka fjalën.

HESET ÇAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Projektligjit për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhani ka për synim kryesor të rregullojë procedurat e të drejtat e subjekteve që merren me trajtimin e duhanit të papërpunuar dhe të produkteve të tij në vendin tonë.

Ne, si Grup Parlamentar e kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe japim mbështetjen në parim në leximin e parë, por kemi disa vërejtje të caktuara. Për shembull, në neni 3, ku bëhet fjalë për përkufizimet, edhe pse disa herë është dhënë në këtë Kuvend vërejtje të mos përdoret shprehja “nënkupton”, pas çdo shprehje atje është dhënë fjala “nënkupton”.

Pastaj, neni 3, paragrafi 1.1, nuk është përkthyer në gjuhën shqipe në tërësi, ku bëhet fjalë për përkufizimin e duhanit, domethënë është përdorë shprehja nga gjuha angleze edhe në gjuhën shqipe, edhe në gjuhën serbokroate.

Pastaj, vërejtje tjetër kemi në nenin 19, ku bëhet licencimi, pika 1.6, nuk është sqaruar shkurtesa AUV në gjuhën shqipe, ndërsa në anglisht është dhënë Veterinary and Food Agency.

Pastaj, në ligj diku përdoret shprehja ndërmarrje, diku kompani, për shembull, në nenin 9, paragrafi 4 dhe neni 19, paragrafi 1.4.

Por, ne si grup parlamentar do të japim kontributin tonë në komisionet funksionale përmes anëtarëve tanë derisa ky projektligj të shkojë në leximin e dytë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të LDD-së, deputeti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Vërtet sot po e shqyrtojmë një projektligj të rëndësishëm që ka të bëjë me prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit.

Që në kuptimin e titullit të këtij projektligji shihet një moskoordinim në mes të ministrive të linjës, pse? Ne si Kuvend kemi obligim që ta qartësojmë. Është e vërtetë që prodhimi i duhanit dhe aspektet që kanë të bëjnë me industrinë e prodhimit të duhanit, aspektet fito – sanitare, nivelin e nikotinit, format që del në treg duhani kanë të bëjnë me Ministrinë e Bujqësisë, ekskluzivisht, por aspekte të tjera, tregtia në përgjithësi ka të bëjnë me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe jo rastësisht edhe në raportin e Qeverisë thotë: “ky projektligj miratohet me vërejtje”, do të thotë unë kërkoj nga të dy ministrat e linjave që janë këtu, edhe ministri i Bujqësisë, por edhe ministri i Tregtisë dhe Industrisë që t’i harmonizojnë kompetencat, sepse po kemi nganjëherë interferime dhe po hartojmë ligje që janë në pajtim me *acquis communautaire* dhe me direktivat e BE-së, por që nuk po na zbatohen në praktikë. A po zbatohet Ligji kundër prirjes së duhanit në praktikë? Kemi çdo ditë reklama që kushtojnë me mijëra euro në televizionet nacionale dhe lokale dhe askush në praktikë nuk e zbaton këtë ligj. Do të thotë, po nxjerrim ligje, nuk po zbatohen, kur po monitorohen po vërejmë mangësi, interferimet po detyrohem, zoti kryetar, që çdo 6 muaj ose një vit ose më së largu 2 vite, t’i plotësojmë, ndryshojmë e tjera e tjera dhe në raportet e progresit, si legjislativ po biem në provim. Por, këtu është faji te ekzekutivi tani, është faji te Qeveria, të cilët gjatë hartimit të këtyre projektligjeve që janë sponsorët kyç, nuk po i koordinojnë mirë kompetencat dhe janë të shkruara shkurt dhe qartë, do të thotë. Sa i takon Industrisë së Duhanit në Kosovë, këto 10 vitet e fundit është

bërë kontrabandë e madhe me duhanin dhe produktet e tij, kontrabandë në të zezën, tregtim ilegal të një malli që kushton shumë, që konsumohet shumë dhe realisht buxheti i Kosovës dhe doganat e Kosovës po thuaj se kanë qenë të papërfillshme dhe këtu më së shumti është dëmtuar edhe konsumatori, se s'dimë çfarë duheni me çfarë cilësie, vlerat e nikotinës e tjera e tjera, me çfarë banderola dhe tani jo rastësisht edhe Ligji për dizajnin e markave industriale e ka rolin e vet, që shteti më në fund të vejë dorë dhe një legjislacion i caktuar të mbikëqyrë qarkullimin, tregtimin, por edhe ta parandalojë kontrabandimin e duhanit. Në të katër anët e Kosovë kemi raste të tilla dhe dua të marr një shembull që gjithë e dini. Dikur Industria e Prodhimit të Duhanit në Gjakovë dhe në Gjilan ka qenë shembull për regjionin. U privatizua Kombinati i Duhanit në Gjilan dhe për 2 vjet falimento. Pse? Për shkak të mungesës së legjislacionit, për shkak të kriterëve të caktuara që do të krijonin një ambient të shëndoshë që prodhuesit, bujqit e regjionit të Gjilanit dhe të Gjakovës, në veçanti, por edhe të komunave tjera të mund të prodhonin, ta kishin një çmim të garantuar dhe të procedonin tutje. Dhe, si pasojë, fqinji ynë verior, Serbia, bëri një hap pas neve, po shumë cilësor, i privatizoi me qindra miliona euro dy kombinatet që prodhonin duhan dhe në një farë forme ka humbur fizibiliteti i këtyre dy gjigantëve, që në një farë forme kanë qenë shumë rentabil në Kosovë.

Andaj, unë ju bëj apel të dy ministrave që të rishikojnë edhe një herë, po i ceku disa komponente të këtij projektligji që kanë të bëjnë tani me kompetenca dhe interferime: regjistri, tregtimi i duhanit të tharë, të dhënat, kujt i takojnë, pastaj etiketat, unë mendoj që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka të bëjë me këto gjëra, banderolat, garancitë bankare, reklamimi, mbikëqyrja, Inspektorati i Tregut e tjera e tjera.

Lidhja Demokratike e Dardanisë do ta mbështesë këtë projektligj, në parim, për shumë arsye, që vërtet të fillohet një herë mirë që ta rregullojmë me ligj këtë fushë të ndjeshme dhe shteti i Kosovës të vejë dorë mbi tregtinë e këtyre konsumeve të jashtëzakonshme që kanë impute direkte në buxhetin e shtetit dhe që e rrisin në një farë forme dhe, pse jo, Lidhja Demokratike e Dardanisë jep edhe një propozim. Ne ende nuk kemi Fond për Sigurimet Shëndetësore, pse mos të precizohet këtu në taksë shtesë dhe ato mjete t'i shkojnë Fondit për Sigurime Shëndetësore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar "7+", deputeti Xhezair Murati e ka fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Faleminderit, hvala, predsedniče!

Dozvolite da pozdravim prisutne ministre i zamenika premijera,

Mi smo analizirali Nacrt zakona sa svim propratnim aktina, kao i tvid u budžetske aplikacije usklađene sa standardima Evropske unije.

Stoje primedbe koje su kolege iznele, ali mi smatramo da je ovaj nacrt zakona, što se tiče samog teksta i odredba, jasan, razumljiv i na jednostavan način reguliše materiju duvana od uzgoja uzgojevaća i potrošača pa sve do zabrana trgovine u određenim slučajevima, uz prihvatanje propusta koje neke od kolega spomenuli.

Veoma je važno, po nama, da ovaj nacrt zakona nalaže donošenje podzakonskih akata Ministarstvu trgovine i industrije u roku od 12 meseci, ali i pored shih, kažem, primedaba koje smo čuli, zbog važnosti ove sfere, zbog toga što se preko carine i akciza slivaju u budžet određena sredstva, mi smo zato da se on što pre usvoji i mi ćemo ga u načelu prihvatiti. Hvala vam!

Drejtimin e seancës e merr zoti Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk ka të paraqitur. Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUSH: Hvala lepa na datu reč!

Kada je u pitanju Nacrt zakona o proizvodnji, preradi i trgovini duvanom, mi kao grupa razmatrali smo pažljivo ovaj zakon. Ovaj Zakon je po treći put, znamo svi, u Skupštini. Ovo izdanje zakona moram da kažem da je malo suženije od ostalih koje smo imali prethodno, ali nema jednu bitnu definiciju za subjekte koji učestvuju u ovom procesu. Nema dobar stav prema tome koja firma, ko na tržištu proizvodi, ko prodaje, to je zakon doneo, ali kada gledamo kakvo je tržište, zakon omogućava i dalje da postoji ovako nesređeno tržište. Nije rigorozan, nego produžava, ka kažem, jednostavno produžava trenutnu tržišnu situaciju koja postoji na Kosovu.

Jako je žalosno da kod ovog zakona, kada je u pitanju licenciranje, neću da zamaram da zamaram kolege, da je jako važno da su pomešani pojmovi kada je u pitanje licenciranje, nadležnosti Ministarstva za poljoprivredu i nadležnosti Ministarstva za trgovinu i industriju. Moraju ove nadležnosti da se dobro definišu da bi nama bili jasni kao poslanicima i svim učesnicima u ovom poslu.

Iz ovog zakona jako je interesantno da mi u nijednom zakonu ne zaštićujemo potrošače, ne gajimo praktično potrošače. Mi sa ovim zakonom nećemo se truditi da gajimo duvan, nego da trgujemo i, da kažem, švercujemo duvanom putem ovog zakona. Mi moramo kao Ministarstvo, naročito Ministarstvo za poljoprivredu mora da napravi podzakonska akta, sa kojima zaštićuje i obezbeđuje proizvodnju na Kosovu i neću da ponavljam, podržavam govor prethodnog kolege, Nasera, gde kaže definitivno da mi moramo da praktično gajimo proizvođače, što znači da smo bili nekad dobri proizvođači duvana i da mi na tržištu gubimo, gubimo tržište sa ovakvim zakonom što je, svi znamo da je u Evropi sada borba za tržište, borba za izvoz, a mi smo imali dobar i kvalitetan duvan. I ako se okrenimo svojim proizvođačima i ako zaštitimo sve poljoprivrednike i ako država stoji iza toga, kao što su rezerve, znate, robne rezerve čak su moguće i sa dodatnim davanjima i od strane države i kada je u pitanju duvan. Evo, ta oblast uopšte nije dotaknuta, niti se bavi ovaj zakon sa ovom oblašću, nego se definitivno daje do znanja kako će lako moći na Kosovu da se uvozi duvan, da se dalje prodaje na način kao što je i samo tržište. Jedino što mogu da kažem u ovom zakonu da je, kao grupa kada smo ga razmatrali, da je jako pozitivno, da je u članu 26. data obaveza za bankarske garancije za one učesnike koji se bavi, znači, uvozom i izvozom duvana. Jako je bitno dali postoje instrumenti za praćenje, ko će ove garancije da plaća i koliko će biti visina garancija, to nije definisano i na osnovu kojih kriterija će biti ove garancije određivane. Mi znamo da kada je u pitanju tržište Kosova, da garancije nisu plaćali veliki investitori koji su dolazili na naše tržište, kada su bile u pitanju usluge elektroprivrede, PTT i ne znam koje još usluge. Nadam se da će biti bankarske garancije, ovaj član 26. da će biti ispoštovan ali on nije definitivni, nije definisan pa neće biti jasan ni samom uvozniku ili izvozniku, da kažem, duvana, a od ovih bankarskih garancija znamo da se puni budžet Kosova.

Moram ponovo da kažem da je ovo jako važno da stvarno moramo jednom zauvek da kažemo da moraju prevoditi da se pogledaju na sva tri jezika, što ću iz jedne misije, kada je definicija šta je duvan, šta je seme, šta je fermentacija, proizvodnja i ostalo, sam cilj donošenja zakona, član 3, izrazi. Moram da kažem ovo, kada je u pitanju nikotin, čitam iz zakona, kaže: "Nikotina podrazumeva otrovni alkohol koji se alkaloid koji se namazi", zamislite, "namazi u duvaku", ne može to niko da razume, "i ima otrovno delovanje u autonomni nervni sistem". Mislim da je jako lako da se kaže "nalazi u duvanu". Stvarno ovakve greške ne treba više da se ponavljaju jer

umorni smo više od ovakvih grešaka. Hoćemo brzo da pročitamo zakon, da nam je prilagodljiv, da možemo da ga razumemo, jer imamo puno zakona, znate koliko smo na ovoj sednici imali i stvarno meni je žao da kažem kada su u pitanju prevodi, mi dosta gubimo vremena i stvara nam to jako veliku nervozu. Hvala na pažnji!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupet parlamentare e kanë kryer prezantimin e tyre për ligjin, tani janë deputetët e paraqitur. Sipas radhës, deputetja Nurishahe Hulaj.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Ministra të nderuar dhe deputetë të respektuar,

Unë mora këtë paraqitje për shkak se kam qenë kryetare e grupit punues për Ligjin për duhanin dhe i paraqes disa të dhëna të rëndësishme për këtë projektligj.

Projektligji për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit është projektligj i strukturuar mirë, përmbajtësor, i hartuar nga grupe punuese profesionale me përbërje multisektoriale.

Në parim e përkrah projektligjin dhe do të jap kontributin tim në komisionin funksional që do ta përpunojë më tutje.

Ky projektligj krijon dhe rregullon stabilitet legjislativ në harmoni me ligjet tjera që ka lidhmëni me këtë projektligj, si me Ligjin për duhanin, Ligjin për markat tregtare, Ligjin për doganat e të tjera dhe iu mundëson subjekteve të regjistruara, që merren me këtë veprimtari, të punojnë në baza ligjore. Projektligji shpreh opinionin për përafrimin me legjislacionin e BE-së.

Unë parimisht i paraqes disa vërejtje:

E para, në nenin 18, ku thuhet - ndalimi për tregtimin e duhanit dhe produktet e tij, paragrafi 1.4, ku thotë: “Nëse në etiketim të paketimit të duhanit nuk ka të dhëna për përmbajtjen e nikotinës dhe katranit”, unë konsideroj se këtu duhet të shtohet edhe “përmbajtja e monoksidit të karbonit”. Kjo përmbajtje me të tri këto elemente në etiketim vlen edhe për nenin 17, paragrafi 1, si dhe për nenin 32, paragrafi 1.1. Kjo formë e harmonizon nenin 4.5 të Ligjit për duhanin, ku zbatimi i këtij neni, do të thotë të nenit 4.5 të Ligjit për duhanin, përmes Iso standardeve i përcakton përmbajtjet e nikotinës, të katranit dhe të monoksidit të karbonit.

Vërejtje tjetër kam në nenin 21 të këtij projektligji. Në të tre paragrafët e këtij neni, që të tre vinë në kundërshtim me nenin 9 të Ligjit për duhanin, i cili është në fuqi. Projektligji në nenin 21, paragrafi 1, ku thuhet se “lejohej shitja me pakicë e duhanit nëpër shërbimet hoteliere përmes shitjes nga automatët”, ndërsa Ligji për duhanin, neni 9 nuk e lejon një gjë të tillë.

Tjetër vërejtje në nenin 30, pra, mbikëqyrja. Ky nen do të duhej të formulohej ndryshe me qëllim që të jetë në harmoni të plotë me nenin 11.2 të Ligjit për duhanin, si dhe me nenet tjera. Pra, formulimi ndryshe do të ishte kështu: “Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në konsultim me Ministrinë e Tregtisë, Industrisë, me Doganat dhe me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij projektligji të formojë komisionin profesional të përbërë nga: Inspektorati fito- sanitar, Inspektorati i tregut, përfaqësuesi i MEF-it dhe të doganave. Ky komision bënë koordinimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes së Ligjit për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit me Ligjin për duhanin në harmoni me nenin 9 të Ligjit për duhanin, neni, 11.2 dhe nenin 12.4 të Ligjit për duhanin”. Pra, këto ishin disa vërejtje që unë do ta ndihmoj edhe komisionin funksional.

Andaj, do të cek edhe për vlerësimin e ndikimit buxhetor. Projektligji nuk paraqet implikime buxhetore, por krijon të hyra për buxhetin e Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti kryesues!
Edhe unë e kam shqyrtuar këtë projektligj. Pa i përsëritur parafolësit e mi, do t'i them disa vërejtje.

Unë kisha për të shtuar këtu tek neni 10 - Kontrata për prodhimin dhe grumbullimin e duhanit, domethënë te forma e kontratës ndoshta kishte qenë mirë në pikën 2 të thuhet: “për prodhimin dhe grumbullimin e duhanit brenda një sezoni, prodhuesi për të njëjtin prodhim nuk mund të lidh kontratë me më tepër” thotë këtu “grumbullues!, ndoshta është mirë të shtohet “kontratë me më tepër se një grumbullues” nëse është në pyetje një grumbullues.

Pastaj, tek neni 11, do të thotë kemi të bëjmë me regjistrin, ka lidhje me nenin 9, ku është deklarimi dhe pika 2 - Regjistri i prodhuesve. Për shembull, tek neni 9, thotë te pika 2: “Regjistri i prodhuesve të duhanit dhe të sipërfaqeve të kultivuara me këtë kulturë mbahet në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural”, derisa në nenin 11 thotë: “Çdo grumbullues në regjistrin e vërtetuar të prodhuesit regjistron dhe e vërteton me vulë numrin e kontratës dhe sasinë e kontraktuar”. Mua po më intereson, a kemi të bëjmë me 2 lloje të regjistrave, një regjistër të cilin e mban prodhuesi, apo ndoshta edhe tjetrin të cilin e mban grumbulluesi dhe një regjistër të cilin e mban ministria. Do të thotë, ndoshta është mirë të konkretizohet për sa lloje të regjistrave bëhet fjalë.

Pastaj, parafolësit thanë, thashë nuk dua t'i përsëris, është afati për ankesa, kompetencat e ministrive sa i përket licencimit, edhe unë i kam aty disa vërejtje. Mendoj se zyrtarët ligjorë të ministrisë së juaj është dashur paraprakisht, para formulimit të këtij ligji, ta konsultojnë Ligjin për duhanin meqë kemi domethënë shumë kolizion sa i përket Ligjit për duhanin dhe këtij ligji.

Këtu në nenin 21, thotë shitja me pakicë, vendet për shitje me pakicë, domethënë për pakicë. “Shitja me pakicë ushtrohet në vende të caktuara dhe lokale të ofrimit të shërbimeve hoteliere përmes shitjes nga automatët”. Më vonë, në përputhje me këtë ligj, ndërsa nuk është në përputhje me Ligjin e duhanit, qysh edhe u tha më herët, mirëpo nën 2 thotë: “lejohet shitja e duhanit te automatet të cilat janë të vendosur në ato vende ku nuk kanë qasje të miturit”. Tash unë e marr si shembull, sikur mos të kishte qenë në kundërshtim me Ligjin për duhanin, po më intereson kjo, ndoshta do të kishte qenë edhe një pyetje për juve, zoti ministër, lejohet shitja e duhanit në automate të cilat janë të vendosur në ato vende ku nuk kanë qasje të mituritë. Shitja në automate është shitje e lirë, shitje pa kurrfarë kontrolli. I mitur është i mituri edhe 14 vjeçar, i cili mund të arrijë gjatësinë 1 metër e 80, 1 metër e 90, 2 metra, 1 metër e 70, do të thotë ka mundësi prej automatit të blejë paqetat e duhanit. Cilat vende i keni paramenduar ju kur e keni hartuar këtu që nuk kishin pas qasje të miturit? Sidoqoftë, këto janë në kundërshtim me Ligjin për duhanin dhe do të fshihen, po sikur të mos kishin qenë, cilat vende i keni paramenduar, për shembull, që kishin mund të mos kenë qasje të miturit.

Sidoqoftë, unë do ta përkrah këtë projektligj duke marrë parasysh rëndësinë e tij dhe do të jap kontributin në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Zonja e zotërinj deputetë,

Shpreh mbështetje për këtë ligj dhe e konsideroj të nevojshëm. Do të dëshiroja vetëm të nënvizoj dy çështje, që mendoj se janë të rëndësishme dhe janë specifike për Kosovën. Është mirë që ligji, edhe pse e kemi pasur edhe një ligj tjetër për duhanin, megjithatë fokusohet më shumë në prodhimin, grumbullimin, tregtimin e duhanit. Por, përshtypja ime është se megjithatë çështja mbetet e parregulluar dhe këtë desha të nënvizoj. Kosova ka pasur një prodhim të konsiderueshëm të duhanit. Ju e dini sa kanë qenë të ardhurat nga kultivimi i duhanit dhe meqë unë vijë me origjinë nga Gjilani, i kujtoj deputetët se Kombinati i Duhanit shumë vite më parë, tri decenie më parë, 80% të produktit i ndaheshin për tatime, ishte e imponuar kjo, dhe me atë që mbetej, ishte njëri nga prodhuesit më rentabil, jo vetëm të Gjilanit, por edhe më gjerësisht në Kosovë.

Çka ndodhi që gjithë ajo veprimtari u rrënua dhe nuk e shoh përpjekjen, projektin, idenë për ta rivendosur atë sistem. Prandaj, edhe nuk mund të bëjmë gjë në këtë fushë pa e rregulluar çështjen e prodhimit të duhanit, veprimtarisë së duhanit dhe subvencioneve që janë siguruar më parë.

Përkundrazi, për pasojë ka ndodhur jo vetëm rrënimi, por është krijuar edhe një fushë e përshtatshme edhe për abuzime dhe kjo është çështja e dytë në të cilën desha të vë theksin.

Ka pasur do përpjekje që në emër të nismave private të përfitohet nga përvojat e mëparshme, por janë dëmtuar seriozisht prodhuesit, sidomos nga ana e Anamoravës, për ata që nuk e dinë. Janë bërë edhe do kontrata me prodhues, pa subvencione të nevojshme, njerëzit kanë sakrifikuar se është premtuar që në fund do të grumbullohet prodhimi dhe me çmime të volitshme do të mund të arsyetojnë investimet dhe mundin e bërë, por në fund pastaj është luajtur me ta, u është ofruar një çmim 1 euro ose aty diku për kilogram duhani, një pako duhan kushton më shumë. E dini çka do të thotë të prodhohet një kilogram duhan, është punë shumë e mundimshme, është e ithtë buka që vije prej duhanit. Dhe kur prodhuesit pastaj, të pakënaqur me trajtimin vërtet absurd, kanë bërë përpjekje për të gjetur edhe ndonjë mundësi, sepse tregtues nga jashtë Kosova iu kanë ofruar edhe çmime disa fish më të shtrenjta, se tregu e lejon këtë, atëherë është përdorur një farë demagogjie nacionaliste, e ata që shesin jashtë Kosovës le të mendojnë a duhet të jetojnë në Kosovë e tjera, dhe kështu vijmë te çështja e tretë që e shohim edhe në ligjin e ofruar.

Bëhet fjalë për prodhimin e planifikuar, për grumbullues të licencuar të duhanit, për obligimin e prodhuesve që të bëjnë kontrata dhe të obligohen që prodhimin ta dorëzojnë te këto kompani të licencuara, por a kontrollohet, çka bëjnë ato kompani, do të thotë imponohet një sistem i planifikuar i prodhimit të duhanit dhe i tregtimit e tjera, po në të vërtetë aty pastaj është lejuar edhe ngulfatja e iniciativës së lirë të prodhuesve.

Unë dyshoj se në këtë mënyrë mund të stimulohet prodhimi i duhanit. Prandaj, edhe angazhohem që këto çështje të trajtohen seriozisht dhe të korrigjohen. Besoj shumë se kolegët deputetë të angazhuar në komisionin përkatës do të kenë kujdes të veçantë në këto çështje, që të mos lejohet që në emër të një ekonomie të tregut tash, të restaurohen praktika të ekonomisë së planifikuar, por tash shumë herë më të sterkequra, që praktikisht e ngulfasin prodhuesin e lirë dhe e pamundësojnë zhvillimin e një veprimtarie shumë të dobishme me leverdi për ekonominë e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues,

Zëvendëskryeministër, ministra, deputetë të respektuar,

Fillimisht, zotëri kryesues, ja i numërova, këto janë tri herë faqe më shumë, pak kush i lexon. E kam bërë një anketim me kolegët, në sistemin e Galupit, kam ardhur te konkluzioni se këto po thuaj, mos të them askush, pak kush i lexon. Propozoj që më së pakti në Kryesi ju ta ngrehni këtë çështje, se do të kishim kursyer, se 120 vetë jemi, t'i heqim këto, kujt i intereson, shkon në zyre i merr këto, i lexon edhe kësi soji. Kjo është një.

Dy, kur do ndokush për ta kritikuar ndonjë shtet, bie fjala nëse s'ka bash kurrkund "për me ia ngjitur" si thuhet "atë gojzën", thotë është shtet që është nomo manik, që do të thotë bën shumë ligje edhe është gati si parakusht, kur bëjnë shumë ligje, apriori ato nuk përfillen. Konkretisht tash ndalem, pse mos ta bënim ne, e kemi Ligjin për duhanin, atë ligj ta plotësojmë ta ndryshojmë. Bie fjala, Ligji për prodhimin, për qarkullimin, për grumbullimin, për klasifikimin ta shtojmë, se këtu nuk është klasifikimi, për tregtimin, për pirjen e duhanit, krejt kjo duhan, domethënë Ligji për duhanin, edhe dispozitat atje ndëshkimore e tjera dhe do ta kishim një ligj. Kur është duhani në pyetje, do të thotë, e merr ligjin, ndryshe vështirë që edhe juristët më të mirë që i kemi do të mund të gjinden në këtë stil se si po punojmë ne, se ky nuk është rasti i parë, ka shumë raste, po unë po ndalem në këtë rast konkretisht.

Kam disa vërejtje konkrete kështu, ju lutem. Që po e zëmë, te marrëdhëniet ndërmjet prodhuesit, grumbulluesit e tjera e tjera, palët kontraktuese edhe e përcakton këtu me paragrafin 2 të nenit 12. thotë: "Forma dhe përmbajtja e kontratës do të përcaktohet me akt nënligjor". Kjo është nonsens, nuk mund të bëhet kjo, sepse kontrata, ju lutem, bëhet sipas autonomisë së vullneteve edhe bëhet sipas jus dispositivum. Shteti nuk interferon në kontratë, vetëm mos të jetë kundër shtetit edhe kundër moralit publik, do të thotë kontra jusdispositivum. Prandaj, kjo dispozitë duhet të hiqet krejtësisht, apo jo, ani aq më parë kur me akt nënligjor, domethënë që ministri, nuk aludoj në zotëri ministrin, se kam respekt, por flas me germën e vogël, ministri, cilido ministër, do të thotë do të përcaktonte formën e kontratës, që nuk është e nevojshme, nuk është e praktikueshme bash kurrkund.

Më pastaj, këtë e thashë për ligjin. Te neni 19, paragrafi 4, "dëshmia se personi përgjegjës apo kompania", jo kompania, se e kemi Ligjin për organizatat biznesore. Janë katër tipa, tash varet a do të jetë kompani apo korporatë, çfarë janë apo ndërmarrje e tjera e tjera. Mund të jetë edhe biznes individual, personal, prandaj duhet ta zëvendësojmë, se kjo e pengon, se për ta prodhuar duhet të jetë kompani, e s'ka kapacitet, a mund të jetë individ që e prodhon duhanin, bie fjala, apo që e shet. Prandaj, entiteti natyral që është term bashkëkohor, apo personi fizik, që e kemi përdorur deri më tash, apo entiteti legal. E tash, cili do qoftë që licencohet, që është i kualifikuar, le të jetë edhe prodhues, edhe qarkullues e tjera e tjera.

Te mbikëqyrja, neni 30. Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji dhe të dispozitave të nxjerra në bazë të tij do të bëhet përmes Inspeksionit fito dhe Inspeksionit tregtar e tjera e tjera. Kjo është çështje e mbikëqyrjes, mbikëqyrja do të duhej të bëhej drejtpërdrejt nga ministria edhe në konformitet me aktin. Këtu vjen shprehje, ju lutem, udhëzimi administrativ, inspektorati i ka ingjencat ligjore.

Te neni 34, te ankesat, te mjetet juridike, këtu konsideroj që është një, paragrafi 3, gabim juridik material dhe konceptual, që nuk mund të bëhet kështu. Kur thotë "kundër vendimit të ... të inspektorit përkatës, pala mund t'i paraqes ankesë në... (unë po e lexoj fjalë për fjalë, gabime ka shumë) Gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh...

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Unë dua vetëm që të inkuadrohem për të qenë edhe unë i qartë. Ne e dimë që kemi prodhuar duhan dhe ne të gjithë e dimë që askush në Kosovë më nuk pi as cigare Drava, as Morava, as Bozhur dhe sot në botë janë 4 kompani të fuqishme, 5 më së shumti që e konkurrojnë njëra - tjetrën. Mendoj që procesi i privatizimit të Kombinatit të Duhanit në Gjilan ka qenë i gabueshëm, sepse ndoshta ju ka dhënë atyre që prodhojnë cigare të falsifikuara dhe krijojnë treg të pabesueshëm në Kosovë, sepse mendoj që është dashur me pretendohet që atë kombinat t'ia shesin njërës dhe t'ia japim licencën njërës nga këto 4 – 5 kompani të fuqishme, duke përfshirë Filip Morisin, British Tabacco, West-in dhe janë disa kompani të tjera të cilat realisht e mbulojnë tregun në botë dhe nuk ka askush që ju konkurron në treg. Ky është një problem me të cilin ne duhet të jemi të qartë dhe çmimi i duhanit të papërpunuar vërtet është i lirë kudo, sepse treg ka në krejt botën dhe këto kompani i shfrytëzojnë tregjet me çmime të lira dhe jo tregjet të cilat dëshirojmë ne ose çmimet të cilat dëshirojmë ne t'ua sheshim.

Fjalën e ka deputeti Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, kryesues!

Unë e përshëndes ardhjen e këtij projektligji në Kuvendin e Kosovës, jam i predispozuar, besoj, dhe ashtu do të duhej të ishte që ligjet të vinë me qëllim të rregullimit të këtyre fushave të cilat nuk kanë qenë të rregulluara deri më tash. Prodhimi, grumbullimi, përpunimi dhe tregtimi i duhanit nuk kanë qenë të rregulluara në masat e duhura konform standardeve ndërkombëtare dhe si pasojë e kësaj kemi probleme me prodhimin, kemi problemet me grumbullimin e duhanit, përpunimin, por edhe tregtimin. Kemi dëshirë dhe shpesh flasim për standardet evropiane, ndërsa kur shikojmë në praktikë se si zhvillohet, për shembull, tregtia e duhanit në Kosovë, domethënë Kosova i ngjanë një vendi ndoshta afrikan apo aziatik, nuk i ngjanë një vendi evropian po të shikohet në rrugët e Kosovës se çka ndodh me këtë, se si shitet ky produkt, dhe si depërton në treg. Ka pasur përpjekje në të kaluarën që me anë të një ligji që do ta miratonte Kuvendi i Kosovës të rregullohen këto veprimtari, por ju e dini që autoriteti i UNMIK-ut i Shtyllës së Katërt, ku kontrollonte edhe doganat, nuk e kanë lejuar që ky segment të bien në autoritetin e institucioneve të Kosovës dhe të rregullohet konform ligjeve të duhura. Këtu u tha tek autoriteti se cili sektor qeveritar duhet ta ketë, mendoj që të dy sektorët, si Ministria e Bujqësisë që merret me prodhim dhe grumbullim, ashtu edhe e Tregtisë me përpunim dhe tregtim, këto janë të dyja bashkërisht dhe bashkërisht edhe duhet të angazhohen që ta zbatojnë këtë ligj, por edhe ta mbikëqyrin këtë ligj sepse është kompetencë e të dyjave dhe unë besoj që të dy ministrat që janë prezentë këtu edhe Qeveria do të arrijë që ta mbikëqyrin në përpikëri zbatimin e këtij ligji.

Unë nuk do të flas, t'i përsëris ato që u thanë nga kolegët tjerë deputetë, por do të ndalem te neni 21, te shitja me pakicë. Konsideroj që në ndalesat që duhet të bëhen, duhet të amendamentohet ky ligj, konkretisht te neni 21, një pikë e re që të shtohet. “Ndalohet shitja e duhanit nga të miturit, por edhe për të miturit”, domethënë ju e shihni që plotë rrugët e Kosovës janë të mbushura me shitës ambulantë, domethënë me fëmijë që shesin këtë produkt dhe konsideroj që kjo duhet të jetë e ndaluar me këtë ligj, por edhe ofrimi i këtyre produkteve të miturve nga shitës të autorizuar me shitje me pakicë, domethënë, duhet të jetë dispozitë e ndaluar me anë të këtij ligji.

Pajtohem me shumë tjerë parafolës që shitjet përmes automatëve të jenë të ndaluara, domethënë, me përjashtim në ato shërbime hoteliere ku ofrohen, ku kontrolli është i paraparë. Përndryshe, këto shitjet përmes automatëve të mos ekzistojnë nëpër qytet apo në vende publike.

Te reklamimi thuhet, tek neni 29, se ndalohet reklamimi i këtyre produkteve sipas Ligjit për markat tregtare. Konsideroj që vetë Ligji për markat tregtare në një farë mënyre i lejon disa forma të reklamimit, por ne duhet ta ndalojmë reklamimin e duhanit në të gjitha format dhe ata të cilët s'e zbatojnë, qoftë mediat, qoftë kompanitë reklamuese, të parashihen edhe masat ndëshkimore tek dispozitat ndëshkuese, që nuk është prapë në këtë ligj, që duhet të ekzistojnë në rast se bëhet reklamimi i duhanit. Këto ishin vërejtjet që i thashë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

E para, është që nevoja për këtë projektligj, pa marrë parasysh edhe ekonominë e tregut që e kemi, shihet se është e domosdoshme, normalisht duke u munduar të krijohen kushte apo edhe kritere që kanë të bëjnë me prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregimin e duhanit. Ajo çka është një vërejtje parimore, ndoshta sa i përket projektligjit, është se nxjerrja e akteve nënligjore që është përcaktuar për zbatimin e këtij ligji mes dy ministrive, ndoshta krijon edhe më shumë zbrazëti ligjore për shkak se nuk janë cekur se në cilat nene dhe në cilin aspekt cila ministri duhet në afatin e parapërditë t'i rregullojë këto akte nënligjore. Të jem i sigurtë, për këtë fushë ndoshta jam pak i hendikepuar, edhe pse personalisht s'jam duhanpirës, por e mira e kësaj është që ndoshta të hyrat buxhetore rriten apo shtohet buxheti i Republikës së Kosovës përmes realizimit me këto aspekte.

Më lejo, zoti kryesues, ta keqpërdori për një minutë, nëse më lejohet ndoshta, mikrofonin, që ka të bëjë lidhur me shpenzimin, ndoshta, edhe të këtyre të hyrave në një aspekt tjetër.

Sot jemi në prag të festës së madhe të Bajramit dhe jemi të gëzuar që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës kryeministri ju uron gjithë besimtarëve myslimanë në vendin tonë festën e Fitër Bajramit, kuptohet në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës edhe përmes aspektit media, që sigurisht është me pagesë. Por, e pata thënë edhe një herë më parë, kur patëm diskutuar për shpenzimet buxhetore, edhe sot është e pakuptueshme se akoma duhet çdo ministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, në shumë gazeta ditore, nga një faqe me pagesë në këto kushte ekonomike, që t'ju urojë po ashtu në emër të tyre personal, me pagesë nga buxheti i Kosovës festën e Fitër Bajramit. Unë mendoj që vetëm në një gazetë ditore të bëhet një matematikë e thjeshtë, janë diku 7250 euro pagesë, ndërsa këto mjete ndoshta kanë mundur pikërisht për këtë festë të racionalizohen dhe të shpenzohen në mënyrë të duhur. Kërkoj falje edhe një herë, por kur t'i debatojmë shpenzimet apo kërkesat për shpenzimet, kërkesën buxhetore për vitin 2011, atëherë ndoshta duhet të debatojmë për këtë çështje më seriozisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zemaj!

Lulzim Zeneli e ka fjalën, i fundit.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke i përkrahur fjalimet e mëparshme që kanë të bëjnë që kjo sferë të rregullohet me legjislacionin, në mënyrë që të evitohet çdo veprim antiligjor në fushën e përpunimit, po në veçanti tregtimit të duhanit, më lejoni të theksoj se krejt legjislacioni i cili procedohet këtu, edhe në këtë format çfarë e kemi sot, reflekton vizionin e qeverisjes që të rregullohet sfera përkatëse.

Unë dua të theksoj atë çka e tha e zoti Hyseni. Dikur nëse është krenuar Kosova me këtë sferë të prodhimit të duhanit, sot nuk bëhet fjalë për prodhim, por bëhet fjalë vetëm për tregtim. Pra, kemi të bëjmë me një fushë, e cila sot nuk ekziston. Nëse pretendohet në të ardhmen të investohet, si rezultat

i vizionit të qeverisjes në këtë fushë, është diçka tjetër, mirëpo duhet ta kemi parasysh se në qoftë se dje gjithë prodhuesit vreshtarë e hodhën rrushin në oborret e prodhuesit të verës në Rahovec dhe sot e kemi një gjendje kur nuk ekziston, e njëjta nuk ekziston prodhimtari e duhanit. Prandaj, mos të lejojmë që nesër e njëjta të kanoset edhe në prodhimtarinë e verës për arsye se të gjitha ato pengesa me të cilat sot po ballafaqohet prodhuesi vendor, sidomos kur kemi të bëjmë me distribuimin, qarkullimin, përpunimin e kësaj veprimtarie, prandaj kur kemi diskutua shumë herë më parë për pengesat që kemi në fushën e implementimit të marrëveshjes së Ceftas dhe sot kjo po haset në praktikë dhe të mos lejojmë që edhe veprimtaria e vreshtarisë të falimentojë siç ka falimentuar tash prodhimtaria e duhanit. Sikur të rregullohet kjo fushë, që të gjithë e përkrahim se duhet të rregullohet me legjislacion, se nëse nuk rregullohet në këtë formë, atëherë lë hapësirë që tabakomafia që është një prej formave më të shprehura në Evropën Juglindore, të qarkullojë edhe në Kosovë, dhe kjo po shihet shumë qartë se në qoftë se nuk rregullohet me legjislacion adekuat dhe në qoftë se ka përzierje të kompetencave të 2 – 3 ministrive, atëherë lë hapësirë që dikush tjetër ta përcaktojë rregullën dhe ligjin sa i përket kësaj fushe.

Unë i kam disa vërejtje parimore që ndërlidhen me çështjen e kualitetit dhe ndalimin e tregtimit të duhanit dhe produkteve të tij në vend. Mbasi kemi të bëjmë vetëm me tregtim të duhanit dhe kemi deklaratën se i plotëson standardet, duhet ta kemi parasysh se standardet evropiane në këtë fushë janë shumë të rrepta, që në ligjin tonë nuk figurojnë. Është mirë që të gjitha ato standarde të inkorporohen. Sot nuk mund të tregtosh duhan në vendet e BE-së pa etiketën për pasojat në shëndet, nuk mund të tregtosh në vendet e BE-së, po edhe të rajonit, në qoftë që nuk është etiketa për përmbajtjen e duhanit. Prandaj, pos monoksidi i karbonit, që duhet të jetë, duhet të jetë edhe përmbajtja e kadmiumit, pa tjetër që duhet, është një prej standardeve të BE-së që duhet të përfshihet në etiketën e duhanit. Prandaj, nëse pretendojmë që me këtë ligj të rregullohet kjo fushë, ne vetëm kemi lënë hapësirë që mafia e duhanit të veprojë në Kosovë. Nuk mund të rregullohet kjo fushë me këtë legjislacion, me këtë ligj kjo fushë shumë e rëndësishme. Nuk bëhet fjalë për prodhimin, kryekëput kemi të bëjmë për tregtimin, prandaj është mirë që komisioni funksional në këtë rast ta ketë parasysh se nuk bëhet fjalë për prodhim derisa prodhimtaria e duhanit në Kosovë ka falimentuar, nuk bëhet fjalë për tregun e lirë, derisa ne e kemi caktuar standarde të cilat përcaktojmë edhe linjën e prodhimit, formën e certifikimit, të grumbullimit e kemi vendosur në një linjë shumë të rreptë.

Prandaj, është mirë që Kuvendi i Kosovës në formën e amendamentimit të ketë parasysh dhe t'i implementojë standardet të cilët ekzistojnë në vendet e rajonit. Sot përpunimi dhe prodhimi i duhanit është numër një. Në qoftë se një fabrikë në vendin e regjionit është shitur, është privatizuar sa krejt ekonomia e Kosovës dhe dihet sa ka qenë kapaciteti i saj, atëherë ne e kemi pasur një prodhimtari duhani që sot nuk ekziston. Dikush për këtë duhet të japë llogari, dikush mund të thotë se është tregu i lirë, po tregu i lirë orientohet me politika qeverisëse. Qeveria e Kosovës nuk ka krijuar ...

KRYESUESI: Faleminderit!

A po vazhdojmë sipas marrëveshjes me leximin dhe me diskutimin e ligjit ose pikën gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dizajnimin industrial, me qëllim që të presim të kthehen deputetët nga mbledhjet në komisione ose pas drekës një nga një shpejt i votojmë.

Po them, është bërë një marrëveshje që të lexohen një herë ligjet dhe pastaj në fund të votohen për shkak se janë 3 komisione në punë dhe tani komisioni i katërt shkoi në një vizitë që e ka pasur të caktuar më herët, kështu që për të mos i penguar në punën e tyre, kemi vendosur bashkë që t'i lexojmë ligjet, në parim, dhe pastaj në fund t'i votojmë një nga një.

Pika gjashtëmbëdhjetë e rendit të ditës:

16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dizajnin industrial

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji. Ftoj ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, zotin Lutfi Zharku, që në emër të Qeverisë para deputetëve dhe Kuvendit ta prezantojë projektligjin.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryesues, ministër,

Të nderuar deputetë,

Qeveria, gjegjësisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është duke ndërmarrë masa të vazhdueshme si në përmirësimin e legjislacionit, ashtu edhe në ngritjen dhe zhvillimin e institucioneve të nevojshme për ndërtimin e një sistemi efikas për sigurimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në Republikën e Kosovës, sistem i cili ka në qendër të tij mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të pronës intelektuale, përkatësisht të asaj industriale.

Ne jemi të vetëdijshëm se prona industriale është një nga fushat bartëse të zhvillimit të ekonomisë së një vendi, pasi që mbrojtja e saj do të thotë mbrojtja e investimeve, zhvillim i teknologjive të reja në procesin e prodhimit, të ofrimit të produkteve dhe shërbimeve të reja dhe inovatore në treg.

Në sferën e mbrojtjes së pronësisë industriale, krahas arritjeve të mëdha janë vërejtur disa mangësi në ligjin aktual sa i përket zbatimit dhe mbrojtjes së të drejtave të dizajneve industriale dhe harmonizimit jo të plotë të ligjit aktual me standardet e BE-së në këtë sferë.

Me projektligjin e ri është thjeshtësuar procedura e regjistrimit të dizajneve industriale, që paraqet një lehtësi për bizneset, sepse është eliminuar vlerësimi i shkallës së risisë dhe karakterit individual të aplikacionit për regjistrimin e dizajnit industrial, e të cilat do të shqyrtohen vetëm në raste të kërkesës për inicimin e procedurave për shpalljen e invaliditetit të dizajnit industrial të regjistruar. Janë specifikuar qartë dispozitat që kanë të bëjnë me aplikimet me pronarë të jashtëm të të drejtave që rrjedhin nga regjistrimi i dizajneve industriale në Zyrën për pronësinë industriale.

Janë përfshirë dispozitat lidhur me kushtet e qarta që kanë të bëjë me përfaqësimin e të huajve në procedurat para Zyrës së pronësisë industriale, si dhe janë paraparë dispozitat të cilat kanë të bëjnë me regjistrimin ndërkombëtar të dizajneve industriale, e të cilat do të hynë në fuqi nga dita e aksesimit të Republikës së Kosovës në Marrëveshjen e Hagës.

Janë përmirësuar dispozitat për dizajnet industriale dhe aplikimet e tyre si objekte të pronës industriale që kanë të bëjnë me të drejtën e transferimit, licencimit, dizajnit si objekt i pengut, konfiskimit dhe falimentimit.

Projektligji i ri është hartuar plotësisht në harmoni me Direktivën evropiane për mbrojtjen ligjore të dizajneve industriale, si dhe me Rregulloren e BE-së e cila ka të bëjë me regjistrimin e dizajneve industriale.

Projektligji gjithashtu përmban dispozita të reja sa i përket zbatimit të të drejtave të dizajnit industrial, si dhe procedurat civilo – juridike për mbrojtjen e të drejtave të dizajnit industrial, të cilat

janë në përputhje të plotë me direktivat e BE-së, e që paraqet avancim të infrastrukturës ligjore në këtë fushë.

Miratimi i këtij projektligji është edhe një plotësim i kriterëve, i prioriteteve të Qeverisë sa i përket harmonizimit të legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së dhe përmbush një nga kërkesat e Raportit të progresit, kurse ndikimi i tij në tregun e Kosovës do të jetë i madh në eliminimin e produkteve të falsifikuara të cilat dëmtojnë konsumatorin.

Me hyrjen në fuqi të këtij projektligji do t'i harmonizojmë plotësisht ligjet nga sfera e dizajneve industriale me direktivat e Bashkimit Evropian, si dhe hapet rruga për implementimin e dispozitave të tyre, gjë që do të ndikojë në qasjen më të lehtë të mbrojtjes së pronësisë industriale në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji dhe duke pasur parasysh nevojën avancimit të kuadrit ligjor në lëmin e pronësisë industriale, ju rekomandoj që këtë projektligj ta shqyrtoni dhe ta aprovoni në këtë seancë të Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Pas prezantimit të projektligjit, hapim debatin për diskutim, në parim.

Kryetari ose raportuesi i Komisionit funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion nuk e do fjalën, atëherë fjalën e kanë kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA- SHALA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje ministra të pranishëm,

Kolegë deputetë dhe ju të gjithë që jeni në sallë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë, e dimë që ekziston Ligji për dizajnin industrial, por është paraqitur nevoja për ndryshimi e tij. Një sugjerim për ndryshim të këtij ligji është i pasqyruar edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën.

Mbrojtja e të drejtave, në veçanti mbrojtja e shpikjeve, dizajnit industrial dhe markave tregtare, është shumë e rëndësishme për tregun unik të Bashkimit Evropian. Qëllimi është për të krijuar sistem të unifikuar për mbrojtjen e këtyre të drejtave në tregun e Bashkimit Evropian siç janë: dizajnët, markat tregtare dhe patentat. Që të kualifikohen për mbrojtje dizajnët, duhet të jenë të reja dhe të kenë veçori individuale, pra duhet të jenë të ndryshme nga produktet ekzistuese.

Qëllimi kryesor i mbrojtjes së dizajnit është që të garantohen të drejtat ekskluzive për pamjen e një produkti, por jo një monopol mbi produktin si të tillë. Ajo që vlen të përmendet, mendoj që ky ligj është i rëndësishëm edhe për arsyen se, me rregullimin e dizajnit industrial, u bëhet një lehtësim edhe konsumatorëve që të mos mashtrohen nga pamja e jashtme, ndërsa brendia e ndonjë materiali ose e produkti të jetë i ndryshëm.

Vërejtjet dhe sugjerimet tona si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, do t'i japim në Komisionin funksional gjatë fazës së amendamentimit. E mbështesim në parim dhe kërkoj që edhe deputetët e tjerë ta mbështesin këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar atë LDK-së, deputeti Zef Morina e ka fjalën.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, vlerëson se Projektligji për dizajnin industrial është i rëndësishëm, pasi eliminon mangësitë dhe vështirësitë të cilat kanë ekzistuar gjer më tani në këtë fushë dhe krijon kushte ligjore në mbrojtjen e dizajnit industrial. Pra, përfshin mbrojtjen juridiko-civile, regjistrimin ndërkombëtar dhe dizajnin komunitar.

Në këtë projektligj janë përcaktuar kushtet për mbrojtjen e dizajnit industrial, e drejta në dizajn, efektiviteti, kufizimet e tjera. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah në parim projektligjin dhe përmes anëtarëve të Komisionit, do të ndihmojë që ky projektligj të jetë sa më i aplikueshëm në praktikë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputeti Ethem Çeku.

ETHEM ÇEKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe grupi ynë parlamentar, në parim e mbështet këtë projektligj duke kërkuar që Ministria të bëjë përpjekje që këtë projektligj, mbas aprovimit ta zbatojë në terren, sepse siç e dimë, në Kosovë janë duke ndodhur shumë fenomene të cilat e dëmtojnë ekonominë kosovare në përgjithësi. Prandaj, them edhe një herë si grup parlamentar e mbështesim, duke dhënë kontributin në komisionet përkatëse dhe duke kërkuar edhe një herë që Ministria përmes mekanizmave të saj, të bëjë përpjekje për ta implementuar këtë ligj dhe mos të na mbetet një ligj i cili është i mirë në parim, por i pa implementueshëm në praktikë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet për dy ministrat që janë prezentë dhe për të gjithë deputetët në këtë sallë.

Duke marrë parasysh rëndësinë e zhvillimit ekonomik të Kosovës, Grupi Parlamentar i AKR-së, ka bërë shqyrtimin e Projektligjit për dizajnin industrial dhe duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji dhe mos zbatueshmërinë e ligjit të mëparshëm për dizajnin industrial, i cili kishte mund t'i sjellë edhe shumë të hyra buxhetit të Kosovës, dhe arsyen e mbrojtjes së konsumatorit në përgjithësi dhe mundësinë e likuidimit të monopolit mbi produktet, Grupi Parlamentar i AKR-së, e përkrah projektligjin në parim, ndërsa vërejtjet të cilat janë në këtë projektligj nga grupi parlamentar do të implementohen në Komisionin parlamentar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, e ka fjalën deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, mbështet në parim Projektligjin për dizajnin industrial. Duke i ditur trendet e zhvillimit të ekonomisë së lirë, nevojat edhe të prodhuesve, por në veçanti të konsumatorëve, por edhe harmonizimin e legjislacionit kompetent të

këtij sektori me direktivat e BE-së dhe asquis communautaire, në mbështesim në parim dhe kontributin tonë do ta japim në procedurat e mëtutjeshme të amendimit të këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ju përhëndes juve edhe ministrat që janë këtu!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Ky ligj është një ligj i cili vërtet me kohë na ka ardhur dhe duhet ta përkrahim, ashtu që Grupi Parlamentar “7+” në parim e përkrah këtë ligj, se është ligj shumë i mirë.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, fjalën e ka deputeti Slobodan Petroviq.

SLOBODAN PETROVIČ: Hvala, predsedavajući!

Uvaženi ministri,

Poštovane dame i gospodo narodni poslanici,

Imajući u vidu važnost ovog zakona, pre svega... nedostatke u ovoj oblasti, Samostalna liberalna stranka, odnosno Poslanički klub je razmatrao Predlog zakona i u načelu podržava Predlog ovog zakona, s tim što ćemo uzeti obavezu da kroz amandmane u komisijama dajemo svoj doprinos. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa ponovo na datu reč!

Kada je u pitanju Zakon za industrijski dizajn, mi smo u okviru naše grupe razmotrili ovaj zakon. U načelu, zakon je dobro urađen. Daje se do znanja da je namena i cilj uopšte i potreba za ovim zakonom naime Pariske konvencije, što znamo da je ovo tržište, kada su u pitanju bili proizvodi u svetu bilo regulisano od početka 1883. godine, sve do danas i da je zadnja konvencija naime regulisanja ove oblasti sređena 1979. godine u Stokholmu i što znači da svaki proizvod mora da ima svoj izgled ili dizajn.

Jedno što hoću da kažem, opet se radi o nekim pojmovima kada je zakon u pitanju, kada su definicije u pitanju, gde moram da kažem da kada je u pitanju na engleskom jeziku, kada se kaže da je..., znamo da na ime ovog Zakona postoji interna i eksterna, što znači unutarnja i spoljašnja međunarodna klasifikacija dizajna na ime pojedinih proizvoda. Što hoću da kažem, jeste da postoji na ime ovog oblika i zakona međunarodna kancelarija, to znamo svi, koja prati dizajn i postoji Pravilnik za dizajn. Pravilnik gde je ustvari upisan pojedini dizajn. Ja imam praksu da kažem da je ovaj dizajn faktički kao vrsta neke azbuke koja je usvojena i koja se poštuje na tržištu. Ovde hoću da dam do znanja, to što sam ja primetila, dali sam u pravu ili nisam, nisam sigurna, ali kaže ovako: kada su davane definicije za dizajn, kaže “komunitarski dizajn” na srpskom, “community design” i “dizajni komunitar”. Ovde imam primedbu i u ime grupe i usvoje ime, ovde bi trebalo da postoji, ovo je bukvalno prevedeno, bukvalno i na albanskom i na srpskom, treba da sotiji: „Dizajn zajednica“, znači i proizvod ima svoj dizajn, svoj oblik potvrđen u jednini i množini. U jednini on je sam, a kada je u množini, on pripada nekoj zajednici, zajednici proizvoda, kao što su, da kažem, poljoprivredni, industrijski proizvodi i pripadani jednoj zajednici, i ovo je bukvalni prevod koji bi

trebalo da se izbacì kada budu radile funkcionalne komisije, jer im nema logiku kada gledamo “community design”, na engleskom i to je bilo rukovodeće ovo što sam videla u ovom zakonu.

Zatim, isto se ta greška nastavlja kada je u pitanju sprovođenje komunitarskog dizanja, ne, sprovođenje dizajna zajednice, znači dizajna zajednice kojoj pripada proizvod. Mislim da to trba da se ispravi na albanskom i na srpskom jeziku. Neću puno da opterećujem kolege, znam da smo umorni pre pauze. Mi u načelu podržavamo ovaj zakon i jako je potrebno za naš nastup na tržište kada je u pitanju ovaj zakon, da se prepoznamo u međunarodnoj zajednici po svojim, ja se nadam domaćim proizvodima koji će imati međunarodni dizajn, koji će nam se dodeliti ili priznati dizajn, nadamo se u budućnosti. Hvala lepa za datu reč!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Nerxhivane Dauti e ka fjalën.

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti ministër i Tregtisë dhe i Industrisë

Dizajni industrial bën pjesë në sferën e pronësisë industriale, një sferë shumë e rëndësishme për ekonominë e lirë të tregut, të mallrave dhe një serë shërbimeve. Aktualisht në Kosovë, në sferën e mbrojtjes së pronësisë industriale ekzistojnë 4 ligje të cilat janë në fuqi: Ligji për patentim; Ligji për markat tregtare, Ligji për dizajnin industrial dhe Ligji për topografitë e qarqeve të integruara.

Institucioni kryesor i cili bën implementimin direkt të këtyre ligjeve të lartpërmendura është Zyra e Pronësisë Industriale. Me anë të Ligjit për dizajnin industrial, rregullohen regjistrimi dhe mbrojtja e dizajnit industrial dhe çështjet tjera thelbësore që kanë të bëjnë me dizajnin industrial. Aktualisht në Kosovë, ekziston Ligji për dizajnin, mirëpo gjatë fazës së implementimit të këtij ligji, është shtruar nevoja e domosdoshme që i njëjti ligj të plotësohet për disa aspekte. Së pari, me qëllim që të lehtësohen procedurat e regjistrimit dhe mbrojtjes së dizajnit industrial, së dyti që të sigurohen procedura më të qarta juridike për mbrojtjen nga apo zbatimi i të drejtave të dizajnëve industriale dhe së treti për të miratuar një ligj modern të harmonizuar me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane në sferën e pronësisë industriale, duke siguruar në këtë mënyrë mbrojtje efikase të objekteve të pronës industriale në Republikën e Kosovës.

Qëllimi i këtyre rregullave të ndryshuara është që t’u ofrojë bizneseve një sistem efektiv dhe të lirë për t’i ndihmuar ata për të fituar qasje në mbrojtjen e dizajnëve. Marrë në përgjithësi, ligji i propozuar është punuar mirë, megjithatë në ë disa kapituj duhet të bëhen riformulime të caktuara, më konkretisht në kreun 13, që ka të bëjë me mbrojtjen civile-juridike të dizajnit dhe zbatimin e së drejtës, në nenin 66, neni 67, 68, 69, 70, në kreun 14 që rregullon çështjen e përfaqësimit, në nenet 78,79 dhe në nenet tjera. Dhe, për këto çështje të cekura, konsideroj se duhet paraqitur amendamente konkrete, me qëllim që të bëhet qartësimi më i qatë i normës juridike dhe që implementuesi i ligjit në fjalë, të jetë më i aplikueshëm.

Dhe, në fund, konsideroj se Ligji për dizajnin, është një ligj i mirë, i kontribuon sferës së mbrojtjes së pronësisë industriale, dhe asaj intelektuale në përgjithësi, bëhet rumbullakimi i rregullimit të çështjeve konkrete që kanë të bëjnë me këtë pronë shumë të rëndësishme për Republikën e Kosovës dhe konsideroj se në shqyrtim të parë duhet miratuar, me vërejtjet dhe sugjerimet e lartpërmendura. Ju falënderoj!

KRYESUESI: Ju faleminderit! I fundit e ka fjalën deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues,

Ministra dhe deputetë të respektuar,

Shkurtimisht do të angazhohem që çështjen e këtij ligji ta ndërlidh me ligjin që pason për shenjë tregtare, por në këtë kontekst ta theksoj këtë fakt se shtetet moderne nuk e aplikojnë këtë metodë tonën, që të bëjnë ligj veç e veç për secilën formë të pronës intelektuale, se prona industriale është pronë intelektuale, quhet në literaturë edhe pronë industriale. Disa prej tyre bëjnë pronën me një ligj të gjitha format e pronës intelektuale, definojnë përcaktohen, edhe caktohet edhe regjistrimi e mbrojtja e tjera. Por, disa shtete, një grup tjetër, format klasike të pronave intelektuale, me një akt ligjor, ndërsa patentën, licencën, nau-haus, emrin tregtar, shenjë tregtare, jo markën tregtare, servisin, shërbimin tregtar, dizajnin, me një akt ligjor. Ja, pse, këtu është prioriteti se më së pakti gjysma e faqeve të këtij ligj mund t'u referohen të gjitha formave të pronave industriale. Prandaj, do ta kishim racionalizuar, domethënë, epim, e kishim trajtuar po e zëmë, dizajnin industrial, ka edhe artistik, grafik e tjera që këtu nuk janë thënë, por mirë, këtu i referohet këtij, po asisoj më pastaj shenjë tregtare e kështu me radhë edhe kjo pjesa e dytë komplet gjysma e tekstit të këtij ligji, do t'i referohej edhe shenjës tregtare edhe emrit tregtar edhe nau-haus edhe shërbimit tregtar e kështu me radhë.

Kam shumë vërejtje, por vetëm në një do të ndalem, te regjistrimi. Te regjistrimi, kjo është një çështje shumë interesante, atraktive është kështu edhe për trajtim edhe për meditim. Mirëpo, këtu nuk është rregulluar mirë dhe duhet të rregullohet mirë, ja pse, të regjistrimi i formave të pronave industriale, intelektuale, përkatësisht, aplikohet koha astronomike, ju lutem. Kjo dispozitë duhet të rregullohet, krejtësisht të rregullohet, sepse mund të ndodhë që disa entitete ta kenë zbuluar, po e zëmë, një dizajn e mund të kushtojë. Po e zëmë, nuk është fjala për dizajnet që janë të lira apo jo, mund të ketë çmim shumë enorm e më pastaj do të ketë të drejtë vetëm ai apo ajo, apo ata që kolegja e tha me vend atje communautaire, se komuniteti është fjala për dizajnin e përbashkët që të ketë të drejtë. Prandaj, aty hapen shumë çështje se mund të bëhen investime të mëdha e do të ketë të drejtë vetëm ai/ajo, apo ata që e regjistrojnë të parët. Prandaj, kjo duhet të rregullohet mirë.

Ka edhe tjera vërejtje, natyrisht, tani do të kursehem. Ju falënderohem!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Ministri nuk e ka kërkuar fjalën. Vazhdojmë me pikën e shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës:

17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për markat tregtare

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji. Ftoj ministrin e Tregtisë dhe të Industrisë, zotin Lutfi Zharku, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të Kuvendit, të prezantojë projektligjin.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryesues, ministër,

Të nderuar deputetë,

Misioni i një sistemi efikas të pronësisë intelektuale është mbrojtja dhe sigurimi i zbatimit të drejtave të objekteve të pronësisë intelektuale, kurse në këtë rast të asaj industriale. Duke ditur që pronësia industriale është një nga fushat bartëse të zhvillimit të ekonomisë së një vendi, mbrojtja e saj do të thotë, mbrojtje e investimeve dhe zhvillim i teknologjive të reja në procesin e prodhimit dhe ofrimit të produkteve dhe shërbimeve të reja dhe inovatore në treg. Kjo do të ndikojë në përmirësimin e strukturës së produkteve dhe shërbimeve të ofruara në treg, me qëllim të mbrojtjes së

jetës, shëndetit të popullatës, mjedisit, konsumatorëve, resurseve natyrore si dhe rritjes së cilësisë së produkteve dhe shërbimeve.

Në projektligjin e propozuar specifikohet procedura më e thjeshtëzuar për regjistrimin e markave tregtare në territorin e Republikës së Kosovës, pasi që është hequr ekzaminimi në baza relative i regjistrimit të markave tregtare, i cili parashihet të bëhet vetëm mbi bazë absolute, refuzimit të regjistrimit të një marke tregtare.

Projektligji respekton parimin e territorialitetit të drejtave të markës së regjistruar tregtare dhe përcakton raportin e të drejtave të markave nacionale ndaj markave ndërkombëtare dhe markave të komunitetit evropian, pas anëtarësimit të Kosovës në Bashkësinë Evropiane.

Po ashtu me projektligjin e ri përcaktohet qartë sipas direktivave të BE-së e drejta e përdorimit e një marke të brendshme ku prova e përdorimit të një marke të brendshme tregtare mund të kërkohej me anë të kundërshtimit të regjistrimit gjatë fazës së regjistrimit të një marke tregtare apo të fillojnë procedurat për anulimin e një marke të regjistruar tregtare.

Element i rëndësishëm i këtij projektligji është që ky përmban dispozita për zbatimin e të drejtave të markës tregtare të cilat janë në harmoni të plotë me direktivën e BE-së, e cila ka të bëjë me zbatimin e të drejtave të markave tregtare, të cilat dispozitat nuk ishin në nivelin e tillë në rastin e ligjit aktual.

Gjatë hartimit të këtij projektligji, po ashtu janë marrë për bazë një numër i dokumenteve ndërkombëtare që rregullojnë sferën e pronësisë industriale në aspektin ndërkombëtar e që përfshinë direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian si dhe marrëveshje, traktate dhe konventa të nivelit botëror.

Miratimi i këtij projektligji është po ashtu një plotësim i prioriteteve të Qeverisë sa i përket harmonizimit të legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së si dhe përmbush një nga kriteret e raportit të progresit, kurse ndikimi i tij në tregun e Kosovës do të jetë i madh në eliminimin e produkteve të falsifikuara të cilat dëmtojnë konsumatorin. Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji dhe duke pasur parasysh nevojën e avancimit të kuadrit ligjor, ju rekomandoj që këtë projektligj ta shqyrtoni dhe ta miratoni në këtë seancë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani hapi debatin për projektligjin e paraqitur nga ministri Zharku.

Ftoj kryetarin ose raportuesin e komisionit funksional, nuk dëshiron ta marrë fjalën.

Atëherë, ftoj kryetarët e grupeve parlamentare ose prezantuesit në emër të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka Sala Berisha - Shala.

SALA BERISHA- SHALA: Faleminderit, kryesues!

Përhëndetje për të gjithë!

Edhe ky ligj është në vazhden e ligjit që e shqyrtuam më parë dhe të ligjeve të tjera që janë si pako e këtyre ligjeve që rregullojnë një sferë shumë të rëndësishme industriale. Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e kemi shqyrtuar këtë projektligj, e mbështesim në parim dhe kontributin tonë do ta japim në Komisionin funksional dhe atje do të shprehim edhe dilemat tona rreth titullit të këtij projektligji, përkatësisht shprehjes markë tregtare, është shenjë apo marka, atje do ta diskutojmë në komision, edhe më tutje do t'i japim vërejtjet dhe sugjerimet tona. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, e ka fjalën deputeti Zef Morina.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka shqyrtuar Projektligjin për markat tregtare dhe do ta mbështesë në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ethem Çeku.

ETHEM ÇEKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi ynë Parlamentar, në parim do ta mbështetë këtë Projektligj dhe, edhe pse e dimë që ekziston një ligj aktual dhe, në të cilën është kërkuar të ndryshohet sipas edhe kërkesave të BE-së dhe institucioneve tjera ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Projektligjin për markat tregtare, po ashtu ne do të ngremë edhe njëherë shqetësimet tona që kërkojnë që Ministria pas aprovimit të projektligjit, të mund ta aprovonjë në tërësi këtë projektligj, sepse e dimë se në çfarë shtate është tregu kosovar në përgjithësi. Në parim e mbështesim dhe vërejtjet tona prapë do t'i japim në Komisionin Parlamentar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i AKR-së, e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për markat tregtare dhe që në start duhet t'ju them se Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah në parim këtë projektligj, duke marrë parasysh se ka qenë në raportin e progresit si vërejtje të cilën është dashur ta plotësojë Kosova dhe duke marrë parasysh se me këtë ligj, bëhet mbrojtja e mallrave vendore dhe investitorëve vendorë dhe investitorëve të huaj të cilat momentalisht i duhen më së shumti Kosovës. Ligji është bërë në harmoni me direktivat e BE-së, mirëpo kishte me qenë edhe një kërkesë e imja ministër që ky ligj të zbatohet në përpikëri duke ditë se zyra për pronësi industriale ka përkrahjen edhe të Komisionit Evropian.

Duke marr parasysh shumë çështje të cilat shtjellohen në ligjin për marka tregtare, mund të them se me këtë projektligj, pas kalimit të shqyrtimit të dytë, do të bëhet edhe një mbrojtje më e mirë ndoshta edhe vetë konsumatorëve mirëpo, njëkohësisht do të bëhet edhe një mbrojtje më adekuate për investitorët vendorë dhe investitorët e huaj. Duke marrë parasysh rëndësinë shumë të madhe të këtij projektligji dhe mundësinë e mos dëmtimit të qytetarëve tanë, Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah në parim këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Në vazhden e këtyre ligjeve, të një pakoje ligjore, e shohim të rëndësishëm si grup parlamentar që ta mbështesim në parim Projektligjin për markat tregtare. Duke e ditur nevojën e avancimit të kësaj fushe të legjislacionit dhe harmonizimi me legjislacionin e Bashkimit Evropian, ne e mbështesim

në parim dhe kontributin tonë do ta japim gjatë procedurave tjera të mendimit të këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, predsedavajući!

Pozdrav ministrima i zameniku premiera!

Ja u ime naše grupe iznosim informaciju da smo mi dobro proanalizirali i Nacrt zakona o trgovačkim marama, ali i sva propratna akta, kao i usklađenost sa evropskim zakonodavstvom. Kao i kod industrijskog dizajna, u Evropi se pridaje veliki značaj ovoj materiji. Te konvencije koje regulišu ovu oblast imaju vrlo dugu tradiciju. Naravno da smo mi novi na svemu ovome, ali se ipak radi o potrebi pravne zaštite ekonomske prirode i ne samo dakle ekonomike, kako ne bi dolazili do čestih sukoba ekonomskih subjekata oko znakova njihovih proizvoda, te i sukoba u slučajevima kopiranja tuđih marki. To je veoma dobro regulisano evropskim zakonodavstvom. Mi ćemo sigurno slediti njihova iskustva. Ovde se radi o zakonu koji je dosta jasan i mislim da će naša diskusija i kasnije naš rad još više da ga upotpuni. Mi ga prihvatamo u načelu.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk ka të paraqitur.

Në emër të Grupit parlamentar për Integritet, deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala ponovo na datu reč!

Kada je u pitanju Zakon o trgovačkim markama, mi smo kao grupa pažljivo razmatrali. Ovo je isto u sklopu prethodnog zakona, Zakon o dizajnu. Sa ovim se zakonima reguliše tržište, ekonomsko tržište kada su u pitanju proizvodi, roba, usluge domaće proizvodnje jedne zemlje i kada je u pitanju strano tržište i okruženje, kao što je u ovom slučaju za nas Evropska zajednica. Ovo je isto potreba na osnovu evropskih zakona, međunarodnih povelja i da ne bi zamarali kolege, mi podržavamo u celosti ovaj zakon i nadamo se da će biti primenjivan, da Kosovo, naši pojedini akteri na tržištu neće da plaćaju penale ako bude bilo falsifikovanja marke koje su poznate u svetu, za koje, ako se uzima licenca, plaća se normalno zakup za licencu. Ja se nadam da će Ministarstvo dobro da napravi mehanizme za praćenje i sprovođenje ovog zakona, kako ne bi posledice, kao grupa smatramo, ne bi trpeo i sam budžet Kosova za pojedine proizvode gde imamo priliku da vidimo da su pojedine marke prisutne na proizvodima, a ustvari taj proizvod ili ta marka, taj investitor nije ni došao na Kosovo. Nadamo se da će ovim zakonom ovo tržište da se reguliše, jer ipak ekonomija je u pitanju i normalno standard svih nas na Kosovu, koji se reguliše sa ovim zakonima. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

E fundit, deputetja Nerxhivane Dauti.

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit, zoti kryesues për fjalën e dhënë!

Përhëndetje, zoti zëvendëskryeministër, Kuçi, dhe të gjithë të pranishmit në sallë!

Ligji për markat tregtare, rregullon një fushë të rëndësishme siç është ajo e markave tregtare. Marka tregtare janë komponentë e rëndësishme e pronës intelektuale, ato përdoren nga ndërmarrjet gjatë zhvillimit të afarizmit të tyre me qëllim të dallimit të produkteve të tyre nga produktet dhe shërbimet e të tjerëve.

Markat tregtare kanë për funksion garantimin e cilësisë, janë indikatorë për konsumatorët që kërkojnë produkte të sigurta, siguroes që shpërblimet u shkojnë investitorëve të cilët posedojnë emër tregtar, i cili përfaqëson qëllim dhe reputacion të mirë dhe njëkohësisht mbrojnë të drejtat dhe detyrimet që ndërliken me pronën.

Aktualisht në Kosovë, ekziston ligji për markat tregtare numër 02-L54, por i njëjti është konsideruar se duhet të jetë në harmoni me aktet më të larta të Bashkësisë Evropiane. Ligji të cilin jemi duke e shqyrtuar krijon një bazë tumirë ligjore për mbrojtjen dhe regjistrimin e markave tregtare në Zyrën për Pronësi Industriale në Republikën e Kosovës, si organ i vetëm për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e markave tregtare. Ligji për markat tregtare në mënyrë koncize rregullon çështjet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me rregullat për mbrojtjen e markave tregtare, mënyrën e fitimit të së drejtës të markave tregtare, si atyre të rëndomta, markave kolektive dhe markave certifikuese, procedurat për regjistrim dhe mbrojtjen juridike civile dhe procedurat e tjera lidhur me markat tregtare. Nga kjo është me rëndësi të theksohet se ligji është gjithëpërfshirës sa i përket rregullimit të markave tregtare, pra kategorizimin e tri lloj të markave tregtare, që në mënyrë decitive i rregullon ligji në fjalë.

Funksioni kryesor i një marke tregtare është të shërbeji identifikues i burim, sa më e dallueshme të jetë një markë tregtare, aq mëshomë mbrojtje do të meritojë. Sipas këtij spektri, ekzistojnë 5 nivele të fuqishmerisë së markave tregtare. Nën një, markat e sajara, nën dy markat arbitrarë, nën tre markat sugjeruese, nën 4, markat përshkruese dhe nën 5, markat e përgjithshme.

Ligji për markat tregtare tani është i harmonizuar në tërësi me konventat ndërkombëtare që rregullojnë markat tregtare dhe më konkretisht me Konventën e Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale të vitit 1883, me marrëveshjen e Madridit të vitit 1891, me protokollin e Madridit, i cili është i harmonizuar me klasifikimin ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve, krijuar nga Marrëveshja e Nicës. Janë mbi 70 shtete palë të kësaj marrëveshje të përmendur, të cilët e përbëjnë të ashtuquajturën Union Special në kuadër të kuadër të kornizës të Unionit të Parisit. Edhe Kosova e përdorë marrëveshjen e klasifikimit Nice. Sipas nenit të Marrëveshjes, çdo shtet jashtë Unionit Special, por i cili është palë e Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronës industriale, mund t'i bashkohet aktit dhe njëkohësisht të bëhet shtet i Unionit Special. Fatkeqësisht, Kosova nuk është as palë e Konventës së Parisit.

Si rrjedhojë, nuk mund t'i bashkohet Unionit Special, të cilin e përmendëm më lartë. Fakti se Ligji për markat tregtare tani është plotësisht i harmonizuar me direktivat evropiane, hap rrugën me qëllim të harmonizimit të ligjeve kombëtare për markat tregtare, është indikator për konsumatorët që të kenë një bazë të fuqishme ligjore, që të kenë produkte vërtet të sigurta.

Këto direktiva, me qëllim i kam përmend, sepse ligji aktual nuk i ka pasur të harmonizuara me të njëjtat, prandaj unë e përshëndes ligjin në fjalë, meqenëse në përpikëri i përmbahet këtij kriteri dhe mendoj se krijon një bazë vërtet të fuqishme ligjore për konsumatorët dhe për të gjithë pjesëmarrësit në treg, pra si për personat fizikë, ashtu edhe për personat juridikë. Dhe në fund, duke marrë parasysh rolin dhe rëndësinë veçantë të këtij ligji për ekonominë e lirë të tregut, për mallra dhe shërbime, e mbështes në shqyrtim të parë këtë ligj, ndërsa kontributin tim profesional do ta paraqes në Komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete! Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e do fjalën. Vazhdojmë me pikën e tetëmbëdhjetë të rendit të ditës

18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullore së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji. Ftoj zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi, që para deputetëve, ta prezantoj projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Zonja e zotërinj

Më lejoni që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës të paraqes para jush Projektligjin për ndryshimin dhe ndryshimin e Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës. Ky projektligj ka për qëllim disa ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03-132 për protokollin e shtetit.

Projektligji për Protokollin e Shtetit rregullon procedurat e akreditimit dhe procedurat pas akreditimit të shefave të misioneve diplomatike të huaja, të cilët do të akreditohen nga presidenti i Republikës së Kosovës. Po ashtu, projektligji përcakton procedurat e kredencialeve para presidentit të Republikës. Projektligji rregullon fillimin e detyrës së diplomatit, atashut ushtarak, konsullit, funksionarit të organizatave ndërkombëtare si dhe kriteret për përzgjedhjen konsullit të nderit.

Me këtë projektligj, presidentit të Republikës së Kosovës i mundësohet që të pret miq të nivelit të lartë dhe në mjediset e tjera rezidenciale, kur vizitori është ë i nivelit të njëjtë. Po ashtu, sipas skemës së paraparë me këtë projektligj të protokollit, të shtetit, janë përcaktuar përparësi të rangjeve zyrtare, të cilat janë ndarë në tri grupe kryesore. Ky projektligj ka për qëllim edhe forcimin e komunikimit të protokollit të shtetit, me misionet diplomatike dhe konsullore, si dhe me Protokollin e Qeverisë dhe të presidentit të Republikës së Kosovës. Projektligji parasheh edhe një trajtim të veçantë për përfaqësuesit e kryeqytetit të Republikës së Kosovës.

Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Protokollit të Shtetit, është përgatitur nga Zyra e Kryeministrit dhe është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me standardet e BE-së. Gjatë hartimit të tij, janë bërë edhe hulumtime dhe trajtimet me shtetet e përafërta. Natyrisht, që ky projektligj ka nevojë që të jepen sugjerimet dhe plotësimet e duhura, edhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe të kemi një projektligj që rregullon në mënyrë të denjë protokollin, i cili do të jetë më shumë protokoll shtetëror se sa tradicional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti zëvendëskryeministër!

Pas prezantimit, tani po e hapim debatin. Kryetari ose raportuesi i Komisionit funksional për Punë të Jashtme, profesor Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë do të flas dyfish edhe në emër të Komisionit edhe të Grupit Parlamentar të LDK-së. Ky është një ligj që është aprovuar para një viti. Ka hyrë në funksion, tash po vjen i plotësuar ashiqare edhe i sprovuar brenda një viti dhe unë mendoj që ka qenë e domosdoshme që të jetë ky përplotësim.

Pikat themelore të plotësimeve dhe precizimeve i tha në mënyrë lapidare paraqitësi i ligjit në emër të Qeverisë, zëvendëskryeministri Kuçi.

Unë mendoj që me këto plotësime dhe me një rilexim të kujdesshëm të tërësisë së ligjit, pjesët që jepen tash dhe ato që ekzistojnë, mund të krijohet një harmonizim i ri i Protokollit të Shtetit të Kosovës, veç se që në fillim unë po them që edhe referenca që e lexoi zëvendëskryeministri, edhe ajo që e kemi në tekst, në ligj, është referencë e gabueshme, sepse ky ligj nuk ka të bëjë me “Gazetën zyrtare”, qysh thuhet, më 4 qershor 2008, por me “Gazetën zyrtare” nr. 53, 1 qershor 2009, më 2008 nuk ka qenë ky ligj, mund të jetë që është një gabim në regjistrime, në referenca, por unë po them që këtu duhet të kihet parasysh që ky neni 1 të precizohet.

Padyshim që LDK-ja dhe komisioni do të merren me këtë ligj, sidomos komisioni funksional dhe mendoj që sa më shpejt ta marrë një formë më të përkryer dhe të kalojë në Kuvend. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të PDK-së, deputeti Ramadan Gashi.

RAMADAN GASHI: Ju faleminderit, zoti kryesues,

I nderuar zoti zëvendëskryeministër,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës, dhe ne në parim e përkrahim aprovimin e këtij projektligji, pasi që mendojmë se bëhet një kompletim më i mirë i kësaj materie ligjore dhe bëhet harmonizimi me standardet e hartimit të legjislacionit në Republikën e Kosovës. Dhe, pasi që kjo fushë, është fushë ekskluzivisht e legjislacioneve nacionale, por që natyrisht duhet të jetë në përputhje me praktikat e të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtën zakonore ndërkombëtare, mendojmë se edhe shteti ynë po e kryen një obligim i cili si shtet i ri i takon. Natyrisht se në komisionet funksionale, ne do ta japim kontributin tonë. Në parim e përkrahim votimin e këtij projektligji.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Zotëri zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Nuk është bërë adet t’ju them se a ju kam thënë para një viti që keni për ta kthyer këtë ligj prej kësaj foltoreje se nuk vyen gjë edhe kam shpresuar që kur ka ardhur, ka për t’u ndrequr, por tash prapë po e shohim se kurrëgjë hiq nuk është ndrequr edhe kam për t’ju kallëzuar pse nuk është ndrequr kurrëgjë se çfarë protokolli po duam ta bëjmë.

Kemi qenë në njëfarë vizite zyrtare me do kryetarë të grupeve, përpos të njërit edhe me disa deputetë edhe një sekretar i përgjithshëm i një Parlamenti na u ankua se ka shumë ligje që po vijnë edhe na e këqyrëm seri edhe ai na tha se kur të vijnë shumë ligje, diçka nuk është në rregull me Qeverinë. Tha kemi problem tha, se nuk bën të vijnë kështu kaq shumë ligje se është krejt kaos situata. Tash një legjislaturë ta shqyrtojë brenda vitit një ligj dy herë është domethënë problem që ka shteti, ky është problem i shtetit se nuk bën kështu. Edhe prapë kur fola për ligjin paraprak, ju thashë se nuk ka entuziazëm, nuk po do të punojë askush edhe shihni ju çfarë entuziazmi ka në Kuvend të Kosovës. Nuk ka kuorum për të votuar. Zëvendëskryeministri një ligj për protokollin e

shtetit e lexon për një minutë, njerëzit nuk donë as të flasin, të gjithë thonë e përkrahim, e përkrahim, e përkrahim edhe thonë na në grupin tonë parlamentar e kemi shqyrtuar. Nuk e kanë shqyrtuar në grup parlamentar, i ka thënë njëri shqyrto ti. Kështu shkon kjo punë. Edhe po ju kallëzoj që, tash po dua për t'ua lexuar se çka shkruan në ligj. Memorandumi është tepër me rëndësi çka shkruan, memorandumi shpjegues, pika 9, do të thotë pse ligji është kështu, thotë kështu: Risitë të avancimet e projektligjit, edhe shkruan, po citoj, po e lexoj çka shkruan në projektligj: “Me hyrjen në fuqi të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimi e Ligjit o3/L-132, për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës, bëhet plotësimi i Ligjit o3/L-132 për Protokollin e Shtetit të Kosovës”. Domethënë, kjo është pjesa e memorandumit shpjegues, pse domethënë, cilat janë përparësitë edhe avancimet e këtij projektligji, kështu na shkruan Zyra e Kryeministrit...

KYESUESI: Deputetë, ju lus për qetësi!

ARDIAN GJINI: Është drejtori i Zyrës për Shërbime, nuk po ia them emrin.

Në nenin 2, paragrafi 5, është tepër me rëndësi. Shih çka thotë: “Ambasadori i ri, gjatë kohës kur nuk i ka krejt letrat kredenciale në rregull, mund të takojë anëtarë të trupit diplomatik, zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe personat tjerë jozyrtarë, por i sugjerohet të mos kërkojë takim me anëtarët e Qeverisë, Kuvendit dhe Presidencës”. Do të thotë, ambasadorëve të këtyre vendeve të mëdha që vijnë këtu rrinë nga një muaj a dy, por atyre me ligj tonin u sugjerohet të mos lypin takime me ministra, me kryeministrin, me kryetarin e Kuvendit. Kurrkujt në Qeveri të Kosovës nuk po i shkon ndërmend që ky paragraf i këtij neni, është diçka që na e rregullojmë për ambasadorët tonë edhe shtetet e atyre ambasadorëve prej kah vijnë e rregullojnë për ata. Nuk mund ne me ligj t'ia ndalojmë asnjë ambasadori të kërkojë takim as nuk mundemi me ligj për t'iu sugjeruar. Qysh i sugjerohet ambasadorit të huaj me ligj? Po të sugjerojmë mos lyp takim me një ministër dhe këtë e shkruan ky ligj që na po dom ta mbështesim.

Tash, për shembull po shkojmë te disa çështje tjera, e kemi nenin 11, që thotë prapë me ligj, ambasadori i huaj kur largohet prej vendit, duhet ta lajmërojë, kur largohet për periudha të shkurta, duhet ta lajmërojë brenda një periudhe të shkurtër ndaj, ta lajmërojë Qeverinë tonë që është shkuar dhe ta lajmërojë kush është. Prapë kjo është një rregull që na bëjmë për ambasadorët tonë edhe ata e bëjnë për shtetet e veta, ose tjetra, shiko çka propozon ligji jonë, qa thotë domethënë që mundet të thyhet, brenda një periudhe kohe prej 1 deri në 2 muaj, nga paraqitja e kredencialeve, do të thotë për ambasadorin e huaj, ambasadori i ri thirret, së bashku me një apo dy ambasadorë tjerë, për drekë ose darkë kurtuazie nga ministri i Punëve të Jashtme. Tash edhe një çështje, e cila duhet të rregullohet me rregullore të brendshme, ne dom ta rregullojmë me ligj, duhet t'ia themi ministrit këqyr brenda nga dy muajve thirre për darkë, se është mirë.

Neni 3 është njëjtë, ka pjesë për shembull ku thuhet: “zonja e parë, a e dyta, a e katërta, nuk është me rëndësi, duhet t'ia thërrasë gratë e ambasadorëve brenda nga dy muajve për darkë, me ligj rregullohet. Po çka të bësh nëse zonja e parë është egërsirë që nuk do për ta thirrur, e them ligjin çka t'ia thuash atëherë presidentit ndaj prej gruas se e ka thyer ligjin.

Këto janë çështje që nuk rregullohen me ligj, këto janë çështje që rregullohen me rregullore të brendshme se Ministrisë së Punëve të Jashtme se nuk bën t'ia thuash me ligj zonjës së parë thirri për darkë edhe për drekë gratë e ambasadorëve. Për të mos e zgjatur më tepër, e kemi edhe listën e protokollit. Lista e protokollit ka përmirësime, dorën në zemër, prej listës së fundit të protokollit, mirëpo në këtë shtet dikush që po i shkruan ligjet, po e qet veten pak më lart, ju thashë ka humbur entuziazmi. Sekretarët e përgjithshëm, domethënë, sekretarët e shtetit, nëse e merrni listën do të ulën në radhë pak më larg se vartësit e tyre. Shembull ta marrim se disa drejtorë të agjencive ose

departamenteve, e sekretarët janë shefat e tyre. Domethënë, edhe këshilltarët politikë ulën më përpara zëvendësministrave që votohen këtu, se këshilltarët e kanë shkruar ligjin, ata kanë qenë aty me këta farë drejtorët. Domethënë, këto janë sende që janë të çuditshme edhe ky ligj prapë do të vijë në Kuvend të Kosovës, po ju them edhe për të tretën, edhe për të katërtën e për të pestën herë se Ligj për protokollin 5-6 nene, nuk ka nevojë me pas më shumë, por Qeveria po do të kallëzojë kur zonja e parë duhet t' i thërrasë në darkë gratë e ambasadorëve edhe po më bën përshtypje që njerëzit nuk po flasin për këto tema, diqysh po i lëshojnë teposhtë. Hajt le të shkojë se është edhe një ligj tjetër, punë e madhe fort që është edhe një ligj, po thua se na ka prurë dikush me zor këtu. As nuk do të flasë kurrkush, as nuk donë me ndejë në sallë, nuk na ka prurë kurrkush bre, kemi lyp për të ardhur, ta përfaqësojmë popullin edhe nuk mund t' i lëshojmë ligjet pa kurrfarë lidhjeje hiq me temën që e kanë që të na kalojnë kështu.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, zoti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Grupi Parlamentar i AKR-së, përkatësisht përfaqësuesit e këtij grupi që aderojnë në komisionet përkatëse e pastaj edhe i gjithë grupi do ta shqyrtojnë, por e kemi lexuar me vëmendje dhe dua të them që intervenimet që janë bërë në Ligjin për Protokollin e Shtetit, sipas nesh, nuk janë shumë substanciale, madje, madje pjesa më e madhe e tyre lidhen vetëm me nenin 6 të ligjit që ka qenë në fuqi dhe konzorojnë që kanë mund të bëhen përmes akteve nënligjore, sepse, nëse i përcillni përmbajnë shumë detaje që në asnjë ligj për protokollin e shtetit, në ligj po flas, jo në akte ligjore, nuk i gjen. Për shembull si duhet të vishet ambasadori kur të vijë t' i prezantojë kredencialet e tjera e tjera, ose për disa detaje që po t' i lexoni me vëmendje, e shihni se janë të tepërta dhe e rëndojnë një ligj. Prandaj, mendoj që ndoshta ky nen ka mund të zgjerohet edhe pak se shteti i Kosovës nuk ka qenë shtet dhe nuk ka pasur fort përvojën se si t' i presë ambasadorët e vendeve tjera, mirëpo jo në këtë volum çfarë detajesh dhe çfarë intervenimesh janë futur e që krejt lidhen me nenin 6.

Unë po e filloj prej memorandumit shpjegues 2, domethënë, pika 2 te qëllimi. Kjo që na vjen, na vë në lajthitje, e tha edhe profesor Hamiti, ligji i referohet Gazetës Zyrtare numër 28, pra, dhe unë kur e marr atë, nuk e gjej hiq kurrkund dhe pastaj, me ndihmën e Sekretarisë së Kuvendit e gjeta Ligjin që është i një viti më vonë. Kjo është çështje teknike që është marrë nga një ligj tjetër ky farë paragrafi me kopy paste edhe ka mbetur i një ligji tjetër që nuk do të duhej kështu, sepse na krijon shumë huti.

Çështje në vijim që konsideroj që nuk ka shënuar shumë avancim, u tha edhe nga parafolësit, është çështje e listës, përkatësisht e rangjeve të zyrtarëve të lartë në shtetin e ri të Kosovës. Pa dashur te grupi i parë, sepse mirëfilli dihen se janë katër instanca që, domethënë, katër institucione që futen në grupin e parë, por po dal menjëherë te grupi i dytë, ish- kryeministrat janë në grupin e dytë, rangohen në vendin 32-të, që i bie pas kryetarëve të komunave dhe pas shumë zyrtarëve që janë më të vegjël, shumë më të vegjël dhe për mua është goxha skandaloze që unë nuk e pash së pakut që mungojnë ish- kryeparlamentarët, nuk janë hiq dhe kjo është një lëshim që nuk guxon të ndodhë.

Po ashtu mund të futen edhe deputetët te kategoria e tretë, jo janë deputetë aktual parlamentarë, por ish- parlamentarët nuk janë, por ajo që do të doja të nënvizoj meqë po bisedojmë për këtë ligj është, ne kemi pasur një ligj megjithatë bazik që një vit dhe ne kemi nënvizuar disa herë se përshtypjet nga ceremonitë e organizuara nga Zyra e Protokollit, që fiktivisht ka ekzistuar,

ceremonitë kanë pasur aq shumë defekte sa të mos ekzistonte hiq ajo zyrë dhe ka pasur mungesë të skajshme të koordinimit ndërmjet Zyrës të Protokollit të shtetit dhe zyrave të protokolleve të institucioneve, të cilat ndonjëherë na kanë bërë të skuqemi si zyrtarë të këtij shteti.

Unë po e përmend vetëm një rast më të freskët që mund ta kujtoni të gjithë, ditën e përzimit të katedrales, zëvendëskryeministri, të shtunën, në fakt kur prezantohen presidenti që është organizator dhe protokollit i Ministrisë së Kulturës apo i Presidencës, ka pasur aq shumë gabime sa që njërit nga zëvendëskryeministrat ia lëshon vendin kryetari i komunës se mbetet pa vend, ndërkaq ministri i Ministrisë përkatëse është ulur afër Presidentit dhe nuk lëvizë fare. Kjo sepse, nëse nuk e dini të nderuar kolegë, protokollit i shtetit ka njëfarë organizimi gati ushtarak dhe mund ta kapë për krahu një zyrtar edhe më të lartin qoftë nëse është ulur në vend gabimisht. Dhe, kjo ka ndodhur edhe të nesërmen, skandali edhe më i madh ditën e diele, tjetri zëvendësministër, le të më falin që po i përmend, mezi gjen vend të ulët në rendin e tretë. Dhe, pavarësisht se dikush po thotë u vonua, nuk ka u vonua në protokoll, vendi mbetet i zbrazët. Unë i përmenda vetëm këta dy shembuj eklatantë, por ta dini që në krejt ceremonitë, prej shpalljes së pavarësisë e këtej e të mos them edhe më herët, në institucionet tona, në protokollin e institucioneve dhe në protokollin e shtetit, që së paku është përgjegjës për Presidencën, për kryeministrin, për ministrin e Jashtëm dhe për kryeparlamentarin, nuk guxon të ketë pasur këso defekte, sepse impresioni i parë i atyre që s'janë kosovarë kur i shohin këto sende thonë, ngadalë se nuk qenkan këta njëherë për t'ua hequr pavarësinë e mbikëqyrur, por për t'ua shtuar dozën e mbikëqyrjes.

Po them do ta japim kontributin në komision. Unë e di që ka një kohezion të mirë në punën e Komisionit për Punë të Jashtme që diçka të heqim nga ato që janë futur si shumë detaje, diçka të shtojmë, por unë po dua të them a do të funksionalizohet Zyra e Protokollit të Shtetit pranë Ministrisë së Jashtme qysh është e rregulluar, a do të funksionalizohet që ... apo jo? Në rast se nuk funksionalizohet, atëherë kot bëjmë ligje, e po them që është përshtypja ime besoj edhe shumë kolegëve jo si opozitarë është që duhet të korrigjohemi në këtë pikë.

Grupi parlamentar i AKR-së në parim e mbështet, por në lexim të dytë do të jetë kontribuues për aq sa mundet, edhe unë mendoj që besoj shumë që përshtatet ky, përkatësisht përpunohet për t'u bërë i pranueshëm dhe ne e mbështetim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Me gabim të teknikës i ke hëngër nja 3 minuta më shumë, po s'ka dert. Ata t'i dhanë.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe ne në atë kohë kur pat ardhur ky projektligj, shumë i mangët, i hartuar shumë dobët, pa përmbajtje shtetërore, diplomatike dhe pa një shpirt protokollar që i nevojitet një shteti, nuk e patëm mbështetur. Dhe, dua të them edhe plotësim- ndryshimi i këtij projektligji vjen ende më skandaloz, me gabime substanciale, përmbajtjesore, diplomatike e mos të flasim për protokollare. Për çfarë protokollit të shtetit po bëhet fjalë ende ka paqartësi? Cilat janë kompetencat e protokollit të shtetit, kompetencat e protokollit të Zyrës së presidentit, të kryeparlamentarit dhe kryeministrit të vendit? Vërtet, me këtë materie, me këtë draft që ka ardhur si i tillë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, tregohet edhe vizioni i kësaj qeverie, definitivisht nuk dini të mbani shtet a? Çdo maturant që e lexon, disa atje po qeshin do figura historike që vetit po i thonë që janë të gjithëdijsëm, por unë tani do t'i demantoj se sigurisht e kanë lexuar romanin "Të mjerët" e Viktor Hugos. Po citoj: Nevoja dhe arsyet e nxjerrjes së projektligjit, shikoni çka thotë ky draft i institucioneve famoze të Republikës së Kosovës? Arsyeja për nxjerrjen e këtij projektligji vjen si kërkesë e presidentit të Kosovës, do të

thotë, po mos të kërkonte presidenti i Kosovës, në do të vazhdonim me atë ligj ashtu si ka qenë, mjerim i Zotit dhe definitivisht as Qeveria e as ky Kuvend nuk do të lodhej fort për protokollin e shtetit. A e dini çfarë gafe në ceremoni të rëndësishme, shtetërore dhe nacionale po e potencoj këtu pritjen e zëvendëspresidentit Bajden, a e dini se sa ka dhënë provim ky shtet dhe këto institucione, a e dini sa e keni skuqur këtë Kuvend dhe popullin e Kosovës? Definitivisht duhet për t'iu ardhur keq edhe atyre figurave historike duhet për t'iu ardhur keq që nuk marrin erë fare prej sjelljes diplomatike, prej kodeksit dhe prej protokollit.

Vazhdojmë më tutje, çështjet e adresuar në projektligj, dëgjoni qeveritarë të nderuar. Drafti i parë thotë, shih çfarë drafti i sillet Parlamentit të Republikës së Kosovës, është hartuar nga ekspertët vendorë dhe nga Zyra për Shërbime dhe Ndihmë Juridike. Para dhe gjatë hartimit të këtij projektligji, ju thuhet deputetëve, janë bërë hulumtime dhe konsultime të gjëra nga natyra e kësaj fushe. Cilat hulumtime, në cilin kod jeni thirrur, çfarë mostre të protokollit të shtetit, cilit shtet, a është oriental, a është perëndimor apo është tej oqeanik, se tani keni lënë edhe terma për hulumtime shkencore? Mbase do të bëhej edhe ndonjë akademik duke hulumtuar se si të hartohet një protokoll i shtetit, që mund të merret një mostër e zakonshme, sepse ekziston një kod i përcaktuar për protokollin e shtetit.

Dhe, vërtet, zoti zëvendëskryeministër, për respektin që e kam për ju si profesor i Universitetit, po jeni 11 profesorë doktorë në Qeveri, ardhja e këtij drafti të tillë iu kisha propozuar ta ktheni, pa e bërë të madhe se vërtet e ofendon, nejtë e morën vesh një 100 milionë njerëz, e ofendon institucionin më të lart legjislativ të vendit, Kuvendin e Republikës së Kosovës, se për ata që kanë shkruar këtë përmbajtje në këtë draft po të isha në vend tuaj do t'i kisha dënuar dhe do të kisha kërkuar përgjegjësi si sillet një draft i tillë.

Cili është Protokollin i Shtetit të Republikës së Kosovës, cilat janë mekanizmat e koordinimit të protokolleve të tri institucioneve kryesore të vendit, s'di kurrkush të tregojë?

Ja edhe disa margaritarë të kësaj materie. Akreditimi i shefit të misionit diplomatik neni 2, paragrafi 2 thotë: "procedura fillon me marrjen e kërkesës në formë të një note diplomatike për agreement, kjo është agreement, marrëveshje e keni shkruar bukfal dhe kush e sheh këtë, do të thotë, është një gaf gjuhësor, substancial, profesional e mos të them juridik e tjera e tjera.

Prapë përsëritet kjo fjala e famshme agreement, do të thotë, ktheni këtë materie që mbase dikush kur paska pasur kohë të lirë e pas hartuar për qejf copy paste, Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës.

Neni 13 thotë, radha e përfaqësisë së rangjeve zyrtare, grupi një apo rendi pajtohem, shikoni te grupi dy se varësisht kush po i harton këto ligje po tenton ta qesë veten përpara. Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës janë në grupin e dytë, thotë: nënkryetarët e Kuvendit, zëvendëskryeministrat, ministrat, kryetari i kryeqytetit, deputetët. Kuvendi është institucioni më i lartë i shtetit dhe i zgjedh edhe presidentin, edhe kryeparlamentarin, edhe kryeministrin edhe ministrat dhe çdo kund kur i kemi marrë pasaportat diplomatike shkruan: deputetët, ministrat. Kem rregullim shtetëror parlamentar dhe këtu duhet të ketë kujdes, mos të flasim që ish-kryeparlamentarët, ish-kryeministrat janë ofenduar me këtë renditje dhe bëhen renditjet e drejtorëve, departamenteve, ministrave, ju lutem, kjo nuk ka kurrkund në botë. Zoti zëvendëskryeministër, me qëllimin më të mirë, Grupi Parlamentar i LDD-së nuk do ta votojë këtë projektligj se është ofendim për shtetin dhe për Parlamentin. Kthejeni mbrapa, hartojeni, merrni draftin e Protokollit të Shtetit

të Republikës së Shqipërisë, është një nga ligjet, por edhe protokollet më të përgatitura në Evropën Juglindore, e silleni prapë në Parlament dhe do ta votojmë. Si të tillë nuk mund ta pranojmë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+” deputeti, Zylfi Merxha e ka fjalën.

ZYLFI MERXHA: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Ju përhëndes juve!

Përhëndes zëvendëskryeministrin dhe ministrin Zharku.

Grupi Parlamentar “7+”, do ta votojmë këtë ligj se deri me tash nuk kemi pasur kështu një ligj. Unë nuk e di këta diskutues sa e rritën punën e bënë kiamet, vallah unë nuk po shoh aq kiamet, shyqyr që na ra rendi, të jemi republika më të re, ta kemi kështu një protokoll, për atë na do ta votojmë.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, deputetja Vezira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala vam na datu reč! Ja se javljam u ime Grupe za integraciju i smatram da je to bila greška.

Kada je u pitanu Zakon o izmenama i dopunama Zakona o državnom protokolu Republike Kosova, mi smo ga u okviru Grupe razmatrali. Pažljivo sam sada slušala sve kolege i sve napomene koje su dali naime Zakona ili na ime dodatih članova na ime prethodnog zakona.

Jedno što je dosta zainteresovalo nas, jeste lista rangiranja i sa punim pravom mi, Skupština treba da dobije svoje zaslužujuće mesto, zakonsko mesto, mislim da je zapostavljena zajedno sa svima nama poslanicima i smatram da će ovo biti kao greška otklonjena u amandamentiranju samog zakona od strane funkcionalne komisije. Jedno što hoćemo kao grupa da damo do znanja, jeste član 11. gde se daje do znanja način kako se dočekuje, kada je u državnoj poseti predsednik ili posetilac na državnom nivou bilo koje funkcije.

Taka 6. člana 11, kaže ovako: Ako čelnik prijateljske države, što znači čelnik, uzeto je iz Hrvatskog zakona, odmah znamo, ako čelnik prijateljske države nije u državnu posetu, znači on je u prolaznu, privatnu, multiletarnu posetu, u tom slučaju kaže paragraf ovog zakona, ne priređuje se počasna ceremonija. Predsednik zemlje, idemo u susret sam, dočekuje ga na aerodromu i pozdravlja ga samo garda i sam ga ispračuje. Ja hoću da dam do znanja, da na ime ovog zakona i na ime ovog člana više ne bude zloupotrebljavana ova Skupština, i mi kao poslanici da ne budemo maltretirani, i kada dolaze prijatelji, pojedini predstavnici premijera i ostalih, da ne moramo da dolazimo ovde da ih pozdravljamo. Toliko od naše grupe. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të grupeve parlamentare, janë kryer diskutimet. Tani vazhdojmë me diskutuesit e radhës që janë deputetët. Sipas renditjes, Hydajet Hyseni- Kaloshi.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë e mbështes edhe kështu siç është përpjekjen për të përmirësuar protokollin, i mirëkuptoj edhe vërejtjet që bëhen se megjithatë edhe me këtë ndryshim, mendoj që do të mbetet në rrëmujë në protokollin tonë, po mendoj që duhet kuptuar, është një proces dhe vetëm le të urojmë që të ketë vazhdimësi në ngjitje, përmirësim, por mendoj se debati dhe vërejtjet mund t'i kontribuojnë këtij përmirësimi.

Më vjen keq që edhe vërejtjet kryesisht bëhen me rangimin, por është e vërteta edhe ky ndryshim është kufizuar, kryesisht do të thotë të renditja. Ne nuk jemi bash edhe të lavdërueshëm si thuash për rend dhe i mbështes edhe vërejtjet që u bënë. Vërtetë, ka raste kur edhe në aktivitete që duhet të jenë ceremoniale, ka rrëmujë që i bënë shumë njerëz edhe kur janë të ftuar, të mos shkoj se ndjehen keq.

Për t'i kontribuar eventualisht përmirësimit të saj, mendoj janë të thirrur në radhë të parë komisionet, kolegët që janë në ato komisione, por unë do të theksoja, veçanërisht faktin që nuk i shoh në vendin ku meritojnë liderët e bashkësive fetare dhe është një nevojë elementare dhe duhet të korrigjohet. Kurse te grupi i tretë më bën përshtypje liderët e partive jo parlamentare, do të thotë, që nuk janë në Parlament, pa specifikim dhe kemi shumë, janë para një vister institucionesh që janë megjithatë të rëndësishme. Janë para, ta zëmë agjencive të pavarura, megjithëse ndonjë agjenci është ngritur lart atje dhe është një problem si trajtohen agjencitë e pavarura në forma të ndryshme, për shembull, vëni re Avokatin e Popullit, ose vini re për shembull në grupin e tretë, kah fundi atje 1.3.11 në shqip është: "Përfaqësues të familjeve të heronjve të Kosovës", është menduar sigurisht "dëshmorëve të Kosovës" unë nuk desha ta bësh çështje, por edhe në Ligjin për veteranët është ky problem, kjo rrëmujë. Në shqip thuhet heronj, në anglisht martirs, kurse serbisht boraca, ani nuk ka kuptim fare nuk ka lidhje me heronjtë e me dëshmorët e tjerë, a është menduar sigurisht "palih boraca", po ajo është hequr dhe këtu përsëri na vjen kjo, kurse futen në mes pastaj përfaqësuesit e shquar të letërsisë, artit dhe shkencës. Deri këtu janë institucionalisht, po këtu përfaqësuesit e shquar, cilët janë? Por, nuk është ta zëmë Lidhja e Shkrimtarëve dhe është interesant kjo bëhet sistematikisht. Nuk po përmendi për shembull edhe ndonjë asociacion siç është ta zëmë Shoqata e të Burgosurve Politikë. Në çdo vend ata trajtohen në protokoll. Unë e drejtoj atë shoqatë, kam marrë ftesa si deputet, kurrë si drejtues i Shoqatës, kurrë nuk e kam bërë çështje, nuk do ta përmendja edhe këtu, po mungon rendi, mungon rregulli, kurse krejt në fund, atje diku janë vendosur shoqatat e veteranëve të luftës. Mendoj që një renditje do të duhej të ishte tjetër. Angazhohem që komisionet t'i rregullojnë dhe propozimi im është le të mos zbulojnë vërtet atë që është e zbuluar, le të marrim një model të përshtatshëm në fqinjësi dhe kemi bile shumë të mira. Le t'ia përshtatin specifikave tona dhe jam i sigurt që do të jetë gjithçka në rregull. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputetja Gjylnaze Sylja e ka fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Që në fillim dëshiroj të theksoj se jo vetëm plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës, por edhe për vetë ligji nuk i plotëson kriteret ndërkombëtare të cilat kërkojnë për protokollin e shtetit, tjetra është se koncepti është plotësisht i gabueshëm.

Zoti kryeministër, dëshiroj t'ua tërheq vëmendjen se në botë protokollin përshkruhet si grup rregullash të mirësjelljes të pranuar ndërkombëtarisht, që do të thotë të gjitha rregullat të cilat do të jenë në këtë ligj, duhet të jenë të pranuar edhe për ata të akredituar, edhe për ne.

Do të thotë, realisht, këto nuk ndryshojmë më shumë se normat e mirësjelljes ose të një sjellje të mirë të individit. Tash unë do të përqendrohem konkret në një çështje, siç është neni 4.2, ku thotë se ambasadori i ri, kur bën kërkesë zyrtare për takim me kryetarin e Kuvendit, kryeministrin, anëtarët e Kabinetit qeveritar dhe kryetarin e Prishtinës, asnjëri prej tyre nuk do të shkojë ta vizitojë në selinë e tij. Unë ua shtroj pyetjen: Çka nëse, po e zëmë, ambasadori i Shteteve të Bashkuara

kërkon që t'i takojë në selinë e tij? A do të thotë tani që mund të shkaktohet në një mënyrë edhe një skandal diplomatik, duhet të refuzojë kryeministri dhe si do ta vëni në fuqi këtë, do ta detyroni kryeministrin apo presidentin apo kryetarin e Kuvendit të mos shkojë?

Një tjetër është që e shoh plotësisht të panevojshme, është neni 14.2, ku thotë se kryeqyteti ka status special. Çka ka të bëjë kjo tash me protokollin e shtetit, kur ne kemi një ligj të posaçëm për qytetin e Prishtinës? Për një çështje pajtohem me Qeverinë dhe kjo është neni 8.4, që thotë se duhet të përcaktohen kriteret për vendosjen e fotografisë së presidentit. Do ta zgjidhni, zoti kryeministër një problem, i cili është shkaktuar një ditë para shpalljes së pavarësisë, ku nga holli i Kuvendit është larguar fotografia e presidentit Rugova. Fatmirësisht, fotografinë e kanë sjellë prapë në vend, me intervenimin e miqve ndërkombëtarë. Që kjo të mos ndodhë, unë i propozoj Qeverisë që sa më shpejt t'i caktojë kriteret për vendosjen e fotografisë së presidentit. Nuk e përkrah këtë ndryshim dhe plotësim të Ligjit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! I fundit është deputeti Rexhep Hoti

REXHEP HOTI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Në fakt u thanë shumica e vërejtjeve për të cilat kisha qëllim të flisja. Në fakt ligji është skandaloz, pajtohem plotësisht me shumë deputetë, duhet të tërhiqet. Edhe përfundimisht mendoj se ne duhet të mësohemi ligjet të cilat i bënë Shqipëria dhe janë të gatshëm t'i marrim dhe mos të mundohemi të krijojmë ligje për teke, për ego e gjera tjera.

Pikërisht folësi i fundit tha fotografia që ndodhet në holl është hequr dhe është dashur të hiqet, sepse nuk ka ligj për ta qitur, do të thotë, nuk është me ligj ajo punë. Ne duhet të mësohemi të funksionojmë me rregulla. Prandaj, edhe ministri i Punëve të Jashtme propozon gjëra të cilat anashkalojnë Kuvendin e Kosovës, dhe është përgjegjësi e Kuvendit të Kosovës apo të Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë, e tjera e tjera, domethënë, absolut nuk ka ndonjë rregull, një rend dhe një kulturë, një minimum të kulturës.

Shpallja e pavarësisë ka qenë skandaloze. Krerët e institucioneve mundohen të flasin, secili kush flet përpara kush më përpara, kush më pas e tjera e tjera. Skandalet shkojnë edhe më tej, shkohet deri te uzurpimi i gjerave ... Ku jemi duke jetuar kështu? Domethënë, kjo është një logjikë e rrugës dhe këtë logjikë të rrugës duhet ta harrojmë. Personalisht mendoj se ligji duhet të tërhiqet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Përfaqësuesi i Qeverisë, zotëri Kuçi, a e dëshironi fjalën? Okej. Ne ta bëjmë, të veprojmë sipas marrëveshjes. Tani në sallë janë 63 deputetë, në qoftë se doni votojmë tani ligjet, pastaj kemi shqyrtimin e Raportit të dytë të progresit për Planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës dhe shqyrtimin e Raportit të Bankës Qendrore, e bëjmë pas pauze këtë. Okej. Atëherë, të nderuar deputetë, lus ata të regjisë që t'i bien ziles në qoftë se është ndonjë deputet jashtë ose t'i thirrni gojarisht, me qëllim që t'i votojmë ligjet që i kemi debatuar.

Fillojmë me votimin e Projektligjit për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë, tani.

Regjia, ktheju pikës 14- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve.

Si duket, diçka nuk është në rregull. Okej, atëherë vazhdojmë se qenka votuar, mua më kanë keq informuar.

Vazhdojmë me votimin e pikës 15, domethënë, Shqyrtimin e parë të Projektligjit për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim.

Votojmë, tani.

Në sallë janë 66 deputetë.

Konstatoj që më 59 vota “për”, 10 vota “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit.

Vazhdojmë me votimin e Projektligjit për dizajnin industrial, pra pikën 16.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tani.

Konstatoj se më 67 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për dizajnin industrial. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me votimin e Projektligjit për markat tregtare, pikën e 17-të të rendit të ditës.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim.

Votojmë, tani.

Konstatoj se më 68 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për markat tregtare.

Vazhdojmë me pikën e 18-të të rendit të ditës - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim.

Votojmë, tani.

Konstatoj se me 34 vota “për”, 25 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Protokollin e Shtetit.

Pra, ligjet, sipas programit i kemi miratuar. Tani i kemi dy raporte që besoj jeni dakord t’i lëmë pas dreke apo doni që të vazhdojmë. Vazhdojmë. Okej.

Vazhdojmë me pikën e 19-të të rendit të ditës:

19. Shqyrtimi i Raportit të dytë të progresit për Planin e veprimit të Kuvendit të Republikës të Kosovës për vitin 2010

Komisioni Parlamentar për Integritet Evropian, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka hartuar Raportin e dytë të progresit për Planin e veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2010 dhe Kuvendit i ka rekomanduar shqyrtim dhe miratimin e tij në mbledhjen plenare.

Ftoj kryetaren e Komisionit funksional, zonjën Zylfije Hundozi, apo raportuesin e Komisionit.

Zonja Hundozi e keni fjalën.

ZYLFIJE HONDOZI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

(Reagime nga salla)

KRYESUESI: Tani vendosëm. T’i kryejmë dy pikat dhe e përfundojmë seancën.

Zonja Hundozi, e keni fjalën.

ZYLFIJE HUNDOZI: A të vazhdoj?

Komisioni Evropian gjatë vitit 2009 i ka intensifikuar aktivitetet e veta ndaj Kosovës dhe tash Kosova ka hyrë në një fazë tjetër të procesit të integritit evropian, duke marrë një perspektivë më të qartë evropiane përmes fuqizimit dhe thellimit të dialogut të procesit të stabilizim -asocimit.

Kosovës i është ofruar dialogu për viza me perspektivë për liberalizimin e tyre pasi të jenë kryer reformat e nevojshme dhe plotësuar kushtet e kërkuara nga Komisioni Evropian, zgjerimi i masave tregtare dhe shqyrtimi i mundësive për një kornizë të marrëveshjes lidhur me parimet e përgjithshme të pjesëmarrjes së Kosovës në programet e komunitetit. Pas përsëritjeve të numrit të madh të vërejtjeve në Raportin e progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, këtë vit institucionet e Kosovës i kanë marrë më seriozisht vërejtjet që po jepen nga ana e Komisionit Evropian dhe e kanë intensifikuar punën e tyre, sidomos Kuvendi i Kosovës, duke zhvilluar aktivitete më intensive në përmbushjen e sfidave të parapara në planin e veprimit.

Edhe pse puna jonë është e intensifikuar, ne jemi të vetëdijshëm që na pret punë e madhe dhe plotësimi i sfidave të shumta që të arrijmë gjer te qëllimi përfundimtar. Paraqitja e këtij raporti sot, para jush e ka qëllimin që të intensifikojë debatin për rëndësinë e detyrave që na presin dhe që të largohemi nga klishetë e diskutimeve rreth integritit evropian, por të bëjmë përpjekje që diskutimet tona t'i orientojmë kah krijimi i politikave të vërteta, përpjekje që do të na qojnë në drejtimin e duhur.

Me këtë raport jemi munduar të bëjmë analiza për efektet e arritura të planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e dala nga Raporti i progresit dhe këto efekte t'i diskutojmë së bashku duke u nisur nga fakti se secili prej nesh, ka një rol për të përmbushur në këtë proces dhe sot i mirëpresim sugjerimet dhe propozimet e juaja për aktivitetet më konkrete që do të kenë ndikim në plotësimin e standardeve të kërkuara nga Bashkimi Evropian dhe që do ta qojnë Kosovën në këtë bashkësi të madhe. Edhe pse nga 85 sfida janë përmbushur vetëm 35, raportimi i komisioneve parlamentare, sa i përket trajtimit të sfidave, ka qenë më intensiv dhe më efikas për 6 muajt e fundit.

Në raport që e keni para jush, janë paraqitur në mënyrë të detalizuar sfidat dhe të arriturat, kështu që unë nuk do të ndalem që t'i numëroj një nga një për shkak të racionalizimit të kohës.

Ministritë me disa përjashtime kanë raportuar rregullisht në komisionet parlamentare, gjë që e ka rritur mbikëqyrjen parlamentare ndaj Qeverisë. Kuvendi ka miratuar 30 ligje që janë paraqitur si sfida në Raportin e progresit. Gjatë muajve prill, maj dhe qershor, Kuvendi ka shqyrtuar raportet vjetor të 14 institucioneve dhe agjencioneve të pavarura. Në prill u miratua Rregullorja e re e punës së Kuvendit, në të cilën janë përfshirë nene që synojnë përmirësimin e zbatimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit, përgjegjësinë ndaj publikut dhe procesit të ligjberës.

Në raportin e Komisionit për Integritim Evropian që e keni para vetes janë radhitur të arriturat dhe sfidat e mbetura dhe analizimi i tyre tregon që në përgjithësi është arritur progresi i limituar në adresimin e vërejtjeve kyçe nga raporti i progresit të vitit 2009.

Qeveria nuk e ka shprehur qartë vullnetin e saj politik për agjendën evropiane gjatë rishqyrtimi të buxhetit për vitin 2010, duke ndarë mjete shtesë për projekte infrastrukturore, ndërsa ka anashkaluar përkrahjen financiare për fushat sfiduese si sistemi gjyqësor, reforma e administratës publike dhe

politikat sektoriale. Qeveria vetëm dje e ka sjell në Parlament Ligjin për Prokurimin publik dhe kjo sipas Komisionit Evropian nuk llogaritet e arritur, por llogaritet e arritur vetëm nëse ligji është kryer definitivisht e prokurimi Publik ka qenë një ndër vërejtjet më të theksuara në raportin e Progresit të vitit 2009.

Situata e sigurisë dhe sundimi i ligjit në veriun e Kosovës është ende sfiduese dhe vazhdon të jetë jashtë kontrollit të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Kriteret më të vështira për t'u përmbushur janë ato ekonomike për faktin se në këtë fushë Bashkimi Evropian ka arritur një zhvillim më të përsosur se në fushat tjera, andaj edhe kërkesat për vendet candidate për anëtarësim janë më të mëdha dhe kërkojnë më shumë mund për t'u përmbushur.

Edhe në këtë fushë, nuk ka progres për vërejtjet e dhëna nga ana e Komisionit Evropian. Korniza afatmesme e shpenzimeve dhe buxheti i Kosovës, vazhdojnë t'i nënshtrohen presioneve ad-hoc dhe nuk paraqesin instrumente efikase, zhvillimore, kështu që zhvillim i vërtetë ekonomik, papunësia, varfëria dhe problemet tjera sociale, mbesin çështje brengosëse. Sqarimi i rolit të UNMIK-ut në përfaqësimin e Kosovës në nismat rajonale, mbetet gjithashtu njëra prej sfidave e cila kërkon një angazhim më të madh të institucioneve tona për zgjidhjen e saj.

Ky raport është shkruar në muajin qershor dhe prej asaj kohe, disa prej sfidave janë përfunduar dhe kjo gjë do të paraqitet si e arritur në raportin për tremujorin e ardhshëm. Disa prej ligjeve që në ndërkohë e kanë kaluar leximin e parë në Parlament, nga ana e Komisionit Evropian nuk konsiderohen si e arritur për arsye se nuk janë kryer definitivisht, kështu, që edhe Komisioni jonë është bazuar në këtë kriter kur ndonjë veprim e ka kualifikuar si e arritur ose si sfidë.

Në bazë të arritjeve dhe sfidave të identifikuara në periudhën raportuese, Kuvendi i Kosovës i nxjerr këto:

REKOMANDIME

Dhe, ju lus zotëri kryesues t'i qitni në votim.

1. Kërkohet nga Qeveria e Kosovës që të rishikohen prioritetet në koordinim me Kuvendin dhe t'i përmbahen afateve kohore të agjendës legislative për vitin 2010, në hartimin dhe procedimin e projektligjeve në Kuvend.
2. Mbështetja financiare e komisioneve parlamentare të jetë e mjaftueshme, bazuar në natyrën e punës së komisioneve dhe mjetet të ndahen me kohë.
3. Të ndahet buxheti për sigurimin e hapësirave për mbajtjen e mbledhjeve të komisioneve.
4. Të fuqizohet Divizioni për Standardizim dhe Harmonizim me ekspertë të fushës përkatëse.
5. Kuvendi i Kosovës të garantojë transparencën, të hapë debatin për çështje të rëndësishme siç janë: sundimi i ligjit, krimi i organizuar, korrupsioni.
6. Të merren parasysh dhe të respektohen vendimet, rekomandimet dhe vërejtjet e institucioneve të pavarura, siç është Avokatit të Popullit në pajtim me ligjin.

Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani vazhdojmë me diskutimet ose deklarinimet e kryetarëve të grupeve parlamentare ose përfaqësuesve të grupeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, është paraqitur kryetari i Grupit, Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti zëvendëskryeministër,

Zotëri ministër i Ministrisë së Integrimeve,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e ka analizuar këtë raport të dytë të Progresit të Planit të veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2010, dhe natyrisht që, pavarësisht defekteve të shumta që ka, ne si grup parlamentar kemi vendosur që ta përkrahim bashkë me rekomandimet, por gjithsesi duhet të themi ato fjalë miradije që i meriton ky raport apo puna dhe angazhimi i akterëve për ta bërë këtë raport, sepse, në fakt është një progres jo i vogël i bashkëpunimit ndërkomisional, ta quaj këtu, komisionet parlamentare në mes vete për ta hartuar këtë raport dhe natyrisht edhe bashkëpunimi i Qeverisë me komisionet parlamentare, por jemi akoma larg realizimit të detyrave të parashtruara, sepse 85 me 35 është raport shumë i largët, por megjithatë duke synuar që ky raport mes komisioneve dhe komisioneve apo Kuvendit dhe Qeverisë do të harmonizohet akoma më shumë dhe do të bashkëpunohet edhe më tepër, ne natyrisht se këtë raport të dytë të progresit të Planit të veprimit e mbështesim bashkë me rekomandimet që i ka dhënë komisioni gjegjës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetja Njomza Emmini.

NJOMZA EMINI: Ju faleminderit, kryesues!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me vëmendje raportin e dytë të progresit të Komisionit Evropian, konkretisht për Planin e veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës të vitit 2010.

Integrimi evropian është bërë kryefjala e ditës në fjalorin politik të Kosovës, gjithmonë e më tepër, ky proces po bëhet sa kompleks aq edhe domosdoshmërisht gjithëpërfshirës e lidhur ngushtë me interesat politike, sociale e grupit të interesit. Është një fakt i pamohueshëm se ecuria e reformave në Kosovë, është një parakusht për progresin tonë drejt Bashkimit Evropian, por është e rëndësishme të kuptohet se ky proces nuk është në qëllim dhe në vetvete, por instrument në funksion të zhvillimit ekonomik e social të Kosovës, ndaj theksi duhet vënë në zbatimin e reformave në sektorët e strategjisë të zhvillimit të vendit.

Nisur nga ky këndvështrim, se pari do të dëshiroja të vlerësoj si një mesazh pozitiv të Qeverisë vendimin për krijimin e Ministrisë së Integrimit Evropian si një strukturë e mirëfilltë ministrore në shërbim jo vetëm të së sotmes për përmbylljen me sfidat e procesit, por më tepër të ardhmes së zbatimit të këtij procesi për përmbylljen e hapave të mëtejshëm në Bashkimin Evropian.

Së dyti, nuk mund pa e përshëndetur faktin se Kuvendi ishte institucioni i parë në Kosovë që përgatiti në kohë rekord planin e veprimit në përgjigje të raportit të progresit të Komisionit

Evropian. Së treti, dua të vlerësoj përpjekjet e bëra nga Parlamenti për ngritjen e një sistemi monitorimi funksional, si për progresin e bërë nga Qeveria, ashtu edhe monitorimin e progresit të vet strukturave parlamentare.

Padyshim që është në të mirë dhe interes të këtij procesi, bashkëpunimi i ngushtë i strukturave qeverisëse me Parlamentin dhe padyshim, këtu kam parasysh jo vetëm Komisionin e Integritimit Evropian, por edhe komisionet tjera funksionale. Me këtë rast, do të doja të mbyllja duke ritheksuar se integrimi nuk është vetëm çështje apo monopol i Qeverisë apo i Parlamentit, por i gjithë shoqërisë kosovare. Duke kuptuar, kjo së pari në arritjen e një mentaliteti të përkatësi evropiane në të gjitha shtresat e shoqërisë. Në këtë proces të rëndësishëm për vendin tonë, secili prej nesh duhet të mendojë dhe duhet të jetë pjesëmarrës aktiv në vijueshmërinë e këtij procesi sa afatgjatë, ashtu edhe i domosdoshëm dhe gjithëpërfshirës. Para së gjithash, unë do ta vlerësoja integrimin evropian si një proces emancipimi shoqëror. Padyshim me emancipimin e një shoqërie, rolin vendimtar e luan emancipimi politik. Me keqardhje më duhet të shpreh opinionin tim personal, vërehet shpesh që lufta politike, në vend të një stimuli emancipues po bëhet jo rrallë një element pengesë për rrugën drejt Bashkimit Evropian.

Andaj, dëshiroj të ritheksoj edhe një herë nevojën për një konsensus gjithëpërfshirës që çështjet e integritimit evropian të shikohen përtej interesave politike të ditës. Këto janë të rëndësishme dhe madhore se kapitale politike, ashtu, sikurse pronësia dhe përfitimet e procesit i takojnë të gjithë shoqërisë kosovare. Shpejtësia e lëvizjes nuk mund të jetë pronësi shpesh e keqpërdorur e grupimeve të ndryshme politike. Ka një limit sa larg mund ta qojmë procesin strukturat teknike. Politika është ajo që së fundi i jep këtij procesi dimensionet reale që na i ofron apo na largon ndaj Bashkimit Evropian.

Dhe së fundi, dua të them që në mbyllje do të thosha se në vizionin tonë integrimi është një proces afatgjatë, ku ne jemi vetëm në fillimet e udhëtimit tonë drejt Bashkimit Evropian. Atëherë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrah këtë raport nga Komisioni Evropian për Integritime Evropiane. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Plani i veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integrimin Evropian për vitin 2010, realisht është një pasqyrë e një periudhe kohore afërsisht 6 muaj e të arriturave, por edhe të përgjegjësive të cilat iu takojnë institucioneve të Kosovës. Edhe pse, në radhë të parë është pasqyrë, në të vërtetë, kryesisht e punës së Kuvendit të Kosovës, është e qartë nga vetë raporti se përgjegjësia primare i takon Qeverisë dhe që ne të jemi sa më afër BE-së, por po ashtu edhe për ta funksionalizuar shtetin, natyrisht që raporti tregon se duhet të ketë pasur një mbikëqyrje shumë më të madhe që Qeverisë se sa që është bërë brenda kësaj periudhe. Pasi që Qeveria është ekzekutiv, shumica e përgjegjësive varet nga ata, por do të thotë edhe suksesi do të varet nga kryerja e këtyre përgjegjësive.

Tash po flas me argumente, në qoftë se kanë qenë nga 85 sa janë vlerësuar, do të thotë vetëm 35 janë nga 85 sfida të planit të veprimit, vetëm 35 janë përmbushur plotësisht ose pjesërisht. Pra, kjo në përqindje do të thotë 41%. Në qoftë se Kuvendi nuk ka arritur që t'i plotësojë as gjysmën e sfidave të cilat janë parashtruar para saj, atëherë kjo natyrisht kërkon një angazhim shumë më të

madh të Kuvendit, sidomos në dy aspekte të legjislacionit dhe të mbikëqyrjes. Edhe pse raporti paraqet një progres sa i përket mbikëqyrjes, është e qartë se nuk është bërë sa duhet, sa i përket përgjegjësisë së Kuvendit në mbikëqyrjen e Qeverisë dhe unë po flas për raportin në faqen 5 dhe 6 ku janë paraqitur të arriturat dhe sfidat. Të arriturat janë në tri pika, sfidat janë në 17 pika.

Sa i përket aktivitetit legjislativ, kanë kaluar 30 ligje në leximin e parë, kurse në leximin e dytë 3 ligje, do të thotë, janë tri të arritura, meqenëse kryetarja e Komisionit e shpjegoi se konsiderohet e arritur vetëm në qoftë se puna kryhet deri në fund, do të thotë, derisa të aprovohet ligji në shqyrtimin e dytë.

Sa i përket rekomandimeve, janë paraqitur 7 rekomandime, edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i përkrah këto rekomandime të Komisionit, ndërsa sa i përket planit të veprimit në fushën e sigurisë, Grupi Parlamentar propozon që të ndërrohen aktivitetet e Komisionit për Siguri, meqenëse në ndër sfidat me rëndësi të cilat i ka identifikuar Komisioni, është numër 7 dhe po citoj: “Situata e sigurisë dhe sundimit të ligjit në veriun e Kosovës, vazhdon të jetë jashtë kontrollit të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Nga ana tjetër, aktiviteti i Komisionit për Siguri, është se duhet të plotësojë një pyetësor lidhur me situatën në veri.

Ne si grup parlamentar, propozon që Kuvendi të merret me mbikëqyrjen e strategjisë për veriun, i cili ka kaluar në këtë Kuvend dhe kjo kërkon pastaj jo vetëm punën, por edhe koordinimin, jo vetëm të Komisionit për Siguri, por edhe komisioneve tjera të parlamentit të Kosovës. Në fund dëshiroj të theksoj edhe një herë rëndësinë e zbatimit të përgjegjësisë të cilat qëndrojnë në këtë plan, meqenëse jemi i vetmi vend në Ballkan që nuk jemi më afër procesit të liberalizimit të vizave dhe vendi më i izoluar në Evropë. Besoj se kjo do të jetë nxitje e mjaftueshme për plotësimin e obligimeve tona. Ne e përkrahim këtë raport. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Gashi

IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

I nderuar ministër prezent,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së, e mbështet dhe një farë mënyre e përshëndet atë pjesë sado të vogël të progresit që të jetë shënuar në punën e legjislativit, domethënë, në raport me Planin e veprimit për integrim në Bashkimin Evropian, përkatësisht në pjesën e përmbushjes të obligimeve tona që do të evidentohen në Raportin e progresit.

Konsideroj që të arriturat që i evidentoj kryetarja e Komisionit, unë e përshëndes punën që e ka bërë Komisioni, është mjaft sintetizuese, mjaftë gjithë përmbledhëse e këtyre të arriturave, mirëpo të mos harrojmë se pjesa më sfiduese e punës së Kuvendit është ajo pjesa e misionit të tij mbikëqyrës, pra mbikëqyrës në implementimin e ligjeve dhe në punën e ekzekutivit. Këtu po mendoj që edhe ndonjë progres i evidentuar nuk është mbi bazën e një kriteri real matës që të mund të quhet progres i njëmendët, por është progres sa për t’u evidentuar, por megjithatë si i tillë është progres shumë i vogël. Natyrisht, kjo është pjesa më sfiduese e vendeve me traditë demokratike, por insistimi ynë që të përmbushim këtë pjesë të misionit dhe jo vetëm ta aprovojmë ligje, mbetet permanent dhe duhet të manifestojmë këtë. Natyrisht, ndonjëherë ka paraqitje të tilla nga grupet parlamentare që vijnë nga koalicioni qeverisës, pra paraqitja individuale që lënë përshtypjen sikur po krijohet njëfarë mund ta quajmë masa të menduarit kritik brenda deputetëve që nuk duhet të

votohet gjithçka që vjen, domethënë, në formë të një, si të them kërkesë të udhëheqësit të partisë, sepse kjo është, domethënë, rritje e koshienës, nëse ka raste të tilla edhe pse janë shumë të pakta. Por, të mos harrojmë se të gjitha po evidentohen dhe rritja e kësaj koshience, e rrit, e ndryshon si të them edhe përshtypjen e monitoruesve të Komisionit Evropian, që janë gjithandej brenda dhe jashtë kësaj sale, se sa po evulon pozitivisht në përmbushjen e obligimeve të veta kushtetuese legjislativi i Kosovës.

Këtu, duhet të them që edhe te pjesa që po e konsiderojmë që kemi progres e aprovimit të legjislacionit, u tha sot me një rast tjetër që ne po aprovojmë ligje, por nuk po jemi shumë si të them kritikë në punën tonë dhe këtu është bashkëfajtor gjithsesi edhe sponzorizuesi edhe Qeveria e ligjeve, por ato ligje filtrin e fundit e kanë këtu në këtë Kuvend dhe nëse të njëjtat na kthehen pas një viti ose më pak se një vit për t'i amendamentuar, atëherë del se na nuk e kemi përmbushur pjesën tonë. Tek e fundit Qeveria është e interesuar t' i kalojë ligjet, ndërkaq ne jemi dhe duhet të jemi të përgjegjshëm t' i përmirësojmë ato, t' i bëjmë kohezive, t' i bëjmë të implementueshme dhe t' i bëjmë në njëfarë mënyre në frymën e standardeve që i kërkon, domethënë, plani i veprimit për integrim në BE.

Thashë, shumë është relative shkalla e vërtetë e këtij progresi që ne jemi të pirur në mënyrë afirmative ta prezantuar mbi bazën, domethënë, të informacioneve empirike në formë statistikore që i marrim, por, jo gjithherë, domethënë ato korrespondojnë me progresin e vërtetë, përkatësisht me përmirësimin e performancës së punës të Kuvendit. Dhe unë konsideroj që jo gjithmonë duhet intensiteti, pra agjenda të na imponohet për të përmbushur një standard që është krijimi i legjislacionit brenda një periudhe të caktuar. Sepse, tek e fundit, kjo nuk na shpie më afër proceseve integruese. Nëse bëjmë ligje që nuk implementohen, ligje me defekte, ligje të cilave duhet t' u kthehemi shumë shpejt. Kuvendi është më mirë të punojë me agjendë të gjatë pune, qoftë edhe gjithë javore, por të mos procedojë dhe të mos përfundojë, domethënë të aprovojë në formën e përkryer ligje të cilat rezultojnë pas një kohe se nuk janë mirë.

Në fund, thash, ne i gëzohemi asaj pjese të progresit dhe urojmë që është evidentuar në këtë raport por urojmë që ai të jetë progres i njëmendët dhe urojmë që në njëfarë mënyre të reflektojmë të gjithë përgjegjshëm konform detyrimit përkatësisht obligimit kushtetues dhe qytetar që e kemi si të zgjedhur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-s;, deputeti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë, kabinet qeveritar,

Plani i veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrim evropian, që ka të bëjë me raportin e dytë të progresit të Komisionit Evropian në rrethanat e të qenurit shtet i pavarur vërtet Komisioni për integritet evropian i Kuvendit të Republikës së Kosovës ka bërë përpjekje që të adresojë përpjekjet e punës së Kuvendit që lidhen me kompetencat e Kuvendit të republikës por edhe kompetencat e komisioneve parlamentare që mbulojnë ministrinë e caktuara të linjës. Në këtë kuptim konsideroj që Komisioni e ka bërë një punë të mirë dhe ka bërë një analizë pragmatike edhe pse mangësitë mund të jenë dhe janë evidente të punës që e ka bërë edhe Kuvendi edhe komisionet funksionale, por edhe ministrinë e linjës në ekzekutivin e vendit.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka adresuar plotësisht ose pjesërisht 35 nga 85 sfida të planit të veprimit. Edhe këto 35 sfida nuk janë përmbushur plotësisht. Nuk janë përmbushur në përpikëri që

nënkupton se duhet një angazhim dhe një seriozitet i shtuar i organit më të lartë legjislativ të vendit, duke e ditur rëndësinë e procesit të integritetit të vendit në mekanizmat e Bashkimit Evropian por duke ia shtuar kësaj që është objektiv nacional i shtetit dhe popullit të Kosovës.

Ndonëse nuk janë realizuar shumica e këtyre aktiviteteve, është vërejtur një bashkëpunim më i theksuar i ekzekutivit apo edhe i agjencioneve të caktuara që kanë të bëjnë me këtë proces të rëndësishëm. Vërtet prodhimi i politikave të brendshme, hartimi i legjislacionit, adresimi i problemeve, orientimi i politikave reflekton edhe në zhvillimet e gjithmbarshme qoftë politike, qoftë në reformat në sisteme të caktuara, në atë të drejtësisë, sigurisë, rendit dhe ligjit apo edhe hartimit të një legjislacioni adekuat që është në akordancë të plotë me aquí comunitaire dhe direktivat e Bashkimit Evropian.

Duhet thënë troç se është shënuar një progres i limituar dhe nuk është shënuar një progres i kënaqshëm dhe nëse këtë e ndajmë me përqindje, atje bie diku që vetëm mbi 40% të këtyre sfidave, që kanë qenë punë tani e Kuvendit të Republikës së Kosovës, por që është varur domosdo edhe nga dinamika e hartimit të legjislacionit, e hartimit të politikave dhe zbatimit të këtyre politikave nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Kemi të arritura të limituara, me procedimin apo edhe me miratimin e disa ligjeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës por mbeten shqetësuese ende shumë fusha të rëndësishme në Kosovë të cilat as për së afërmi nuk i janë ofruar përmbushjes së kriterëve për këtë proces të rëndësishëm.

Sundimi i ligjit mbetet i cënueshëm nga mungesa e vullnetit politik. Është ky një konstatim që vërtet si institucione pa dallime pozitive – opozitive duhet t'i përveshim mangët, t'i rrekemi punës dhe t'i bëjmë reformat e nevojshme sepse shtetet e regjionit tanimë vetëm sa e kanë nxënë atë trenin i fundit i cili shpie drejt Evropës dhe anëtarësimit, kurse Kosova, pa marrë parasysh procesin, rrethanat, sui generis, mosnjohjen nga pesë vende anëtare të 27 vendeve të Bashkimit Evropian, vërtet duhet t'i kryejmë detyrat e shtëpisë, duhet ta kryejmë punën tonë si shtet dhe si institucione.

Një nga çështjet tjera shqetësuese është edhe politizimi i vazhdueshëm i administratës publike, përkundër rekomandimeve të qarta të Komisionit Evropian. Është momenti i fundit që Qeveria, ministria, edhe pse e kemi miratuar pakon e ligjeve për shërbyes civilë dhe për reformimin e administratës rezultatet janë të pakta, rezultatet nuk janë inkurajuese dhe vërtet kambanat tanimë bien për ekzekutivin e vendit që vërtet të fillojë bazat – themelet e ndërtimit të një administrate të pavarur, një administrate që i shërben qytetarit dhe qytetarëve e jo interesave partiake.

Politizimi i vazhdueshëm i bordeve të ndërmarrjeve publike, si pengesë në menaxhimin dhe funksionimin e tyre të pavarur, ka pasur një ndikim të keq, ka krijuar një imazh të keq, janë shënuar afera të caktuara të cilat kanë ndikuar si imazh i vendit në zvarritjen, prolongimin apo edhe mungesën e investimeve të huaja direkte dhe të kapitalit të huaj në vendin tonë.

Reforma e gjyqësorit, miratimi dhe zbatimi i ligjeve për gjyqësorë dhe mungesa e mbështetjeve adekuate për orientimin dhe hartimin e politikave për procesin e integritetit në BE, Kuvendi në radhë të parë që e miraton buxhetin e Republikës së Kosovës, por Qeveria duhet të përcaktojë edhe limite kohore por edhe mbështetje financiare me kosto financiar të caktuar.

Situata e sigurisë dhe sundimi i ligjit në veriun e Kosovës është sfiduese. Vërtet këto institucione të Republikës së Kosovës duhet të gjejnë një konsensus, duhet të merren hapa konkretë shtetërorë konform Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe legjislacionit adekuat. Nuk mund të arsyetohemi

pafundësisht se EULEX-i duhet të bëjë këtë apo atë, se bashkësia ndërkombëtare ka këtë apo atë qasje, por si shtet duhet të tregojmë që jemi seriozë dhe në çdo cep të Republikës së Kosovës funksionon Kushtetuta dhe legjislacioni ynë nacional.

Zhvillimi ekonomik është një sfidë tjetër. Papunësia, varfëria, problemet sociale mbesin ende çështje brengosëse, mbetet ende shumë për t'u bërë dhe do të duhej të ishte motiv tani për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe për dikasteret profesionale e kompetente të kësaj ministrie që të hartojnë strategjitë adekuate sektoriale dhe të hartojnë legjislacion i cili do të rregullojë dhe do të trajtojë me kompetencë dhe në mënyrë ligjore këto fusha që janë të rëndësishme edhe për mirëqenien qytetare, edhe për stabilitetin, edhe për sigurinë por edhe për trendet e zhvillimit ekonomik.

Dhe, është këtu edhe zëvendëskryeministri por edhe ministri i Integritetit, vërtet funksionimi i qëndrueshëm i medias së lirë dhe të pavarur, duhet të japim shenjë si popull dhe si shtet për funksionimin normal të mediave të lira dhe të pavarura në Kosovë.

Nuk dua të elaboroj më tutje, kemi raste eklatante edhe ditëve të fundit, vërtet ka ardhur momenti që shoqëria kosovare median ta kuptoj si avancim i shoqërisë, si transparencë, si përgjegjësi por edhe si llogaridhënie pa marrë parasysh se kujt i adresohen kritikant.

Dhe në fund, përfaqësimi i Kosovës në nismat rajonale dhe sqarimi i rolit të UNMIK-ut, UNMIK-ut i ka skaduar afati në Kosovë. Është momenti që institucionet e Republikës së Kosovës të përfaqësohen në mekanizmat rajonalë e në veçanti në disa mekanizma që kanë të bëjnë edhe me këmbimet tregtare, zhvillimin ekonomik, të tregtisë e tjera të vendit tonë me rajonin por edhe me Evropën.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e vlerëson këtë raport të hartuar nga Komisioni për Integritet Evropian dhe e mbështet në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala vam, predsedavajući!

Pozdrav zameniku premijera, ministru,

Mi smo kao i ostale grupe pristupili ozbiljno analizi, jer smo i učestvovali u izradi preporuka Komisije za evropske integracije i smatramo da su one vrlo detaljne, vrlo analitične i vrlo, ja bih rekao, uspešno urađene, tako da nemamo tu nikakve primedbe jer smo i sami bili deo onih koji su radili na njima.

Kada je u pitanju predloženi plan delovanja Skupštine Kosova za evropske integracije, mi mislimo, prvo, da Komisija u svom radu zaista spada među vrlo-vrlo aktivne Komisije i da trougao komisije sa Kancelarijom premijera, preko zamenika premijera i sa resornim ministarstvom koje je novo uspostavljeno, funkcionira za ovo kratko vreme stvarno na jednoj vrlo uspešnoj, ja bih rekao, bazi i da recito, po rečima ministra, koji kaže - vrata Komisije našeg Ministarstva su uvek otvorena kada je u pitanju dalji rad ove komisije na ispunjavanju njenih zadataka. Normalno, predsednica Komisije poseban ton daje svojim aktivnostima i dovođenjem svih ministara i svih relevantnih međunarodnih predstavnika koji su zaduženi za napredak zakona u oblasti usvajanja zakonodavstva. Eh, kako će ici put kasnije realizacije, to je sasvim drugo pitanje.

Neko od kolega prethodnih diskutanta, reče da je Kosovo najdalje u Evropi od Evropske unije i tako dalje. Pa, to je i normalno ako je najkasnije i počelo. Mi imamo iskustva posetama Hrvatskoj, koja je

2002. postala pridruženi član i vidimo da još nije članica. Možemo da zamislamo onda koji nam tek put predstoji.

Ja se slažem sa kolegama koji kažu da smo u nekim momentima zakonodavstvo prihvatili nedovoljno ozbiljno i nedovoljno odgovorno, nedovoljnim posetama ministara, ažuriranjem, odlaganjem zakona i tako dalje, sve su to neki naši subjektivni propusti koje imamo.

Nijednog momenta ne možemo da se zavaramo da pred nama nisu izazovi o kojima su mnogi govorili. Ovo je vrlo složen proces koji treba u kontinuitetu godinama da se radi i mi ne trebamo sebe da zavaravamo jer mi možemo davati sliku Evropi kako mi mislimo da treba da je damo, ali evropljani sami skupljaju sliku o nama na osnovu rezultata koji postižemo.

Mi smo posebno zainteresovani za zakone u kojima se tretiraju ljudska prava i zaštita manjina u oblasti građanskih i političkih prava, u oblasti ekonomskih i društvenih prvima, u oblasti kulturnih i ostalih prava i tako dalje, tako da ćemo tu i dalje davati svoj doprinos.

Ceneći vreme, ceneći to što je ovo zasedanje uoči našeg velikog praznika, ja ću ovoga puta biti kraći. Mi svesrdno prihvatamo izveštaj Komisije ali i preporuke koje su date. U to ime, evo čestitam praznik svim vernicima, dakle Muslimanima Kosova, ovde, iz skupštinskih klupa i ovim još jednom kažem da smo mi u potpunosti prihvatili preporuke komisije o kojima smo danas razgovarali. Evo, toliko i hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Čuli smo dosta od kolega oko Izveštaja Evropske komisije za progres i imamo dotičan plan same Skupštine za realizovanje tih preporuka. Jako važan izveštaj. Meni je žao što sam kao Parlamentarna grupa zadnja i da je pred nama veliki praznik. Isto ne bih htela kolege da ostavim, da kažem, da dugo čekaju da odemo kući što pre i zbog toga ću da budem jako kratka kada je u pitanju ovaj izveštaj, ali bih se osvrnula na onaj deo kada su u pitanju ljudska prava i zaštita manjina.

Jako je dobro da je Evropska komisija došla do saznanja da postoje zakoni koje smo mi ovde u Skupštini usvojili, kao što je Zakon o posebnim zaštićenim zonama i da postoji akcioni plan za zaštićene zone, kao što je i izrada Zakona o istorijskom centru u Prizrenu, pošto sam iz Prizrena i dajem do znanja da ovi zakoni, videla sam u planu, da oko ovih zakona i oko ovog akcionog plana nije nešto definitivno napravljen plan i program oko ostvarivanja kada su u pitanju ovi akcioni planovi.

Jedno što je jako zabrinjavajuće za nas kada su u pitanju manjine, jeste ne saradnja ili, kako da kažem, nema koordinacije i organizacije Ministarstva za povratak i zajednice i nema ni sa Kancelarijom premijera. Znači, to su dve samostalne jedinice koje nemaju međusobnu saradnju. Mi smo više puta kao poslanici ukazivali i Kancelariji i Ministarstvu da treba da sarađuju, uvek smo dobijali odgovor da je to Ministarstvo pri Vladi i posebno da je kancelarija samostalna i treba samostalno da radi. Vidite, i Evropska komisija im je dala domaći zadatak da trebaju da međusobno sarađuju u dobrobit nas svih zajednica.

Jako je važan podatak da opštine, kada je u pitanju jezik, da je samo 20 opština usvojilo u načelo sporazum ili poštovanje zakona kada je u pitanju Zakon o službenim jezicima, što znači da se sve

prevodi, piše i na dva jezika, u 20 opština. Opet je ovo žalosno, to je polovina kosovskih opština i ja apelujem da ovo bude što pre i da budu i prevodi i da bude zaposleno stručnih katrova, jer pripadnici naših zajednica se nalaze, mogu tačno da kažem, u jednom izolovanom svetu. Ima pripadnika naših zajednica koji ne znaju albanski, među njima sam i ja i smatram da to nije novina za naše kosovske građane niti za državu, niti za vladu i da to treba da sprovodimo sami što pre i da poštujemo Zakon o jezicima.

Jako važan podatak je i to da, ja sam dala do znanja ovde da mora da postoji zvaničnik za polnu ravnopravnost na nivou Vlade, države i posle po opštinama zato što je jako bitna ličnost i figura u institucijama koja bi rešavala jako važne probleme.

Kada su u pitanju zakoni, moram da kažem, što ne mogu da izostavim, kada su u pitanju zakoni i kada nam je dat od strane Evropske komisije prioritet koje sve zakone nemamo i koje sve to zakone treba da što pre donesemo, ponovo je Zakon o socijalnom osiguranju, ponovo je formiranje Fonda za socijalno osiguranje, što praktično mi ovo izbegavamo, znamo da je Zakon o radu u toku, ali kada su ovi zakoni, mi nešto nemamo veliki progres, niti je pred Skupštinom stigao taj zakon.

Jako je važan podatak kada je u pitanju Zakon o zapošljavanju, kada je regulisanje u javnim preduzećima, gde je bilo i političkog uticaja i u svim javnim institucijama i to treba da sve nas zabrine i normalno da nas zabrine pojam korupcije za koju moramo da se borimo i da nađemo pravilne i dobre mehanizme, bez obzira što smo doneli Zakon o korupciji i Zakon o suzbijanju pranja novca i moramo normalno što više, kada je u pitanju pravda, da monitorišemo kao Skupština, što nismo radili kao komisije nijedan zakon, praktično, monitoring na terenu i da budemo prisutni što više u onim institucijama za koje donosimo ovde zakone za koje praktično zakoni postoje.

Jako bitno je da što pre, posle šest meseci, mi znamo da svakih šest meseci imamo monitoring Evropske komisije, i da isti taj monitoring mi sami napravimo plan i da delujemo u institucijama gde moramo sami da vidimo kakva je prava situacija i da sami međuparlamentarci i parlamentarci ostalih pišemo izveštaje koji bi u skladu bili sa Evropskom unijom, sa Evropskom komisijom, gde bi mogli sami da damo progres i da kažemo da smo praktično postigli neki progres za dobrobit svih naših građana.

U načelu podržavamo ovaj izveštaj kao Parlamentarna grupa i daćemo svoje priloge kako bi pospešili da bude bolji plan Skupštine za sledeće tromesečje. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Megjithatë, e qite normën mjaft, nuk iu përmbajte asaj që the në fillim. Janë edhe pesë diskutues. Fjalën e ka Myrvete Pantina. Mirë është të tërhiqet ndonjëri, se krejt janë të Partisë Demokratike!?

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Sipas Raportit të paraqitur nga Komisioni për integritet evropian, puna e Kuvendit në zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian konsiderohet se ka qenë më efikas në krahasim me atë të vitit të kaluar, edhe pse mbi 50% të aktiviteteve të parapara, sipas planit, nuk janë realizuar.

Mendoj se Komisioni për Integritet Evropian ka bërë një punë të mirë, për arsye se ka analizuar atë çka është realizuar dhe çka na pret në të ardhmen. Për këtë mendoj se raporti duhet të përkrahet por edhe të gjithë jemi të vetëdijshëm se duhet të kihet një angazhim shtesë si nga Kuvendi ashtu edhe nga Qeveria për realizimin e planit të veprimit të Kuvendit, sepse deri në fund të vitit na presin edhe

shqyrtimi i 83 projektligjeve në Kuvend dhe kjo kërkon angazhim shtesë, pra edhe nga ana e Qeverisë.

Në raport janë paraqitur të arriturat nga plani, do të thotë për periudhën gjashtëmujore, si dhe sfida për periudhën vijuese. Sfodat janë të shumta, edhe më tutje, por unë do të ndalem në disa të cilat i konsideroj si më të rëndësishme. Ndër to vlerësoj se sundimi i ligjit paraqet një sfidë shumë të madhe për periudhën e ardhshme në të cilën drejtim duhet të punohet me përkushtim të madh.

Janë brengosëse akuzat për korrupsion dhe keqpërdorime në gjykata, të cilat janë paraqitur në raport. Po ashtu numri i madh i rasteve të pazgjidhura në gjykata. Është brengosës mungesa e gjyqtarëve lokalë, ose numri i pamjaftueshëm i tyre në kuadër të Dhomës speciale të Gjykatës Supreme, gjë që e pamundëson zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me procesin e privatizimit, si konkretisht, është shpërndarja e 20%-shit të punëtorëve të ndërmarrjeve të privatizuara, një obligim i cili vonohet dhe shtyhet vazhdimisht.

Po ashtu, në të ardhmen duhet të përmirësohet edhe zbatimi i urdhrave për largim nga pronat e uzurpuara, gjë që duhet të kryhet nga ana e Agjencionit të Pronave të Kosovës.

Është po ashtu një sfidë tjetër ngritja e vazhdueshme profesionale e administratës publike për të mund ajo më me efikasitet të kryejë detyrat e saj. Po ashtu, një sfidë shumë e madhe është edhe zhvillimi ekonomik, papunësia, varfëria. Sistemi statistikor konsiderohet se është i dobët dhe ky pamundëson vlerësimin më të plotë të situatës ekonomike në Kosovë. Të dhënat statistikore të institucioneve tona, shpeshherë nuk përputhen dhe krijojnë konfuzion, sikurse ato të Bankës Qendrore të Kosovës, Ministrisë së Ekonomisë së Financave dhe Entit të Statistikës. Do të thotë, ato do të duhej të ishin të harmonizuara.

Po ashtu mbetet një sfidë e madhe sqarimi i pozicionit të Kosovës me disa vende fqinje në kuadër të integritimit rajonal – CEFTA-s, pasi që ajo drejtpërsëdrejti reflektohet në ekonominë e Kosovës dhe e dëmton atë.

Një sfidë tjetër, është problemi që ka të bëjë me prokurimin publik. Sipas Raportit të progresit, situata në këtë fushë është keqësuar në krahasim me vitin e kaluar.

Është shqetësues numri i madh i tenderëve të anuluar për shkak të mos përputhshmërisë me kërkesat administrative, si dhe rritja e numrit të tenderimit me një burim... Prandaj, do të thotë nga ky raport shihet se në të ardhmen na pret një angazhim më i madh për të mund të realizohet plani i veprimit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Gani Koci e ka fjalën.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë do të ndalem më tepër në planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për tremujorin e ardhshëm, kështu shkruan në titull, ndërsa mbi të është plani i veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropiane për vitin 2010, raporti i dytë i progresit që ka të bëjë me vitin 2009, prandaj do të dëshiroja të di që ky tremujor i ardhshëm a ka të bëjë me tremujorin që vjen tash, do të thotë fundi i tremujorit të katërt të këtij viti, apo është diçka që korrespondon me fillimin e vitit 2010, sepse jemi në muajin shtator tash. Se ka të bëjë me tremujorin e parë të këtij viti tregon edhe pika 6... p.6, kështu shkruan, thotë Zyra për regjistrimin e partive politike, sipas raportit të progresit dhe dobësitë që janë pa në këtë zyrë. Kuvendi i Kosovës, Kryesia, Komisioni për buxhet e financa, ndërsa në këtë

matricën, në pjesën e tretë të kësaj matrice thotë “Kuvendi i Kosovës shqyrtoi funksionimin e komisionit qendror zgjedhor dhe të sekretariatit të tij, sipas kërkesave dhe mundësive buxhetore të përkrahë shtimin e kapaciteteve njerëzore dhe financiare gjatë procesit të shqyrtimit të buxhetit për vitin 2010. Buxhetin e vitit 2010 e kemi shqyrtuar prej tetorit të vitit të kaluar deri në dhjetor kur e kemi miratuar për 2010, tash nuk di a ka të bëjë me 2011 apo me 2010 në këtë rast. Ne këtu kemi shqyrtuar edhe raportin e punës për 2009 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe kjo çështje ose kjo sfidë që është paraparë këtu në raportin e Komisionit qendror zgjedhor nuk e kemi gjetur. Do të thotë nuk kemi pa atë se komisioni qendror zgjedhor për shkak të buxhetit të vet ka pasur kapacitete të reduktuara. Përkundrazi, ju e dini edhe në fillim të këtij viti që janë përsëritur zgjedhjet shumë herë, shumë runda, ka pasur edhe shtim të buxhetit dhe asnjëherë nuk është shtruar kërkesë dhe nevojë e këtij komisioni për shtim të stafit. Prandaj, Komisioni që e ka përpunuar këtë plan të veprimit për tremujorëshin e ardhshëm që është pak e diskutueshme, duhet të ketë parasysh këtë fakt dhe këtë element.

Te pika 28, thotë: Korniza ligjore për adresimin e korrupsionit”, duhet të përmirësohet. Ju e dini se edhe brenda këtij viti, vitit 2010 ne kemi pasur disa ligje që kanë të bëjnë në parandalimin e këtij fenomeni dhe thotë Kryesia e Komisionit, në matricën, në pjesën e dytë, Kryesia e Kuvendit, Komisioni për buxhet e financa, Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve e tjera, e tjera... thotë: shqyrtimi i Projektligjit për adresimin e korrupsionit në procedurë të rregullt parlamentare. Unë nuk jam kah e kuptoj çka do të thotë shqyrtimi i projektligjeve në adresimin e korrupsionit në procedurë parlamentare, kur të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me luftimin e këtij fenomeni, duke pasur parasysh ligjet që parandalojnë këtë fenomen, janë shqyrtuar dhe shqyrtohen në mënyrë të rregullt dhe në procedurë të rregullt në Kuvend, prandaj formulimet e tilla mendoj që duhet t'i ketë parasysh komisioni që e ka përgatitur këtë çështje.

(Ndërhyrje)

Jo, unë nuk thashë do të jem as i shkurtër, as i gjatë, aq sa më takon të flas, edhe si kryetar i Komisionit për Buxhet e Financa, që ka të bëjë me çështjen.

Pika 65 thotë: në përgjithësi ligjet e reja të cilat nuk ndërlidhen me kornizë afatmesme të shpenzimeve të KASH-it, po e kuptoni për çka është fjala, që nuk e përmbajnë pjesën që quhet – deklaratë financiare se koston për implementimin e këtij ligji, me sa di unë, si deputet edhe i këtij mandati, po edhe i mandateve tjera, po them në këtë mandat nuk ka ndodh që Kuvendi i Republikës së Kosovës të miratojë ndonjë ligj që nuk e ka pas deklaratën financiare dhe nuk ka qenë i përfshirë në kornizën afatmesme të shpenzimeve, prandaj hartuesit e matricave të tilla, po e quaj, duhet të kenë parasysh dhe të njohin pak edhe punën e komisioneve ose së paku të marrin raportet e komisioneve dhe në qoftë se komisionet s'bëjnë raporte atëherë mund të sekretaria të shohin cilat ligje ose cilat kanë kaluar nëpër ato komisione gjegjëse dhe të shohin edhe punën dhe veprimet e komisioneve përkatëse lidhur me këto çështje.

Te pika 71, thotë: Për sa i përket prokurimit, situata është keqësuar në krahasim... e tjera, e tjera. Nuk di a është keqësuar apo është përmirësuar. Unë e di vetëm një fakt. Në vitin 2010 kemi shqyrtuar shumë raporte të auditorit të përgjithshëm për organizatat buxhetore në shpenzimet buxhetore. Dhe, me përjashtim, me përjashtim gati në të gjitha organizatat buxhetore ka pasur përmirësim të performancës së menaxhimit të financave publike...

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Koci! Vazhdojmë me deputeten Drita Kadriu.

DRITA KADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti zëvendëskryeministër,

Kolegë deputetë,

Meqenëse jemi në përfundim të diskutimit rreth kësaj pike të rendit të ditës, po pajtohem me kolegun Koci rreth emërimit të kësaj pike si rend dite. Realisht, ne po shqyrtojmë të arriturat e planit të veprimit që e ka miratuar Kuvendi për sfidat që kanë dalë nga Raporti i progresit për Kosovën, të vitit 2009.

Vështrimet e mia në këtë raport janë të orientuara rreth mënyrës, metodologjisë dhe formës së hartimit të vetë dokumentit i cili dokument shpesh paraqet më pak të arritura se sa që realisht kanë ndodhur brenda Kuvendit.

Këtë çështje e potencon edhe vetë raporti, në faqen 19, kur thotë se edhe pse komisionet i kanë përfunduar detyrat që kanë dal nga plani i veprimit, kanë organizuar mbledhje të rregullta, kanë organizuar dëgjime publike, gjithmonë për sfidat që i ka ngritur Raporti i progresit dhe i ka obliguar plani i veprimit, këto raporte, këto aktivitete nuk janë harmonizuar tani me këtë raport që po e shqyrtojmë.

Problemi është këtu se raporti nuk ka identifikuar, nuk ka gjetur mënyrën e komunikimit të komisioneve rreth aktiviteteve që janë ndërmarrë për eliminimin e këtyre dobësive.

Një problem tjetër që na paraqitet në këtë dokument janë se raporti për këtë fazë vijuese për këta muajt e fundit që kanë mbet, nuk ka hartuar asnjë instrument që do t'i obligonte komisionet për arritjen dhe përmirësimin e gjendjes. Për shembull, nëse sfida ka qenë mungesa e ligjit për shëndetin mendor ose mungesa e strategjisë për trashëgimi kulturore, tani përsëritet aktiviteti i njëjtë që ka qenë në fillim i identifikuar si aktivitet në këtë raport.

Unë sugjeroj që këto instrumente vepruese të planit të veprimit, të hartohen saktë, në mënyrë që komisionet t'i dalin përballë detyrave dhe të obligohen pastaj bartësit e këtyre detyrave. Për shembull, ligji për shëndet mendor të miratohet në seancën e dytë të dhjetorit. Atëherë ne e obligojmë saktësisht bartësin dhe presim rezultate matëse në fund të vitit rreth planit të veprimit të Kuvendit dhe mund të themi se strategjia ose ligji për shëndet mendor nuk është iniciuar, është në këtë fazë ose është miratuar nga Kuvendi.

Një formë e tillë e neglizhimit të aktiviteteve që kanë ndodhur, paraqitet edhe me problemet ose sfidat që është ngarkuar Komisioni i arsimit, respektivisht çështjet që janë lidhur me Ministrinë e Arsimit ose me gjykatat në pjesën e veriut.

Pika e tretë, ose çështja e tretë, të cilën unë e kam identifikuar gjatë shqyrtimit të këtij raporti është se problemet apo kërkesat të cilat i trajton si të paarritshme raporti, realisht Kuvendi i ka tejkaluar. Për shembull, problemi numër 19, problemi numër 14 ose Ligji për shërbimin civil është i kaluar, Ligji për gjykatat është kaluar në këtë Kuvend, prandaj është dashtë që këto çështje të cilat janë tejkaluar të paraqiten si të arritura.

Dhe krejt në fund, i nderuari zoti kryesues, meqenëse kemi në dorë dokumentin e planit të veprimit, sugjeroj që në dokumentet e tilla t'i shmangemi përdorimit të fjalëve ose shprehjeve që tregojnë një retorikë siç është vullneti politik, sepse janë të paktë mekanizmat që në dokumentet e planeve të veprimit i matin këto shprehje.

Ju përcjell një argument nga dokumenti, ku thotë, te faqja 5, fjalia e parë, e sfidës së tretë dhe fjalia e dytë...

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë po vazhdoj aty ku mbeti Gania, t'i them edhe disa çështje që kanë të bëjnë me planin e veprimit të Kuvendit. Edhe në planet e veprimit të Kuvendit që kemi pasur më përpara por edhe në këtë plan të veprimit të Kuvendit hartuesit e këtij plani të veprimit i përziejnë kompetencat e komisioneve.

Hartuesit e këtij plani të veprimit duhet të kenë kujdes që vërtet të bashkëpunojnë me komisionet dhe të dinë punën e aktivitetin e komisionit dhe detyrat e komisioneve të cilat janë të parapara me rregullore.

Në planin e veprimit, që është miratuar më përpara, kanë qenë të përziera detyrat e Komisionit për buxhet e financa me detyrat e Komisionit për ekonomi, tregti, industri, energjetikë dhe telekomunikacion. Në këtë plan të veprimit janë përzier detyrat e Komisionit për buxhet dhe financa dhe Komisionit për mbikëqyrjen e financave publike.

Te pika 5 dhe 4, ku thuhet që Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave dhe Komisioni për Integritet Evropian, të kërkohet nga trupi mbikëqyrës i prokurimit të përgatisë një raport dhe të ndërmarrë hapa. Të gjitha organet mbikëqyrëse të prokurimit, qoftë KRPP-ja, qoftë APP-ja, qoftë OSHP-ja, me ligj i kanë të parapara afatet se kur do t'i dorëzojnë raportet dhe këto raporte i kanë dorëzuar dhe nuk... është e paraparë që të dorëzojnë raportet në tremujorin e katërt, siç paraqitet këtu. Këto raporte i shqyrton Komisioni për buxhet dhe financa.

Kur është çështja te shqyrtimi, te pika p) 72, thotë që Komisioni për mbikëqyrje të financave publike të bëjë shqyrtimin e projektligjit të prokurimit publik në procedurë të rregullt parlamentare. Shqyrtimin e Projektligjit për prokurimin publik e bën Komisioni për buxhet dhe financa. Nuk e bën Komisioni për mbikëqyrje të financave publike, me përjashtim se nuk përjashtohet mundësia që të japë rekomandime dhe të bëhet ashtu siç kanë të drejtë të gjithë deputetët të bëjnë amendamente në këtë projektligj.

Dhe një çështje tjetër, që është shumë e rëndësishme këtu, në pikën p) 76, tek vlera e kontratave të dhëna të prokurimit publik është rritur dhe prezantuar gati 20% të produktit në Kosovë, për të mos e lexuar më tutje, tash në matricë shënohet që me këtë çështje do të merret Komisioni për mbikëqyrjen e financave publike, që nuk është detyrë e këtij komisioni dhe të krijohet... E tash në pikën tjetër, thotë: pasi të krijohet komisioni parlamentar për financat publike të marrë përsipër shqyrtimin e praktikave të prokurimit dhe të përgatisë një raport me rekomandime si të tejkalohen sfidat e përmendura në raportin e progresit.

Unë nuk di se këtu është paraparë me u formua ndonjë komision parlamentar për financa. Këtu ekziston Komisioni për buxhet e financa dhe nuk e di çka ka menduar hartuesi i këtij plani të veprimit të Kuvendit për integritet evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Branislav Gërbiq!

BRANISLAV GRBIĆ: Zahvaljujem, predsedavajući na datu reč!

Gospodine zamenice,

Uvažene dame i gospodo narodni poslanici,

Pred nama je još jedan, znači, preporuka znači o radu Skupštine u vezi integracije, to je nešto što sigurno je interes svih građana Kosova i nas predstavnika u Skupštini Kosova. Ovo je jedno jako bitno pitanje integracije manjinskih zajednica u kosovsko društvo. To je jedno pitanje koje mi stalno imamo na nekim sastancima nevladinih organizacija, kako stranih, tako i domaćih. To je jedan proces koji mi predstavnici manjinskih zajednica želimo jedanput da rešimo, da ne čekamo da nas vlada Srbije ili neko drugi integriše u kosovsko društvo u kojoj pripadamo i smatramo da ovde pripadamo. To je znači jedan proces koji želimo zajedno da podelimo sa građanima Kosova, predstavnicima zajednica Albanaca i ostalih. To je nešto što sigurno interesuje sve građane Kosova i to je nešto što mi želimo da preuzmimo odgovornost onoliko koliko pripada svim građanima Kosova.

Smatram da jedna transparentnost, kako politička volja Vlade Kosova, politička volja međunarodne zajednice i svih treba da bude prepoznata u predstavnicima zajednica na Kosovu, manjinskih zajednica na Kosovu koje žive ovde i to je nešto što smatram da smo u skladu sa Ahtisarijevim planom i periodom od '99. godine do sada mogli i trebali smo da imamo volje i onoliko mogućnosti da ipak prepoznamo taj interes dela građana, da ne kažem svih, ali onog dela koji ne zavisi od investicija Srbije ili nečega koji želi da se uključi u ovo društvo. To je nešto što sigurno Vlada Kosova treba da prepozna i u tom smislu da bude malo transparentnija i malo poštenija u odlučivanju i u preporukama i u osvajanju, znači, i dodeljivanju mesta radnika, kao i drugih odgovornosti, jer došlo je vreme da ne želimo da se krijemo iza nečije politike koja ne daje rezultate, ne samo znači da ne budemo stalni neki dežurni krivci, govorim o manjinskim zajednicama, ne govorim o većinskoj, stalni krivci koji neće da prihvataju zakone i kosovsko društvo. Nije tačno! Mi želimo da uzmemo integracione procese u svoje ruke i da ova Vlada, kao što sam rekao, znači prepozna takve ljude. To je znači nešto što smatram da imamo pravo i nešto što mislim ide u neku varijantu odgovornosti, jer smatram da smo sazreli kao građani s obzirom da smo i dobili državnost, da imamo prava na odgovornost i tu odgovornost želimo da podelimo sa svima.

Integracioni procesi su jako bitni i ja sam kao član Komisije za integracije, gde mi je zadovoljstvo da radim s tim ljudima, išao, znači, i van Kosova i ovo pričao da ipak život na Kosovu je moguć, da je moguć jedan međunarodni život i da sigurno takav život treba da forsiramo i to je nešto što ova Skupština treba da podrži i mislim da malo više treba akcenat da se da u takvom jednom pravcu.

Ja ne bih želeo da dužim i da zamaram moje kolege i ujedno bih na kraju želeo da čestitam svima predstojećí Ramazanski bajram i da poželim svima ljudima muslimanske veroispovesti da ta tri dana prožive u miru i raspoloženju sa svojom porodicom. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Rexhep Hoti.

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar zonja e zotërinj,

Dëshiroj t'i vë shkurt gjashtë theksime mbi planin e veprimit, në raportin e dytë të progresit për planin e veprimit. Do të thotë, në pyetje është fuqizimi i Kuvendit të Kosovës.

Në radhë të parë kisha për të thënë se do të ishte mirë që në këtë pikë të fuqizohet fuqishëm, të fuqizohen shefat e grupeve parlamentare dhe komisionet. Domethënë, pa fuqizimin e këtyre dy segmenteve në Kuvend, mendoj se punët nuk do të shkojnë si duhet. Në veçanti kërkoj që të kenë më shumë hapësirë shefat e grupeve parlamentare dhe të mos bien pre e politikave, qofshin ato partiake apo të segmenteve tjera.

Theksimin e dytë do ta vë tek ligjet. Ne e dimë se për të shkuar në Evropë standardet, s' duhet të kemi vizione hiq, se vizionet i ka përcaktuar Evropa dhe ne duhet t'i vëmë standardet. Duhet diku 100.000 faqe. Për t'i bërë këto 100.000 faqe, ne duhet vërtet të prodhojmë ligje shumë më shpejt se sa jemi duke prodhuar. Kohë nuk kemi.

Një ... shumë i rëndësishëm i Bashkimit Evropian, i ka thënë shul shqip Qeverisë së Kosovës: merrni ligjet në Shqipëri dhe mos bëni hajgare. Prandaj, në qoftë se kanë interese segmente të caktuara në Kosovë që të marrin, për shkak të aspekteve të ndryshme financiare, financime andej ose kënde, ato le t'i bëjnë në prapavi por ligjet le t'i marrin atje dhe t'i bimë, të ecë puna më shpejt.

Theksim tjetër, që Kuvendi i Kosovës të jetë më funksional, kisha me vë në theks debatet. Edhe në këtë drejtim dua të them se ky Parlament duhet të merr në duar të veta çështjen për të cilën edhe realisht është. Ky Kuvend ende s'ka thirrur asnjë seancë për të debatuar për çështjen - problemet në veri. Vazhdimisht flitet se do të ketë bisedime. Ende ne s'e kemi mbajtur një seancë... Ne duhet të ngjallemi më tepër me debate politike dhe në këtë drejtim të forcohemi jashtëzakonisht shumë.

Theksim tjetër, është Qeveria. Parlamenti i Kosovës duhet përfundimisht të ndalet dhe të kërkojë përgjegjësi prej Qeverisë së Kosovës. Ne e kemi këtë të drejtë kushtetuese dhe duhet ta ushtrojmë. Nuk mund Qeveria e Kosovës të sillet me arrogancë, që nganjëherë sillet, duke dhënë në veçanti edhe ministrat e caktuar japin propozime të tilla të cilat i shkelin çdo normë kushtetuese, për çështje shumë kapitale, të cilat duhet të merren vendime në Kuvendin e Kosovës del ... Ne e respektojmë të drejtën që çdo përkthyes mund të jetë ministër ose çdo bokser, sepse është i zgjedhur, mekanizimi i tillë e lejon. Por Kuvendi i Kosovës nuk duhet ta lejojë që t'i shkelet fuqia vetëvendosëse.

Pikë tjetër, e theksimit për fuqizimin e Kuvendit, desha të përmendi opozitën. Opozita parlamentare përfundimisht duhet të kthehet jo vetëm në kundërshtimet e argumentuara por në substancën e vet që ajo ofron. Ky Kuvend është lodhur duke dëgjuar çka ishte e çka s'ishte mirë, ndërkaq ata duhet të mundohen dhe të prodhojnë politika alternative. Më vjen keq të them dhe e them këtë jo me tendencë të keqe, por dy deputetë të pavarur ofrojnë – prodhojnë më tepër substanca alternative se sa krejt opozita bashkë. Kjo s'është në rregull.

Propozimin e fundi dhe theksimin e fundit e kam te shoqëria civile, që gjithashtu ndërlidhet me atë që Kuvendi i Kosovës ... të jetë më funksionale. Shoqëria civile, duhet përfundimisht të heqë dorë nga nihilizmi dhe nga tendenca për të krijuar perceptime të ndryshme negative të cilat realisht nuk kanë të bëjnë me realitetet e vërteta politike. Ne e dimë se klasa politike në Kosovë ka probleme të mëdha. Shteti, të gjitha, jemi në fillim. Por, shoqëria civile duhet të ketë konsiderata dhe problemet t'i adresojë saktë e jo me nihilizëm të tepruar për qëllime të veta personale. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni, i fundit!
Regjia, le t'i bie ziles për të ftuar deputetët për të votuar!

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Jam i fundit mirëpo mu deshtë ndoshta tri çështje që janë të rëndësishme dhe do të duhej të ishin në raport, jo për diçka tjetër, mirëpo së paku të mos e mohojmë punën që e kemi bërë. Unë e di që nuk ka tendenca për me mohuar, mirëpo ndoshta raporti me qenë më i qartë. Nga raporti shihet se nuk janë përshkruar të gjitha veprimet të cilat kanë ndodhur në komisionet parlamentare dhe natyrisht nuk janë përshkruar apo nuk janë shkruar të gjitha ligjet që tanimë janë edhe të dekretuara dhe nëse e

aprovojmë si raport, do të ishte jashtëzakonisht e pafalshme sepse me vetëdije po aprovojmë një raport pa i plotësuar së paku këto ligje të cilat tanimë veç i kemi të aprovuara dhe do të kërkoja si çështje me qenë edhe një herë – që raporti të aprovohet me shtesat që do të bëhen edhe një herë me një shikim nga komisionet parlamentare. Nuk jemi larg, jemi në një ndërtesë të Kuvendit, por të themi se mungon ligji për avokatin, mungon ligji për gjykatat, mungon ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe ligjet e tjera, është pak sa e pafalshme. Ishte çështja e parë.

Çështja e dytë, është një konstatim që është dhënë, po e lexoj, në faqen 9.

(Ndërhyrje)

Po e kuptoj periudhën kohore, mirëpo dokumenti do të aprovohet sot në Kuvendin e Kosovës dhe nuk është diçka absolute që nuk mund të ndryshohet dhe të plotësohet. Po e kuptoj periudhën, por po përmendi vetëm faqen 9, një konstatim ku jepet te demokracia dhe sundimi i ligjit. Thotë: komisionet parlamentare nuk kanë raportuar për progres në fushat si vijon:

- Miratimi i procedurave të ... për bashkëpunim ndërkombëtar;
- Adresimin e rasteve të korrupsionit dhe keqpërdorimit në gjykata;
- Rekrutimin e numrit të rasteve të pazgjidhura për rastet civile dhe penale;
- Zgjidhjen e rasteve të ngjarjeve të marsit 2004.

Për njoftim: Komisioni për legjislacion dhe gjyqësi, për këto çështje ka pasur dëgjim publik dhe i ka ftuar të gjitha mekanizmat që janë përgjegjës për këtë dukuri, duke filluar nga Ministria e Drejtësisë, bile ka qenë prezent edhe ministri, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Prokuroria e shtetit, Agjencioni Antikorrupsion dhe të tjerë, që s'po i përmend. Dhe, kemi hartuar raport edhe për bashkëpunimin ndërkombëtar, kemi kërkuar që procedurat, ministria përkatëse me i bë dhe e keni raportin, përpak minuta mund ta merrni të shkruar nëse lejon asistenti me u fut në sallë. Kemi adresuar, janë shumë mirë edhe në raportin e Agjencisë Antikorrupsion, të gjitha rastet që janë për gjyqësorin dhe prokurorinë, rastet që dyshohen për vepra penale, janë përcaktuar shumë qartë dhe raporti është i qartë, domethënë edhe kjo detyrë ka përfunduar. Kemi marrë informacione të sakta edhe për mosveprimin e gjykatës në pjesën e veriut dhe domethënë është një raport ku kemi thënë ende në këtë kohë të dëgjimit publik nuk kemi veprim konkret të gjykatës dhe natyrisht kemi marrë edhe një informacion të prokurorit të shtetit që ka qenë prezent edhe për situatën se si apo sa vepra kanë mbetur ende për ngjarjet e marsit, të gjitha j anë në raport. Dhe do të ishte e padëshirueshme që të del konstatimi se nuk kemi bë... E kemi bë një dëgjim publik, me të gjitha institucionet, prandaj ne nuk kemi çka të bëjmë tjetër, sepse nuk kemi instancë që vendosim me marrë ndonjë veprim konkret as për rastet e ngjarjeve të marsit por as për rastet e tjera.

Dhe, një çështje tjetër. Në rekomandime nëse i shihni, pajtohem me rekomandimet, por u në konsideroj se buxhet është ndarë për komisionet parlamentare, bile edhe atë buxhet me këto procedura nuk e shfrytëzojmë as 10% sepse procedurat janë asisoj që vetëm për ekspertë nuk lejohet domethënë për trajnime, për forma të ndryshme të udhëtimeve e kështu me radhë.

Një çështje tjetër, nëse e merrni dhe e shikoni drejt. Në planin e veprimit, për shembull është paraparë në muajin e tretë të organizohet një dëgjim publik për ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale i cili është në fuqi. Prandaj, mos të lejojmë diçka. Është ligji në fuqi dhe nuk ka nevojë me pas dëgjim publik se ligji është në fuqi në periudhën e tretë, prandaj janë ngarkuar në planin e veprimit disa. Është mirë...

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar referuesja, kryetarja e Komisionit për integritet, deputetja Zylfije Hundozi.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë, së pari falënderoj të gjithë deputetët që morën pjesë në diskutim, sidomos për sugjerimet që i dhanë. Besoj se në punën e mëtutjeshme të Komisionit këto të gjitha do të merren parasysh.

Së pari, unë cekë që ky raport është shkruar në qershor, nuk është faji i Komisionit që ka ardhur në seancë sot, në shtator dhe në ndërkohë, në muajin qershor në korrik janë aprovuar, janë miratuar ligjet për gjykatat, për sanksionet penale, dhe për prokurimin publik, ne s'kemi mund të tash këtë me ndryshuar se është diçka një procedurë e cila duhet të kalojë dhe unë në fjalimin tim e cekë që në raportin e ardhshëm krejt këto kanë me u konsideruar si sfida. Domethënë, për shkak të procedurave parlamentare ne s'kemi mund t'i përfshijmë ato ligje që janë bërë pas raportit, domethënë vazhdimisht çdo ditë është dashur me u ndryshua. Domethënë, kjo nuk e ka një logjikë dhe unë e cekë këtë.

Pastaj, ky raport është shkruar duke i falënderuar bashkëpunimit me komisionet tjera. Do të thotë, çka kanë raportuar komisionet në Komisionin për Integritet Evropian, atë e kemi marrë parasysh. Ne e cekëm, në realitet në raport është e cekur që shumica e komisioneve parlamentare e kanë intensifikuar punën e vet, kanë bashkëpunuar me Komisionin për Integritet Evropian, i kanë prurë raportet me disa përjashtime. Njëri prej përjashtimeve është Komisioni për buxhet, i cili i dha ato kritika, këta nuk na kanë çuar neve raport, kështu që edhe nuk kemi pasur bashkëpunim me ta për çfarë arsye nuk e di, ata i dinë arsyet e veta. Po tash e tutje lus Komisionin për buxhet që me kohë t'i bie raportet e veta që në raportin tjetër që bëhet të futen, do të thotë, sa më saktësisht.

Edhe veprimet që janë bërë, që janë mbetur, gjithashtu ekziston mundësia e komisioneve parlamentare me i dhënë sugjerimet e veta se ky është një plan i përbashkët i Kuvendit të Kosovës. Nuk jemi vetëm ne autorë. Ne këtë e punojmë në bazë të arriturve, në bazë të raporteve, në bazë të dhënave që i marrim. Nuk i qesim këto prej veti. Do të thotë, sa kanë bashkëpunuar komisionet, ai është produkt i punës së të gjitha komisioneve. Unë nuk e marr vetëm të Komisionit për Integritet Evropian. Dhe kisha me i lutur komisionet që sa më i mirë të jetë bashkëpunimi aq më e mirë do të jetë puna e Parlamentit të Kosovës sa i përket punës së integritetit evropian. Dhe, kisha me ju lutur me i qit në votim rekomandimet. Pra, sa do që të jemi perfeksionista, gjithmonë ekziston mundësia me gabuar po gjithmonë ekziston edhe mundësia me u përmirësuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sa janë deputetë? Në sallë janë 69 deputetë. Nuk i është përmendur emri askujt.

E vë në votim shqyrtimin e Raportit të dytë të progresit për Planin e veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2010. Votojmë së bashku me rekomandimet dhe kuptohet, që të merren parasysh edhe vërejtjet që janë dhënë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani.

Konstatohet se me 64 vota "për", 1 "kundër" dhe 2 "abstenime", Kuvendi miratoi Raportin e dytë të progresit për Planin e veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2010, së bashku me rekomandimet dhe vërejtjet e dhëna.

Vazhdojmë me pikën e njëzet të rendit të ditës:

20. Shqyrtimi i Raportit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

për vitin 2009

Komisionet parlamentare në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit e kanë shqyrtuar Raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2009 dhe Kuvendit i kanë paraqitur raporte me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për buxhet e financa zotin Gani Koci, që ta marrë fjalën. Në emër të Komisionit dhe i ke dhjetë minuta.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për buxhet dhe financa i raporton Kryesisë dhe Kuvendit për punën e vet, prandaj në cilësinë e kësaj dua të jap edhe një raport të Komisionit lidhur me çështjen të cilën po e shqyrtojmë. Rekomandimet e

Komisionit i keni marrë. Ka qenë muaji korrik kur e kemi shqyrtuar këtë raport, kemi të bëjmë me raportin për vitin 2009 dhe me vete kam edhe procesverbalin e të gjithë diskutuesve – anëtarë të Komisionit që kanë folur lidhur me këtë raport në Komision dhe ka qenë një qëndrim unanim i anëtarëve të Komisionit që raporti t'i procedohet për miratim Kuvendit dhe se i përmbush të gjitha kërkesat ligjore të raportimit të këtij institucioni të rëndësishëm të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarja je Komisionit për ekonomi, tregti, industri, energjetikë, transport, telekomunikacion, zonja Muzejene Selmani e ka fjalën.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zotëri kryesues!

Duke marrë parasysh se në mbledhjen e Komisionit parlamentar, të datës 29.06.2010 në prezencë të drejtuesve të BQK-ës dhe ekspertëve e deputetëve, është diskutuar lidhur me politikat zhvillimore ekonomike të vendit dhe Komisioni parlamentar për ekonomi, tregti, industri, energjetikë, transport dhe telekomunikacion, nxjerr këto rekomandime:

1. Banka Qendrore e Kosovës të marrë në konsideratë propozimet lidhur me politikat dhe mbajtjen e fondeve jashtë vendit për të cilat Komisioni vlerëson se ka mundësi që një pjesë e tyre të vjen në funksion të stimulimit të sektorit privat dhe të biznesit me qëllim të zhvillimit ekonomik, rritjes dhe prodhimitarisë vendore si në sektorin e agrikulturës, industrisë prodhuese dhe përpunuese.
2. Komisioni vlerëson se ambienti, siguria ekonomike dhe bankare është e kënaqshme, në favor të investimeve të këtyre fondeve në Kosovë dhe atë të bazuar në principe, kritere dhe standarde bankare siç janë për kreditë e buta për investime, greis-periodha lidhur me teknologjitë e reja prodhuese, aftësimin profesional, punësimet dhe arritjet e konkurrencës në treg, dhe
3. Komisioni po ashtu vlerëson nevojën për një debat parlamentar lidhur me politikat, fondet dhe kreditimet e sistemit bankar në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-ës, kush e dëshiron fjalën? Deputetja Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryeministër,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e Bankës Qendrore të Kosovës dhe është i mendimit se Raporti është i përgatitur sipas standardeve ashtu siç e parasheh Ligji për Bankën Qendrore të Kosovës.

Në këtë raport janë të përfshira të arriturat në zhvillimin ekonomik në sektorin real, fiskal dhe të jashtëm.

Ekonomia e Kosovës edhe përkundër krizës globale ekonomike kishte një performancë relativisht të mirë, është një ndër vendet e pakta që ka pasur rritje ekonomike gjatë vitit 2009, me një rritje diku rreth 4.4% që kryesisht ka ardhur si rezultat i rritjes së shpenzimeve publike dhe rënies së çmimeve prej 2.4%, çka do të thotë se bartës kryesor i rritjes ekonomike ishte sektori publik i cili ka rrit konsumin dhe investimet, kurse një rritje të lehtë ka pasur edhe në sektorin privat.

Sektori financiar ka vazhduar të rritet gjatë vitit 2009, duke arritur vlerën e aseteve prej 2.8 milionë.

Sektori i Bankës së Kosovës ka pasur rritje gjatë vitit 2009 por me një normë më të ulët krahasuar me të kaluarën, ku vlera e aseteve paraqet një rritje prej 22%.

Depozitat janë rritur diku rreth 19.8% kurse rritja e kreditimit ishte prej 8.9%, kurse kreditë e këqija kanë qenë diku rreth 4.4%.

Nëse shikojmë raportin, shohim se struktura e kredive nuk ndryshon nga e kaluara. Dominojnë kreditë në ndërmarrjet e sektorit të tregtisë me 56.4% kurse sektori i industrisë ka 25% të gjithsej kredive të ndërmarrjeve. Është shqetësuese se edhe më tutje sektori me pjesëmarrjen më të ulët vazhdon të mbetet sektori i bujqësisë, me vetëm 4% të gjithsej kredive për ndërmarrjet.

Bankat me institucionet tjera përkatëse, duhet të vlerësojnë mundësinë e kushteve më të mira sidomos sa i përket normës së tatimit që të rritet kreditimi i bujqësisë dhe sektorëve tjerë prodhues që do të ndikojnë në stimulimin e eksporteve sidomos kur kemi parasysh deficitin e lartë tregtar që po e përcjell ekonominë e Kosovës dhe që është i paraqitur edhe në këtë raport.

Edhe më tutje, mbeten shqetësim institucionet mikro-financiare, që mbulojnë 7.9%, janë diku 7.9% në totalin e kredive të sektorit financiar, ku operojnë 19 institucione mikro-financiare të cilat kanë lëshuar diku 57.500 kredi, me vlerë 109 milionë euro, që është 16% më shumë se vitin e kaluar.

Nuk është bërë asgjë që t'i qasen me seriozitet këtyre institucioneve, që të rregullohet statusi i tyre apo të bëhet transformimi i tyre, gjë që ka ndodhur edhe në vendet tjera, ashtu që këto institucione të kalojnë në organizata biznesi për arsye se ushtrojnë aktivitete përfituese dhe duhet t'i nënshtrohen tatimit.

Në këtë raport të Bankës Qendrore, është i përfshirë po ashtu edhe raporti i auditorit, ku sipas këtij raporti, pasqyrat financiare të Bankës me datën 31 dhjetor 2009, paraqesin një pamje të vërtetë dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Por, sipas Ligjit për Bankën Qendrore, kapitali dhe llogaritë e rezervave të përgjithshme duhet të jenë së paku të barasvlershme me 5% të shumës totale të gjendjeve kreditore të gjitha llogarive të mbajtura në librat e Bankës në fund të çdo viti financiar.

Kjo kërkesë, nuk përmbushur në vitin 2008 nga ana e Bankës Qendrore dhe kjo çështje është ngritur edhe në Kuvend gjatë vitit të kaluar, por është e pakuptueshme pse kjo nuk është përmbushur as në vitin 2009, kurse në Raportin e Bankës Qendrore nuk thuhet asgjë në lidhje me këtë çështje, të cilën në vazhdimësi e paraqet Raporti i Auditorit të jashtëm.

Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e përkrah rekomandimin e Komisionit për buxhet dhe financa, me kërkesën që të punohet më shumë në drejtim të hartimit të ligjeve që kanë të bëjnë me rregullimin e fushës financiare, sidomos të Ligjit mbi letrat me vlerë, Ligjit për sigurimet, Ligjet për raportimet financiare dhe ligjet tjera të cilat e rregullojnë lëmin e financave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-ës, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke e vlerësuar me të drejtë atë që e tha kryetari i Komisionit, ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim Raportin, gjegjësisht edhe raportin e Komisionit me rekomandimet, në tërësi.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Haki Shatri e ka fjalën.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës, konsideron se shqyrtimi i këtij raporti në këtë situatë është i pakuptimtë për një arsye të thjeshtë. Për këtë seancë e kemi pasur të propozuar në pikat e para nga vetë Bordi shkarkimin e guvernatorit. Më vonë, Kryesia e Kuvendit e ka tërhequr atë propozim, i ka arsyet e veta.

Ne mendojmë se është e pakuptimtë shqyrtimi dhe diskutimet, sepse në qoftë se ngrehim dilema këtu, nuk ka kush të na përgjigjet. Ne nuk domi me paragjykuar arsyet e problemit të guvernatorit me drejtësinë, dëshirojmë që ai të dalë i pastër dhe nuk kemi kurrfarë paragjykimi, por në këto rrethana mendojmë se është krejt e pakuptimtë me diskutuar dhe me miratuar një raport të cilin e ka nënshkruar një person i cili sot ka probleme me drejtësinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Muzejene Selmani.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke marrë parasysh se ky raport është shqyrtuar në bazë të Ligjit për Bankën Qendrore dhe është raport vjetor i vitit 2009, mund të them se Grupi Parlamentar i AKR-ës e ka shqyrtuar këtë raport dhe raporti është punuar në bazë të ligjit, ku tregon gjendjen faktike të zhvillimit ekonomik gjatë periudhës 2009.

Në këtë raport të Bankës Qendrore për vitin 2009 shihet se norma e rritjes ekonomike ka qenë 3.8%, ku kontribuues për këtë rritje ka qenë sektori publik dhe shihet mjaft mirë se Kosova është përballë me krizën globale financiare dhe në këtë krizë qëndrueshmërinë e saj e ka ruajt vetëm çështja e investimeve të sektorit publik.

Raporti vjetor 2009 i BQK-së është përfshirë si tërësi, me shumë sfida për të gjithë ekonominë kosovare, veçanërisht për BÇK-ën ku kërkohet që të përmirësohet struktura e qëndrueshme ekonomike ligjore, ku mund të them veç ka filluar të punohet ligji për Bankën Qendrore, ligji i ri.

Në këtë raport shihet sa është i madh numri i investimeve publike, dhe lidh direkt zhvillimin ekonomik të Kosovës, investimet publike, gjë që s'kishte me qenë shumë e rrugës për një shtet i cili do që të ketë një zhvillim më të mirë ekonomik.

Në këtë raport shihen shifrat e larta të deficitit tregtar, ku janë prej 1.7 milionë euro dhe ku shihen vetëm investimet publike. Në raportin e vitit 2009 shihet se ka rënie të investimeve të huaja në Kosovë, ka tkurrje të kredi-dhënies, rënie të remintancave dhe rritjen marramendëse të papunësisë. Konsumi privat ka shënuar rënie për 5.5%, e cila ka ndodhur për shkak të performancës së dobët të sektorit real.

Në këtë raport shihen edhe normat vjetore të rritjes së sektorit bankar që ishin vetëm 8.9% ndërkaq në vitin 2008 kanë qenë 32.7%.

Në këtë raport prapëseprapë shihen edhe rritjet e kredive të këqija, ku janë nga 3.3% në 4.3% dhe do të thotë se i gjithë raporti pasqyron gjendjen faktike të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Duke marrë parasysh se tash është viti 2010 dhe shqyrtohet raporti i vitit 2009, Kosova prapë përballet me mungesën e swift-kodit bankar jo me dëshirën ndoshta edhe të gjithë deputetëve, por me dëshirën e politikë-bërësve apo të Qeverisë e cila duhet të jetë më këmbëngulëse në këtë aspekt.

Grupi Parlamentar i AKR-ës duke u bazuar në analizën e bërë dhe rekomandimet e dy komisioneve parlamentare, e përkrah raportin në përgjithësi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Deputetë të nderuar,

Edhe sot Kuvendi po tregon që me të vërtetë nuk është në gjendje kurrë vetë t'i zbatojë ligjet të cilat i miraton. Sipas Ligjit për Bankën Qendrore do të duhej sot të prezantojë raportin e Bankës Qendrore guvernatori, mirëpo ajo e pakta që do të duhej ta sigurojë Kuvendi i Kosovës se do të duhej që ose zëvendësguvernatori apo edhe ministri i Ekonomisë dhe Financave... e jo në këtë mënyrë të injorohet Kuvendi deri në atë shkallë që të jetë ofenduese. Kjome të vërtetë po tregon që ne nuk jemi konsekuent të ndërtojmë institucione, të ngrisim seriozitetin e institucioneve tona, fatkeqësisht!

Sa i përket Raportit, edhe pse Raporti i Bankës Qendrore i përmbush standardet teknike të raportimit, ky raport i gjason më shumë një raporti vjetor të aktivitetit ekonomik të vendit nga se pjesa më e madhe i referohet kësaj çështjeje kurse roli kryesor që e ka Banka Qendrore është mbikëqyrja e institucioneve financiare, si të bankave, institucioneve mikro-financiare, kompanive të sigurimit dhe Fondit pensional, në këtë raport përfshihet krejt në 10 faqe.

Duke pasur parasysh që objektivat kryesore të Bankës Qendrore duhet të ishin sigurimi i stabilitetit financiar dhe mbështetja e politikave të përgjithshme ekonomike në vend, në bazë të gjitha parametrave që janë bërë publike dhe shkallën e ngadalshme të zhvillimit ekonomik, është evidente që nuk po arrihen këto synime.

Rritja më e shpejtë e depozitave në krahasim me rritjen e kredive gjatë vitit 2009, gjithsej depozitat kanë rritje prej 310 milionë ose 21% krahasuar me vitin 2008. Vështirë mund të thuhet se në këtë mënyrë mbështetet zhvillimi ekonomik i vendit. Derisa të hollat mrizojnë në Bankën Qendrore,

atëherë gjithmonë do t'i kemi normat e larta të interesit të kredive dhe së dyti, nëse këto të holla mrrizojnë dhe ne nuk kemi siguri t'i fusim në tregun kosovar, atëherë shtrohet pyetja – si do të mund t'i bindnim investitorët e huaj që ata kanë siguri t'i sjellin të hollat e tyre në tregun kosovar. Kështu, sipas raportit në vitin 2009 investimet e huaja direkte kanë shënuar një rënie vjetore prej 20.4%.

Ajo që do të duhej sqaruar e ne nuk kemi sot askënd për të na sqaruar, është se në raport qëndron se viti 2009 u shoqërua me deflacion prej 2.4% i ndikuar kryesisht nga rënia e çmimeve të importit, është për t'u dyshuar në këtë të dhënë. Pyetja ime, për të cilën tash askush s'ka të përgjigjet, është se nga ne i paskemi importuar këto mallra?

Sektori bankar i Kosovës, sipas raportit, mbylli vitin 2009 me një profit neto prej afër 30 milionë eurove. Profiti i realizuar ishte për 30.5% më i ulët krahasuar me vitin 2008, që tregon për një performancë më të dobët të sektorit bankar.

Ajo që është shqetësuese është edhe rritja e dallimit ndërmjet normave të interesit në depozita dhe kredi, kështu që kemi rritje në normat e interesit në kredi, kurse rënie të normave të interesit në depozit.

Gjithashtu, është shqetësuese se tregu bankar si sektor i rëndësishëm i ekonomisë vazhdon të dominohet nga tri banka që ndajnë 90% (19%) të tregut në Kosovë me norma të interesit të përafërt.

Është evidente që mbetet edhe shumë të bëhet nga ana e institucioneve përkatëse dhe të vlerësohen se çfarë reforma duhet ndërmarrë, ashtu që të ulët interesi i kredive, të përfitojë ekonomia, të përfitojnë qytetarët dhe të mos lëkundet afarizmi i bankave.

Pra, do të duhej vlerësuar mundësinë e krijimit të sektorëve tjerë prodhues me theks të veçantë në bujqësi, nga se sektori me pjesëmarrje më të ulët në kredi vazhdon të jetë sektori i bujqësisë me vetëm 4% të gjithsej kredive për ndërmarrje që do të ndikonin drejtpërdrejt në reduktimin e importeve dhe do të stimulonin eksportin, duke ndikuar në mënyrë direkte në përmirësimin e bilancit tregtar dhe në rritjen ekonomike.

Humbjet në Trustin, po ndodhin prapë. Vlera e humbjeve llogaritet 19 milionë euro, deputetë të nderuar, kështu që vlera e aksionit të Trustit aktualisht ka ra nga 0.97 që ka qenë në 1.1. As gjatë humbjes së parë e as tani, Banka Qendrore nuk zbatoi ligjin dhe atë sipas nenit 35.2 që ka për detyrë t'i japë këshilla Qeverisë, si dhe Kuvendit për çështjet të rëndësishme financiare që kanë të bëjnë me objektivat e Bankës Qendrore ose që janë në kuadër të kompetencave të tij.

Është e vërtetë se kjo vlerë është më e vogël se ajo mbi 100 milionë por fatkeqësisht për institucionet tona humbja e milionave është bërë imtësi, me të cilën ata nuk kanë kohë të merren dhe fundja ato janë të holla të popullit.

Dhe, në fund, që të arrijmë një sistem të qëndrueshëm bankar, duhet të ceket se infrastruktura ligjore për Bankën Qendrore duhet të kompletohet duke marrë parasysh ligjin për bankat komerciale, Ligjin për sigurimet, Ligjin mbi letrat në vlerë, Ligjin për raportimet financiare si dhe legjislacioni tjetër që e rregullon fushën financiare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, e ka fjalën deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Përsëhendesim juve dhe stafin që e ke afër, se këta tjerët, faqja e bardhë – këmbët e lehta, askënd s’po e shoh tjetër.

Ne, “7+” e kemi vendosur që në parim ta përkrahim këtë raport për Bankën Qendrore të Kosovës, ashtu që në leximin e dytë ndoshta do të përmirësojmë diçka.

Dhe, krejt myslimanëve që e festojnë Fitër Bajramin në Parlament dhe jashtë Parlamentit, krejt Kosovës, haxhi Merxha ua bën për hair Bajramin!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Slllobodan Petroviq e ka fjalën.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, predsedavajući!

Uvažene kolege i kolegince, narodni poslanici,

Imajući u vidu preporuku dweju komisija, Poslanička Grupa Samostalne liberalne stranke podržava ovaj izveštaj u celini.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar për integrim, Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Ponovo je pred nama jako važan izveštaj Centralne banke. I povodom ovog izveštaja mi smo ovaj izveštaj pažljivo razmatrali. Povodom ovog izveštaja imala bih puno da kažem nešto korisno za nas ovde u Skupštini i u opšte za sve institucije i građane Kosova. Moram da kažem da je izveštaj tehnički jako slab, informativno jako lab, tako da milo mi je da su se dve komisije funkcionalne pobrinule da daju namenske preporuke i više je red jednom, i više je jednom red zauvek, kolege, kada ovo pričamo da se međusobno slušamo i poštujemo.

Jedno što je jako bitno, jeste da mora Centralna banka, kada je kao autoritet ovde na Kosovu jedna vodeća institucija koju je ova Skupština imenovala i da ta institucija zajedno sa svima ovde na Kosovu shvati da mora da se reguliše bankarski sistem. Znači, da bi se to regulisalo, ja nisam prepoznala u ovom izveštaju da je Centralna banka dala sebi domaći zadatak da kroz posmatranje same sebe posmatra i sve ekonomske izvršioce, subjekte na Kosovu. Prvo, normalno, što mora da bude i što je ovo zakasnelo ovde, kada je u pitanju Fond za penzijsko i invalidsko osiguranje koji je najveći po irnosu, i Fond za privatizaciju, gde uvek imamo informaciju da su ti fondovi u inostranstvu i vidimo da ti fondovi gube u ekvivalentu svoje sume koju su dali na čuvanje, da kažem, ili na obrt ili na oplodjenje. Međutim, vidimo da ti fondovi gube i da mi od toga na Kosovu ništa ne dobijamo.

Jedan primer ću da dam kako je u Sloveniji rešen Fond za privatizaciju. Napravljen je Fond za razvoj u samoj zemlji i imamo primer kako se Slovenija razvila i kako je sačuvala svoja preduzeća i danas je posle 20 godina Gorenje ponovo prisutno kod nas.

Ja ovaj primer dajem praktično da bi bio razuman za građane i za nas, normalno. Mi smo pročitali i znam da je svestan svako od nas poslanika šta se dešava. Mora da se reguliše bankarski sistem, ne mogu poslovne banke ovde da uzimaju para koliko hoće, da oni obrću kamate a da se zadužuju sa nekom malom kamatom i ne može, mora da se reguliše, postoje pravila – od do, kada su kamate u pitanju. Ne kažem interes, kažem kamate, da bi bilo opet jasno svima.

Sa najvećim kamatama, sa najvećim interesnim kamatama se ovde radi i da se banke prepoznaju i da plaćaju. To su poslovne banke koje ne daju bez kamate sledećem klijentu da one plaćaju i doprinos i dohodak i proviziju za postojanje, sve ostale obaveze koje imaju sve banke u svetu.

Drugo što bih htela da kažem, naročito da se pobrinemo, čak da napravimo mi kao Skupština u svojim komisijama ili u parlamentarnim grupama da se pokrene pitanje imovine, kao što su dva fonda, i da jednostavno stavimo, da kažem, pod nadzor ove Skupštine Fond o penzijskom i invalidskom osiguranju i Fond o privatizaciji. Da znamo gde je taj fond, gde se nalazi, ko radi sa tim fondom, koje su provizije i da li se taj fond ulaže na Kosovu, što sumnjamo, u građevinarstvu, gde se oplođuju pare, gde idu, građani moraju da znaju, mi poslanici prvo moramo da znamo, da budemo i da imamo svoju političku volju i političku moć da ove pritisnemo i zajedno sa međunarodnom zajednicom, gde ne sumnjam da nećemo da dobijamo pomoć, i jednom zauvek rešimo ove stvari.

Evo, Centralna banka se nije bavila sa ovim. Mi znamo, po zakonu, od ukupnog budžeta Centralna banka treba da ima od 25 do 35% gotovine, svaka država, a ostali fondovi su za oplodnju i razvoj ekonomije, socijalne strukture zemlje, razvoja društva, kulture i sve. I ove segmente, i ove fondove moramo da stvaramo, a Centralna banka treba da je, ja kažem, saobraćajac u ovome.

Nažalost, mi je ne prepoznavamo danas kao takvu i mi smo zabrinuti i sa izveštajem nismo zadovoljni i ne možemo ga podržati. Hvala na pažnji!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë dëshiroj të mbështes atë që e tha zoti Haki Shatri, që është me të vërtetë e pakuptimtë që të shqyrtohet raporti sot. Në fund të fundit, kujt po i flasim. Njeriu i cili duhet të jetë këtu, sipas ligjit, dhe t'u përgjigjet shqetësimeve tona, guvernatori i Bankës nuk është për shkak të zhvillimeve që opinioni e di, domethënë arrestimi i guvernatorit, kurse me ligj kërkohet që ai t'ia paraqet raportin njëvjeter Kuvendit.

Tjetra, jemi në muajin shtator dhe po shqyrtojmë Raportin e vitit 2009. Është dashur raporti të shqyrtohet në maj të këtij viti, atëherë kur vetë përgjegjësit e Bankës Qendrore të Kosovës kanë mbajtur konferencë për shtyp lidhur me raportin, pa u proceduar paraprakisht në Kuvend.

Dhe, arsyeja e tretë pse sot jo vetëm që nuk mund të shqyrtohet, por nuk bën të aprovohet, është se nuk përmbushen kërkesat ligjore që i parashtron Ligji për Bankën Qendrore të Kosovës dhe unë po i përmendi vetëm disa.

Do të thotë, e para është se nuk ka asnjë analizë makro-ekonomike dhe zhvillim të tregut financiar.

E dyta, është se nuk raportohet aspak për zhvillimet e politikave ose rishikimin e atyre politikave dhe shpjegimin se çfarë politika do të bëjnë në të ardhmen, sa kanë përmbushur objektivat e veta dhe çfarë do të bëjë Banka në të ardhmen sa i përket aspektit ekonomik.

Një kërkesë me rëndësi ligjore për Kuvendin që duhet ta bëjë Banka, janë udhëzimet të cilat duhet t'ia japë edhe Qeverisë, edhe Kuvendit. Nuk i plotëson të gjitha këto.

E dyta, shqetësimeve të qytetarëve të Kosovës kush duhet t'u përgjigjet? Për shembull, 451 milionë nga privatizimi, sa është kamata prej tyre, ku janë investuar, pse nuk e ka mbikëqyr Banka Qendrore

Fondin Pensional meqenëse, sipas ligjit, është institucion i cili bën mbikëqyrjen edhe të këtij fondi dhe nuk ka intervenuar edhe pse, sipas ligjit, si agjent fiskal i Qeverisë është dashur të intervenojë, e humbjet janë shumë të mëdha për qytetarët e Kosovës.

E mora fjalën për një arsye të vetme që deputetët të jenë të vetëdijshëm se në qoftë jo vetëm e shqyrtojnë, por nëse e aprovojnë këtë raport, është një gabim i madh dhe është me të vërtetë shkelje ligjore, e pakuptimtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Rexhep Hoti.

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Është një përgjegjësi e veçantë t'i përkushtohet një analizë raportit vjetor të Bankës Qendrore të Kosovës, si njëra ndër shtyllat boshtore në fushën e tregut të institucioneve financiare.

Meqenëse koha është zvogëluar, unë do të përpiqem ta shkurtoj, dhe vetëm në disa pika do të ndalem në vërejtje.

1. Njëra ndër detyrat kryesore të BQK-ës është socifikuar me ligj për themelimin e saj, neni 6, i cili thotë... Domethënë, Banka do t'i rekomandojë udhëzimet e gjera politike Kuvendit dhe Qeverisë në fushat që i ka në përgjithësi. Jam person që me profesion i përcjell informacionet dhe nuk kujtoj ndonjë ngjarje ku menaxhmenti i BQK-ës i ka ofruar këtij Kuvendi apo Qeverisë, institucioneve edhe rekomandime lidhur me kompetencat që i ka në përgjithësi.

Ne jemi shtet i ri në ndërtim dhe institucionet dhe rekomandimet profesionale janë fundamentale.

2. Nga raporti vjetor nuk është vështirë të kuptohet që shifrat, faktet, argumentet e ofruara mbi rrjedhën makro-ekonomike të Kosovës dhe më gjerë, nuk janë të bazuara në hulumtimet dhe kërkimet e ndërmarra nga ekspertët e BQK-ës. Përveç një hulumtimi, origjinal të themi, i cili për atë që e ka lexuar është më tepër shkollor dhe akademik, vlera praktike e të cilit është shumë e vogël, ekspertët e BQK-ës nuk kanë bërë ndonjë hulumtim tjetër. Mungesa e institucioneve, përkushtimi për punën hulumtuese dhe kërkimore besohet se ka sjell që në skenë të kemi shumë pakë informacione e rekomandime për Qeverinë dhe Kuvendin.

3. Ekziston një pakënaqësi shumë e madhe e etniteteve të bizneseve në Kosovë lidhur me punën e bankave komerciale në Kosovë, veçanërisht lidhur me normat e larta të kamatës. Besohet se ka qenë dhe është detyrë e menaxhmentit të BQK-ës të japë sqarime opinionit të gjerë lidhur me shkaqet e ekzistimit të kamatave të larta në tregun financiar të Kosovës dhe besoj se është mungesë e iniciativave të këtij autori, pse në Kosovë nuk kemi një fond të posaçëm që do të kreditonte me kamata preferenciale sektorin më të rëndësishëm të ekonomisë së Kosovës siç është bujqësia. Është edhe në interes të Qeverisë së Kosovës edhe të këtij sektori të ekonomisë që bankat komerciale në vendin tonë të krijojnë një fond për rritjen e aftësisë konkurruese të fermerëve tanë në rajon.

4. Nuk është vështirë të konstatohet se strukturat udhëheqëse të BQK-ës janë struktura të mbyllura. Ekzistojnë fakte se drejtuesit kryesorë të departamenteve të Bankës janë zgjedhur pa konkurse të jashtme në bazë të preferencave dhe dëgjueshmërisë.

Për fund, ruajtja e stabilitetit financiar të Kosovës nuk është rezultat i punës dhe i menaxhimit të mirë të krerëve të këtij institucioni por si rezultat i mbylljes së ekonomisë së vendit.

Besoj që në Kosovë kemi shumë të ri të cilët kanë një qëndrim shumë modern mbi tregun financiar, duhet t'i jepet shansi atyre dhe nuk kemi kohë të provojmë mendësitë e vjetra në këtë sektor kaq të rëndësishëm që i mungon Kosovës. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit për fjalën e dhënë!

Sinqerisht me thënë, unë po e kam sot vështirë të diskutoj për një raport i cili është i nënshkruar prej guvernatorit i cili është në paraburgim, por gjithashtu edhe prej kryetarit të Bordit drejtues i cili publikisht deklaroi në një prej momenteve të tij gjatë paraqitjes publike se nuk është asgjë shqetësuese se është guvernatori në paraburgim.

Nëse nuk është shqetësuese se guvernatori është në paraburgim dhe ngriten dyshime të bazuara për korrupsion, e ndoshta edhe për krim të organizuar, atëherë dikush është në faj. Ose është prokuroria, cilado që të jetë, vendore apo ndërkombëtare e ULEX-it që e mban në paraburgim ose është fajtor ai që mbahet në paraburgim. Me fjalë të tjera gjendja nuk mund të tejkalohet, si gjendje pa fajtor. Sepse kjo mund t'i përngjajë si asaj gjendjes në vitin 2005 apo në 2006 kur kryetari i Kuvendit pati deponuar dosje në prokurorinë e UNMIK-ut për shumë prej fytyrave publike, ministra dhe asgjë s'u bë, asnjë fajtor nuk u duktë, kurrkush, të gjithë janë të pa faj.

Dhe vetë fakti që afrohet një raport për Bankën Qendrore të Kosovës nga edhe personi përgjegjës vendimmarrës i atij autoriteti, siç është me këtë rast guvernatori Hashim Rexhepi gjendet në paraburgim, s'e di çfarë kuptimi ka, se raportet janë drejtpërdrejt të lidhura me besimin që ti e ke ndaj të dhënave që e prezenton. Në momentin që humbet besimi, besimi është i lëkundshëm me këtë rast. Sepse, unë si deputet më janë ngritur dyshimet dhe janë ngritur edhe prej prokurorisë dyshimet, se është bërë atëherë automakisht i vërë në dyshim se edhe ky raport është manipulim i të dhënave.

Nuk mund të diskutohet për të dhëna statistikore por edhe të dhëna të natyrave tjera, të natyrës tjetër të dhënave ndoshta edhe përshkruese të cilat janë të përpunuara prej guvernatorit që është në paraburgim dhe kurrigjë, asgjë, si një farë qetësie. Normalisht, në gjendje normale, në një vend funksional demokratik me rastin kur guvernatori futet në paraburgim gjendja nuk mund të jetë status quo më. S'ka mundësi. Diçka do të duhej të lëvizë prej atij vendi.

Edhe në rast se formalisht, sepse tendencat që shpjegohen, është i fajshëm – i pafajshëm, dhe në rast se në kushte formale dhe juridike mund të jetë i pafajshëm, perceptioni i qytetarëve është sepse aty ka mosbesim. Dhe, të nderuar, besimi siç e dimë është kategori psikologjike. Beson apo nuk beson, por është elementi themelor i funksionimit të demokracisë, se së paku edhe demokracia funksionon mbi bazën e besimit. Dhe tash ne shqyrtojmë, lexojmë të dhëna prej njeriut që nuk ka besim, apo që e ka besimin e lëkundur.

Po e theksoj edhe një herë, po lexojmë të dhëna ndoshta që janë nënshkruar edhe prej kryetarit të Bordit drejtues Gazmend Luboteni që deklaroi publikisht se nuk ka asgjë shqetësuese që është guvernatori në paraburgim. Shih ti! Nëse s'ka shqetësuese asgjë që është guvernatori, çka mund të jetë shqetësuese atëherë. Dhe, po flasim, gjithashtu, për një raport i cili është nënshkruar prej një guvernatori të cilin Qeveria me një emër të vetëm e ka sjell në Kuvend të votohet. Dhe, pas përpjekjeve disa herë, që është refuzuar nga deputetët e këtij Kuvendi, filluan të vlonin korridoret dhe filloi një lëvizje që kryetarët e grupeve parlamentare dhe liderët e partive filluan të këmbëngulin në deputetë që ai të votohet. Me fjalë të tjera, kushdo që mund të sheh, mund të lexojë transkriptet e

asaj mbledhjeje. Mund t'i lexon ato transkripte dhe e sheh që me vështirësi është shtyrë, është shtyrë, është ardhur vetëm një emër, është shtyrë nga kryeministri i Kosovës, është shtyrë posaçërisht nga ministri i Financave dhe Ekonomisë që të bëhet guvernator. Sot, guvernatori në burg, ne i lexojmë raportin e njeriut të paraburgosur. Ju kisha lutur që të jemi më të vëmendshëm se këto elemente mund të jenë me dëme afatgjata, së paku në njëfarë kulture organizative dhe udhëheqëse të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka, i fundit, deputeti Driton Tali!

DRITON TALI: Faleminderit!

Të nderuar të pranishëm,

Për ata që e kanë lexuar këtë raport, nuk ndryshon nga stili i të shkruarit të raportit të mëtejshëm, e patëm pas vjetër kësaj vakti, e patëm pas kritikuar për shkak se është shkruar në atë stilin që të informojnë tepër, domethënë lexuesin ta lodhim me informata të panevojshme dhe ato të cilat i interesojnë opinionit, nuk na japin apo na i japin në atë mënyrë aq të fshehta që duhesh vërtet ta studiosh mirë dhe të jesh ekspert për ta kuptuar apo për të nxjerrë diçka pastaj.

Nga 100 faqe që është shkruar këtu, domethënë deri te faqe 87, merreni lexojeni, tregojnë për, bie fjala, për letra të guvernatorit, të Bordit të drejtorëve, ekonomia botërore, ekonomia e Evropës Juglindore, për të vazhduar: tregu i punës, domethënë informata të cilat i marrim në buxhet të Kosovës, në Entin Statistikor, madje edhe prej aty janë marrë. Pastaj kemi informata, sa kemi eksport-import, sa është rritur inflacioni, deflacioni, e tjera, e tjera. Nuk po them se nuk do të duhej të ishin këtu, por do të duhej të ishin të kufizuara dhe në mënyrë mirë të dhëna për profesionalistin dhe të jepen informata të cilat që sa e sa jemi kah i kërkojmë dhe, siç thonë, na doli goja pas veshi, e s'po na i tregon kurrkush: ku u po investohen paratë e Kosovës?

Një informatë, e kemi pasur sivejt, thuhet se 266 milionë euro të Kosovës janë investuar në letrat me vlerë. Profiti i atyre 266 milionëve është 3 milionë. Dhe, nëse shkojmë te faqe 87-88, te menaxhimi i mjeteve, pra aty ku na tregojnë se si menaxhohen mjetet, na shpjegojnë se paratë investohen të sigurt në bankat qendrore dhe ato investohen me interesin të cilin e jep banka gjegjëse. Askund në Evropë, në vitin 2008 nuk ka qenë norma mesatare ndër 3.75 apo 3.85%, dhe kur e llogarisim normën e fitimit të 266 milionëve të investuara jashtë del të jetë 1,2 %. Këtu dikush ka vjedhë. Unë jam i bindur se këtu Qeveria nuk kanë gisht, sepse s'dinë, se jo që e kishin me lënë për njerëzillëk, por dikush nga ndërkombëtarët. Se edhe këta tanët s'dinë. Se jo që e kishin me lënë për riza-ilah që thuhet.

Pastaj, unë po them, kthehemi te informatat të cilat na interesojnë neve. Kthehuni te faqe 43, nëse nuk gaboju. Na shpjegon për normat e interesit, që është një informatë që shumë i intereson, sidomos ekonomisë. Në marrtë vesh dikush këtu ...!? Janë statistika, numra të thjeshtë, pa domethënie.

Pastaj, po kthehemi te disa informata të cilat na i jep Banka Qendrore dhe krekoset. Ja, për shembull, me 30 qershor guvernatori, nja dy javë para se të hyjë në burg, na del dhe krejt i buzëqeshur, na thotë se, na paralajmëron krijimin e kushteve ligjore për krijimin e bankave investuese. Dhe, buzëqeshet! Në vend që t'i vijen keq, me qajtë! Qe sa e sa, s'mund ta kenë bërë një ligj për bankat investuese. Kjo është mjerim! Ky del e qeshë, ky zotëria!

Po, po, veç këqyreni në fotografi, i buzëqeshur është! Thotë, sikur njeri që po e zbulon Amerikën!

(Ndërhyrje)

Po, nja dy javë... Nuk e ka ditur që po shkon në burg. Pastaj, çka u bë? Asnjë informatë s'e kemi për Post-bankën e famshme. Deri në nëntor të vitit të kaluar, Qeveria 3 herë ka thënë se jemi të interesuar, po këtu asnjë fjalë s'e kemi. Jo zyrtarisht thuhet, se 3 bankat e huaja komerciale kanë bërë presion për mos tu krijuar post-banka, ama asnjë informatë në këtë raport nuk e kemi.

Po kthehemi te shpenzimet. Shihni, për 167 të punësuar, janë harxhuar, të paktën siç thuhet këtu, një shumë... Tash po e këqyri! Thotë, 2 milionë e 160.000 euro, që nëse i përpjesëtojmë këto, na dalin rroga mesatare 1.077 euro në muaj. Kurrë nuk na kanë treguar se sa e si është bërë gradimi atje. Apo, thotë, shpenzimet operationale dalin edhe më shumë: 1.827.000 euro, sepse i çojnë njerëzit nëpër treningje sepse i marrin miqtë, jo me kualifikime adekuate, duke pasur të ri sa të duash. Por i marrin ata jo me kualifikimet e duhura dhe pastaj normal se duhet me i dërgua në treningje....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj se nuk ka më të paraqitur për diskutim.

Vazhdojmë me votimin e Raportit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2009.

Në sallë janë 68 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Konstatoj se 26 vota janë “kundër”, 16 “abstenime”, 17 “për”, kështu që nuk miratohet raporti.

Kemi pikën e njëzetënjëtë të rendit të ditës. Grupi Parlamentar “7+” e ka tërhequr propozimin, prandaj konstatoj se seanca e sotme mori fund. Faleminderit për bashkëpunimin dhe kërkoj falje, nëse dikush është zemëruar, disi.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve